

INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI” - PRISHTINË
INSTITUTI I HISTORISË - TIRANË

SHQIPTARËT GJATË LUFTËS SË DYTË
BOTËRORE

(Përmbledhje studimesh)

Prishtinë, 2014

Redaktor përgjegjës i botimit:

Prof. assoc. dr. Sabit SYLA

Redaktor shkencor:

Akademik assoc. Marenglen VERLI

Redaktore gjuhësore:

Meliha BALLA

Shqipe DODA

Arti grafik:

Ma. Teuta SHALA - PELI

Konferenca shkencore

**“Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore”
(23 tetor 2013)**

Prishtinë, 2014

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE

Sabit SYLA - Fjala e hapjes

1. Beqir META

Shqiptarët në optikën e forcave politike greke gjatë Luftës së Dytë Botërore.....15

2. Hakif BAJRAMI

Programet serbe për likuidimin e shqiptarëve 1941-1945.....25

3. Muharrem DEZHGIU

Çështja kombëtare shqiptare dhe bashkëpunimi i LNÇ-së shqiptare e jugosllave gjatë Luftës së II Botërore..... 39

4. Ana LALAJ

Lufta Antifashiste - një debat i hapur Çështje të diskutueshme mbi Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare në Shqipëri.....47

5. Marenglen VERLI

Antifashizmi, alternativa e perspektivës për kombin shqiptar.....81

6. Izber HOTI

Disa aspekte të studimit të historisë së shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore.....95

7. Sabit SYLA

Qëndrimi i forcave politike dhe ushtarake të Shqipërisë ndaj Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore.....111

8. Fehmi REXHEPI

Lufta e shqiptarëve për vetëvendosje e bashkim kombëtar gjatë Luftës së Dytë Botërore.....135

9. Etleva BABAMETO

Rezistenca shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore në këndvështrimin e britanikëve.....151

10. Hamit KABA

Studime britanike për kufijtë shqiptaro-jugosllavë gjatë Luftës së Dytë Botërore.....161

11. Sabile KEÇMEZI - BASHA

Karakter i kombëtar i programit të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, 1943.....171

12. Ledia DUSHKU

Situata politike dhe shoqërore në Kosovë sipas raportit të Mazar Sopotit (12 nëntor - 9 dhjetor 1941).....191

13. Sonila BOÇI

Minoritetet në Shqipëri përballë sfidave të Luftës së Dytë Botërore.....201

14. Muhamet SHATRI

Çlirim apo ripushtim jugosllav i Kosovës dhe trojeve të tjera etnike më 1944.....217

15. Skënder ASANI

Zhvillimet politike në Shkup pas kapitullimit të Bullgarisë (shtator -nëntor 1944).....243

16. Etleva GOXHAI

Qëndrimi i Mbretit Zog ndaj pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste.....249

17. Qerim LITA

Situata politiko-ushtarake në trevat shqiptare lindore pas kapitullimit të Italisë.....261

18. Zeqirja REXHEPI

Tetova dhe rrethi i saj gjatë Luftës së Dytë Botërore.....281

19. Lush CULAJ

Vrasjet në Klinë e rrethinë në vitet 1944 – 1945.....297

20. Nebi DERVISHI

Rreth masakrës së Ladorishtit në vitet e Luftës së Dytë Botërore (28 tetor 1944).....309

21. Nuri DRAGOJ

Vështrim mbi Luftën Italo - Greke dhe pasojat që rrodhën prej saj në trevat jugore të Shqipërisë.....331

Beqir META

Fjala e mbylljes.....353

P A R A T H Ë N I E

Në nëntor të vitit 2013, Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë në bashkëpunim me Institutin e Historisë - Tiranë organizuan në Prishtinë: promovimin e veprave dhe revistave shkencore të këtyre dy institucioneve gjatë viteve 2012 - 2013, Konferencën shkencore “Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore”, si edhe një vizitë në Kompleksin memorial “Adem Jashari” në Prekaz. Mbajtja e këtyre aktiviteteve të përbashkëta dëshmon për një bashkëpunim të mirëfilltë në mes të dy instituteve shkencore, atij të Tiranës dhe Prishtinës, në fushën e dijes dhe shkencës në përgjithësi.

Konferenca i filloi punimet më 19 nëntor. Përmasat e ngjarjeve historike të Luftës së Dytë Botërore, emri i studiuesve të njohur që u paraqitën me kumtesa dhe këndvështrimi tematik i veçantë i Konferencës e përligjën interesimin e madh të pjesëmarrësve në këtë veprimtari e posaçërisht të mediave që e përcollën atë.

Organizatorët e Konferencës, duke vlerësuar cilësinë e kumtesave me risitë e sjella nga studiuesit, vendosën që t'i publikojnë frytet e punës së Konferencës në këtë vëllim të veçantë. Shpresojmë, që publiku vendas dhe i huaj, i interesuar për historinë e shqiptarëve gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore, do të gjejë informacione të reja e interpretime origjinale me interes, që do të ndihmojnë në thellimin e njohurive për mjaft çështje të rëndësishme të kësaj periudhe historike.

Sabit SYLA

Tetor, 2013

**Prof. assoc. dr. Sabit SYLA - U. d. Drejtor i Institutit të
Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë**

**FJALA E HAPJES NË KONFERENCËN SHKENCORE:
“SHQIPTARËT GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE”**

***Të nderuar zonja dhe zotërinj,
Të nderuar mysafirë dhe pjesëmarrës të kësaj Konference,
Të nderuar kolegë, studiues të historisë nga hapësira gjithë
shqiptare,***

Rasti i parë e solemn, që më jep mundësinë të ndodhem para jush për të thënë disa fjalë për hapjen e kësaj Konference, të organizuar në bashkëpunim me Institutin e Historisë në Tiranë, më emocionon e më bën të ndihem i nderuar. Andaj, kam kënaqësi dhe nder të veçantë që në emër të Këshillit Organizues të dy institucioneve tona shkencore, Institutit të Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë dhe Institutit të Historisë, Tiranë, t’ju përshëndes me përgëzimet dhe urimet më të sinqerta për pjesëmarrjen tuaj në Konferencën shkencore: “Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore”.

Të nderuar të pranishëm,

Ne, duhet të çmojmë lart rolin dhe kontributin e jashtëzakonshëm që duhet të kenë të dy institutet tona shkencore, për studimin e historisë së popullit shqiptar, nga lashtësia deri në

ditët e sotme, për përgatitjen dhe botimin e përmbledhjeve dokumentare, artikujve, monografive dhe organizimin e veprimtarive shkencore si: simpoziume, konferenca e tryeza të rrumbullakëta, që hedhin dritë mbi historinë e zhvillimeve politike e diplomatike, ekonomike-shoqërore e kulturore të historisë sonë kombëtare në shkallë ballkanike, evropiane dhe më gjerë.

Bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve tona, është një detyrë e rëndësishme, si një sferë e veçantë në zhvillimin e marrëdhënieve shkencore. Bashkëpunimi është shprehje e zgjerimit të dijes, mishërimit, ndihmës reciproke, ndikimit progresiv të përparimit kulturor e shoqëror dhe nevojë kohe shumë e domosdoshme. Orientimi i aktiviteteve të tilla për marrëdhënie të ndërsjella, është i dobishëm në veçanti, duke u zbatuar përmes projekteve të përbashkëta, në studime dhe kërkime shkencore e kulturore, në përvojë, planifikim, reformim. Në këtë rrafsh duhen, edhe platforma kombëtare afatshkurtra, afatmesme e afatgjata duke u bërë kështu edhe Piemonte të integriteteve të përbashkëta në planin arsimor, kulturor e shkencor.

Instituti i Historisë në Prishtinë, mbetet i angazhuar që kërkimit shkencor, t'i japë rolin që i takon. Ne, në këtë drejtim, i kemi vënë vetes për detyrë, që të vazhdojmë në të ardhmen të realizojmë një axhendë të ngjeshur aktiviteteve shkencore. Historia e një kombi, nuk mund të njihet, pa thesarin dhe trashëgiminë historike dhe vazhdimisht duhet ta rikthejmë kujtesën tonë të kaluarës. Ky vizion, të gjithë neve na jep kurajë dhe na nxit për angazhime edhe më të mëdha në informimin e brezave të ardhshëm, për historinë e së kaluarës që të përballen me sfidat zhvillimore në fushën shkencore në përputhje me kërkesat e reja të botës bashkëkohore.

Zonja dhe zotërinj,

Në këtë Konferencë do të zhvillohet një veprimtari e shumanshme shkencore. Në 2 sesione do të lexohen 23 kumtesa nga studiues të njohur nga hapësira shqiptare. Kumtesat nga fusha e historisë shkruhen për t'i sjellë të vërtetat e periudhave të

ndryshme, për të cilat, historianët u referohen fakteve dhe dëshmive historike dhe paraprkisht vlerësojmë se, kumtesat që sot do të lexohen, janë të këtij niveli shkencor. Ndaj me të drejtë presim që edhe debatet e frytshme të jenë shtysë hulumtimesh e gjurmimesh duke sjellë rezultate të reja shkencore, të cilat, pa dyshim, do t'i shpien përpara studimet në fushën e historiografisë shqiptare e më gjerë.

Në Konferencë, marrin pjesë në veçanti studiuesit e fushës përkatëse, andaj, mbajtja e saj, ka një rëndësi të veçantë jo vetëm për dy institutet tona, si institucione të larta shkencore dhe si organizatorë të saj, por edhe për studimet historike në përgjithësi. Konferenca, si aktivitet shkencor i hapësirës sonë mbarëshqiptare, jep njëkohësisht një kontribut të çmuar për begatimin e studimeve historike në hapësirën tonë. Ajo sjell rezultatet e hulumtimeve të realizuara nga emra të dëgjuar të historiografisë shqiptare, që do të hedhin dritë mbi shumë çështje të rëndësishme, që lidhen me të kaluarën e këtyre trevave, mbi çështje të panjohura e të pastudiuara sa duhet, duke e begatuar me prurje të reja dijen historiografike shkencore.

Zonja dhe zotërinj,

Në fund, duke ju dëshiruar punë të mbarë e të frytshme dhe qëndrim të këndshëm në ambientet e Institutit Albanologjik, i shpall të hapura punimet e Konferencës shkencore “Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore”.

Ju faleminderit!

Akademik Beqir META
(Tiranë)

SHQIPTARËT NË OPTIKËN E FORCAVE POLITIKE GREKE GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Forcat politike greke mbajtën qëndrime të veçanta ndaj çështjes shqiptare, të cilat herë ishin konvergjente, herë ndryshonin nga njëra tjetra në dimensione të ndryshme. Në këtë referat do të përqendrohemi kryesisht në qëndrimet e forcave të djathta greke për arsyen e thjeshtë se gjatë kësaj periudhe ato ishin në qeveri qoftë brenda vendit, qoftë në ekzil.

Forcat e djathta në qeveri e kaluan në heshtje agresionin fashist italian kundër fqinjit të tyre verior, Shqipërisë. Madje, me gjithë shqetësimin se agresioni italian do të drejtohej edhe kundër Greqisë, qeveria greke nuk ngurroi të shprehej edhe me tone mirëkuptimi dhe kënaqësie se, pas këtij akti, “një epokë e re për zemërsie dhe bashkëpunimi paqësor” po fillonte midis dy vendeve.¹

Qeveria greke ndaloi çdo veprim politik antiitalian të Mbretit Zog gjatë qëndrimit të tij në Greqi, dhe Musolini e falënderoi personalisht Metaksas-in për masat që kishte marrë për

¹ *The Greek White Book*, botim i qeverisë greke në ekzil, London 1942, dok. nr. 28, f.30.

të penguar manifestimet e Zogut gjatë qëndrimit të tij të shkurtër në Greqi.

Një akt tjetër antishqiptar i forcave të djathta greke ishte internimi dhe poshtërimi masiv i meshkujve të Çamërisë në prag të agresionit italian kundër Greqisë.

Forcat qeveritare greke, pasi thyen sulmin italian u hodhën në kundërsulm dhe pushtuan Shqipërinë e Jugut gjatë periudhës 22 nëntor - 8 dhjetor 1940. Ato demonstuan hapur armiqësinë ndaj pavarësisë dhe institucioneve kombëtare shqiptare. Ushtria greke në trevën e pushtuar shkatërroi sistematikisht kishat ortodokse shqiptare, në shenjë hakmarrjeje për progresin që kishte arritur Kisha Ortodokse Autoqefale shqiptare (KOASH) gjatë viteve '20 - '30, si edhe xhamitë dhe teqetë.² Shqiptarët që dezertuan nga formacionet e ushtrisë italiane u mbajtën në kampe përqendrimi dhe u trajtuan si robër lufte. Ata u liruan vetëm në verën e vitit 1941, pas pushtimit të Greqisë prej gjermanëve.

Pasi pushtoi Shqipërinë e Jugut, qeveria e djathtë greke u kërkoi gjermanëve që të ndërmjetësonin një armëpushim me Italinë, që ajo të lejohej të mbante të okupuara territoret shqiptare, duke premtuar se nëse arrihej kjo, Athina do të braktiste aleancën me Britaninë e Madhe.³

Me synimin për të mbajtur shqiptarët në anën e kundërt të barrikadës, qeveria greke refuzoi me vendosmëri ofertat e tyre për luftë të përbashkët kundër pushtuesve italianë, pas sulmit italian mbi Greqinë dhe gjatë gjithë periudhës së Luftës së Dytë Botërore. Ajo refuzoi qoftë ofertat e qeverisë legjitime shqiptare në ekzil, që drejtohej nga A. Zogu⁴; ashtu dhe ofertat e nacionalistëve

² Arkivi i Zyrës Historike të Shtabit Madhor të ushtrisë italiane (AUSSMEI), Raccogl.23, fasc. 8. Relacion i Komandës së Korparmatës IV dërguar Zyrës Informative të Armatës XI, mbi dëmet e shkaktuara nga ushtria greke në tempujt e kultit fetar në Korçë, 30 qershor 1941.

³ J.S. Koliopoulos, *Greece and the British Connection, 1935-1941*, Oxford, 1977, f.189.

⁴ *British National Archives*, Foreign Office Records (FO), FO 371/24868,

shqiptarë brenda vendit. Agjentët britanikë që vepronin në terren konstatonin se shifat e ushtrisë greke dëshironin ta aneksonin rajonin dhe po bënë gjithçka që të pengonin përpjekjet britanike për të nxitur rezistencën e shqiptarëve kundër italianëve.⁵

Ky qëndrim konsistent negativ pati ndikime të rëndësishme në marrëdhëniet shqiptaro-greke dhe në zhvillimet politike në Shqipëri. Kundërshtimi grek bëri që të humbasë një shans historik për bashkëpunimin greko-shqiptar, i cili do të kishte qenë shumë i çmueshëm në ndërtimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë pas luftës. Gjithashtu, presioni grek për mosnjohjen dhe mosmbështetjen e rezistencës antifashiste shqiptare ndikoi deri diku edhe në politikën e Britanisë së Madhe kundrejt çështjes shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe në dy vitet e para pas saj, ç'ka i solli dëme organizimit të rezistencës së popullit shqiptar dhe për më tepër interesave themelore të tij për njohjen dhe afirmimin ndërkombëtar të pavarësisë dhe sigurimin e territorit kombëtar.

Refuzimi për të bashkëpunuar me qeverinë e ligjshme shqiptare, pasojë e të cilit ishte tërheqja e britanikëve për ta angazhuar A. Zogun në planet e rezistencës antiitaliane, ndikoi ndjeshëm për minimin e përpjekjeve që po bënte ai me sukses për krijimin e një Fronti Kombëtar, duke bashkëpunuar me shumë prej ish-kundërshtarëve të tij të mëparshëm. Kështu, kundërshtimi aktiv grek jo vetëm që ndikoi në dobësimin e rezistencës shqiptare, por ishte një nga shkaqet që pengoi organizimin dhe unifikimin e saj, duke ndikuar në përçarjen dhe konfrontimet që do të vinin më pas.

Ndonëse qeveria greke u përpoq t'i maskonte qëndrimet e saj me mosbesimin dhe pakënaqësinë që ajo kishte ndaj A. Zogut, akuzat greke kundër tij ishin më tepër një pretekst për të përligjur

M.Palairt për FO, Athinë, 29 nëntor 1940.

⁵ Julian Amery, *Sons of the Eagle*, A study in Guerilla War, London, MacMilan and Co., 1948, f. 40.

qëndrimin negativ kundrejt pavarësisë dhe integritetit territorial të Shqipërisë. Këtë gjë e kuptuan atëherë dhe zyrtarët e Foreign Office (FO). Shefi i zyrës për Shqipërinë pohonte se “vërejtjet ndaj Zogut ishin vetëm një justifikim i synimeve të grekëve për të pushtuar Shqipërinë” dhe se ata shqetësoheshin se po të bashkëpunonin me Zogun, apo me një organizëm kombëtar drejtues të rezistencës shqiptare, “kjo do t’i angazhonte grekët që të pranonin rimëkëmbjen e pavarësisë së Shqipërisë pas luftës”.⁶ Madje britanikët pohonin se grekët kishin shkuar shumë larg. Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë greke njoftoi përfaqësuesin britanik në Athinë se kundërshtonte organizimin e një kryengritjeje të përgjithshme në Shqipëri, dhe se i vetmi veprim praktik i pranueshëm për të ishte lufta guerile në prapavijat italiane.⁷ Dukej qartë se grekët donin ta mbanin lëvizjen e rezistencës shqiptare në nivelin e grupeve të vogla dhe të fraksioneve pa lidhje me njëri-tjetrin, pra që ata të ishin, më së paku, të paefektshme dhe të paafta për të organizuar një rezistencë kundër pushtimit grek në të ardhmen e afërt dhe të mos dëlnin si një autoritet kombëtar në arenën e brendshme dhe atë ndërkombëtare.

Kryesisht për shkak të kundërshtimeve greke, qeveria britanike nuk e lejoi angazhimin e A. Zogut dhe të qeverisë legjitime shqiptare në organizimin e rezistencës dhe bllokoi njohjen e saj ndërkombëtare si qeveri në ekzil e një vendi të pushtuar nga fashistët. Kundërshtimi grek bëri që Londra të detyrohej të zgjidhte midis nacionalizmit grek dhe atij shqiptar. Duke parë interesat e saj politike e ushtarake, ajo zgjodhi të parin në kurriz të të dytit. Këtë qëndrim e shprehte qartë shefi i Departamentit të Jugut në FO, P. Nichols, i cili pohonte: “është e

⁶ Arben Puto, *Nëpër analet e diplomacisë angleze*, Tiranë, 1976, f. 54; FO 371/24867, Shënim i Pearson Dixon, 26 nëntor 1940.

⁷ B.J. Fischer, *Albania and the Italian invasion*, f. 100; FO. 371/24868, Sër Palairret për FO, Athinë, 25 shkurt 1941.

drejtë që për momentin ne nuk duam ta përdorim nacionalizmin shqiptar kundër italianëve dhe është krejtësisht e mundur që ne asnjëherë nuk do të duam ta bëjmë këtë gjë”⁸. Po kështu edhe më vonë, në vitin 1942, Sekretari i Jashtëm britanik Anthoni Eden pohoi hapur dhe prerë: “Shqiptarët nuk janë aleatët tonë prandaj nuk mund të kërkojnë që ne t’i trajtojmë si të tillë. Ndërsa, grekët dhe jugosllavët janë aleatët tonë dhe ne duhet të marrim parasysh interesat e tyre kundrejt Shqipërisë”⁹. Ky pozicion mbeti i pandryshuar deri në fund të luftës pavarësisht nga rritja e rezistencës antifashiste në Shqipëri.

Kur trupat greke hynë në Shqipërinë e Jugut e deklaruan atë si një “territor grek” të çliruar duke shfaqur hapur synimet pushtuese dhe duke alarmuar nationalistët dhe popullsinë shqiptare. Por grekët nuk u mjaftuan me deklaratat politike, ata qysh në këtë moment filluan përpjekjet diplomatike për të realizuar aneksimin e Shqipërisë së Jugut pas luftës. Ata zhvilluan bisedime me anëtarët e qeverisë jugosllave gjatë dhjetorit të vitit 1940, duke alarmuar edhe Beogradin në këtë situatë tepër kritike.¹⁰

Akoma më tragji - komike ishte qëndrimi i qeverisë greke në momentin e sulmit gjerman kundër Greqisë, në prill të vitit 1941. Duke dashur që kapitullimi ta gjente ushtrinë greke në Shqipërinë e Jugut, Shtabi i saj nuk pranoi të tërhiqte 14 divizionet greke nga Shqipëria dhe t’i bashkonte ato me forcat britanike, të cilat po i rezistonin sulmit gjerman në vijën Aliakmon. Këtu duhet theksuar se në këtë kohë e gjithë ushtria greke, me përjashtim të tri divizioneve, ishte përqendruar në frontin shqiptar. Në këtë mënyrë ai vuri në rrezik asgjësimin fatal të forcave britanike, që ndodheshin në Greqi për ta ndihmuar në rezistencën kundër

⁸ FO 371/24866, Shënime të P.Nichols, 27 qershor 1940.

⁹ FO 371/37137. Letër e Edenit për anëtarët e Dhomës së Komuneve, L.Hore – Beliska, 2 tetor 1943.

¹⁰ FO 371/24866, Telegram i Campbell (Beograd) për FO, 31 dhjetor 1941.

gjermanëve. Tërheqja e forcave nga Shqipëria erdhi shumë vonë, pas presioneve të forta britanike. Domethënia e këtij veprimi absurd ishte e qartë: Ushtria greke donte një kapitullim të shpejtë dhe “të ndershëm” tek gjermanët për të ruajtur avantazhin politik që kishte krijuar nga lufta kundër italianëve. Pjesa themelore e këtij synimi ishte tërësisht politike: ushtria greke nuk donte të paragjykonte pozitën e saj si fituese e luftës kundër italianëve pasi e vlerësonte këtë si një aset dhe përfitim ligjor e politik për pretendimet e saj territoriale.

Një çështje shumë interesante është metamorfoza e elitës politike nacionaliste greke pas pushtimit gjerman. Një pjesë e tyre u bënë kuislingë. Por, edhe pjesa tjetër e tyre, që ishte shumica, megjithëse u treguan aq të mençur sa të mos bashkëpunonin hapur me qeverinë kuislinge greke dhe me gjermanët, futën pasuesit e tyre në administratën kuislinge dhe bënë shumë pak për të luftuar Boshtin. Kështu vepruan venizelistët dhe metaksistët, që ishin dy grupimet më të mëdha politike të djathta. Tek të gjithë këta politikanë, nacionalizmi dhe aspiratat nacionaliste (duke përfshirë edhe aneksimin e Shqipërisë së Jugut) ishin primare dhe përcaktuese kundrejt rezistencës dhe luftës kundër gjermanëve.

Kështu menjëherë pas pushtimit të Greqisë nga gjermanët, qeveria greke në mërgim filloi të formulojë dhe të shpallë hapur synimet e saj territoriale kundrejt Shqipërisë. Këto synime u artikuluan zyrtarisht në memorandumin e 29 shtatorit 1941 dërguar qeverisë britanike ku paraqiteshin “argumentet” e saj për aneksimin e “Vorio Epirit”.¹¹ Më tej, qeveria dhe forcat nacionaliste greke i shtuan përpjekjet politike e diplomatike për realizimin e këtij objekti. Presioni grek ndikoi në formulimin e deklaratës britanike të 17 dhjetorit 1942 për pavarësinë e Shqipërisë, në të cilën thuhej se kufijtë e Shqipërisë do të diskutoheshin pas lufte.

¹¹ FO 371/19715, Përkujtesë e qeverisë greke dërguar qeverisë britanike, 29 shtator 1941.

Kjo politikë mbeti konstante deri në fundin e luftës dhe vijoi edhe pas saj. Qeveria greke bëri një propagandë politike të ethshme për diskreditimin e luftës antifashiste të shqiptarëve para Aleatëve dhe opinionit të tyre publik.

Ndërsa, më 10 nëntor 1944, në prag të çlirimit të Shqipërisë, qeveria greke i kërkoi zyrtarisht qeverisë së SHBA, që Shqipëria të konsiderohej e të trajtohej si një shtet armik dhe që trupat greke të merrnin pjesë në pushtimin e saj deri në lumin Shkumbin.¹²

Duke pasur në qendër të politikës së tyre aneksimin e Shqipërisë së Jugut, forcat nacionaliste greke në pranverën e vitit 1944 hodhën poshtë edhe disa propozime të reja të forcave nacionaliste shqiptare për një bashkëpunim në luftën kundër pushtuesit dhe në betejën e ardhshme kundër rrezikut sllavo - komunist që u kanosej të dy kombeve.¹³

Midis forcave të djathta nacionaliste greke sigurisht duhet veçuar ushtria republikane greke, ose ndryshe EDES-i, i komanduar nga Napolon Zerva, i cili kreu spastrimin e përgjakshëm etnik të shqiptarëve myslimanë të Çamërisë, temë tashmë e njohur dhe e trajtuar nga historiografia jonë postkomuniste. Profili politik i Zervës dhe ithtarëve të tij republikanë ishte thuajse i njëjtë me ato të partive dhe të grupeve të tjera të djathta greke. Ai ishte i interesuar kryesisht për pushtetin dhe jo për rezistencën kundër gjermanëve me të cilët, ndonëse kishte marrë ndihma nga britanikët, kishte një bashkëpunim të fshehtë, që studiues seriozë perëndimorë e kanë cilësuar si një bashkëpunim me “ujkun në errësirë”. Pas kërkesave dhe presioneve në rritje të britanikëve, ai pranoi me vështirësi që të angazhohej në luftë kundër gjermanëve vetëm në momentet e fundit të luftës, pikërisht në verën e vitit 1944. Por, edhe këtë e

¹² FO 371/43554, Dokument i Kabinetit të Luftës së SHBA përcjellë FO nga Departamenti i Shtetit, 10 nëntor 1944.

¹³ *Arkivi Qendror Shtetëror*, (më tej: AQSH), Fondi 14/AP, viti 1944, dos. 8, fl.2.

bëri duke i shkëputur Misionit Britanik dhe pikërisht kolonelit Wodhouse një koncesion tepër fitimprurës për realizimin e objektivit themelor dhe të kahershëm të nacionalizmit grek: pëlqimin e britanikëve për dëbimin e popullsisë shqiptare nga Çamëria me pretekstin se gjoja ajo do të pengonte veprimet luftarake të Zervës kundër gjermanëve. Këtë akt të rëndë gjenocidal e djathta greke do ta mbronte atëherë dhe më vonë me shumë vendosmëri ndërsa e majta komuniste do të përpiquej më vonë të përfitonte prej kësaj tragjedie të popullsisë shqiptare duke u përpjekur ta angazhonte atë në luftën civile në Greqi, pikërisht ashtu siç u përpoq Zerva ta angazhonte këtë popullsi në betejën kundër së majtës greke, pak kohë para se ai të ndërmernte spastrimin e përgjakshëm etnik të Çamërisë. Me gjithë dramën e madhe dhe presionin për shfarosje, që iu kërcënua shqiptarëve, duhet nënvizuar se ata nuk iu nënshtruan këtyre presioneve apo kurtheve.

Edhe e majta greke, ndonëse nuk artikuloi qëndrime aq ekstreme kundërt Shqipërisë dhe minoritetit shqiptar në Greqi, demonstroi qëndrime të qarta nacionaliste. E majta nuk tregoi interes të mjaftueshëm për përfshirjen e minoritetit shqiptar në luftën antifashiste dhe nuk u deklarua qartë për të ardhmen e tij pas luftës. Gjithashtu qëndrimi i saj nationalist u evidentua edhe në dy drejtime të tjera. Së pari, ajo pengoi të dërguarit e PKSH në Çamëri, që të zhvillonin një aktivitet politik efektiv për mobilizimin e popullsisë çame në luftën e përbashkët kundër gjermanëve dhe, së dyti, përfaqësuesit e saj në minoritetin grek në Shqipëri mbajtën qëndrime nacionaliste, duke nxitur ndjenjat separatiste të këtij minoriteti. Këto qëndrime sollën edhe fërkime reciproke midis dy partive komuniste dhe ndikuan negativisht në forcimin e rezistencës antifashiste.

Për sa i përket pretendimeve territoriale ndaj Shqipërisë, PKG ishte shumë më pak e zëshme se sa forcat e djathta, por edhe qëndrimet e saj kishin një profil të qartë shovinist. Për më tepër

PKG gjatë luftës miratoi një rezolutë me anën e së cilës kërkonte aneksimin e Shqipërisë së Jugut nga shteti grek.¹⁴

Vija nacionaliste e PKG do të evidentohet edhe më qartë menjëherë pas përfundimit të luftës. Kongresi i 7-të i PKG që u mbajt në fillim të tetorit 1945 vendosi: “Në qoftë se një shumicë demokratike favorizon pushtimin e menjëhershëm ushtarak të “Epirit të Veriut” nga ushtria greke, partia do të bëjë objeksionet e saj, por do të respektojë vendimin e shumicës”.¹⁵

Si përfundim mund të pohojmë se qëndrimi i forcave politike greke gjatë luftës, pavarësisht nga nuancat midis tyre, ishte nacionalist dhe me tipare të qarta shovene dhe antishqiptare. Ky qëndrim ishte faktori themelor që pengoi afrimin dypalësh, rezistencën antifashiste dhe i kontribuoi ruajtjes së tensionit deri në fund të luftës dhe pas saj.

¹⁴ AQSH, Fondi 14/AP, dos.31, Raport i mbajtur nga N. Zahariadhis në konferencën e PKG në Shqipëri.

¹⁵ Dominique Eudes, *The Kapetanios: Partisans and Civil War in Greece, 1943-1949*, Monthly Review Press, New York and London, 1972.

Prof. dr. Hakif BAJRAMI
(Prishtinë)

PROGRAMET SERBE PËR LIKUIDIMIN E
SHQIPTARËVE 1941-1945

Shqiptarët e Kosovës gjatë viteve 1941 - 1945 ishin të rreshtuar në tri grupacione politike. Në grupacionin e parë ishin rreshtuar personalitete të njohura si profashistë, në grupacionin e dytë ishin të rreshtuar disa intelektualë të shkolluar në Shqipëri, që u pozicionuan si prokominternistë dhe në grupacionin e tretë ishin të rreshtuar kryesisht disa personalitete nga shtresat e pasura dhe me autoritet të cilët prireshin nga Anglia. Në fund do të triumfonin prokominternistët e rreshtuar kah Koalicioni antihitlerian (SHBA, Anglia dhe BRSS). Këtë realitet, në luftën e drejtë për liri dhe pavarësi e objektivizon ky studim që mbështetet kryesisht në burimet arkivore të kohës.

Programet serbe për likuidimin e shqiptarëve 1941-1943

Programet serbe para Luftës së Dytë Botërore ishin bazë për programet që u paraqitën në rrethanat e luftës. Politika shtetërore dhe nacionale serbe gjatë viteve 1941-1945 kishte në dispozicion, për likuidimin e shqiptarëve, një arsenal programesh, që ishin krijuar më parë. Më 15 janar 1937 ishte themeluar “Klubi Kulturor Serb”, të cilin e drejtonte Slobodan Jovanoviqi. Klubi kishte organin e vet medial, “Srpski glas”. Deri në vitin 1941 nga ky klub dolën 11 (njëmbëdhjetë) programe për likuidimin e shqiptarëve. Këtij arsenali programesh (nga viti 1937), më 1938 do të shtohet Konventa Jugosllavo - Turke për depërtimin me dhunë të shqiptarëve nga Jugosllavia në Turqi. Të gjitha këto shërbenin si gjeneratori kryesor që do të shërbente autorëve çetniko - komunistë serbë më vonë, për të shkruar programe të tjera për likuidimin e shqiptarëve nga trojet e veta etnike. Më 1 janar 1939 fushatës antishqiptare do të bashkëngjitet me një Program (Elaborat) Ivo Abdriqi, nëpunës i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë Jugosllave përkatësisht kryediplomati jugosllav në Berlin, jo vetëm për likuidimin e shqiptarëve në Jugosllavi, por edhe për ndarjen e Shqipërisë në bashkëpunim me Italinë fashiste. Një shovinist tjetër që punonte në Ministrinë e Punëve të Jashtme, i quajtur Ivan Vukotiq do të përpilonte një Elaborat (Program) për okupimin e tërë Shqipërisë. Më tej do të pasonte Programi i J. Jankoviqit për mënyrën e vendosjes së pushtetit serb në Shqipërinë bregdetare. Kurse më 8 shkurt 1940 do të publikohet “Programi për kolonizimin dhe serbizimin definitiv të Kosovës”.

E përbashkët e të gjitha këtyre programeve, sidomos e Elaboratit të Vasa Çubrilloviciq, të 3 marsit 1937, ishte asgjësimi në masë i shqiptarëve, zgjedhja e gjenocidi si metodë, sikurse ishte vepruar ndaj shqiptarëve më 1878 në Toplicë, i cila kishte pasur sukses në politikën koloniale, shfarosëse ndaj shqiptarëve.

Etapa e parë e programeve çetnike për likuidimin e shqiptarëve 1941-1942

Dihet se më 6 - 17 prill 1941 Mbretëria Jugosllave kapitulloi para nazizmit gjerman në të gjitha nivelet. Shteti shumëkombësh u copëtua, kështu që për likuidimin e shqiptarëve, kuislingët serbë filluan një etapë të re në kushtet dhe rrethanat e reja. Politika e vjetër do të vazhdonte tani (1941-1945) me metoda që lejonin rrethanat e Luftës Botërore.

Program i përgjithshëm i çetnikëve i mbështetur në Konventën Jugosllavo - Turke të vitit 1938 Program i përvetësuar nga Kosta Peçanci për likuidimin e shqiptarëve më 6. VI. 1941.

1. Kolonizimi i viseve jugore

Numri i madh i popullsisë shqiptare e myslimane 480 000 shqiptarë (sipas të dhënave ushtarake më 1938 ishin 578 000 shqiptarë) e 138 000 myslimanë (ushtarakë 38 000) që jetojnë në pjesët tona jugore që janë okupuar pas luftërave ballkanike, paraqet një problem të rëndësishëm në aspektin nacional dhe strategjik. Pas mbarimit të Luftës Botërore kanë ekzistuar në këtë popullsi LËVIZJE spontane për shpërngulje në Turqi dhe në Shqipëri, por më vonë këto dukuri janë ndalur, për arsye se këto dy vende e kanë ndërprerë dhënien e vizave.

Çështja e kolonizimit të këtyre viseve me elementin tonë (sllave) nacional nga viset pasive është me interes ekonomik dhe ka lidhje të ngushtë me shpërnguljen e popullsisë myslimane që sigurohet me Konventë.

2. Puna më 1935 - 1937

Në shtator të vitit 1935 janë mbajtur disa konferenca ndërministrORE në Ministrinë tonë të Punëve të Jashtme, në të cilat është thënë se duhet përdorur të gjitha mjetet për ta ASGJASUAR propagandën shqiptare kundër shpërnguljes dhe se autoritet tona tatimore, financiare e arsimore, duhet të zbatojnë ndaj kësaj popullsie të gjitha dispozitat ligjore (si është shkollimi i detyrueshëm etj., kinse shqiptarët nuk e dëshironin shkollimin, por ai në gjuhën shqipe ishte vepër penale - HB) që në këtë mënyrë të detyrohen të shpërngulen.

Në vështirim të klauzolave të theksuara u janë dhënë urdhëresa organeve lokale në prill të vitit 1936, por tërë aksioni është dashur të pezullohet që në shtator të vitit 1936 për shkak të zgjimit nacional të popullsisë shqiptare. (Shqiptarët thanë: PO, shkollim i përgjithshëm në gjuhën shqipe. Pushteti tha JO - HB: shiko: Ministria e Arsimit në AJ. K. 1936 - Shkollimi i shqiptarëve, sekret nr. 21 - 36).

Organet agrare në ndërkohë bënë kolonizimin me popullsi nacionale (sllave - HB) në Serbinë Jugore, përmes metodave special duke marrë tokat e ashtuquajtura mera dhe tokat e të shpërngulurve shqiptarë e myslimanë. Këtë aksion e pengonin organet e pushtetit shqiptar e turk, duke mos u dhënë viza të shpërngulurve.

3. Bisedimet e mëhershme me Turqinë

Para disa viteve janë zhvilluar bisedime me Qeverinë turke për shpërnguljen e popullsisë së përmendur. Nga ana e Turqisë janë bërë përpjekje që të shtyhen këto bisedime, me arsyetim se mungojnë mjetet financiare për vendosjen e emigrantëve nga Jugosllavia e Rumunia. Nga ana e Turqisë theksohej atëherë se

Turqia me dëshirë do ta pranonte popullsinë shqiptare. Përafërsisht kështu përgjigjej edhe Qeveria shqiptare.

4. Shpërngulja e popullsisë turke prej vendeve të tjera ballkanike

Turqia në vitet e fundit, ka bërë përpjekje intensive që ta kolonizojë vendin e vet me popullsi myslimane prej vendeve ballkanike. Emigrimet e para kanë filluar me Konventën Greko-Turke (më 1923 me Konferencën e Llozanës mbi këmbimin e popullsisë - HB) për këmbimin e popullsisë së 30 janarit të vitit 1938 (kështu është në dok., por është fjala te viti 1923 - HB). Me këtë Konventë parashihet shpërngulja e obligueshme e grekëve nga Turqia dhe e turqve nga Greqia, me përjashtim nga Stambolli dhe Trakia Perëndimore. Kështu janë shpërngulur gati 1, 500 000 persona nga Turqia dhe Greqia.

Më 4 shtator 1938 Turqia e ka nënshkruar me Rumaninë Konventën për shpërnguljen e turqve nga Dobruxha në Turqi. Me këtë Konventë është paraparë shpërngulja shkallëzuese sipas zonave. Rumunia është obliguar të paguaj njëfarë dëmshpërblimi për hektar të tokës së braktisur të të shpërngulurve.

Më 1937 midis Bullgarisë e Turqisë është arritur marrëveshje për shpërnguljen e një pjese të popullsisë turke nga Bullgaria në Turqi.

5. Vendimet e Këshillit të Antantës Ballkanike Shkurt i vitit 1938

Në mbledhjen e Këshillit të Antantës Ballkanike në Ankara, më 25 - 27 shkurt 1938, ministri i atëhershëm turk i Punëve të Jashtme, Ruzhdi Aras, e shtroi çështjen e shpërnguljes së turqve prej vendeve ballkanike dhe propozoi që të formohej një komision i përbërë me nga dy përfaqësues jugosllavë, rumunë e

turq dhe një vëzhgues grek. Ky Komision do ta studionte këtë çështje dhe do të jepte propozime konkrete. Propozimi u pranua dhe u vendos që ky Komision të mbledhet në prill të vitit 1938.

5. Puna e Konferencës ndërministrore gjatë vitit 1938

Pas vendimit të Këshillit të Antantës Ballkanike, pranë Ministrisë Jugosllave të Punëve të Jashtme, më 6 mars, 13 prill, 30 maj e 15 e 16 qershor 1938, u mbajtën mbledhjet e Konferencës ndërministrore, e cila do të jepte për detyrë që t`i përgatisë materialet për projektin e Konventës dhe t`i përcaktonte parimet e përgjithshme.

Në këto mbledhje u vendos që të kishte përparësi shpërngulja e elementit FSHATAR, në mënyrë që të lirohen tokat për kolonizim. U diskutua për numrin e emigrantëve që mund të pranonte Turqia. U vendos që Turqisë t`i paguheshin maksimalisht nga 15 000 dinarë dëmshpërblim për person. Prej kësaj shume, 20% do të paguheshin në deviza të lira, kurse 80% në xhirollogarinë e Qeverisë turke në Bankën Kombëtare të Jugosllavisë për blerjen e mallit në Jugosllavi.

6. Bisedimet në Stamboll

Në bazë të vendimit të Këshillit të Antantës Ballkanike, Komisioni për shpërngulje u tubua në Stamboll më 9 qershor 1938 dhe deri më 13 korrik 1938 mbajti TETË (8) mbledhje. Mbledhjet i udhëhoqi delegati turk Hasan Saka. Delegatët tanë ishin: M. Ristiq, shef i Seksionit Ballkanik në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe V. Magovçeviq, inspektor në Ministrinë e Bujqësisë. Morën pjesë edhe përfaqësuesi rumun dhe vëzhguesi grek. Bisedimet midis përfaqësuesëve tanë dhe atyre turq u mbajtën në një komitet special redaktues, në të cilin nuk morën pjesë as rumunët e as grekët. Bisedimet ishin të gjata. Turqit insistonin

posaçërisht në çështjen financiare (dëmshpërblim), ndërsa për çështjet e tjera u treguan shumë të ndershëm. Me njëmbëdhjetë korrik 1938 përfunduan bisedimet dhe u përafua teksti i Konventës.

7. Përcaktimi kryesor i Konventës

Konventa përmban këto përcaktime kryesore:

1. Do të shpërngulen 40 000 familje myslimane fshatare nga rajonet e okupuara pas luftërave të viteve 1912 - 1913 e që arrijnë deri në 200 000 persona, sipas listave që do t'i përpilojë Komisioni jugosllav.
2. Konventa është e përpiluar ashtu që përfshin popullsinë shqiptare dhe atë turke (që flet nga pak turqisht në familje dhe për nevoja tregtare), megjithëse kjo nuk është theksuar në mënyrë ekskluzive.
3. Shpërngulja do të fillojë më 1 korrik 1939 dhe zgjatë gjashtë vjet. Në vitin e parë do të shpërngulen 4 000 familje, në vitin e dytë 6 000 familje, në vitin e tretë e të katërt nga 7 000 familje dhe në vitin e pestë dhe të gjashtë nga 8 000 familje.
4. Qeveria jugosllave do t'i paguaj Qeverisë turke nga 500 lira turke për çdo familje të shpërngulur, që do të thotë gjithsej 20 milionë lira turke. Pagesa do të bëhet për çdo gjysmë viti, më 1 prill dhe më 1 shtator të secilit vit. Nga kjo shumë 30% do të paguhet në deviza e 70% në formë plasimi në Bankën Kombëtare Jugosllave në llogari të Qeverisë turke, e cila me këto mjete do të blejë mall te ne.
5. Të gjitha pronat fshatare të familjeve të shpërngulura do t'i takojnë Qeverisë jugosllave, e cila do t'i përdorë për qëllime të kolonizimit.
6. Popullsia e qyteteve, e cila nuk u nënshtrohet dispozitave të Konventës, edhe më tej mund të shpërngulet lirisht, kurse për

popullsinë fshatare shpërngulja është e OBLIGUESHME për të gjithë ata që gjenden në listat e kolonizimit.

7. Qeveria jugosllave do ta bëjë transportimin FALAS të të shpërngulurve deri në Selanik, duke llogaritur se çdo familje ka të drejtë të transportojë, gjithashtu pa pagesë, 4 krerë kafshë të trasha dhe 10 krerë kafshë të imta.

8. Hyrja në fuqi e Konventës

Sipas dëshirës së delegacionit turk, Konventa do të duhej të nënshkruhej menjëherë pas redaktimit. Kjo megjithatë, nuk u bë dhe Konventa ende nuk është nënshkruar. Çështja e nënshkrimit tani është bërë aktuale dhe, nënshkrimi sipas dispozitave të Konventës do të duhej të bëhej më 1 korrik të këtij viti (1939). Ministria e Punëve të Jashtme, lidhur me këtë, u është drejtuar me pyetje ministrive të interesuara: Ministrisë së Bujqësisë e Ministrisë së Ushtrisë e të Marinës, të cilat janë pajtuar që të nënshkruhet Konventa, dhe Ministria e Financave, e cila ka bërë disa vërejtje, përkatësisht i ka theksuar disa obligime financiare nga Konventa. I ngarkuari me Punë i Qeverisë turke në Beograd ka deklaruar se Qeveria turke dëshiron ta nënshkruaj, ta ratifikojë dhe ta zbatojë Konventën. Sipas fjalëve të tij, nënshkrimi do të mund të bëhej në Beograd qoftë në Ankara.

1. Ratifikimi i Konventës

Është bërë çështje gjithashtu edhe procedura e ratifikimit të Konventës së nënshkruar. Nuk do të ishte mirë të shkohet sipas procedurës së rregullt të ratifikimit në Parlament. Kjo mënyrë do të PROVOKONTE diskutime të pakëndshme dhe Konventa do të kishte publicitet të theksuar. (Beogradi i druante internacionalizimit të çështjes sepse nuk ishte fjala fare për TURQ, po për shqiptarë që jetonin në fshatra. Fjala pra ishte me

ua grabitë pronat shqiptarëve e më i kolonizuar sikurse që kishte vepruar Serbia më 1878 në Toplicë. Ishte ky një spastrim gjenocidal shtetëror me implikime të paparapara ndërkombëtare, sepse Italia nuk e dëshironte një ndërmarrje të tillë - HB). Mënyra më e pranueshme e ratifikimit do të ishte (theksojnë zyrtarët serbë - HB) përmes një dekreti të Këshillit të Ministrave.

2. Organizimi dhe zbatimi i Konventës

Organizimi dhe zbatimi i kësaj Konvente kërkon punë, pasi të shpërngulen rreth 200 000 persona me një pjesë të pasurive të tundshme dhe të kafshëve të trasha e të imta të tyre. Zbatimi duhet të bëhet me sa më pak incidente e afëra, megjithëse besohet se do të ketë implikime të brendshme e të jashtme që zbatimi i Konventës të PENGOHET.

Për të gjitha këto arsye është e nevojshme që të ndërmerren sa më parë të gjitha masat e nevojshme që organizimi të jetë i mirë. Lidhur me këtë, do të ishte mirë të bëhet dhe të miratohet plani i cili do ta parashihet tërë organizimin dhe kompetencat e të gjitha organeve që duhet të angazhohen rreth zbatimit të Konventës, e të sigurohen edhe mjetet e nevojshme material për këtë. Nuk mjaftojnë vetëm idetë e artikuluar.

Konventa, me nenin XVIII, parasheh vetëm një komision special, të themeluar nga Qeveria jugosllave, i cili do t'i punojë listat vjetore të të shpërngulurve dhe do t'ua paraqesë përfaqësuesve turq për vërtetim.

Beograd, më 6 prill 1939. (Dokumenti gjendet në: DASIP. B. F. 31. D. II/9 - sekret dhe vetëm në frëngjishte).

Porosia për shfarosjen e shqiptarëve

Programin e parë për likuidimin e shqiptarëve në kushte të luftës e shkroi Kosta Peçanci më 6 VI 1941 me titull “Depërtimi në Kosovë”. Në Program në mes tjerash thuhet: “Kur të nisem në rrugën me fat, e di se çka mendon dhe çfarë planesh thur për jugun tonë. Besoj që në Sanxhak, në Dukagjin dhe në Fushë Kosovë nuk do të mbetet asnjë plis për farë. Lumenjtë Llapi, Sitnica dhe Ibri e Drini do të bartin dy muaj koka të shqiptarëve”. Këtë porosi Luba Novakoviqi ia dërgon Kosota Peçancit më 12. IX. 1941 pasi që e kishte lexuar Programin fashist të Dimitrije Lotiqit për “Likuidimin e Hebrenjve” nga viti 1939.

Programi i Stevan Moleviqit më 30. VI. 1941 për “Serbinë Homogjene”

Në fillim të qershorit me program origjinal për krijimin e Serbisë së Madhe do të paraqitet Stevan Moleviqi, një çetnik nga Nikshiqi. Në Programin e tij ai parashihte jo vetëm shfarosjen e shqiptarëve në Shqipërinë Kontinentale, por përfshinte edhe Shqipërinë Veriore bregdetare, duke synuar Shkodrën. Në programin e tij i vizatoi kufijtë e Serbisë, “shtet” ky që sipas tij duhet të ishte etnikisht i pastër.

Programi i Drazha Mihajloviqit për shfarosjen e shqiptarëve

Drazha Mihajloviq më 20. XII. 1941 do të përpiloi një program operacional për shkatërrimin e të gjithë “myslimanëve nga Ballkani” e ku do të ishin shqiptarët në rend të parë. Në pjesën ku bënte fjalë për operacione sistematike në teren Drazha Mihajloviq kërkonte nga vartësitë e tij që t’u përmbahen neneve të Konventës Jugosllavo - Turke për depërtimin e shqiptarëve në Anadoll. Me këtë program ai e njoftoi edhe Qeverinë mbretërore

jugosllave (serbe) në emigrim në shtator të vitit 1942. Në kërkesën e tij programore parashihej që të shfarosen shqiptarët në të gjitha lokalitetet e këtyre qendrave administrative: në Banovinën e Vardarit parashihej të shfarosen shqiptarët e Prizrenit, Dragashit, Suharekës, Tetovës, Gostivarit, Rostushës, Dibrës, Strugës, Prishtinës me Llap, Kaçanikut, Gjilanit, Preshevës, Prespës, Ohrit, Kërçovës, Krushevës, Poreçit, Manastirit, Shkupit, Kumanovës, Velesit, Shtipit, Koçanit, Raadovishtës, Strumicës, Dojranit, Gjevgjeliës, K. Palankës dhe Kratovës.

Në Banovinën e Zetës parashihej të shfarosen shqiptarët e Pejës, Istogut, Mitrovicës, Gjakovës, dhe Rahovecit.

Në Banovinën e Moravës parashihej të shfarosen shqiptarët e Llapit (Podujevës), Vushtrrisë dhe Drenicës. (Këtë porosi programore Drazha Mihajloviq e nxirrte nga NENI 2 i Konventës Jugosllavo - Turke për depërtimin e shqiptarëve në Anadoll).

Lidhur me këto programe për shfarosjen e shqiptarëve Qeveria mbretërore jugosllave debatoi tri herë, prill - maj 1943 për implementimin e Konventës me përfaqësuesit e Republikës së Turqisë. Kontaktet u mbajtën në Kajro të Egjiptit me propozimin e palës Turke. Në kontakte pala Turke kërkonte që t'i paguhen paratë e parapara nga Konventa për “shpronësimin e pronave shqiptare në Jugosllavi”.

Etapa e dytë

Etapa e Programeve Komunisto - Çetnike për shfarosjen e shqiptarëve 1943 – 1945

Programin e parë për t'i tradhtuar shqiptarët antifashistë do ta përpilonte Svetozar Vukmanoviq Tempo me emrin “NË DETYRËN POLITIKE” (“Na političkom zadatku” më 8 shkurt 1943). Svetozar V. Tempo do të hynte në trevat shqiptare më 8 shkurt 1943. Ai i kishte vënë vetes për detyrë, me sugjerime të

Millovan Gjillasit, që në rend të parë të paraqitet para udhëheqësve shqiptarë antifashistë si një person që ka pedigree ndërkombëtare - kominterniste. Ai nuk donte të dijë se Sejfullah Maleshova, Koço Tashko, Enver Hoxha, Ramadan Çitaku e të tjerë ishin shumë më të ngritur se ai. E vërtetë në Shqipëri ishin edhe dy malazezë që nuk ishin atje pa detyra të caktuara. Por, edhe ata (Miladini dhe D. Mugosha) ishin nxënës shumë të dobët në krahasim me drejtuesit politikë shqiptarë, të cekur më lartë. Këtë fakt e vërteton niveli i shkrimeve të kohës për secilin. Dokumentet flasin vet dhe ato kanë mbetë.

Nga letrat (edhe nga Programi: “Në detyrë politike”) vërehet pa asnjë dyshim qëllimi kriminal i Tempos. Për çka është fjala? Tempo i kishte dhënë veti për detyrë që ta përçajë udhëheqësinë politike dhe ushtarake antifashiste shqiptare dhe njëherit ta ndezë në tërë trevën shqiptare luftën civile (qytetare), vëllavrasëse. Lidhur me këtë, në Kosovë ai nuk ia arriti asnjë qëllimi dhe doli në Shqipërinë bregdetare me ambicie se atje do të plasoi çdo paragraf të programit të tij. Edhe atje do të hasë në kundërshtime dhe do të lexohet në mes rreshtave çdo sugjerim ideologjik, strategjik dhe politik i tij. Me këtë politikë S. V. Tempo do të ëndërrojë që shqiptarët t’i prezantoj pas mbarimit të turneut të tij si udhëheqës që e tolerojnë fashizmin dhe nuk janë në vijat e para të Luftës Antifashiste. Në këtë mënyrë ai ëndërronte se shqiptarët do të dënohen nga koalicioni antifashist. Por, jo vetëm në Shqipëri por edhe në Kosovë shqiptarët sidomos pas kapitullimit të Italisë (shtator 1943) do ta kuptojnë fare mirë se kah duhet përqendruar rreshtimin pa asnjë dilemë kah lufta frontale antifashiste. Kuptohet se ky rreshtim në Kosovë do të arrihet më me vështirësi, por fakti se në Shqipëri lufta antifashiste ishte shumë e fuqishme, ai rreshtim do të reflektohet edhe në Kosovë e kudo në viset etnike shqiptare. Kështu, historikisht “misioni” i Tempos duhet shikuar si përpjekje për tradhti ndaj një

populli fqinjë, por edhe si dështim i politikës koloniale jugosllave në ato rrethana.

BURIMET:

- Elaboratet e “Klubit Kulturor serb” në A. të Kosovës (fotokopje), në RSFJ, Sperski Kulturni Klub 1935-1938).
- Konventa Jugosllavo-Turke për shpërnguljen e shqiptarëve në Anadoll 1938 (gjenerator i të gjitha Programeve), në DASiPB, Poslanstvo Stambul, D. II/1939, s.pav.1938 - Konvencija.
- Elaborati i Ivo Andriqit, Për ndarjen e Shqipërisë 1939, në AIS. 37 Elaborat o Albaniji, I. Andris, 1939.
- Programi i Kosta Peçancit, Për asgjësimin e Arnautëve 1941, në AJ, Fund M.Nedic, 1941, K.8.
- Programi i Stevan Moleviqit, Për Serbinë homogjene 1941, në Arshiv Jugoslavije, Fond. M.Nadic, K.8.
- Programi i Drazha Mihajloviqit, Për asgjësimin e myslimanëve dhe Arnautëve në mënyrë selektive 1942, në: AJ, Fondi Milan Nedic, K.8, 1942.
- Elaborati I V. Qubrilloviqit , Për Likuidimin e shqiptarëve , 03. XI. 1944, në: AJ, sig.44, I.Cubulovic.
- Elaborati I V. Qubrilloviqit, Për asgjësimin e pakicave në Jugosllavi deri sa të zgjatë lufta, 5 janar 1945, në Arkiva Çetnike në A.J. godina 1945, I.Cubulovic.
- Programi për likuidimin e Arnautëve (aktualizim i Konventës Jugosllavo - Turke) 2 shtator 1945, Në AJ, Fondi i Milovan Gjilasit, viti 1945, K.5.

Prof. dr. Muharrem DEZHGIU
(Tiranë)

**ÇËSHTJA KOMBËTARE SHQIPTARE DHE
BASHKËPUNIMI I LNÇ-së SHQIPTARE E JUGOSLLAVE
GJATË LUFTËS SË II BOTËRORE**

Pozita e shqiptarëve, para dhe gjatë Luftës së II Botërore, përbën një veçori, që duhet marrë domosdoshmërisht në konsideratë, për trajtimin objektiv të qëndrimit të tyre ndaj saj. Lufta i gjeti shqiptarët në një situatë, kur nuk e kishin zgjidhur detyrën e çlirimit dhe bashkimit të tyre kombëtar.

Shqiptarët në trevat e tyre etnike, jashtë kufirit politik të Shqipërisë, de facto ishin nën sundimin dhe shtypjen e të huajve. Ndaj tyre ushtrohej një politikë e egër shkombëtarizuese e pastrimit etnik, duke u mohuar të drejtat kombëtare e shoqërore. Qëndresa dhe rezistenca e shqiptarëve, në ato treva, ishte fokusuar për ruajtjen e identitetit të tyre kombëtar.

Karakteri çlirimtar kombëtar i luftës dhe i qëndresës së shqiptarëve në trevat e tyre etnike mbeti tipar permanent përballë dhunës së sunduesve të huaj sllavë në Jugosllavi, apo grekë në Çamëri. Në këto rrethana kritike, të rrezikut për asgjësimin etnik, shqiptarët e këtyre trevave, objektivisht, ishin të gatshëm të bashkëpunonin me çdo faktor të brendshëm e të jashtëm mbështetës, për çlirimin kombëtar të tyre.

Historiografia shqiptare nuk e ka marrë në konsideratë aq sa duhet këtë rrethanë historike të pozitës së shqiptarëve në trevat jashtë kufijve politikë të Shqipërisë, për të bërë vlerësimin e qëndrimeve e të veprimeve të tyre në rrjedhën e kësaj lufte.

Pushtimi italian i Shqipërisë, në prill 1939, solli humbjen e pavarësisë së saj. Shqipërisë iu imponua organizimi i një lufte çlirimtare, për të rifituar pavarësinë e mëparshme.

Me fillimin e Luftës Botërore, lufta e shqiptarëve, pavarësisht se ku banonin në Shqipëri apo në trevat etnike jashtë saj, mori karakterin e luftës çlirimtare mbarëkombëtare shqiptare. Detyra e çlirimit kombëtar i vuri shqiptarët në një emërues të përbashkët, pavarësisht nëse pushtuesit dhe sunduesit ishin italianë, serbë apo grekë. Pra, ata ishin vënë përballë rrezikut të asgjësimit të shtetit kombëtar në Shqipëri të cilin kishin shpresën që ta kishin si shtet unik të tyre.

Pushtimi italo - gjerman i Jugosllavisë dhe i Greqisë në prill të vitit 1941, objektivisht solli ndryshime për pozitën e mëparshme të shqiptarëve në ato shtete. Bashkimi me Shqipërinë i Kosovës dhe i trevave të tjera, në kuadrin e ndarjes së zonave të pushtimit në Ballkan, ndryshoi pozitën sociale, ekonomike e politike të shqiptarëve. Për herë të parë, ata përjetuan bashkimin e tyre nën një administratë të përbashkët shqiptare. Situata është krejt ndryshe nga më parë, kur sundonte shteti jugosllav. Shqiptarët përjetuan, për herë të parë, fitoren e të drejtave kombëtare në fushën e arsimit e të kulturës, lidhjen ekonomike midis krahinave shqiptare, etj.

Fati i shqiptarëve, tashmë, do të varej jo vetëm nga rezultatet e Luftës Botërore, ku roli i tyre nuk përbënte një faktor përcaktues, por do të varej nga unifikimi i qëndrimit të tyre në luftën për çlirim kombëtar.

Përfshirja e shumicës së shqiptarëve në një njësi të përbashkët administrative (pavarësisht nga emërtimi Shqipëri e Madhe apo Shqipëri etnike), përbënte një premisë shumë të

rëndësishme historike, për të kanalizuar energjitë dhe përpjekjet e shqiptarëve në një objektiv të përbashkët - çlirimin kombëtar.

Bashkimi i Kosovës dhe i trevave të tjera shqiptare me Shqipërinë solli një frymëmarrje të thellë për Lëvizjen Kombëtare, që ushqeui me oksigjen ndërgjegjen e nacionalistëve shqiptarë me besimin se çlirimi dhe bashkimi kombëtar i shqiptarëve ishte jo vetëm ideal, por edhe një realitet i prekshëm. Përvoja 3 – vjeçare e bashkimit të shqiptarëve nën një administratë të përbashkët ushqeui për vite të tjera me radhë lëvizjen kombëtare. Ajo mbajti të ndezur luftën për çlirimin e bashkim të shqiptarëve.

Shprehës të kësaj aspirote të përbashkët të shqiptarëve, u bënë përgjithësisht forcat nacionaliste shqiptare. Në programet dhe në vijën politike të tyre artikulohej njësia e përbashkët kombëtare si ideal dhe si realitet. Me fjalë të tjera, ata shtrinin si qëllim përpjekjen e përbashkët të të gjithë shqiptarëve, për të konsoliduar atë realitet historik, të krijuar në rrjedhën e kësaj lufte (si rezultat i veprimit të faktorëve të jashtëm por, gjithsesi, në interes të shqiptarëve). Situata në të cilën u gjendën shqiptarët, kur shumica e tyre për herë të parë ishin të bashkuar, pavarësisht nga roli që mund të luanin në luftën botërore, u trajtua nga propaganda e pushtuesve të saj fashistë dhe u përjetua nga nacionalistët si arritje e cila shprehte, në një farë mase, korrigjim të padrejtësive të bëra më parë ndaj shqiptarëve.

Politika social - ekonomike “dorëlëshuar” e Italisë ndaj Shqipërisë, në vitet e para të pushtimit, vonoi veprimet e organizuara të qëndresës kundër pushtuesit. U deshën 3 vjet që në Shqipëri të ndjehej pesha e shfrytëzimit të pushtuesit dhe të kuptohej thelbi demagogjik i veprimeve diversive të tij.

Ndërsa, në tokat e “liruara”, shqiptarët e përjetuan praninë e italianëve si çlirim, në raport me gjendjen e rëndë diskriminuese gjatë sundimit sllav. Për rrjedhojë, nuk mund të pritej rezistencë e

menjëhershme e shqiptarëve kundër italianëve. Këta të fundit, vlerësoheshin nga shqiptarët përgjithësisht, si faktor i jashtëm në favorin e tyre, për t'i shpëtuar nga e keqja më e madhe, sundimi afro 30 vjeçar sllav. Kurse, për serbët lufta e qëndresa kundër italianëve konsiderohej si luftë për rivendosjen e sovranitetit të tyre shtetëror në Kosovë dhe për ushtrimin e shtypjes mbi shqiptarët. Pra, qëllimi i luftës së sllavëve nuk përputhej me atë të shqiptarëve, madje ishte krejt i kundërt.

Lëvizjet nacionalçlirimtare, që vepruan në Jugosllavi e Shqipëri ishin të drejtuara nga partitë komuniste. Nën etiketën e luftës kundër fashizmit, armikut të përbashkët, ato vendosën bashkëpunimin midis tyre. Bashkëpunimi i tyre mbi baza ideologjike ishte në thelb mbështetje e ndërsjelltë për ardhjen e komunistëve në pushtet. Tek ky bashkëpunim i Lëvizjeve Nacionalçlirimtare të dy vendeve, duhet të kërkohet edhe shkaku i minimi të unitetit kombëtar të shqiptarëve gjatë Luftës II Botërore.

Është e provuar tashmë, se, anulimi i Marrëveshjes së Mukjes ishte rezultat edhe i presionit dhe ndikimit të përfaqësuesve të PKJ në Shqipëri, tek PKSH. Duke prishur Marrëveshjen e Mukjes, PKJ realizonte dy objektiva kundrejt shqiptarëve i jepte mbështetje PKSH për të ardhur në pushtet që gjatë luftës. Ndërkohë, me këtë forcë politike (PKSH), mendonte se do të gjente gjuhën e përbashkët për Kosovën, për t'ia lënë përsëri Jugosllavisë. Por, mbi të gjitha, bashkëpunimi i lëvizjeve nacionalçlirimtare shqiptaro - jugosllave, unifikoi qëndrimin ndaj nacionalistëve shqiptarë, duke i cilësuar ato si forca "reaksionare", që minonin bashkëpunimin internacionalist të të dy vendeve. Një pozicionim i tillë i dy partive komuniste ndaj nacionalizmit shqiptar, u bë pengesa më e madhe e zgjidhjes së çështjes së çlirimit kombëtar të shqiptarëve.

Bashkëpunimi i lëvizjeve nacionalçlirimtare shqiptaro-jugosllave, në dëm të çështjes së çlirimit kombëtar të shqiptarëve, u shpalos, sidomos, në fund të Luftës Botërore, kur lufta në Kosovë bëhej kundër forcave atdhetare shqiptare që kundërshtonin ripushtimin e Kosovës nga ushtria jugosllave.

Thirrja e forcave të UNÇSH për ndihmë nga ana e Titos, në fundin e luftës, për “çlirimin e Jugosllavisë”, synonte që ato të luanin rolin e amortizatorit, në qetësimin e situatës. Në këtë mënyrë u lehtësonin punën forcave jugosllave, të shuanin me terror qëndresën mbarëpopullore kosovare. “Shtypja e revoltave u shndërrua në një kasaphanë të vërtetë, që synoi asgjësimin sistematik dhe të organizuar të popullit shqiptar. Nga të dhënat e dëshmitarëve të ngjarjeve dhe të dokumenteve të kohës del se, gjatë dimrit të vitit 1944 - 1945, në viset shqiptare në Jugosllavi, u asgjësuan rreth 40.000 veta”¹.

Nuk është e rastit që udhëheqja e LNÇJ, në javën e fundit të gushtit 1944, shpalli amnistinë për çetnikët. Të dy palët (partizanë e çetnikë) iu vërsulën Kosovës dhe trojeve etnike shqiptare me synimin që ta terrorizonin e gjunjëzonin gjithë elementin shqiptar. Elementët çetnikë serbë u inkuadruan në radhët e formacioneve të UNÇ të Jugosllavisë, pas nënshkrimit të marrëveshjes midis J.B.Titos dhe të J.Subashiçit. Dhuna ndaj shqiptarëve, menjëherë pas Luftës II Botërore, për nga përmasat, qëllimet, metodat e përdorura dhe propaganda që e ushqe, ishte e njëjlojtë me atë që u ushtrua mbi të në vitet e sundimit të dinastisë mbretërore të paraluftës².

Atdhetarët shqiptarë, që kanë vuajtur në burgjet e Jugosllavisë për kauzën e drejtë, për çlirim e bashkim kombëtar, e kanë vlerësuar kërkesën për ndihmë të UNÇSh si një dinakëri të madhe të Titos. Me këtë ndihmë, jugosllavët do t’i shpëtonin

¹ Lefter Nasi, *Ripushtimi i Kosovës*, Tiranë, 1994, f. 182.

² *Po aty*, f. 131.

kryengritjes mbarëpopullore të shqiptarëve të Kosovës, si dhe do t'i shpëtonin komprometimit para botës për gjenocid ndaj shqiptarëve. Pikërisht, në këtë moment të vështirë e delikat, Enver Hoxha i bëri një shërbim të madh Titos. Duke lëshuar në hapësirat e Kosovës thirrjen: “Shpërndahuni vllazën, se nuk luftojmë vllau me vllaun” brigadat partizane shqiptare luajtën rolin e zjarrfikësit dhe lehtësuan ushtrinë jugosllave për ripushtimin e Kosovës.

Është tepër dëshpëruese që të lexosh në dokumentet e kohës urdhër operacioni të brigadave të UNÇSH që, në bashkëpunim me forcat jugosllave, të luftonin për asgjësimin e shqiptarëve që kundërshtonin ripushtimin e Kosovës në fund të shtatorit të vitit 1945. Në urdhrin e operacionit të Brigadës XXII, që ndodhej në Vrapçisht, më 28. IX. 1945, midis të tjerash thuhej: “Brigada XXII në bashkëpunim me forcat jugosllave të Kosovës, do të vihen në lëvizje prej Jugut për në Veri dhe ato jugosllave prej Veriut në Jug, në mënyrë që elementëve të mbetur armiq, mos t'u mbetet rrugë shpëtimi, por, o dorëzim ose vdekje”³.

Në udhëzimet për këtë operacion u kujtohej partizanëve se, këtij operacioni i është kushtuar një rëndësi e madhe si nga ana e Armatës 6 jugosllave, ashtu dhe nga Shtabi i Divizionit (të UNÇSH). Çdo sukses i ushtrisë sonë kombëtare, të mendohet si një sukses tjetër në zhdukjen e bandave reaksionare që mundohen me çdo mënyrë të turbullojnë gjendjen në Kosovë, Maqedoni, si dhe në Shqipëri.⁴

Me gjithë propagandën e madhe të “bashkim- vëllazërimit” midis popujve, që motivonte operacione të tilla pastrimi, rezultati

³ AQU, Div. 5, Brig. XXII, viti 1945, Urdhër operacioni i shtabit të brigadës jugosllave për batalionet e saj, Vrapçisht, 28.IX.1945.

⁴ Arkivi Qendror i Ushtrisë (më tej: AQU), Divizioni V, Fondi Brig. XXII S, viti 1945, f. 26-28. Urdhër operacioni i Shtabit të Brigadës për batalionet e saj, Vrapçisht, 28.IX.1945.

mbetej i njëjtë. “Shovinizmi është në kulm... Populli shqiptar është i shtypur”⁵ - shprehej seksioni informativ i Brigadës XXII.

Udhëheqësit komunistë të dy vendeve, të Shqipërisë dhe Jugosllavisë, në periudhën e fliritit të përzemërt, në vitet e para të pasluftës botërore, përshtatën forma e mënyra bashkëveprimi kundër të gjithë atyre shqiptarëve, që aspironin apo vepronin për çlirim e bashkim kombëtar.

⁵ Po aty, Informacion i Sektorit Informativ të Brigadës XXII për Shtabin e Divizionit në Gostivar, më 2.VII.1945.

Prof. dr. Ana LALAJ
(Tiranë)

**LUFTA ANTIFASHISTE - NJË DEBAT I HAPUR ÇËSHTJE
TË DISKUTUESHME MBI LUFTËN ANTIFASHISTE
NACIONALÇLIRIMTARE NË SHQIPËRI**

Tema e Luftës Antifashiste është ndër më të debatuarat në historiografinë e sotme shqiptare. Trashëgimia e shkrimeve për luftën është më e shumta, krahasuar me të gjitha periudhat e historisë sonë. Në letërsinë artistike, artet pamore etj., tema e Luftës Antifashiste mbeti më e lëvruara e viteve të komunizmit. Kujtimet për luftën, jetëshkrimet për dëshmorët e saj u bënë lënda bazë për edukimin e fëmijëve në shkolla. Po kështu, studimet e deri historikët për veprimet e formacioneve të luftës në qarqe, rrethe etj., zunë vendin kryesor në programet e institucioneve shkencore, arsimore e kulturore, të organizatave të veteranëve të luftës etj. E gjithë kjo trashëgimi, përfshirë edhe atë studimore shkencore, përshkohet nga tendencioziteti i hapur politik e klasor, gjë që i ka dëmtuar jo vetëm në frymë studimet për luftën, por i ka deformuar ato edhe në përmbajtje. Ky fakt tanimë është i identifikuar dhe i gjithëpranuar, së paku në rrethet akademike. Kjo trashëgimi, e ngarkuar me kaq shumë teprime e shtrembërime, nuk është aq e lehtë për t'u sjellë në një dritë më realiste, po të mbajmë parasysh se, veç të tjerash, ende nuk mungojnë mbrojtësit

emocionalë të luftës, ashtu sikundër në këto vite është ndjerë gjallërimi i kundërshtarëve emocionalë të saj. Në këto shënime jam ndalur në disa çështje të diskutueshme të periudhës në fjalë, me përpjekjen për të shkuar drejt të vërtetave ose, së paku, për të nxitur më tej debatin.

Çështja e parë e diskutueshme: Lufta Antifashiste ishte apo nuk ishte luftë civile?

Kjo temë nuk është e re tek ne. Ajo u hap që gjatë luftës, u mor dhe u rimor dy a tri herë në periudhën e pasluftës, për t'u rihapur në vitet '90-të e në vazhdim. Në *rrafshin akademik* termit “luftë civile” studiues të ndryshëm i japin kuptime të ndryshme, që do të thotë se rreth saj ende nuk ka një përkufizim të stabilizuar. Po ashtu, i pastabilizuar ka qenë kuptimi për luftën civile edhe në historiografinë tonë të pasçlirimit. Në vitin 1952, në maketin e parë të Historisë së Shqipërisë, përgatitur aso kohe nga Instituti i Shkencave, thuhej se lufta civile në Shqipëri kishte filluar në vjeshtën e vitit 1943 dhe se ajo ishte imponuar nga “reaksioni i brendshëm”.¹ Nga gjithë sa është folur më pas, e vlen të shkëputen dy opinione. Njëri është i prof. Ndreçi Plasarit, i cili më 1974 e kundërshtoi tezën e luftës civile me arsyetimin se ajo nuk përbënte një luftë më vete, por qe “pjesë përbërëse e luftës kundër pushtuesve”, ndonëse përmbante “elementë të kësaj lufte, si në brendi ashtu edhe në formë”.² Tjetri është i prof. Luan Omarit, i cili më 1977 e çoi më tej këtë tezë, duke pranuar se,

¹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi (më tej: F.) 14/Arkivi i Partisë (më tej: AP) Strukturë, viti (më tej: V.) 1952, dosja (më tej: D.) 600, Mbledhje e Komisionit të Historisë së Re të Shqipërisë, më 25.9.1952.

² Ndreçi Plasari, “Bashkimi i popullit rreth PKSH në frontin nacionalçlirimtar”, në *Konferenca kombëtare e studimeve për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar*, Tiranë: Shtëpia botuese “8 Nëntori”, 1974, f. 51; Shih edhe: *Studime Historike*, Botim i Institutit të Historisë, viti XXVIII, Nr. 4, Tiranë: 1974, f. 43.

përveç karakterit nacionalçlirimtar, lufta “mori edhe karakter më të theksuar klase, në formën e saj më të ashpër, në formën e luftës civile”.³ Ky është pak a shumë mendimi akademik deri në vitet ’90-të, i cili më shumë e pranon se e kundërshton luftën civile në Shqipëri.

Në *rrafsh politik* për luftën civile për herë të parë është folur pas kapitullimit të Italisë fashiste. Në vjeshtën e vitit 1943, kur komunistët prishën Marrëveshjen e Mukjes, Balli Kombëtar i akuzoi ata si shkaktarë të luftës vëllavrasëse. Më tej, në fillim të korrikut 1944 Shtabi Aleat i Mesdheut e paralajmëroi ashpër Enver Hoxhën se komanda supreme nuk do ta toleronte luftën civile, sepse ajo shkonte ndesh me strategjinë aleate për bashkimin e forcave deri në fitoren përfundimtare mbi Boshtin nazifashist.⁴ Përgjigja e Hoxhës ishte po ashtu e prerë dhe kundërshtuese se në Shqipëri, sipas tij, “nuk kishte grindje të brendshme dhe aq më pak luftë civile, duke shtuar se, kishte *vetëm një grindje dhe një luftë: luftë kundër okupatorit në radhë të parë dhe kundër veglave të tij tradhtarë*” (nënvizimi është i dokumentit).⁵ Megjithatë, edhe në rrafshin politik (njësoj si në atë akademik) bie në sy paqëndrueshmëria në kuptimin e luftës civile dhe në përdorimin e këtij termi. Vet Hoxha duket se është konsekuent me përcaktimet fillestare dhe në shkrimet e fjalimet e tij të mëvonshme nuk haset ndonjë shmangie. Ndryshe ka ndodhur, për shembull, me Mehmet Shehun, i cili, më 1956, në një referat të vetin shpjegon se Lufta Nacionalçlirimtare, “përveç karakterit antifashist,... u pleks edhe me luftën e klasave, e cila... *në të vërtetë ka qenë luftë civile*” (nënvizimi im-AL).⁶ Në rrethanat kur është mbajtur ky referat,

³ Luan Omari, *Revolucioni popullor në Shqipëri dhe çështja e pushtetit*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, Tiranë: 1977, f. 13.

⁴ *British National Archives, London*, Public Record Office (PRO), PRO. AIR 20/8396; PRO. HS 5/69.

⁵ AQSH, F. 41, D. 141, V. 1944, Letër e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë NÇ drejtuar Shtabit Aleat të Mesdheut, 12 korrik 1944.

⁶ *Po aty*, AP/Strukturë, Drejtoria e Agitpropit, D. 94, V. 1956, fl. 19. “Mbi rolin e

nuk ka arsye që pohimi i Shehut të lexohet si kundërshti e qëllimshme ndaj Hoxhës. Më e mundshme është që Shehu të ketë shprehur një bindje të vetën, pa pasur informacionin e mjaftueshëm për pikëpamjen e Hoxhës.

Në këto njëzet vitet e fundit kjo temë merret e rimerret, e përsërisë, gjithnjë në rrafsh politik. Më 1944, Enver Hoxha e kundërshtoi tezën se në Shqipëri ishte duke ndodhur një luftë civile, pasi atij i duhej të përligjte operacionet ndëshkuese në Veriun e vendit, që deri atëherë kontrollohej nga Abaz Kupi dhe bajraktarë të tjerë e që sipas tij ishin të gjithë tradhtarë e “vegla të armikut”. Ndërsa sot, pas gati 70 vjetësh, duket se janë rizgjuar emocionet e bartësve historikë*, ku dallojnë dy grupe. Njëri grup mbron në mënyrë konstante tezën se në Shqipëri nuk ka pasur luftë civile por vetëm Luftë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në grupin tjetër qëndrimet variojnë nga mendimi se pas pushtimit gjerman pati luftë civile e deri në ekstrem fare se Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare në Shqipëri nuk ishte tjetër veçse luftë civile. Kuptohet, ky qëndrim i fundit është i motivuar nga ide zhvlerësuese për kontributin shqiptar në Luftën Antifashiste.

Sa u tha më lart, duket se debatet e sotme janë mbajtur më shumë në rrafsh politik dhe të dominuara nga emocione politike. Në këto kushte jo rrallë debati shkencor ndjehet i frenuar. Aq e dukshme është kjo sa në botimin e fundit të *Historia e Popullit Shqiptar*, IV, autorët u rrëshqasin fakteve dhe komenteve për luftën civile.⁷ Po kështu edhe prof. Kristo Frashëri në një intervistë

Bashkimit Sovjetik në lëvizjen socialiste ndërkombëtare dhe mbi unitetin ideologjik të forcave socialiste ndërkombëtare”, referat i M. Shehut me intelektualë dhe anëtarë të Shoqatës së Miqësisë me BS në Tiranë, më 20.12.1956.

* Me togfjalëshin ‘bartës historikë’ kuptohen pjesëmarrësit ose aktorët e drejtpërdrejtë në Luftën e Dytë Botërore në Shqipëri, si dhe familjarët që mbrojnë veprën e paraardhësve të tyre sot.

⁷ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, “Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj, 1939-1990”, grup autorësh, përgatiti për botim prof. dr. Xhelal Gjeçovi, Tiranë: “Toena”, 2008, f. 65-128.

të vetën e kundërshton idenë e luftës civile⁸ dhe, me këtë rast, na duhet të vërejmë se edhe në terma akademikë është bërë një hap prapa, duke mos u pranuar jo më koncepti i luftës civile, po as i elementëve të saj. Ndërkohë, ka studiues të tjerë që e pohojnë luftën civile në Shqipëri, si Uran Butka⁹, prof. Muharrem Dezhgiu¹⁰ etj.

Pra, me gjithë debatet, ende nuk ka një mendim përfundimtar. Diskutimet politike janë mënyra më e sigurt për t'iu larguar të vërtetave historike. Por në rastin tonë edhe mbajtja e debatit thjesht në terma akademikë, mendoj se nuk është më e mira për të shkuar tek e vërteta. Sepse teza e luftës civile është “djegëse” jo në kuptimin akademik të saj, në kuptimin e termit në vetvete, por për gjithë sa ka ndodhur realisht në atë kohë, që disa e quajnë e të tjerë nuk e quajnë luftë civile. Emocionet e bartësve të sotëm historikë apo dhe emocionet e pasardhësve politikë* janë pengesë për të sqaruar rrethanat, të cilat sollën që kjo luftë nga ndeshje me pushtuesin të rrëshqiste në përleshje me njëri - tjetrin. Prandaj çështjen mund ta shtrojmë pak më ftohtë: çfarë ka ngjarë, cilët ishin aktorët e ngjarjeve dhe mandej çdonjërit prej aktorëve t'i gjejmë kapelën e duhur. Kështu them se mund të shkohet drejt saktësimi të të vërtetave.

⁸ *Gazeta shqiptare*, “Mit’hat Frashëri atdhetar derisa bashkëpunoi me hitlerianët”, 21 prill 2012. Prof. Kristo Frashëri shkruan “Po në Shqipëri a pati më 1944 luftë civile? Në rast se brenda në Shqipëri do të kishte shpërthyer konflikti për çështjen e pushtetit midis Frontit Nacionalçlirimtar dhe rreshtimit të Ballit Kombëtar, pa pjesëmarrjen e forcave ushtarake hitleriane do të kishim me siguri luftë civile. Por punët rrodhën ndryshe”.

⁹ Uran Butka, *Mukja shans i bashkimit, peng i tradhëtisë*, Tiranë: “Drier”, 2007; Uran Butka, *Lufta Civile në Shqipëri, 1943-1945*, Tiranë: “Drier”, 2006.

¹⁰ Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria në pushtimin italian (1939-1943)*, Tiranë: “Mësonjëtorja”, 2005.

* Me togfjalëshin ‘pasardhës politikë’ nënkuptojmë ata persona që sot janë angazhuar drejtpërdrejt apo mbështesin ato parti politike, që e konsiderojnë veten pasardhëse të partive apo organizatave politike që vepruan gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri.

Për Marrëveshjen e Mukjes dhe kolaboracionizmin

Për Marrëveshjen e Mukjes e sidomos për prishjen e saj është folur shumë, janë bërë konferenca përkujtimore, janë shkruar libra¹¹, që do të thotë se ka mjaft informacion në qarkullim. Megjithatë nuk mendoj se kjo temë është e ezauruar, që do të thotë se ka ende të pathëna dhe pika ende të diskutueshme. Njëra prej tyre është se *kush e mori nismën për mbledhjen e Mukjes*. Studiues vendas dhe të huaj e kanë shtruar secili këtë pyetje. Disa thonë se presioni britanik ka çuar palët drejt një marrëveshjeje, por njëri prej oficerëve britanikë, Reginald Hibbert, thotë se takimi u mbajt pa dijeninë e tyre.¹² Një tjetër oficer britanik, Bill Maclean, ngulmon se nismëtar ishte Kupi, ndërsa studiuesja Elisabeth Wiskeman thekson se nismëtarë ishin oficerët britanikë dhe Kupi.¹³ Në një manifest të Mithat Frashërit dhe të Abaz Ermenjit dërguar Foreign Office në Londër shkruhet se “sipas rekomandimeve të bëra nga Misioni Aleat Ushtarak [Allied Military Mission] një mbledhje me përfaqësuesit tanë dhe të organizatës komuniste u bë në Mukaj (Mukje) pranë Tiranës”¹⁴. Në secilin prej pohimeve të mësipërme mungojnë referencat nga arkivat vendase.

Sipas dokumenteve shqiptare bëhet me dije se në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar [KPNÇ]

¹¹ U. Butka, *Lufta Civile ...; Po ai, Mukja shans i bashkimit ...; Abaz Ermenji, Vendi që zë Skënderbeu në historinë e Shqipërisë*, Tiranë: “Çabej”, 1996; Hasan Dosti, *një jetë për çështjen shqiptare*, Tiranë: “Botart”, 2008; M. Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian ...*, .

¹² Reginald Hibbert, *Fitorja e hidhur, Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë*, Tiranë: Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë: 1993, f. 92.

¹³ Të dhënat sipas Bernd J. Fischer, *Shqipëria gjatë luftës 1939-1945*, Tiranë: Botimet. “Çabej MÇM”, 1999, f. 205.

¹⁴ PRO. FO 371/43554. “Balli Kombetar Manifesto”, prepared by Abaz Ermenji & Midhat Frasheri-July 1944.

në Labinot*, më 9 korrik 1943 u mor vendimi “të bahet kontakt me Ballin”, ku do të bisedohet për “bashkim”, “luftë për vdekje okupatorit”, “Shqipëri e Lirë Demokratike”. Si përfaqësues të KPNÇ në këto bisedime u zgjodhën Baba Faja Martaneshi, Myslim Peza, Mustafa Gjinishi dhe Ymer Dishnica¹⁵. Më 10 korrik, anëtarët e KPNÇ patën takim me majorin Neil “Billy” Maclean, kryetari i misionit ndërlidhës britanik në Shqipëri, të cilin e informojnë dhe për vendimin e marrë nga Këshilli një ditë më parë, për bisedime me Ballin Kombëtar. Po atë ditë, majori Maclean i entuziazmuar, i dërgon letër drejtuesve të Ballit Kombëtar, të cilët i përshëndet për qëllimin e mbledhjes: bashkimin dhe arritjen e një marrëveshjeje për koordinimin e veprimtarisë kundër Boshtit, vlerëson se bashkimi është jetik për luftën kundër armikut të përbashkët dhe shpreh dëshirën të takohet me përfaqësuesit e Ballit Kombëtar brenda një kohe të shkurtër¹⁶.

Studiuesi Muharrem Dezhgiu na sjell një dokument interesant, një letër që katër përfaqësuesit e KPNÇ më 18 korrik, ia dërgojnë Qendrës së Organizatës “Balli Kombëtar” [BK], ku parashtrojnë ftesën e KPNÇ për një takim të përbashkët. Sipas dokumentit, në atë takim, KPNÇ dhe BK do të përfaqësoheshin nga delegacionet e tyre, me “fuqi të plota” për të “bisedue dhe vendosë” për “bashkimin e forcave të të gjithë kombit në luftë kundër armikut”. Në letër njoftoheshin “zyrtarisht parimet themelore të Lëvizjes Nacional Çlirimtare”¹⁷. Me të drejtë autori analizon në detaje letrën e mësipërme, e cila hedh dritë të konsiderueshme për statusin e përfaqësuesve të KPNÇ dhe për platformën të cilës ata duhej t’i përmbaheshin në bisedimet e

* Mbledhja e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar u mbajt në Labinot më 4, 7, 9 dhe 10 korrik 1943.

¹⁵ AQSH, F 40/Këshilli i Përgjithshëm Nacional Çlirimtar, V. 1943, D. 3.

¹⁶ Po aty, D. 7.

¹⁷ M. Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian ...*, f. 281-282, cituar sipas: AQSH, F 40/Këshilli i Përgjithshëm Nacional Çlirimtar, V. 1943, D. 7; shih gjithashtu: U. Butka, *Mukja shans i bashkimit ...*, f. 33-34.

ardhshme në Mukje. Një burim që nuk mund të anashkalohet është Faik Quku, asokohe sekretar i përgjithshëm i BK, i cili thotë se në mbledhjen e Tapizës, më 26 korrik 1943, ishte i dërguari i Frontit Nacionalçlirimtar, Mustafa Gjinishi, ai që këmbënguli t'u merrte fjalën për bashkim Mit'hat Frashërit dhe Hasan Dostit, të cilët ishin ngurues. Procesi u zhblllokua falë ndërhyrjes së Qukut dhe më pas u bë Mukja, më 1 - 2 gusht.¹⁸

Në versionin zyrtar të Historisë së PPSH thuhet se kjo parti nuk ishte kundër krijimit të partive të tjera në vend, me kusht që ato të luftonin pushtuesin dhe të merrnin pjesë në Frontin Nacionalçlirimtar.¹⁹ Vështirë të thuhet sa është kjo e besueshme, sidomos me zhvillimet pas prishjes së Marrëveshjes së Mukjes. Aq më tepër që vetë Hoxha mungesën e partive të tjera politike e quan “një e mirë e madhe e pallogaritshme për çështjen e socializmit në Shqipëri”²⁰. Sidoqoftë faktet thonë se deri sa u bë mbledhja e Mukjes, komunistët ishin këmbëngulës për një marrëveshje me ballistët. Dihet se në shtator 1942, një pjesë e nacionalistëve që erdhën në Konferencën e Pezës iu bashkua Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar që u krijua aty. Të tjerët, shumica, në nëntor shpallën organizatën e tyre, Balli Kombëtar, emër që haset më parë në një trakt të vitit 1939, po që nuk ka të shënuar as ditë e as muaj dhe Balli nuk identifikohet si organizatë.²¹ Balli nuk e njohu asnjëherë Frontin

¹⁸ Faik Quku, *Qëndresa shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botnore*, Tiranë: Shtëpia botuese “ILAR”, 2006, Vëll. 2, f. 245-247.

¹⁹ *Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë*, Tiranë: Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, 1968, f. 143.

²⁰ “Raport i mbajtur në Kongresin IV të Frontit Demokratik të Shqipërisë”, 14 shtator 1967, në: Enver Hoxha, *Raporte e fjalime, 1967-1968*, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH, Tiranë: 1969, f. 157.

²¹ AQSH, F. 270, V. 1943, D. 11, fl. 3. Ky është një trakt i njohur me titull “Nacionalizma shqiptare” dhe që ka për nëntitull “Balli Kombëtar”. Në fund të traktit shënohet “Shqipëri 1939”. Në përmbajtje, *Nacionalizma shqiptare* bën të njohura qëllimet e saj, shprehur në tetë pika, midis tyre qëllimet për një Shqipëri të lirë dhe independente, për kufijtë etnikë, për sakrificë në emër të atdheut, për

Nacionalçlirimtar, të cilin e shihte të manipuluar nga komunistët. Megjithatë, pjesëmarrja e Ballit në Front dhe në këshillat nacionalçlirimtarë deri në pranverë 1943 mbeti ftesë e hapur. Të dhënat flasin se Ballit i është ofruar përfaqësim si organizatë, sipas formulës që bashkë me Partinë Komuniste dhe Ballin Kombëtar në Front do të ishin të përfaqësuar edhe nacionalistët e pavarur.²² Pikërisht këtë klauzolë të fundit thuhet se nuk e pranoi Balli, pasi secili nga këta të pavarur nuk përfaqësonte tjetër, veçse veten.²³ Sa për kujtesë, nacionalistët e pavarur, si Abaz Kupi, Myslym Peza, Baba Faja Martaneshi, Ndoc Çoba, Kamber Qafmolla kishin hyrë në Front (madje ata ishin zgjedhur dhe anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm Nacional Çlirimtar), kur nuk ishte shpallur ende Balli dhe sipas ballistëve, atyre u binte të përjashtoheshin. Gjithsesi këto janë llogari politike, si të njërës ashtu edhe të palës tjetër.

Po pse komunistët ishin kaq këmbëngulës për një marrëveshje bashkëpunimi me Ballin? Një nga arsyet është se marrëveshja me Ballin e zbuste disi boshllëkun e krijuar, pasojë e synimit të papërmbushur të Konferencës së Pezës për një front të

marrëdhënie të mira me fqinjët, për grumbullim rreth flamurit të Skënderbeut dhe jo rreshtim nën flamuj ideologjikë. Në trakt emërtimi *Balli Kombëtar* përmendet vetëm një herë dhe i njëjshuar me *Nacionalizma shqiptare*, në të cilin thuhet se ajo (*Nacionalizma...*) “nuk është një parti, as edhe një grup, por përfshin gjithkënd që flet shqip”. Nuk përmendet as formacioni pushtues i kohës dhe nuk ka indikacione për veprime konkrete kundër tij. Një shqyrtim i vëmendshëm i këtij dokumenti bën të mendosh se pas pushtimit fashist, prill 1939, vërtet duhet të ketë pasur një përpjekje të nacionalistëve për të krijuar një organizatë gjithëpërfshirëse të rezistencës, siç e shpjegojnë disa autorë që janë marrë me këtë temë, midis tyre Hasan Dosti, Faik Kuku etj. Sidoqoftë, edhe nëse më 1939 është iniciuar krijimi i një organizate me emrin *Balli Kombëtar*, duket se kjo përpjekje nuk është pasuar me veprime të mëtejshme organizative, qoftë dhe në fshehtësi, derisa organizata me të njëjtin emër u shpall në nëntor 1942.

²² AQSH, F. 40, Lista 1, D. 3, “Procesverbal i Mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, mbajtur më 4, 7, 9 dhe 10 korrik 1943 në Labinot”.

²³ Po aty.

bashkuar nacionalçlirimtar pa dallime feje, krahine dhe idesh politike. Por kjo arsye nuk është e mjaftueshme, nëse, veç zhvillimeve të brendshme, nuk do të mbajmë parasysh zhvillimet e atëhershme në plan ndërkombëtar, raportet politike midis aleatëve në Luftën e Dytë Botërore dhe politikat e fronteve nacionalçlirimtarë.

Në këtë linjë arsyetimi, kujtojmë se në mars 1943, PKSH u mbledh në Konferencën e parë të saj për gjithë vendin. Në atë Konferencë, bashkë me një letër të Titos, Blazho Jovanoviçi (Blažo Jovanović), anëtar i KQ të Partisë Komuniste Jugosllave, solli njohjen nga Kominterni dhe orientimet e këtij të fundit për PKSH. Orientimet thoshin, ndër të tjera, se partia duhej ta vinte theksin në forcimin e “frontit nacional të të gjithë patriotëve shqiptarë” dhe se duheshin shmangur parullat që dilnin “jashtë caqeve të çlirimit nacional të Shqipërisë”.²⁴

Dihet se parulla e “fronteve popullore” nga poshtë ka qenë platformë e Internacionales Komuniste. Kjo parullë nënkuptonte organizimin e lëvizjeve përmbysëse popullore deri në një revolucion socialist botëror. Por në vitin 1935, në Kongresin e VII të Internacionales së Tretë Komuniste, mbajtur në Moskë, më 25 korrik - 21 gusht, Gjergj Dimitrovi, sekretar i përgjithshëm i saj hodhi parullën e “Fronteve Popullore Antifashiste”²⁵ që do të krijoheshin në çdo vend sipas karakteristikave shoqërore e politike

²⁴ “Centralni Komitet KPJ - Drugarskom Centralnom Komitetu KP Albanije (drugu Miladinu [Popoviću])”, në: *Izvori za istoriju SKJ, dokumenti Centralnih organa KPJ, NOR i revolucija 1941-1945*, Tom II, Knjiga 7, Dokument 75, Beograd: Izdavački Centar Komunist, 1988, f. 341-344. Letër e Titos dërguar KQ të PKSH, më 22 shtator 1942. Blazho Jovanoviçi u largua nga Shtabi i Titos, në Gllamoç (Glamoč), në tetor 1942 dhe arriti në Shtabin e UNÇSH, në Labinot, në dhjetor të atij viti, ku mori pjesë në Konferencën e Parë të PKSh për vendin më 17-22 mars 1943 dhe qëndroi deri në prill 1944.

²⁵ “Unity of the Working Class against fascism (Concluding Speech Before the Seventh World Congress of the Comintern)”, August 13, 1935, *Georgi Dimitrov, Selected Speeches and Writings, Birth Centenary Volume*, New Delhi: People’s Publishing House, 1982, f. 109.

përkatëse. Kjo nisur nga fakti se fashizmi po bëhej një rrezik ndërkombëtar (Itali, Gjermani, Spanjë). Në secilin front komunistët do të bashkoheshin me organizimet e klasës punëtore dhe së bashku do të luftonin kundër kapitalit dhe fashizmit. Megjithatë dokumentet dëshmojnë se kishte shumë paqartësi te partitë komuniste për ndërtimin e fronteve popullorë antifashistë. Moskuptimet u shtuan sidomos kur u nënshkrua pakti i mossulmimit Molotov - Ribentrop, midis Bashkimit Sovjetik komunist dhe Gjermanisë naziste (gusht 1939). Gjithashtu ishte shumë vështirë të mobilizoje masat popullore kundër fashizmit në ato vende që ende nuk ishin pushtuar nga shtetet fashiste, si p.sh. në Britaninë e Madhe, në Belgjikë, në vendet skandinave etj.

Më vonë, ditën që u sulmua BS, më 22 qershor 1941, Josif Stalini i kërkoi Gjergj Dimitrovit, të orientonte partitë komuniste se në vend të Fronteve Popullorë Antifashistë të ngriheshin “Frontet e Bashkuar Nacionalë Antifashistë”.²⁶ Një direktivë më të detajuar për të ndërprerë parullën e revolucionit socialist botëror dhe për të filluar kudo lëvizjet nacionale, që do të mishëroheshin në krijimin e fronteve nacionalë antifashistë, Kominternua ua dërgoi partive komuniste më 7 korrik 1941.²⁷ Ky ishte një orientim i ri përbashkues për grupet politike dhe elitat përfaqësuese përballë rrezikut botëror nazifashist. Mbi këtë platformë të re u krijuan komitete nacionalçlirimtarë me përfaqësim të grupeve e partive politike të rezistencës në

²⁶ *The Diary of Georgi Dimitrov, 1933-1949*, New Haven&London: “Yale University Press”, 2003, f. 167. Instruksione iu dërguan partive komuniste në Amerikë, Angli, Suedi, Belgjikë dhe Francë, Hollandë, Bullgari, Kinë dhe Jugosllavi.

²⁷ *Po aty*, f. 175-176; Shih gjithashtu Eduard Mark, “Revolution by Degree: Stalin’s National Front Strategy for Europe, 1941-1947”, *Cold War International History Project*, Washington D.C.: Working Paper, No. 31, f. 9-10. Në vitet e mëvonshme të Luftës, strategjia e Fronteve Nacionalë u pasurua. Drejtimet kryesore ishin: krijimi i fronteve nacionale; theksimi i nacionalizmit; parullat për reforma shoqërore ekonomike të moderuara, jo revolucionare; respektimi i “demokracisë borgjeze”; premtimet për qeverisje efektive; solidariteti me Aleatët.

Jugosllavi, Greqi, Francë, Poloni, Bullgari, Itali etj. Këtë orientim zyrtar mori PKSH në mars 1943 dhe Enver Hoxha, i porsazgjedhur në krye të PKSH, kishte detyrë ta respektonte. Kjo mendoj se ka qenë një arsye e dytë pse Hoxha në pranverë - verë 1943 ende këmbëngulte për një marrëveshje bashkëpunimi me Ballin. Miladin Popović [Miladin Popović], emisari jugosllav pranë Hoxhës, e shpreh qartë këtë ide në letrën dërguar Titos më 11 korrik, një ditë pas mbledhjes së Kryesisë së Këshillit Nacionalçlirimtar në Labinot, ku u mor vendim për bisedimet e LNÇ me Ballin Kombëtar. Në atë letër Popović shkruan: “Shokët për ditë të tëra janë marrë me kontaktet dhe shqyrtimin e tendencave të grupeve të ndryshme nacionaliste ... Balli po na i “ngatërron letrat” teksa po “i përzien”. Shpresoj se me forcë do ta detyrojmë që të mos përziejë e ngatërrojë letrat tona. Shokët tanë kanë vendosur që të mos e përjashtojnë atë nga lufta dhe në këto pozita do të qëndrojnë deri në fund. Vetëm se lidhur me qëndrimin ndaj tij duhet të gjejmë e të bazohemi tek direktivat e Kominternës lidhur me qëndrimin ndaj faktorëve të tjerë politikë, sepse Kominternën ne e kemi përfaqësues të “unitetit të të gjitha forcave revolucionare”²⁸. Por në optikën e Miladin Popoviçit dhe drejtuesve komunistë shqiptarë ky unitet do të kishte një formulë të veçantë. Në letrën e mësipërme Popović shkruante: “E kemi forcuar punën për rivendosjen e marrëdhënieve miqësore dhe afrimin me Ballin Kombëtar, i cili deri më tash na ka krijuar mjaft shqetësime. Natyrisht që në fillim synojmë e përlllogarisim që ta marrim Ballin nën kontroll, për ta marrë më pas nën zotërim si bllok të tërë, me qëllim që të izolojmë elementët reaksionarë brenda tij, të cilët në fakt nuk janë të shumtë në numër”²⁹.

²⁸ *Izvori za istoriju SKJ - Dokumenti Centralnih organa KPJ, NOR i revolucija, 1941-1945*, Tom II, Knjiga 12, Redaktor përgjegjës, Dragoslav Džinić, Dok. 64, “Letër e Milo [Miladin Popović], instruktor i KQ të PKJ në Shqipëri, dërguar Palokës [Pavle Jovičević], sekretar i Komitetit të Qarkut të PKJ për Kosovë dhe Metohi, më 11 korrik 1943, Beograd: Izdavački Centar Komunisti, 1989, f.210.

²⁹ *Po aty*.

Në mbështetje të arsytimit të mësipërm, po përmend diçka që me sa di nuk është folur rreth saj ose është folur pjesërisht. Në periudhën që flasim ishin komunistët ata që kërkonin marrëveshje nga lart, ndërsa ballistët propozuan marrëveshje nga poshtë, ato që u quajtën “komisione koordinimi”³⁰ e që edhe në këtë rast Balli vuri kusht të mos publikohej. Është e paqartë pse Balli u druhej marrëveshjeve nga lart, kur në thelb këto ishin marrëveshje politike dhe prej tyre më i fituar do të ishte pikërisht Balli. Është e njohur një psikozë megalomane dhe jorealiste e nacionalistëve të asaj kohe. [Kujtojmë atë që shkruan Haki Stërmilli në ditarin e vet për mbledhjen e Mukjes, kur para fillimit të bisedimeve ballistët kërkuan të përfaqësoheshin me 12 delegatë, ndërsa komunistët me 6, pasi ballistët, sipas tyre, përfaqësonin gjithë popullin, ndërsa komunistët vetëm një pjesë të tij].³¹ Por veç jorealizmit për shtrirjen e Frontit Nacionalçlirimtar, ka mundësi që deri atëherë nacionalistët të jenë përfshirë edhe nga një psikozë përjashtuese. Në vetëdijen e nacionalistëve, bashkëpunimi ishte jo vetëm në kundërshtim me antikomunizmin e tyre, por do të ishte edhe faktorizim i komunistëve, pra mbështetje për ta, çka prishte punë në llogaritë e Ballit për pushtet. Sidoqoftë, teza se ballistët iu shmangën bashkëpunimit për llogari të pushtetit të nesërm, mbetet për t’u provuar.

Arsyeja e tretë pse komunistët këmbëngulën për bashkëpunim me nacionalistët e Ballit e që lidhet me sa thashë më sipër, është se deri në verën e vitit 1943, Enver Hoxha nuk kishte në kokë një projekt të qartë për sistemin politik të Shqipërisë së pasluftës ose të paktën nuk kishte atë projekt që u shpall pak më vonë, në shtator, në Labinot. Është interesante një letër e Vukmanoviç Tempos (Vukmanović Tempo), i deleguar i Titos për

³⁰ Për më shumë për komisionet e përbashkëta ose komisionet e koordinimit shih: M. Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian...*, f. 248-259.

³¹ Haki Stërmilli, *Shtigjet e lirisë*, ditar, Tiranë: Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, 1967, f. 24.

koordinimin e veprimeve midis shtabeve nacionalçlirimtare në Ballkan, në gusht 1943, kur sapo ishte larguar nga Shqipëria. Në këtë dokument Tempo informonte udhëheqjen e partisë së tij se Enver Hoxha me një pjesë të KQ të PKSH deri atëherë kishin qenë të mendimit që më parë se të krijonin Shtabin e Përgjithshëm, si dhe të hynin në fazën e organizimit të pushtetit të pasluftës (kupto: në zonat e lira), ata duhej të kishin bisedime me Ballin Kombëtar.³² Sigurisht Tempo u shpjegon shefave të vet edhe për përpjekjet që atij i janë dashur për ta bërë Hoxhën që të tërhiqej nga ai qëndrim, për çka flet edhe në kujtimet e tij të mëvonshme në librin *Struggle for the Balkans*. Si shpjegohet që në atë kohë Hoxha vinte më përpara marrëveshjen me Ballin dhe vetëm pas saj formimin e Shtabit të Përgjithshëm apo ngritjen e pushtetit të pasluftës? Pavarësisht nga dobësia që ndjente Hoxha për të hedhur i vetëm hapat drejt pushtetit të nesërm, mendoj se ka ndikuar dhe situata ndërkombëtare, siguria që Stalini u kishte dhënë dy aleatëve të tjerë, sidomos Winston Churchill-it, për bashkëpunimin në luftë midis forcave politike dhe ndarjen e pushtetit të pasluftës me zgjedhje të lira. Mesazhi i parë i sigurisë për Aleatët ishte ndërhyrja e Stalinit për të shpërndarë Kominternin, në maj 1943. Ky është një çast që e nënvizon me të drejtë prof. Xhefri Suein (Geoffrey Swain) në Universitetin e Glasgout, kur vëren se “në vjeshtë dhe në dimër 1942-1943, mesazhi i këshilltarëve sovjetikë, kurdoherë që ata merrnin kontakt me grupet e rezistencës, ishte që partitë komuniste të tregoheshin fleksibil dhe të gatshme për të shërbyer si partnerë të rinj në një qeveri koalicioni të pasluftës”.³³ Në rastin e Shqipërisë,

³² “Svetozar Vukmanović Tempo, delegat Centralnog Komiteta KPJ – Centralnom Komitetu KPJ, 8 avgust 1943”, në: *Izvori za istoriju SKJ ...*, Tom II, Knjiga 12, Dokument 102, prilog br.13, f. 378-380. Letër e Tempos, i deleguar i KQ të PKJ në Maqedoni e Kosovë, dërguar KQ të PKJ, më 8 gusht 1943.

³³ Geoffrey Swain, “Tito’s International?”, *The Historical Journal*, Vol. 35, Cambridge University Press, No. 3 (Sept., 1992), p. 647.(Marrë nëpërmjet JSTOR).

sikurse dihet, deri në gusht 1944 nuk erdhi asnjë këshilltar a misionar sovjetik. Po kjo nuk do të thotë se fryma e këtyre orientimeve, në një mënyrë ose një tjetër, të mos ketë hyrë në shtabin komunist të luftës.

Një arsye e fundit pse komunistët kërkuan bashkëpunim me Ballin e që është vërejtur më së pari nga studiues të huaj, është se atë kohë flitej për një plan zbarkimi të ushtrive Aleate në Ballkan, që solli edhe pushtimin gjerman të Shqipërisë. Dokumentet britanike shënojnë se Hoxha në mënyrë të përsëritur u përpoq të marrë vesh nga misioni britanik për kohën e zbarkimit.³⁴ Hoxha kishte arsye të mendonte se zbarkimi i Aleatëve do ta favorizonte Ballin properëndimor dhe prandaj ai i shtoi përpjekjet për të arritur me të një marrëveshje bashkëpunimi.³⁵ Dhe në mos qoftë kjo arsyeja kryesore, me siguri është një arsye më shumë.

Për mjaft kohë ka qëndruar varur një pikëpyetje e madhe se si ndodhi që komunistët, ata që e kërkuan marrëveshjen, ishin pikërisht ata që e prishën. Duke shfletuar dokumentet e mbledhjes së Kryesisë së KNÇ, në Labinot, më 9 korrik, ku u vendos për bisedimet me Ballin Kombëtar, konstatohet lehtësisht se diskutimet ishin deklarative, nuk kishte analiza për çështjet që do të shtroheshin për diskutim, u shfaq mosbesim për krerët e Ballit Kombëtar dhe u mor vendimi se “do të bahej një konferencë e vogël” dhe se krerëve të Ballit do t’u thuhej: “Me ju, pa ju do të vazhdojmë luftën deri në fund”³⁶. Kurse delegacioni i Ballit Kombëtar, megjithëse kryesohej nga Mithat Frashëri, kryetar i Ballit Kombëtar, mendonte se takimin në Tapizë do ta bënte me

³⁴ ‘Trotsky’ Davies, *Illyrian Venture, the Story of the British Military Mission to Enemy-occupied Albania 1943-1944*, London, Bodley Head: The Garden City Press LTD, 1952, f. 77-78.

³⁵ B. J. Fischer, *Shqipëria gjatë Luftës ...*, f. 205.

³⁶ AQSH, F. 40, V. 1943, D. 3. Mbledhja e Kryesisë së Këshillit Nacionalçlirimtar në Labinot, më 9 korrik 1943.

Abaz Kupin³⁷ dhe jo me një delegacion të Këshillit Nacionalçlirimtar. Pra, të dy palët nuk ishin përgatitur seriozisht për mbledhjen e Mukjes, si një takim ku do të merreshin vendime historike.

Një muaj pas mbledhjes së Mukjes, në fillim të shtatorit 1943, në Konferencën II Nacionalçlirimtare, marrëveshja u dënua zyrtarisht si “marrëveshje në kundërshtim me interesat e luftës dhe të bashkimit të popullit shqiptar”.³⁸ Formalisht konferenca nuk e preu bashkëpunimin me Ballin, por vuri të atilla kushte, që Balli nuk mund t’i pranonte. Njëri prej kushteve ishte që ai të njihte këshillat nacionalçlirimtarë *si i vetmi* [nënvizimi im - A.L.] pushtet i popullit në Shqipëri.³⁹ Kjo do të thoshte se Balli nuk mund të kishte këshillat e tij as në fshatrat ose komunat që ai kontrollonte. Puna shkoi deri aty sa në fillim të tetorit Hoxha orientoi shokët e vet se nuk bëhej më fjalë për bashkëpunim me Ballin, por “vetëm për shpartallimin e tij”.⁴⁰ Pas tyre edhe krerët e

³⁷ *Po aty*, F 14/AP-PKSH, V. 1943, D. 21. Letër e Ymer Dishnicës dërguar Enver Hoxhës pas mbledhjes së Tapizës, më 26 korrik 1943, ku delegacioni i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar u takua me delegacionin e Ballit Kombëtar. Midis të tjerash Dr. Dishnica shkruan: “Të hënën më 26 korrik patmë një takim me një delegacion të improvizuar të Ballit Kombëtar. E them kështu mbasi megjithëse neve ia kishim bërë një letër thirrje zyrtare në emër të delegacionit të Këshillit të Përgjithshëm Nacional Çlirimtar, ata na u përgjigjën oralisht se do të vinin në pjekjen e caktuar. E aty mbasi ardhë zunë të thoshin se neve e dinim se kemi takim vetëm me Bazin [Abaz Kupi], por meqë jemi aty, atëherë mund të diskutojmë e të bëjmë disa sqarime pa qenë nevoja e një procesverbali...”.

³⁸ Rezolucioni i Konferencës së Dytë Nacionalçlirimtare, 8 shtator 1943, *Dokumente të organeve të larta të pushtetit revolucionar nacionalçlirimtar (1942-1944)*, Instituti i Historisë së Partisë pranë KQ të PPSH, Tiranë: 1962, f. 59.

³⁹ *Po aty*, f. 58.

⁴⁰ “Letër e KQ të PKSH drejtuar Komitetit Qarkor të PKSH për Gjirokastrën, në lidhje me qëndrimin kundrejt Ballit Kombëtar, Legalitetit dhe misionëve ushtarake angleze”, lëshuar më 1 tetor 1943, *PPSH – dokumente kryesore, 1941-1948*, vëllimi I, Botim i dytë, Tiranë: Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, 1971, f. 211.

Ballit orientuan të vetët se “çdo sulmi dhe atentati komunist t’i përgjigjeni menjëherë dhe po me atë mënyrë”.⁴¹

Çfarë kishte ndodhur? Lajmet për Mukjen e kishin vënë në alarm Hoxhën dhe shtabin e tij, i cili ato ditë ndodhej në Kucakë, një fshat në zonën e Oparit. Me sa duket, pika më djegëse ishte ajo e krijimit të Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë. Komentues të mëvonshëm kanë vërejtur, dhe ndoshta ata kanë të drejtë, se ky komitet e nxirrte jashtë loje Këshillin Nacionalçlirimtar, ndërkohë kur drejtuesit komunistë shqiptarë parashikonin që Ballin Kombëtar ta vinin “nën kontrollin” e tyre në Lëvizjen NÇ. Siç e shpjegon Sejfulla Malëshova, në Kucakë të gjithë ishin të një mendjeje se deri atëherë qëndrimi ndaj Ballit kishte qenë oportunist.⁴² Për më tej mendimet ishin të ndara. Një pjesë thoshte që Balli të demaskohej politikisht, të tjerë të goditej me armë.⁴³ Në Kucakë ndodhej edhe Tempo, “ambasadori shëtitës” i Titos, i sapokthyer nga Greqia. Ai ka shpjeguar se roli i Ballit Kombëtar ishte i njëjtë me atë të çetnikëve, të cilët, sipas tij, kishin dashur që partizanët e Titos t’i largonin nga lufta kundër pushtuesve ose t’i asgjësonin “me ndihmën e pushtuesve dhe pastaj të paraqiten vetë si e vetmja forcë e armatosur, që duhet të marrë pushtetin nga Aleatët, pas përfundimit të luftës”.⁴⁴ Dokumentet thonë se ai ka këmbëngulur në idenë se Balli duhej demaskuar dhe diferencuar, e pastaj një Ball i përçarë luftohej më lehtë. Edhe në informacionin që Miladin Popoviç i dërgon Titos, më 19 tetor 1943, pohohet se me Tempon “biseduam me KQ [PKSH], duke i studiuar mirë

⁴¹ AQSH, F. 270/AP-Balli Kombëtar, V. 1943, D. 11, fl. 102. “Qarkore Nr. 7”, lëshuar më 7 tetor 1943.

⁴² Diskutimi i Sejfulla Malëshovës në Plenumin e Beratit, 23-27 nëntor 1944, *Politikë antikombëtare e Enver Hoxhës, Plenumi i 2-të i KQ të PKSH, Berat 23-27 nëntor 1944*, Dokumente, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë: 1996, f. 127. Diskutimi i Sejfulla Malëshovës në Plenumin e Beratit.

⁴³ *Po aty*.

⁴⁴ Svetozar Vukmanović – Tempo, *Struggle for the Balkans*, London: Merlin Press, 1990, f. 130.

çështjet, situatën etj., e krijuar dhe konkluduar për nxjerrjen e një trakti, ku do të deklarohet se PKSH nuk e njeh as mënyrën e krijimit të “Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë”, madje as funksionet e tij si instanca më e lartë në Luftën Nacionalçlirimtare dhe se ka vendosur të thërrasë menjëherë konferencën për zgjerimin e Frontit Nacionalçlirimtar”.⁴⁵ Vetë Tempo nuk lë pa përmendur se e ka kundërshtuar idenë e goditjes me armë të Ballit para se të bëhet një proces i pritshëm diferencimi, që do të thoshte se do të dilnin forca “në luftë të hapur kundër partizanëve”, të cilat, sipas tij, “duhet të shpartallohen ushtarakisht”.⁴⁶

Teza se Marrëveshja e Mukjes u prish me ndërhyrjen e jugosllavëve është e njohur. Pyetja shtrohet pse jugosllavët vepruan jashtë udhëzimeve sovjetike për marrëdhëniet e fronteve nacionalçlirimtare me grupimet nacionaliste? Studiues të huaj këtë e shpjegojnë me interesat e Titos dhe të partisë së tij në Ballkan dhe sidomos në Shqipëri e Greqi.⁴⁷ Ashtu si te ne, edhe në Greqi partitë komuniste ishin gjithnjë me sytë nga Moska, por te porta bënë “rojë” jugosllavët. Në të dyja këto vende, në tetor 1943, shënohen përplasjet e para midis komunistëve dhe grupeve nacionaliste. Burimet thonë se në Greqi jugosllavët e nxitën gjithnjë e më keq konfliktin e brendshëm. Në verë 1944, sipas këshillave të sovjetikëve, komunistët grekë pranuan të hynin në qeverinë e George Papandreut, një qeveri koalicioni, atëherë në mërgim. Por pas largimit të gjermanëve, përsëri me nxitjen e jugosllavëve, PKG u largua nga qeveria dhe në dhjetor drejtoi kryengritjen në Athinë, që u shtyp egërsisht me pjesëmarrjen e ushtrive britanike e që në 37 ditë thuhet se pati 8 mijë të vvarë.⁴⁸

⁴⁵ *Izvori za istoriju SKJ - Dokumenti Centralnih organa KPJ, NOR i revolucija, 1941-1945*, Tom II, Knjiga 13, Redaktor përgjegjës, Branko Vuković, Dok. 214, “Letër e Miladin [Popović], instruktor i KQ të PKJ në Shqipëri dërguar J.B.Tito”, më 19 tetor 1943, Beograd: Izdavački Centar Komunisti, 1990, f.476.

⁴⁶ *Po aty*.

⁴⁷ G. Swain, “Tito’s International? ...”, f. 647-651.

⁴⁸ Misha Glenny, *Histori e Ballkanit, 1804-1999, nacionalizmi, luftërat dhe Fuqitë*

Në të dyja partitë komuniste linja e ndërhyrjes jugosllave ishte e njëjtë, ndërsa pasojat, për shkak të rrethanave të tjera, në Greqi ishin një katastrofë. Edhe në Shqipëri, Tito ishte i interesuar për të ashpërsuar marrëdhëniet e Lëvizjes Nacionalçlirimtare me nacionalistët, sepse në këtë mënyrë dobësohej dhe qëndresa e shqiptarëve ndaj synimeve të Titos për Shqipërinë dhe Kosovën.

Si përfundim, prishja e Marrëveshjes së Mukjes provokoi vëllavrasjen dhe kjo është përgjegjësi e komunistëve. Fundja, këtë e kanë pranuar vetë drejtuesit komunistë të luftës, që nga Hoxha e me radhë të tjerët.⁴⁹ Zhvillimet që pasuan, u themi apo nuk u themi atyre luftë civile, përbëjnë një konflikt të përgjakshëm, që studiuesi i respektuar Uran Butka e ka sjellë në një monografi shteruese.⁵⁰ Nëse në këtë përballje të përgjakshme komunistët dolën fitues, do shënuar se kostoja njerëzore dhe politike ishte vërtet e lartë. Është rasti të shënojmë se vite më vonë Enver Hoxha është shprehur se Mukja do të kishte qenë fatalitet për Lëvizjen Nacionalçlirimtare, se ajo “do të kishte qenë Varkiza shqiptare”.⁵¹ Megjithatë ai asnjëherë nuk e ka përmendur ndërhyrjen “shpëtimtare” të jugosllavëve. Po kështu, ai i ka marrë me radhë të gjitha ato që ai i quan ndërhyrje të emisarëve jugosllavë, gjatë dhe pas luftës, të njohura dhe të panjohura dhe i ka përmbledhur në librin voluminoz *Titistët*. I vetmi rast që nuk përmendet, as si “shpëtimtar” dhe as si ndërhyrje imponuese e jugosllavëve, është prishja e Marrëveshjes së Mukjes.

e Mëdha, Instituti i Dialogut dhe i Komunikimit, Tiranë: Botimet “Toena”, 2007, f. 540.

⁴⁹ *Politikë antikombëtare e Enver Hoxhës, Plenumi i 2-të i KQ të PKSH, Berat 23-27 nëntor 1944*, dokumente, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë: 1996. Përgatitur nga Ndreçi Plasari dhe Luan Maltezi. Në këtë plenum Hoxha pranon se me mbledhjen e Labinotit, shtator 1943, “ne i dhamë Ballit armën për të na luftuar, duke na akuzuar si shkaktarë të prishjes së marrëveshjes dhe të vëllavrasjes” dhe se “parulla ja me ne, ja kundër nesh ishte në rendin e ditës”.

⁵⁰ Uran Butka, *Lufta civile në Shqipëri ...* .

⁵¹ Enver Hoxha, *Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë*, kujtime, Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, 1982, f. 228.

Megjithatë vazhdon të mbetet ende si çështje e diskutueshme nëse gjatë luftës pati ose jo kolaboracionizëm me pushtuesit dhe, nëse po, a ishte ai i përligjur. Në historiografinë komuniste, kolaboracionizmi i nacionalistëve nuk është vënë asnjëherë në dyshim. Ky ishte një trajtim aq refraktar sa u shmang të flitej edhe për personat historikë që luftuan e dhanë jetën kundër pushtuesit, vetëm pse ata kishin qenë në radhët e Ballit Kombëtar ose në grupe të tjera të rezistencës, që nuk kontrolloheshin nga komunistët. Në studimet e sotme variantet janë pak a shumë këto: 1. që nacionalistët bashkëpunuan me pushtuesin dhe ky është varianti tradicional; 2. që, përveç Ballit bashkëpunues, grupet e tjera nacionaliste të rezistencës nuk bashkëpunuan me pushtuesin, por as me komunistët; 3. që krerët e Ballit nuk bashkëpunuan me pushtuesin, por vetëm disa segmente të tij; 4. që as Balli Kombëtar dhe as pjesë të tij nuk bashkëpunuan me pushtuesin, por vetëm individë ekstremistë, të cilët nuk ishin pjesë e Ballit dhe as kishin të bënin me të.

Pra, opinionet janë ende të ndara. Mendoj se nuk është vështirë për të mbledhur e sistemuar faktet. Më të vështira janë komentet mbi faktet. Bie fjala, marrim tezën se Balli nuk ka bashkëpunuar, por vetëm disa segmente të tij. Këtu më së pari duhet sqaruar se ç'kuptohet me bashkëpunim. Në qoftë se me bashkëpunim kuptojmë vetëm terrenin ku zhvillohen veprime luftarake, është e kotë që krerët politikë të Ballit t'i kërkojnë atje. Në qoftë se pjesë e bashkëpunimit janë edhe marrëdhëniet me strukturat kuislinge të qeverisjes, për të vazhduar më tej me furnizimet në armatime e municione nga pushtuesi, në këtë rast nga gjermanët, të dyja këto provohet se janë bërë ose drejtpërdrejt ose me miratimin e krerëve të Ballit. Në përvojën time, sa më shumë jam zgjeruar në kërkimet për Shqipërinë në Luftën II Botërore, të dhënat e mbledhura flasin për kolaboracionizëm dhe jo për mungesë të tij. Kësisoj, pjesa e vështirë nuk është e vërteta, por komentet mbi të vërtetën. Për shembull, teza se segmente të

Ballit Kombëtar “bashkëpunuan në mënyrë të detyrueshme me forcat gjermane për të luftuar kundër rrezikut komunist në Shqipëri”⁵² është krejt e diskutueshme dhe, për mendimin tim, një shfajësim (për të mos thënë përligjje) i sforcuar, më shumë politik se shkencor.

Çështja tjetër e diskutueshme: roli i britanikëve si pjesë e faktorit të jashtëm

Në zhvillimet e Luftës Antifashiste në Shqipëri, faktori i brendshëm është premisa e parë për vetë ekzistencën e luftës. Në këto zhvillime, përfshirja masive e popullit dhe sidomos e rinisë në Frontin Antifashist Nacionalçlirimtar, është tregues i rëndësishëm i orientimit popullor dhe i forcës drejtuese në luftë, Partisë Komuniste. Por kur është fjala për fitoren e kësaj lufte, teza se faktori i brendshëm ishte mbizotërues, kjo është e vjetruar dhe në thelb një tezë propagandistike. Në një luftë botërore, fitimtarët apo humbësit ndajnë fate të përbashkëta. Thelbësore është që, për rrethanat e Shqipërisë, një rreshtim i gabuar mund të ishte fatal për të ardhmen e këtij vendi. Për fat, zgjedhja e duhur u bë shpëtimi i tij.

Për rolin e britanikëve, gjatë dhe pas luftës, në historiografinë tonë nuk është shkruar pak. E keqja është se kjo çështje ka qenë ndoshta më e politizuara nga të gjitha temat e luftës, kësisoj dhe nga më të deformuarat. Megjithatë në vitet 70-të nga arkivat e Londrës për herë të parë u morën mjaft dokumente të rëndësishme, të cilat u depozituan në arkivin e Institutit të Historisë dhe ky fond është shfrytëzuar nga studiues të ndryshëm. Mbi bazën e këtyre dokumenteve, prof. Arben Puto aso kohe shkroi librin “*Nëpër analet e diplomacisë angleze*”, të cilit, me gjithë kufizimet e kohës, ende mund t’i referohesh. E rëndësishme është se fondi i arkivit të Institutit është pasuruar me dokumente të

⁵² M. Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian...*, f. 456.

reja, nga vjeljet e fundit në Londër, aq sa mund të thuhet se për britanikët dhe politikën britanike me Shqipërinë tanimë ka dokumente pa fund. Mjaft të them se për qëllimet e këtij shkrimi m'u desh të kaloj nëpër duar mijëra faqe dokumentesh, me burim arkivat britanike dhe me subjekt Shqipërinë gjatë luftës, letërkëmbime, raporte, udhëzime etj., të cilat nisin nga misionet në terren dhe shkallë-shkallë në shtabet koordinuese e deri në qeveri dhe anasjelltas. Kuptohet, një pjesë e madhe e dokumenteve përsëriten e kryqëzohen nga njëri seksion ose nga njëra zyrë në tjetrën. E rëndësishme është se ato hedhin dritë të mjaftueshme për gjithçka ndodhte me grupet e rezistencës, përballjen dhe flirtet me pushtuesin, përplasjet me njëri-tjetrin dhe, në distancë me këto, politikën e Londrës.

Misionet britanike të luftës patën rol të ndjeshëm jo vetëm në Shqipëri, po dhe më gjerë në Evropë. Ato vepronin në kuadër të SOE (*Special Operations Executive*), një strukturë e pavarur e krijuar nga Winston Churchill, që kishte detyra zbulimi, sabotazhi dhe rikonicionesh ushtarake në vendet e pushtuara nga Fuqitë e Boshtit. Planet e SOE duhej të koordinoheshin me planet e përgjithshme strategjike dhe taktike të Aleatëve dhe kjo ishte përcaktuar qartë në Kartën e SOE të korrikut 1940*. Rreth 13 mijë njerëz u shpërndanë nëpër Evropë dhe vlerësohet se ata kishin lidhje me një milion agjentë të tyre, prandaj SOE u quajt ndryshe

* Fillimisht SOE vepronte sipas këshillave të ministrit të Ekonomisë së Luftës dhe të Ekzekutivit Politik të Luftës (Political War Executive), por me zgjerimin dhe intensifikimin e luftës, konsideratat ushtarake u bënë mbizotëruese dhe në mars 1943, direktivat operacionale jepeshin nga Joint Chiefs of Staff [Shefat e Shtabit të Përbashkët] në Londër dhe Combined Chiefs of Staff [Shefat e Shtabit të Kombinuar] në Washinton. Sistemi i veprimtarisë së SOE dhe i institucioneve me të cilat SOE duhej të koordinonte veprimtarinë e saj kanë ndryshuar disa herë gjatë luftës. Disa nga institucionet me të cilat SOE bashkëpunonte ishin: War Office-Ministria e Luftës, Special Operation Committee-Komiteti i Operacioneve Speciale, General Head Quarter- Shtabi i Përgjithshëm, Foreign Office-Ministria e Jashtme etj. Detyra më kryesore e SOE mbeti mbështetja me armatime, veshje etj. e grupeve të rezistencës në këto vende.

“ushtria sekrete e Churchill-it”. Në fakt, Mbretëria e Bashkuar nuk kishte interesa të veçantë në Shqipëri, pesha ushtarake e të cilës në luftë ishte modeste. Për këtë arsye edhe misionet britanike qenë më të kufizuara në numër, ndryshe nga Greqia, për shembull, ku kishte 53 të tilla, mbi pesë herë më shumë. Megjithatë është interesante të vërejmë se kur u krijua SOE, në verë 1940, gjëja e parë me të cilën asaj iu desh të merrej është pikërisht plani për një kryengritje të armatosur në Shqipëri kundër pushtuesve italianë, me pikënisje nga Jugosllavia, punë e filluar pak më herët nga shërbimet e fshehta britanike e që një vit më pas përfundoi me dështim, kur Jugosllavia u pushtua nga gjermanët⁵³.

Në tekstet shkollore të periudhës komuniste ndihma britanike është trajtuar në mënyrë vulgare, se ajo nuk ishte tjetër veç ndonjë ngarkesë e hedhur nga ajri me ca lecka, automatikë pa fishekë dhe këpucë, shpesh të një këmbe. E vërteta është se, me gjithë vështirësitë, oficerët ndërlidhës britanikë mundën të siguronin furnizime të konsiderueshme me armë, veshje dhe ushqime për ata që luftonin. Oficerët e parë ndërlidhës hynë në Shqipëri në fund të prillit 1943 dhe që nga prilli e deri në gusht ata vendosën lidhjet me dy grupet kryesore të rezistencës, Frontin Nacionalçlirimtar dhe Ballin Kombëtar. Në gusht ata kompletuan me veshje dhe armatime 550 partizanët që krijuan Brigadën I. Megjithatë, deri në shtator 1943, ndryshe nga Greqia, ndihmat britanike në Shqipëri kanë qenë ende modeste. Një raport i SOE-s nga Kajro e bënte me dije Churchill-in se deri atëherë SOE kishte hedhur në Ballkan furnizime në materiale dhe para “që janë ekuivalente me 1.5 milion pound në ar dhe monedha lokale”. Prej këtyre, sqaron raporti, një milion pound kishin shkuar në Greqi,

⁵³ Elisabeth Barker, “Albania, 1939-41: the Revolt That Never Happened”, në *British Policy in South-East Europe in the Second World War*, London: The Macmillan Press LT, 1976, f. 47-54.

440 mijë pound tek Mihajloviçi dhe pjesa e mbetur, 60 mijë, te Tito dhe në Shqipëri.⁵⁴

Në raportet britanike flitet në hollësi për gjithçka u dërgua në Shqipëri, sa para, material luftarak dhe mallra shkuan te formacionet e luftës e sa humbën në pyje ose ranë në duar të armikut, sa u shpenzuan nga shqiptarët e sa u përdorën nga vetë misionet. Një raport i Philip Broad, atë kohë ministër rezident në Shtabin e Mesdheut Qendror në Kazerta, që ia përcjell zyrës së përfaqësuesit të tij në Bari, përmban një vlerësim të shumës në monedhë flori dërguar nga SOE në Shqipëri për grupet e rezistencës nga prilli 1943 deri më 31 tetor 1944. Sipas këtij raporti, për Shqipërinë u dhanë gjithsej 76 mijë e 200 lira sterlina në ar, prej të cilave 31 mijë e 900 shkuan për Frontin Nacionalçlirimtar, me destinacion blerje ushqimesh, ilaçe, veshje, armë etj., dhe 7 mijë e 100 shkuan për të mbështetur formacionet nacionaliste të Abaz Kupit dhe të Gani Kryeziut në veri.⁵⁵ I njëjti dokument përmban edhe anekset, ku përshkruhen ngarkesat e mbërritura, si armë, veshje, ushqime dhe barna mjekësore, gjithsej 2 mijë 334 tonë. Të dhënat e përshkruara janë në hollësi, që nga armët e deri te bluzat e çorapet. Megjithëse në këto raporte nuk thuhet se cilët grupe përfituan ndihma materiale, dihet tashmë se pjesa më e madhe shkuan për Frontin Nacionalçlirimtar. Zërat më kryesorë të furnizimeve janë: 6800 pushkë, 4900 automatikë, 1790 mitralozë të lehtë, 16 milionë e 500 mijë fishekë, 54 mijë bomba dore, granata etj., 28 mijë uniforma dhe 57 mijë palë këpucë ushtarake, 140 tonë ushqime të thata, 70 kv yndyrna, 140 tonë grurë dhe 46 tonë tagji për mushkat.⁵⁶ Dërgesat britanike në Shqipëri u kthyen në shqetësim për gjermanët. Në pranverë 1944

⁵⁴ Martin Gilbert, *Road to Victory: Winston S. Churchill, 1941-1945*, London, Aucland, Melbourne, Singapore, and Toronto: Minerva, 1992, f. 498.

⁵⁵ PRO. Foreign Office (FO) 371.43554, *Office of the Representative at Bari of the Resident Minister Central Mediterranean Bari*, 29th November, 1944.

⁵⁶ *Idem*, Appendix P, *Supplies infiltrated into Albania by Air and Sea During the Period May 1943 to January 1945*.

ata sollën nga Serbia jugore Divizionin I Alpin, siç pohojnë vetë ata, më i miri në Ballkan, për të rivendosur kontrollin në Shqipërinë e Jugut, sidomos në aksin rrugor më të rëndësishëm në rast të tërheqjes gjermane, aksin Janinë-Vlorë-Shkodër.⁵⁷ Pasojë e këtij operacioni ishte edhe mbyllja e bazës detare të Karaburunit, ku priteshin ngarkesat. Raportet për furnizimet flasin edhe për kohë të vështira, siç ishte dimri 1943 - 1944, por gjithsesi të dhënat e mësipërme dëshmojnë se banalitetet me automatikë pa fishekë dhe këpucë të një këmbe janë larg të vërtetës.

Veç ndihmave materiale, a kishin misionet detyra të tjera, ushtarake ose politike? Jo vetëm tek ne, po kudo gjetkë, misionet në terren ishin udhëzuar të kryenin vetëm detyra ushtarake. Së paku kështu flitet në raportet. Por veprimet e terrenit u nënrenditen kurdoherë politikave të qendrës. Misionarët e Churchill-it në Evropën Qendrore e sidomos në Ballkan, në mbështetje të formacioneve vendase të luftës, e detyruan *Wehrmachtin* të angazhonte në këto rajone rreth 30 divizione me gjysmë milioni ushtarë.⁵⁸ Në pikëpamje ushtarake, kjo ishte një detyrë e pastër taktike ushtarake. Por kjo detyrë taktike përmban edhe objektiva politike, që lidhen me llogaritë e pasluftës.

Misionet britanike kishin synim të përfshinin në rezistencë aktive kundër nazifashizmit të gjitha shtresat sociale dhe krahët politikë, sidomos grupimet jekomuniste, ku ishin vërejtur edhe prirje për kolaboracionizëm. Churchill-i llogariste se një mbështetje e paanshme jo vetëm do t'i afronte grupet me njëri-tjetrin, se midis tyre dhe misioneve britanike do të krijohet një klimë miqësore, por dhe qeverisjet e ardhshme do të ishin më përfaqësuese, sipas rregullit që, ata të cilët ndanin përgjegjësitë në

⁵⁷ PRO. FO 371/43572; Shih edhe *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A-VIII-306, Britania dhe rezistenca evropiane në vitet 1939-1945, Oksford dhjetor 1962, f. 33.

⁵⁸ David Smiley, *Me detyrë në Shqipëri*, Tiranë: Shtëpia Botuese Enciklopedike, 1993, f. 9.

luftë, do të ndanin edhe pushtet pas luftës. Por, me sa duket, për Churchill-in prania e misioneve të tij në terren nuk ishte e mjaftueshme për të garantuar qeverisje demokratike në Ballkan. Ky qëllim politik e nxiti kryeministrin britanik të paraqesë një plan zbarkimi të Aleatëve në Ballkan, që do të kryhej pas zbarkimit në Sicili (korrik - gusht 1943). Hyrja e trupave aleatë, praktikisht anglo - amerikanë, në Ballkanin Perëndimor do ta hidhte ushtrinë gjermane përtej Alpeve, por do të ishte edhe një pengesë për depërtimin sovjetik. Kjo nuk u tha, por qëllimi politik i Churchill-it ishte i lexueshëm. Jo vetëm Stalinit, po as Ruzveltit nuk i pëlqeu këmbëngulja britanike për Ballkanin, edhe pse në pikëpamje ushtarake operacioni ishte i motivuar. Madje aq i motivuar, sa ushtarakë të lartë gjermanë më vonë janë shprehur të habitur pse Aleatët hoqën dorë nga një operacion që do ta shpejtonte fundin e luftës. Megjithatë, siç e thotë studiuesi Misha Glenny, “kur Eisenhower-i hidhte poshtë planin britanik për ndërhyrje në Ballkan, ai garantonte, pa dashur, sundimin rus në pjesën më të madhe të gadishullit”.⁵⁹

Të kuptohemi, harmonizimi i taktikave ose zgjidhjeve ushtarake me qëllimet politike është në thelb të çdo strategjie lufte. Por, përpos këtij harmonizimi të domosdoshëm, është vërejtur dhe një përzierje qëllimesh dhe për këtë ka shumë shembuj. Në Jugosllavi, fjala vjen, kur në prill 1941 ajo u pushtua nga gjermanët dhe ushtria mbretërore u shkërmoq, gjenerali Dragoljub (Drazha) Mihajlović u vu në krye të një pjese të kësaj ushtrie dhe organizoi menjëherë rezistencën e armatosur. Paralelisht me Mihajlović-in, të njëjtën gjë bëri edhe Josip Broz Tito, duke krijuar me shpejtësi njësitë e veta në gjithë Jugosllavinë, që e detyroi Adolf Hitlerin të sjellë pa vonesë përforcime dhe të urdhërojë masa terrori mbi popullsinë civile. Megjithatë në shtator 1941, oficeri i parë britanik që mbërriti në Jugosllavi, edhe pse u vu në lidhje si me Titon, ashtu edhe me

⁵⁹ M. Glenny, *Histori e Ballkanit ...*, f. 520.

Mihajlloviçin, këtij të dytit i komunikoi se qeveria britanike ishte e gatshme të njihte lëvizjen e tij si forca e vetme e ligjshme e rezistencës në vend.⁶⁰ Për muaj të tërë radio e shtypi britanik Mihajlloviçin e ktheu në legjendë, ndërsa për partizanët mezi thuhej ndonjë fjalë më të rrallë. Ndryshe nga Mihajlloviçi, në rastin e Titos nga takimi i parë e deri sa u vendos misioni britanik pranë tij, shtator 1943, kaluan plot dy vjet. Kjo mbështetje e njëanshme pati efekte të këqija që, edhe për shkak të saj, të dyja grupet u përplasën me njëri - tjetrin dhe Mihajlloviçi përfundoi te gjermanët.

Shembulli më tipik i politikës së njëanshme britanike është Greqia. Ashtu si Jugosllavia, ajo ra nën pushtimin gjerman në prill 1941. Por fillimet e rezistencës së atjeshme datojnë një vit më vonë, maj 1942, me Aris Veluqiotis dhe një grup i vogël komunistësh. Sapo në vjeshtë ia mbërritën britanikët, ata inkurajuan grupe alternative të rezistencës, por me gjithë përpjekjet nuk i sollën dot në balancë me partizanët e ELAS-it, të cilët në çastin kur ikën gjermanët kishin nën kontroll katër të pestat e territorit. Për t'ua dhënë pushtetin nationalistëve grekë, Churchill-i nuk kishte rrugë tjetër, përveçse të përdorte forcën ushtarake.

Në Shqipëri oficerët britanikë duket se nuk kishin ndonjë orientim të veçantë, jashtë rregullit të përgjithshëm për të mbështetur ato grupe, që luftonin realisht forcën pushtuese. Këtu

⁶⁰S.W. Baily, "British Policy Towards General Draža Mihailović", në: *British Policy Towards Wartime Resistance in Yugoslavia and Greece*, London: The Macmillan Press Ltd, 1975, f. 59-93; Shih gjithashtu: Elisabeth Barker, "Some Factors in British Decision-making over Yugoslavia 1941-4", në *British Policy ...*, f. 22-58. Më 20 shtator 1941, D.T.Hudson, më vonë Kolonel, ishte oficeri i parë britanik që hyri në Jugosllavi, në Ravna Gora, pas pushtimit të Jugosllavisë nga Boshti, dhe ishte në lidhje me Mihajlloviçin dhe Titon; pas tij pranë shtabit të Mihajlloviçit shkuan disa oficerë ndërlidhës, kurse pranë shtabit të Titos, misioni i parë britanik i drejtuar nga Brigadier Fritzoy Maclean arriti vetëm në shtator të vitit 1943.

ata gjetën dy grupe kryesore të angazhuara në luftë, Frontin Nacionalçlirimtar dhe Ballin Kombëtar, por që kishin probleme me njëri-tjetrin. Edhe në rastin e Shqipërisë ndodhte si me Jugosllavinë, media britanike, kryesisht BBC, fillimisht nuk jepte fare informacion për aksionet e FNÇ, por vetëm për ato të Ballit. Madje kishte raste që aksionet e FNÇ njoftoheshin sikur ishin të Ballit⁶¹. Sidoqoftë britanikët bënë një hap të vlefshëm për të arritur një marrëveshje midis dy grupeve. Siç e kemi thënë, marrëveshja u prish nga komunistët pas ndërhyrjes së Tempos. Në kushtet e përplasjes me FNÇ⁶², krerët e Ballit në tetor 1943 orientuan çetat e tyre që “tash për tash” të mos ndërmerreshin veprime kundër gjermanëve⁶³. Por kjo “tash për tash” shkoi një vit. Praktikisht Balli u tërhoq nga lufta me gjermanët e për këtë humbi dhe mbështetjen e britanikëve. Në fund të vjeshtës 1943 të vetmit që e morën këtë mbështetje ishin partizanët e FNÇ. Atë kohë kryetari i misionit, gjenerali Edmund Davies, dorëzoi në shtabin e Enver Hoxhës 15 mijë lira sterlina në ar, pa bërë fjalë për dërgesat materiale.⁶⁴

Dimri 1943 - 44 ishte i vështirë për partizanët, por në pranverë ata u organizuan. Bashkë me ta u organizuan edhe vetë britanikët, po këtë herë pikësynim i tyre ishin grupet nacionaliste në Veriun e Shqipërisë dhe sidomos zogistët e Kupit. Grupi i

⁶¹ AQSH, F 41/AP-Shtabi i Përgjithshëm, V. 1943, D. 46, f. 5-5/1, 22 tetor 1943.

⁶² Letër e KQ të PKSH mbi masat për forcimin e pushtetit të Këshillave Nacional-Çlirimtare dhe të Partisë, mbi qëndrimin kundrejt “Ballit Kombëtar”, kundrejt “Legalitetit” dhe kundrejt misionëve anglezë”, lëshuar më 1 tetor 1943; *PSSH – dokumente kryesore, 1941-1948*, vëllimi I, Botim i dytë, Tiranë: Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, 1971, f. 204-209. në këtë letër Enver Hoxha jep urdhër komiteteve qarkore të PKSH për të vepruar “politikisht dhe ushtarakisht kundër Ballit Kombëtar”.

⁶³ AQSH, F. 270/AP-Balli Kombëtar, V. 1943, D. 11, fl. 102. “Qarkore Nr. 6”, lëshuar më 7 tetor 1943. në këtë qarkore, KQ i Ballit Kombëtar i jep urdhër komiteteve krahinorë që “të pezullojnë çdo operacion luftarak kundër forcave gjermane tash për tash”.

⁶⁴ PRO. HS 5/66/B8/2/PL/211. Telegram nga B8 për G. OPS, më 30 janar 1944.

britanikëve, më kryesorët prej tyre Bill Maclean, Julian Amery dhe David Smiley u gjendën te Kupi në prill 1944 dhe nuk u larguan prej aty deri në fund të luftës. Ky ishte misioni i koduar *Consensus II*. Nga dokumentet del se në rrethanat e krijuara, Londra riaktivizoi kartën e Ahmet Zogut, si mundësi e fundit për mbështetje.⁶⁵ Për këtë arsye përfshirja në luftë e legalistëve të Kupit dhe përgatitja e një terreni inkurajues për rikthimin e Zogut ishte veçanërisht e rëndësishme. Por ky plan i Londrës nuk pati sukses. Në maj, Hoxha mbledhi Kongresin e Përmetit dhe në vendimet e tij njëra prej pikave e ndalonte kthimin në Shqipëri të mbretit Zog. Hoxha përjashtoi çdo mundësi bashkëpunimi me Kupin. Ai urdhëroi një divizion [I] për të shkatërruar forcat e Kupit dhe të nacionalistëve të tjerë në Veri dhe për të vendosur atje pushtetin e këshillave nacionalçlirimtarë.⁶⁶ I kësaj kohe është paralajmërimi i Shtabit Aleat të Mesdheut për ndërprerjen e furnizimeve për formacionet e UNÇ. Puna mbërriti deri atje sa Hoxha kërkoi largimin e majorit Maclean dhe të tjerëve nga shtabi i Kupit. Në të kundërtën, ai paralajmëroi se do t'i kapte ata dhe do t'ia jepte një gjykatë partizane për bashkëpunim me “kolaboracionistët” e luftës⁶⁷. Nga Shtabi i Barit iu kërkua Hoxhës të tërhiqte menjëherë akuzat për Maclean, Smaily dhe Saymour, përndryshe do të largoheshin të gjithë oficerët britanikë nga Shqipëria. Hoxha u tërhoq me pretekstin e rremë se e kishte dhënë atë urdhër “në një moment emocional pas marrjes së lajmit të keq për vdekjen e Mustafa Gjinishit” dhe dha siguri se “nuk do të linte asnjë re sado të vogël të errësonte qiellin e pastër të marrëdhënieve shqiptare - britanike”⁶⁸. Megjithatë në shtabin britanik në Bari efektet ishin ndjerë. Si përfundim, Maclean dhe të

⁶⁵ PRO. HS 5/68/R 1787/39/G. Telegram nga FO në Kajro, më 6 shkurt 1944.

⁶⁶ AQSH, F. 41, V. 1944, D. 158.

⁶⁷ Po aty, F 41/Shtabi Përgjithshëm i UNÇSH, V. 1944, D. 148, fl. 79-81.

⁶⁸ PRO. FO 371/43553/R 14256. Telegram from Bari to Resident Central Mediterranean Caserta, 7 shtator 1944.

tjerët u njoftuan për të raportuar në Shtab, që do të thoshte largim i misionit nga Kupi dhe nga Shqipëria⁶⁹.

Britanikët ishin mbështetësit financiarë dhe ushtarakë kryesorë të Hoxhës, por pas asgjësimit të rivalëve të brendshëm, britanikët mbetën “opozita” e vetme e tij. Të gjitha të dhënat tregojnë se marrëveshja e Mukjes u prish për motive pushteti. Pas Mukjes u fshinë të gjitha skemat e një qeverisjeje demokratike pas lufte. Është krejt e qartë se ky ishte kontribut i drejtpërdrejtë i të dërguarve jugosllavë, dy prej të cilëve, Miladin Popović dhe Dushan Mugosha (Dušan Mugoša), ishin më shumë se këshilltarë permanentë të partisë komuniste. Më 9 tetor 1943, J. B. Tito nisi një letër për në Shqipëri, e cila u duhej dorëzuar “me çdo kusht shokëve shqiptarë”. Me këtë rast ai porosiste bashkëpunëtorët e tij: “Lidhuni ngushtë me ta (shokët shqiptarë - shënimi im, A. L.) dhe ndihmojini me këshilla etj., që të mos i mashtrojnë ndonjë agjent drazhist shqiptar dhe anglezët të mos i venë nën ndikimin e tyre, siç kanë bërë me partizanët grekë”.⁷⁰ Pas këtij orientimi, Hoxha lëshoi një qarkore, e njohur me emrin “qarkorja Shpati”, me të cilën kërkohet prerë “të mos i lëmë britanikët të fusin hundët në punët tona të brendshme”.⁷¹ Kësaj linje Hoxha i qëndroi me konsekuencë.

Është e njohur që organizimi i luftës, organet dhe formacionet ushtarake të saj në Shqipëri janë modeluar sipas

⁶⁹ PRO. HS 5.71. Radiogram i HQ Force 399 dërguar HQ LFA, më 17 tetor 1944. Bari SOE kërkon largimin e Macleanit nga formacioni i Kupit.

⁷⁰ “Direktiva Vrhovnog Komandanta NOV i POJ druga Tito od 9 octobra 1943 II Korpusu Narodno-Oslobodilačke Vojske Jugoslavije”, *Zbornik dokumenata i podataka o Narodnooslobodilačkom Ratu Jugoslovenskih Naroda*, Tom II, Knjiga 10, Vojnoistorijski Institut, Beograd: 1962, f. 369.

⁷¹ “Direktiva e KQ të PKSH dhënë komiteteve qarkore të Partisë, për forcimin e lidhjeve me Bashkimin Sovjetik, për qëndrimin kundrejt Ballit Kombëtar, Legalitetit dhe misionëve angleze për forcimin e frontit, të këshillave dhe të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, për forcimin e partisë dhe të organizatave të tjera antifashiste”, më 3 nëntor 1943, *PPSH – dokumente kryesore...*(burim i përmendur), f. 232-233.

shembullit jugosllav. Por, dokumentet arkivore tregojnë se këshillat e Titos për Shqipërinë ishin edhe më përtej nga sa mund të bënte ai vetë në vendin e tij. Ai udhëzoi për një kongres (është fjala për Kongresin e Përmetit, maj 1944), i cili të shpallte një komitet antifashist në rolin e një qeverie të përkohshme, me arsyetimin se Shqipëria e kishte më të lehtë ta bënte këtë pa vonesë, pasi nuk kishte një qeveri tjetër të njohur nga Aleatët.⁷² Pas dimrit të vështirë të vitit 1943 - 44, kur Hoxha kishte mbetur i rrethuar për tre muaj në fshatrat e Çermenikës (dhjetor 43 - shkurt 44), iu përvesh punës për organizimin dhe zhvillimin e Kongresit të Përmetit⁷³. Si model u morën vendimet e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë (AVNOJ), akte që juristi i diplomuar në Tuluzë, Manol Konomi, e pati shumë të vështirë t'ia përshtaste Kongresit të Përmetit. Tito ishte i kënaqur me praktikatat përjashtuese të Hoxhës dhe eliminimin e kundërshtarëve, siç bëri vetë me Mihajloviçin. Por në ndryshim nga Hoxha, Tito u kushtëzua nga britanikët se çdo hap i mëtejshëm, do të varej nga marrëveshja e tij me qeverinë e mbretërisë jugosllave në Londër (pa Mihajloviçin). Kjo marrëveshje u arrit dhe fryt i saj ishte pjesëmarrja e Ivan Subashiçit (Ivan Subašić), kryeministër i qeverisë mbretërore, si ministër i jashtëm në qeverinë e përkohshme të koalicionit të kryesuar nga Tito (mars-nëntor 1945).

Ndërsa partizanët shqiptarë ishin të çliruar nga çdo kusht i këtij lloji, pikërisht se nuk kishte një qeveri shqiptare të njohur. Për fat të keq, këto ishin favore për Hoxhën dhe ai i kishte duart e lira në planet e tij të pasluftës. Shqipëria, megjithëse një nga viktimat e para të fashizmit në Evropë, nuk u ftua për të qenë

⁷² AQSH, F. 14, AP – PKSH, V. 1943-1944, D. 39, “Letër e Titos drejtuar Miladin Popoviçit”, më 9 tetor 1943.

⁷³ Në fillim të prillit 1944, Hoxha mbledhi Plenumin e KQ PKSH, i cili i propozoi Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm NÇ, thirrjen e Kongresit Antifashist NÇ. Vendimi i Kryesisë për thirrjen e Kongresit, i marrë më 15 prill 1944, u miratua në plenumin e parë të KQ PKSH, të mbledhur në HELMËS, më 15 maj 1944.

firmëtare e Deklaratës së themelimit të Kombeve të Bashkuar antifashistë, në janar 1942. Kjo do të thoshte se Shqipëria nuk ishte anëtare zyrtare e Aleancës, siç ishin p.sh. fqinjët e saj, Jugosllavia dhe Greqia, të cilat në Aleancë përfaqësoheshin me qeveritë e veta në emigracion. Në Shqipërinë e pushtuar nga Italia fashiste, qeveria e krijuar brenda vendit ishte kuislinge, kurse në emigracion nuk u krijua dot një qeveri shqiptare përfaqësuese. Edhe Zogu, që atëkohë jetonte në Londër, nuk u njoh nga Aleatët si kryetar i ligjshëm i shtetit shqiptar dhe po kështu nuk u njoh as një qeveri shqiptare në emigracion. Për rrjedhojë Qeveria e Madhërisë së Tij [Britanisë së Madhe] nuk e konsideronte Shqipërinë një aleate zyrtare të saj dhe kjo pati reperkusione në statusin e Shqipërisë gjatë dhe pas Luftës. Një deklaratë e ministrit të Jashtëm britanik, Anthony Eden, në Dhomën e Komuneve të Parlamentit britanik, në dhjetor 1942, më shumë i shqetësoi se i qetësoi shqiptarët. Sipas asaj deklarate, Qeveria e Madhërisë së Tij njihte luftën antifashiste të popullit shqiptar, garantonte pavarësinë e Shqipërisë pas luftës, por nuk njihte as qeverinë e ligjshme shqiptare, dhe nuk garantonte as kufijtë e shtetit shqiptar të pavarur të paraluftës. Qeveria e Madhërisë së Tij e konsideronte çështjen e kufijve të shtetit shqiptar pas lufte si një çështje e cila do të duhej të shqyrtohej në zgjidhjet e Paqes. Me këtë deklaratë, ministri i Jashtëm britanik e kishte lënë ‘derën hapur’ për kërkesat greke ndaj Shqipërisë së pasluftës.

E fundit, është folur se britanikët kanë pasur qëllime zbarkimi në Shqipëri. Shtabi Aleat i Mesdheut kishte planifikuar të dërgonte disa njësi komando për operacione në ndihmë të partizanëve shqiptarë. Ky plan veprimesh iu paraqit Hoxhës më 16 shtator 1944 nga oficeri ndërlidhës me Shtabin e Përgjithshëm, Alan Palmer. Fillimisht Hoxha e kundërshtoi hyrjen e trupave speciale, por mareshali Henry Maitland Wilson, komandant i Shtabit të Mesdheut, e njoftoi Hoxhën se trupat komando të tij do të përdorreshin në ndihmë të partizanëve dhe sapo të kryhej detyra,

“ata do të largoheshin menjëherë”, sepse kishin aksione të tjera në Ballkan.⁷⁴ Pas kësaj u dha leja.

Nuk është e sigurt nëse britanikët kishin qëllime të mirëfillta zbarkimi në fund të luftës, megjithëse ka dokumente në mbështetje të kësaj teze. Kështu pas operacionit të komandove në Sarandë, zyra e Barit njoftonte Foreign Office se shpresohej që “çdo gjë të shkojë mirë” dhe të mbanin në Shqipëri “një bazë të përhershme”.⁷⁵ Pohime të ngjashme gjejmë edhe tek ata që kanë shkruar kujtimet për luftën, madje edhe nga vetë oficerët britanikë, sado që ata janë më të rezervuar. Në këto burime flitet edhe për një planzbarkimi të një regjimenti të motorizuar në bregdetin e Ishmit, që do t’u vinte në ndihmë forcave të Kupit.⁷⁶ Frikën e zbarkimeve britanike e ka pasur edhe vetë Tito, i cili kundërshtoi një kërkesë të Churchill-it, në dhjetor 1944, që disa divizione britanike të zbrisnin në Dalmaci, gjë që u bë shkak për një mesazh të ashpër që kryeministri britanik i ktheu Titos.⁷⁷ Duket se, ashtu si Tito, edhe Hoxha është ndjerë i pasigurt. Nuk është fjala për një ripushtim në kuptimin klasik, por në Jugosllavi, prania e shtuar e ushtrive britanike, mund të rikthente në skenë Mihajllloviçin, ashtu siç ishte i gatshëm Kupi në Shqipëri.

Sigurisht, Britania e Madhe i kishte mundësitë ushtarake për zbarkim, por kishte të kufizuara mundësitë politike. Është ndryshe të hysh me komando për aksione të veçanta e ndryshe të hysh me trupa e njësi të motorizuara. Ky do të quhej pushtim dhe mund të krijonte probleme midis Aleatëve. Në çastet kur Churchill-i ishte i preokupuar të mos i ikte Greqia nga duart, ai

⁷⁴ AQSH, F. 41, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇ, V. 1944, D. 140.

⁷⁵ PRO. FO 371/43572, 28th September 1944, Mr. Broad from Bari to FO, tel. N° 722, Reapeted to Resmed Caserta.

⁷⁶ Beqir Ajazi, *Nga shkaba me kurorë te drapri me çekan*, Tiranë: Shtëpia botuese “55”, 2007, f. 170-171, 177; Shih gjithashtu: Julian Amery, *Bijtë e Shqipës*, Tiranë: “Lumo Skëndo”, 2002, f. 302, 356.

⁷⁷ Vladimir Dedijer, *Documenti 1948*, Knjiga prva, Volume I, Beograd: 1980, f. 60.

nuk mund të provokonte me Shqipërinë. Dhe kur në tetor 1944, në Moskë, midis atij e Stalinit u arrit marrëveshja për Greqinë dhe Ballkanin në përgjithësi, për Shqipërinë nuk u fol. Në fakt, dokumentet provojnë se më 11 tetor Churchill-i i ka kujtuar ministrit të tij të Jashtëm Eden se Shqipëria nuk ishte përmendur deri atëherë në bisedime dhe personalisht ai mendonte që “ne duhet të këmbëngulim në rregullimet 50 me 50 me sovjetikët”.⁷⁸ Por në 14 blloqet, me mbi gjithsej 800 fletë (regjistrime të takimeve bashkë me materialet ndihmëse), të hapura deri më tani, me të cilat unë jam këshilluar, dhe që gjenden në Arkivin Kombëtar të Londrës (National Archives in Kew), nuk ka ndonjë shenjë të jetë folur as më vonë për Shqipërinë, gjatë gjithë ditëve të bisedimeve. Ka prej atyre që shënimin e mësipërm të Churchill-it e vlerësojnë ezaurues në rastin e Shqipërisë⁷⁹, por, sipas meje, ky shënim nuk e mbyll, përkundrazi e shton enigmën. Jo harresa, por shmangia për ta sjellë çështjen në bisedime, të bëjnë të hamendësosh për arsyet që qëndrojnë pas saj, që do të thotë se këtij vendi ose i duhej ndenjuri larg ose ai ishte lënë i hapur për negociata të ardhshme.

⁷⁸ PRO Premier 3/41. Letër e Churchillit për Anthony Eden lidhur me Shqipërinë, më 11 tetor 1944.

⁷⁹ Behar Shtylla, “Fundi i një enigme diplomatike”, *Zëri i Popullit*, 9 tetor 1994.

Akademik assoc. Marenglen VERLI
(Tiranë)

ANTIFASHIZMI, ALTERNATIVA E PERSPEKTIVËS PËR KOMBIN SHQIPTAR

Problematika e trevave dhe e kombit shqiptar në vitet e Luftës së Dytë Botërore është shumë e gjerë. Në këtë trajtesë synimi kufizohet në fokusimin vetëm të *pozicionit të mbajtur përgjithësisht nga shqiptarët ndaj konfliktit botëror dhe, brenda këtij kuadri, të përcaktimit se sa realist ishte pozicionimi i tyre dhe i forcave politike që e nxitën atë.*

Gjithsesi, qoftë edhe vetëm në këtë këndvështrim, problemi nuk është i pa trajtuar. Por, për fat të keq, ai ende aty këtu ka mbetur në diskutim nga historiografia e huaj dhe, sidomos diferencohet e shtrembërohet nga historiografia serbo - jugosllave, veçanërisht kur është fjala për shqiptarët e Kosovës dhe ata të viseve të tjera të aneksuara në ish-Jugosllavi¹. Problemi ka qenë lënë pa trajtimin e duhur edhe nga historiografia shqiptare në të dy

¹ D. Bogdanoviq, *Knjiga o Kosovu*, Belgrade 1985; E. Kardeli, *Lufta për njohjen dhe pavarësisë e Jugosllavisë së Re, 1944-1947*, Kujtime, Prishtinë 1981; S. Gjakoviq, *Sukabi na Kosovu*, Belgrade 1984; S.V.Tempo, *Revolucija koja teçe*, Beograd 1981; S.V. Tempo, *Borba za Balkan*, Lubjanë 1981; V. Dedijer, *Marrëdhëniet jugosllave-shqiptare (1939-1948)*, Beograd 1949.

anët e kufirit (natyrisht me specifikat respektive), për shkak të pengesave të ndryshme objektive e subjektive, të cilat, në forma të reja gjatë 24 vjetëve të fundit, ende janë të pranishme². Madje në këtë periudhë ka ndodhur që rishikime të bëra me paragjykime, pa njohuri, pa argumente dhe pa seriozitetin e nevojshëm shkencor, shpesh për motive thjesht abuzive partiako - politike, të venë në pikëpyetje edhe konkluzione të padiskutueshme të arritura më parë, jo vetëm nga historiografia shqiptare por dhe ajo botërore³. Natyrisht nuk kanë munguar, nuk mungojnë as sot, përpjekjet për një trajtim objektiv, veçanërisht të thelbit të problemit⁴. Ato konfirmojnë se *kombi shqiptar iu bashkua koalicionit të madh antifashist duke dhënë kontributin e vet jo të vogël, përkrah shteteve dhe kombeve që morën pjesë në të, se pozicioni i tillë i shqiptarëve ishte i vetmi që mund të zgjidhej për t'u shërbyer interesave kombëtare të perspektivës dhe se forcat politike dhe individët që punuan për këtë alternativë, pavarësisht nëse ishin vizionarë të kthjellët idealistë apo pragmatistë të shkathët, në fund të fundit, realisht, kontribuan që aspiratave mbarëkombëtare, për një Shqipëri të lirë e të bashkuar, të mishëruara në programin e Rilindjes, të mos u mbyllej horizonti.*

Pavarësisht nga arritjet, historiografisë sonë i mbetet shumë për të bërë për periudhën e Luftës së Dytë Botërore. Kjo është një detyrë e ngutshme që lind jo vetëm për motive shkencore, jo vetëm nga nevoja e ballafaqimit me historiografinë e fqinjëve dhe më gjerë, por edhe sepse evidentimi dhe analiza

² *Historia e Shqipërisë*, V.III, Tiranë 1984; A. Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë 1941-1945*, Prishtinë, 1971; M. Kodra, *Shqiptarët e Maqedonisë gjatë Luftës së Dytë Botërore (1939-1944)*, Kumanovë 1996.

³ R. Hibert, *Fitorja e hidhur, Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë*, Tiranë 1993; W. Tilman, *Kujtime që nuk shlyhen*, Tiranë 1997.

⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.IV, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2008, f. 23-161; L. Nasi, *Ripushtimi i Kosovës*, Tiranë 1994; Xh. Gjeçovi, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës*, Tiranë 1998; Xh. Gjeçovi, *Lufta Nacionalçlirimtare në Shqipëri*, Tiranë 1999.

realiste e ngjarjeve dhe figurave të kohës do në na përcillte mesazhe me vlerë dhe do të frenonte spekulimet që bëhen sot nga segmente të caktuara të politikës (duke nxitur diferencime, duke shkëmbyer akuza të rënda, madje duke lançuar idenë irracionale se gjatë Luftës një reshtim tjetër do të kish qenë shpëtimtar etj.) në dëm të unitetit kombëtar, si edhe të ndërtimit të një strategjie unike kombëtare.

Duke u bashkuar me konkluzionin se kombi shqiptar ishte pjesëtar i koalicionit antifashist, do të mundohem të paraqes dhe argumentet e nevojshëm, çka besoj se mund të bëhet duke u dhënë përgjigje analitike një sërë pyetjesh:

Sa dhe si u inkuadrua kombi shqiptar përkrah Koalicionit Antifashist? A pati diferenca në këtë inkuadrim midis trevave të ndryshme shqiptare, brenda dhe jashtë kufijve politikë të 1913-ës? Në se pati diferenca sa ishin ato dhe përse u krijuan? Sa ndikoi faktori ndërkombëtar dhe sa faktori shqiptar në vetvete për krijimin e këtyre diferencave? Çfarë rrezikoi dhe çfarë fitoi kombi shqiptar duke u rreshtuar në krah të aleancës antifashiste dhe a kishte realisht alternativë tjetër për të zgjedhur? Mund të shtroheshin edhe pyetje të tjera.

Le t'u përgjigjemi pyetjeve me argumente sa më të qëndrueshëm.

Së pari, sa dhe si u inkuadrua kombi shqiptar përkrah Koalicionit Antifashist?

Shqiptarët e kishin filluar rezistencën antifashiste qysh më 7 prill 1939. Gjashtë vjet më vonë, në nëntor 1944, kur Lufta e Dytë Botërore në viset shqiptare po përfundonte, në njësitë e armatosura të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar të Shqipërisë, sipas të dhënave zyrtare, numëroheshin rreth 70 mijë partizanë, të inkuadruar në 24 brigada, përkatësisht në 8 divizione dhe 3

korparmata⁵. Rreth 53 mijë luftëtarë të tjerë bënin pjesë në formacionet që ishin krijuar në Kosovë, të inkuadruar në 9 brigada dhe në njësi të tjera më të vogla⁶. Ndërkohë për të dëshmuar sakrificat e bëra në luftën kundër pushtuesve fashistë janë publikuar shifrat: 28 mijë dëshmorë në Shqipëri dhe 6 mijë të tjerë në Kosovë; pa llogaritur dëmet e mëdha materiale në infrastrukturë, në degët e ndryshme të ekonomisë, në fondin e banesave etj.⁷

Edhe pse disa nga të dhënat e mësipërme janë të kontestueshme (numri i dëshmorëve vlerësohet vitet e fundit se ka qenë pesëfishuar) edhe pse nuk dihet sa vetë humbën jetën nga lufta ndërmjet shqiptarëve në vitet 1943-1944, edhe pse nuk dihet sa ishte pjesëmarrja e pakicave etnike në përbërje të formacioneve partizane, veçanërisht në Kosovë, (në kuadrin e gjithë banorëve të trevave shqiptare pakicat ishin prezente jo më tepër se 10-12 për qind), përsëri mund të konkludohet se aktivizimi dhe sakrificat e kombit shqiptar prej afro dy milionësh, në të dy anët e kufirit të 1913-ës, përkrah koalicionit antifashist, ishin masive. Rreth 7 për qind e popullsisë së trevave shqiptare, ose rreth 25 për qind e meshkujve të aftë për armë, sipas të dhënave të sipërpërmendura, u rreshtuan me aleatët, kurse 1,7 për qind e popullsisë humbi jetën në luftën kundër fashizmit. Nëse do të llogarisnim edhe formacionet e tjera shqiptare të armatosura, që në raste të ndryshme, të organizuara ose spontanisht, luftuan ose ishin gati të luftonin kundër fashizmit italo - gjerman dhe kundër aleatëve të tij të hapur ose të maskuar ballkanas, sikurse ishin p.sh. çetnikët serbo - malazezë, përqindja e shqiptarëve që luftuan e sakrifkuan rritet dhe më tepër. Madje kombi shqiptar, pasi çliroi pa

⁵ *Historia e Shqipërisë*, vëll. III, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë 1984; *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar*, vëll. I, II, III, IV (prill 1939-nëntor 1944), Tiranë 1983.

⁶ A. Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë...*

⁷ *Po aty*.

pjesëmarrjen e ushtrive të huaja territorin e vet nga trupat pushtuese fashiste, rast unikal ky në Evropë (në viset shqiptare siç dihet vepruan vetëm misionet ushtarake të aleatëve), kontribuoi edhe për shpartallimin e trupave naziste në Mal të Zi, në Sanxhak, në Bosnje, në Kroaci dhe në Slloveni.

Por a nuk do të ishte e drejtë që si luftëtarë antifashistë të llogariteshin edhe pjesëmarrësit e revoltave të dimrit 1944-1945 në Kosovë, sepse ata luftuan kundër çetnikëve me uniforma të partizanëve jugosllavë, madje ende pa mbaruar Lufta e Dytë Botërore? (Fashizmi në Evropë nuk është përfaqësuar vetëm nga Hitleri e Duçja dhe ushtritë e Rajhut e të Imperos. Fashizmi ka pasur figura të vetat edhe Pilsudskin në Poloni, Hortin në Hungari, Frankon në Spanjë, ka pasur aleat Stojadinoviçin në Jugosllavi etj. Në fund të fundit çetnikët, ushtarët etj., kishin përfaqësuar fashizmin në Jugosllavi). Po kështu, në radhët e të rënëve kundër fashizmit a nuk duhen numëruar edhe ushtarët shqiptarë të armatës jugosllave, që u nisën në luftë kundër trupave italo - gjermane më 6 prill 1941 dhe u vranë prapa krahëve nga oficerët e tyre serbë, mandej edhe të mobilizuarit e masakruar në Tivar, që shkonin në front kundër fashistëve, edhe ata që u zhdukën në Frontin e Sremit me urdhër të Shtabit Jugosllav, edhe të vrarët në Drenicë, Ferizaj, Tetovë etj., nën etiketën “reaksionarë” e “ballistë”, të cilët ishin jo pak, po rreth 47 mijë vetë? Atëherë shifrat zyrtare të përmendura më sipër do të lëviznin dukshëm dhe shqiptarët që luftuan kundër fashizmit real, për liri e demokraci, do të dilte se kanë përbërë ndoshta 10 për qind të popullsisë shqiptare, kurse të rënë 4 për qind të saj.

Natyrisht midis forcave të ndryshme politike shqiptare, që kishin në programet e tyre çlirimin nga pushtuesi fashist, ose midis segmenteve të tyre, kishte mjaft kontradikta. Ato krijuan edhe probleme të brendshme e rajonale, për shkak rivalitetesh ose

konceptimesh të ndryshme të situatave dhe në këtë kuadër pati edhe çoroditje, afrime e largime në tentativat për bashkëpunim, edhe orientime të gabuara, madje edhe përplasje, por kjo nuk ndodhi vetëm në Shqipëri dhe nuk përbën thelbësoren në tërësinë e angazhimit antifashist të kombit shqiptar. Për të përcaktuar se kush veproi më drejt dhe kush ishte më i vyer për Koalicionin Antifashist, në konstelacionin e forcave shqiptare, një tregues i rëndësishëm është qëndrimi i aleatëve perëndimorë ndaj grupimeve të ndryshme të shqiptarëve, i mbajtur mbi bazën e seleksionimit të asaj që ishte më thelbësore për momentin, në morinë e çështjeve të ndryshme. Pa dyshim, më thelbësore atëherë gjykohej pjesëmarrja sa më aktive në luftë për shpartallimin e fashizmit⁸. Kjo linjë e ndjekur nga anglo - amerikanët do t'i forconte pozitën e Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar në Shqipëri (krijuar më 16 shtator 1942) të drejtuar nga PK Shqiptare, kundrejt Ballit Kombëtar (krijuar nëntor 1942) dhe Legalitetit (krijuar nëntor 1943), si dhe të Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Kosovë (në prill u krijua Shtabi i UNÇK, në dhjetor Këshilli NÇKKP), edhe pse të drejtuar nga PK Jugosllave, kundrejt “Lidhjes së Dytë të Prizrenit” (krijuar më 16 shtator 1943). Ndonëse me mjaft influencë, këto organizata nacionaliste, me pasivitetin në luftën antifashiste, që i çoi disa figura të tyre në rrugën e bashkëpunimit me pushtuesit, dolën gradualisht jashtë loje, duke zhgënjyer e çoroditur pasuesit e tyre dhe duke i kontribuar monokolorit partiako - politik të pas luftës.

Po sa ishte numri i atyre shqiptarëve që u kthyen në bashkëpunëtorë të pushtuesve, që i kthyen armët popullit të vet dhe Koalicionit Antifashist dhe sa u inkuadruan në Luftën Antifashiste? Pyetja nuk mund të marrë përgjigje të saktë, me gjendjen e deritanishme të studimeve.

Si kudo në vende të ndryshme të Evropës së pushtuar nga fashizmi (madje kjo ndodhi edhe në vendet e papushtuara), edhe

⁸ R. Hibert, *Fitorja e hidhur...*; W. Tilman, *Kujtime që nuk shlyhen...*

në trevat shqiptare, përveç forcave të rezistencës, apo forcave që u deklaruan të tilla, si edhe atyre që u përpoqën të qëndrojnë asnjnës, ekzistonte edhe kategoria e kolaboracionistëve, të cilësuar të tillë për shkak të raporteve të dukshme të bashkëpunimit me pushtuesit. Për ta thuhet se, pak apo shumë, për një kohë të shkurtër apo të gjatë, në rrethana të thjeshta apo të ndërlikuara, të mashtruar apo me ndërgjegje, u kanë shërbyer pushtuesve. Por cilët duhen konsideruar kolaboracionistë të vërtetë? A ishin bashkëpunëtorë të vërtetë të pushtuesve gjithë ato kategori të rrogëtarëve të regjimit të kohës, të gjithë efektivat e reparteve të ushtrisë, milicisë, xhandarmërisë etj. Pa iu përgjigjur këtyre pyetjeve nuk mund të jepet asnjë e dhënë reale për numrin e kolaboracionistëve. Sigurisht nuk duhet dhe nuk mund të konsiderohen të tillë në radhë të parë të gjithë ata nëpunës, ushtarakë etj., që, edhe pse nuk u bashkuan hapur me formacionet antifashiste, simpatizuan dhe, sa e si mundën, ndihmuan luftën antifashiste. Nuk mund të ishin të tillë p.sh. efektivat e batalioneve shqiptare, që u dërguan më 1940 në frontin italo - grek dhe nuk pranuan të luftonin për fashizmin. Po Bedri Pejani, atdhetar i njohur, veçanërisht në vitet 20 - 30, sekretari i dikurshëm i Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”, miku dhe nxitësi i Asim Vokshit për të shkuar vullnetar në Spanjë, shok i Gjergj Dimitrovit, por edhe drejtues për disa muaj i “Lidhjes së Dytë të Prizrenit”, njeriu të cilin Fadil Hoxha, (numri një i Lëvizjes Antifashiste në Kosovë), nuk nguronte ta vizitonte në burgun e Jugosllavisë së re e t’i çonte cigare⁹, si duhet quajtur? Po prefekti i Pejës e më pas i Tetovës, Tafil Boletini, një veprimtar i hershëm i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, krah i djathtë i Isa Boletinit, me merita në lirimimin e sa e sa të burgosurve antifashistë në vitet e

⁹ P. Uli, Q.Sakajeva, *Asim Vokshi*, Tiranë 1979; *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Kujtimet e Rexhep Shpendit.

Luftës, babë i një antifashisti të vendosur, nga ata që më pas do të vuanin Goli - Otokun, si duhet quajtur¹⁰? Po afaristi Vangjel Peristeri, që nuk hezitoi të rrëmbente nga zyrat e autoriteteve të pushtimit hartat që u nevojiteshin miqve të tij guerilas e partizanë¹¹? Sa e sa raste duhen parë konkretisht e një për një.

Nëse do të llogariten kolaboracionistë vetëm ata që deri në fund të luftës i qëndruan pranë okupatorit duke i shërbyer verbërisht, atëherë kombi ynë mund të krenohet se kishte ndoshta numrin më të vogël në Evropë të kolaboracionistëve të vërtetë. Është domethënës fakti se ndryshe nga shumë kombe të tjerë të Evropës shqiptarët nuk dhanë trupa të armatosura që të luftonin përkrah divizioneve fashiste në frontet e mëdha të Lindjes ose të Perëndimit, madje as reparte që të përdreshin për të shtypur lëvizjen antifashiste të popujve fqinjë. Nuk morën thjesht as hak mbi pjesëtarët e kombeve, që deri në prag të Luftës i kishin shtypur e terrorizuar. Rasti i Kosovës në vitet 1941 - 1944 dëshmon për këtë. Dihet botërisht se çfarë u ndodhi serbëve në Kroaci. Dihet gjithashtu se si qëndron në kuadrin e Jugosllavisë raporti i të rënëve në luftë kundër fashizmit me të vrarët nga përplasjet e brendshme nacionale e politike. Gjatë Luftës së Dytë Botërore shqiptarët jo vetëm nuk i ranë kujt në qafë për llogari të fashizmit, por, duhet theksuar, se në trevat shqiptare hebrenjtë e Ballkanit gjetën një strehë të paimagjinuar, kurse lëvizja antifashiste e kombeve fqinjë gjeti më tepër se një prapavijë të sigurt. Tipik është rasti i lëvizjes antifashiste të popullit maqedonas, i cili terrenin kryesor ku u zhvillua e pati në trevat shqiptare, ku jetonte edhe popullsi maqedonase¹².

Në vijim të pyetjeve, që u parashtruan, fillimisht do të shtonim se inkuadrimi masiv i shqiptarëve në krahun e koalicionit antifashist nuk përjashton ekzistencën e *diferencave gjeografike*

¹⁰ T. Boletini, *Përballë sfidave të kohës (1916-1963)*, Tiranë 1996.

¹¹ N. Luçi, *Kujtime lufte*, Tiranë 1975.

¹² M. Kodra, *Shqiptarët e Maqedonisë gjatë Luftës së Dytë Botërore...*, etj.

dhe sociale lidhur me kohën dhe përmasat e këtij inkuadrimi. (Në veri lëvizja ishte më e dobët se në jug, në Kosovë më e vonuar, krahasuar me Shqipërinë). Këto diferenca, sikurse dihet, lidheshin me faktorë të ndryshëm e të shumtë, ndër të cilët si faktorë të brendshëm rol të konsiderueshëm luanin niveli i zhvillimit ekonomik - shoqëror rajonal, tradita e organizimit, niveli i arsimimit, influenca e forcave të ndryshme politike, pozicioni gjeografik në kuadër të trevave shqiptare, përbërja etnike, ekspozimi përballë rrezikut që vinte nga formacionet terroriste të kombeve fqinj etj. Vonesa relative, për shembull, e shqiptarëve të Kosovës për të hyrë në veprim, lidhet me kushtet e tyre specifike, përkatësisht me gjendjen e tyre të padurueshme të paraluftës, që kishte keqësuar seriozisht raportet shqiptaro-sllave, për pasojë me situatën më të mirë nën pushtimin e ri fashist, që krahasuar me të kaluarën përjetohej gati si çlirim, mandej lidhej me rrezikun e vazhdueshëm çetnik serbo - malazez gjatë gjithë periudhës 1941 - 1944, lidhej me politikën tendencioze shovene të PK Jugosllave, që drejtonte atje lëvizjen antifashiste por që në fakt me politikën që ndoqi pengonte përfshirjen e shqiptarëve në të etj.¹³ Faktorët e përmendur janë të njohur, po ashtu edhe pasojat që ata sollën.

Duhet nënvizuar se në rrethanat e kohës *faktori ndërkombëtar*, përkatësisht situata në Ballkan dhe qëndrimi i Fuqive të Mëdha Perëndimore Evropiane e Botërore, pjesëtare të Koalicionit Antifashist, nuk i favorizonte shqiptarët. Kjo nuk mund të mos ndikonte që në vise të ndryshme shqiptare, veçanërisht në ato që kishin vuajtur nën zgjedhën e huaj pas vitit

¹³ L. Nasi, *Ripushtimi i Kosovës...*; M. Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, Tiranë 1997; M. Piraku, *Ripushtimi jugosllav i Kosovës*, Prishtinë 1992; M. Kodra, *Shqiptarët e Maqedonisë gjatë Luftës së Dytë Botërore...*; M. Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë në vitet 1918-1941*, Tiranë 1992; H. Bajrami, *Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1918-1941*, Prishtinë 1981; etj

1913, në shtresa të caktuara të popullsisë dhe në forca të caktuara politike, të mungonte motivi i nevojshëm për t'u hedhur pa rezerva në veprim. Njohja në dhjetor 1942 e Luftës sonë Çlirimtare, nga Britania e Madhe, SHBA dhe BRSS, nuk garantonte më tepër se ekzistencën e shtetit shqiptar të paraluftës. Mosnjohja e kufijve të ndryshuar si rezultat i pushtimeve të shteteve fashiste, të cilat realisht për shqiptarët kishin bërë deri diku një korrigjim të padrejtësive të së kaluarës dhe në fakt përmirësimin e gjendjes së tyre në Kosovë etj., mandej prononcimi i mjegullt i PK Jugosllave për të drejtën për vetëvendosje deri në shkëputje pas luftës, ndërkohë që shqiptarët kërkonin t'u pohohej qartë dhe menjëherë se do t'u jepej mundësia të realizonin aspiratën e tyre për t'u bashkuar me shtetin shqiptar, për më tepër hapat e PKJ në drejtim të kundërt, në favor të ruajtjes së Jugosllavisë në kufijtë e paraluftës (shih vendimet e Jajcës, nëntor 1943) e deri pengesat për zhvillimin e lëvizjes antifashiste në Kosovë etj., ishin elementë që nuk mund të kapërceheshin lehtë nga kushdo. (Do të shtonim në parantezë se qëllimisht, që gjatë luftës, PKJ, u përpoq të krijonte opinionin se ndryshe nga situata në Shqipëri, situata në Kosovë kontrollohej nga reaksioni dhe se gjoja shqiptarët e Kosovës ishin të gjithë bashkëpunëtorë të fashizmit. Çfarë projekte bëheshin fshehtas në Shtabet e UNÇL Jugosllave, provohet nga dokumentet e kohës, nga ngjarjet e mëvonshme madje edhe nga guximi i Vasa Çubrilloviqit të njohur, që kish kurajën t'i paraqiste në nëntor 1944 forcës së re politike që po merrte pushtetin në Jugosllavi, një elaborat të ngjashëm me atë të vitit 1937, ku llogaritej në detaje spastrimi etnik i Jugosllavisë nga “pakicat” jo sllave. Kjo Platformë e spastrimit etnik për Kosovën dhe më gjerë parashikonte në thelb po atë qëndrim që çetnikët e Drasha Mihajloviçit e patën deklaruar haptas qysh në fillim të Luftës)¹⁴.

¹⁴ L. Nasi, *Ripushtimi i Kosovës...*; M. Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore...*; V. Çubrilloviqi, *Problemi i pakicave në Jugosllavinë e re*, 3 nëntor 1944, në

Siç shihet, në situatën që ekzistonte, rreshtimi në një koalicion ku merrnin pjesë serbët dhe përgjithësisht sllavët, të dëshmuar më se një herë si armiq të kombit shqiptar, për më tepër me pikëpamje të njësuara antishqiptare në të gjithë spektrin e tyre partiako – politiko - ideologjik, madje rreshtimi kundër italo - gjermanëve, me kontribut në të kaluarën për njohjen dhe konsolidimin e shtetit shqiptar, të llogaritur aleate të natyrshëm të shqiptarëve në rrethana normale, kërkonte largpamësi dhe guxim. Troç, përzgjedhja e aleatëve kërkonte një vizion sa idealist aq dhe pragmatist perspektiv, duke peshuar mirë raportin e forcave në arenën ndërkombëtare dhe duke studiuar strategjinë globale të Fuqive të Mëdha perëndimore, që ishin shpirti i koalicionit antifashist.

Sot është vështirë të pohohet sa rastësisht, ndikuar nga elementë të traditës ose të momentit, apo sa në sajë të vizionit të qartë e llogaritjeve të sakta, shumica dërmuese e shqiptarëve u rreshtua në koalicionin antifashist. Sidoqoftë, të majtët e të djathtët e spektrit politik shqiptar të kohës, apo komunistët dhe nacionalistët, që u mirëkuptuan për të luftuar fashizmin, edhe pse të gjithë e synonin pushtetin pas luftë, edhe pse niseshin nga pikëpamje të ndryshme për ndërtimin e Shqipërisë së pasluftës, duke e konceptuar me një regjim si në BRSS, ose me një regjim si në demokracitë perëndimore, edhe pse shpreheshin shumë apo pak për çështjen e një Shqipërie në kufijtë e natyrshëm etnikë pas luftës, duhet të kenë kuptuar se nuk kishte alternativë tjetër përveç bashkimit me koalicionin antifashist. Në të kundërt pasojat negative do të ishin të pashmangshme dhe të paparashikueshme. Nuk mund të ishin realiste pikëpamjet për pasivitet e pritmëni, që të shmangeshin dëmet që sjell lufta. Është miopi të mendohet se mund të luhej me aleatët e mëdhenj të koalicionit antifashist, duke

shijuar në fund frytet e sakrificave të tyre, ndërkohë që ata, pa ndërprerje, kërkonin qartë e me këmbëngulje luftë aktive kundër trupave fashiste të pushtimit dhe linin të kuptohet se do të përkrahnin atë palë që luftonte. Nuk mund të ishte gjithashtu realiste politika e asnjësisë që ndoqën disa atdhetarë kosovarë, për shkak të mosbesimit ndaj PKJ, që drejtonte luftën antifashiste në Kosovë. Kurse bashkëpunimi me pushtuesit, duke theksuar “kontributin e tij” për krijimin e “Shqipërisë së Madhe”, zgjidhje kjo as e plotë, as definitive dhe as pa probleme, ndërkohë që aleatët perëndimorë paralajmëronin se bashkimi me Fuqitë e Boshtit do të vinte në pikëpyetje pretendimet për të zënë një vend të merituar midis shteteve të lira të Evropës, në mos tradhti kombëtare ishte një alternativë vetëvrasëse.¹⁵ A nuk u ndëshkuan rëndë ata që dolën të mundur nga Lufta e Dytë Botërore? A nuk pësojnë gjithnjë të mundurit?

Koha provoi se demokracitë perëndimore me shumë probleme të brendshme pas Luftës së Parë Botërore, u ndodhën njëherazi përballë potencialeve ekonomiko - ushtarake dhe ideologjike të rrezikshme të diktaturave të së majtës dhe të djathtës ekstreme, përkatësisht regjimeve komuniste e fashiste në BRSS, Itali, Gjermani etj., të cilët mungesën e vlerave e kompensonin me propagandë jo pak efikase. Pasi dështuan fillimisht në përpjekjet për të eliminuar diktaturën bolshevike, të cilën vetëm arritëm ta pengojnë ta shtrihej përtej kufijve të dikurshëm të ish - Perandorisë Ruse, pasi dështuan sërish në përpjekjet për t’i eliminuar regjimet komuniste e fashiste duke i përplasur midis tyre, demokracitë perëndimore, së fundi, me një politikë realiste, mjaft racionale, siç e provoi koha, bënë aleancë me BRSS kundër Boshtit Fashist, që ishte më i fuqishëm dhe më

¹⁵ *Kosova në vështrimin enciklopedik*, Tiranë 1999; Shih edhe vepra të përmendura më lart të autorëve A. Hadri, L. Nasi, M. Shatri, M. Piraku, M. Kodra, R. Hiberts, W. Tilman, J. Emery, P. Kemp, etj.

agresiv¹⁶. Pesë vjet më vonë, pasi fashizmi në pushtet ishte shpartalluar, filloi beteja kundër komunizmit, e ashtuquajtura “lufta e ftohtë”, e cila vazhdoi intensivisht për 45 vjet. Gjatë kësaj lufte demokracitë perëndimore ristrukturuan ekonominë, politikën sociale, politikën nacionale (p.sh. hoqën dorë nga kolonitë etj.) dhe mbi këtë bazë përvetësuan më shumë shtresa të popullsisë, pra siguruan potenciale të mëdha dhe të ndërgjegjësuara, ose cilësore, njerëzore.¹⁷

Përzgjedhja e aleatëve që bënë përgjithësisht shqiptarët në vitet e Luftës së Dytë Botërore, edhe pse u pasua nga shtyrja në kohë e zgjidhjes së çështjes nacionale, apo çështjes së Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare, edhe pse kishte risk rrezikun për pavarësinë e shtetit shqiptar, si rezultat i forcimit të lobit serbo - jugosllav në radhët e elitës politike shqiptare që drejtoi luftën antifashiste dhe mori pushtetin pas saj, edhe pse u pasua nga 45 vjet vuajtjesh dhe sakrificash, në të dy anët e kufirit politik, nga viktima, prapambetje, përpjekje për shkombëtarizim në Kosovë e më gjerë, etj., etj., (kemi përmendur se vetëm në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare në Jugosllavi në dimrin e viteve 1944 - 1945 u masakruan rreth 47 mijë vetë, deri në vitin 1966 u shpërngulën rreth 400 mijë të tjerë, u mohuan për shqiptarët të drejtat më elementare etj., etj.),¹⁸ ishte një *përzgjidhje e drejtë, realiste*. Sot duket edhe më qartë se përcaktimi i shqiptarëve në krahun e koalicionit antifashist gjatë Luftës së Dytë Botërore, hapi perspektiva për kombin shqiptar në tërësi. Janë të gjitha gjasat që ai të zhvillohet e të përparojë në të gjitha fushat, duke u rivlerësuar

¹⁶ U. Laker, *Evropa në kohën tonë*, Tiranë 1996; M. Sajers-A.E. Kahn, *Konspiracioni i madh kundër Rusisë*, Tiranë 1951, etj.

¹⁷ G. Partos, *Bota që erdhi prej të ftohtit*, Tiranë 1994, etj.

¹⁸ A. Lalaj, *Politika antishqiptare e PKJ ndaj së drejtës së vetëvendosjes së popullsisë shqiptare gjatë viteve 1941-1945*, Tiranë 1985, (disertacion i depozituar në AIH); Z. Shtylla, *Politika serbomadhe e shpërnguljeve të shqiptarëve para dhe pas Luftës së Dytë Botërore*, Tiranë 1984, (disertacion i depozituar në AIH).

si faktor i rëndësishëm në Ballkan dhe duke parë jo të largët edhe ditën e zgjidhjes së problemit të vet kombëtar, të mbetur pezull qysh më 1913, natyrisht në përputhje me standardet e kohës sonë.

Prej 17 shkurtit të vitit 2008, Kosova është e pavarur dhe sot e njohur nga mbi 100 shtete, shqiptarët në Maqedoni po ecin hap pas hapi për zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit të vitit 2001, situatë e shqiptarëve në Malin e Zi dhe në Preshevë, Bujanovc e Medvegjë ka përmirësim krahasuar me dy dekada më parë, çështja çame ka dalë nga pluhuri i harresës. Nuk ka arsye pra për të mos qenë optimist dhe për të mos besuar në të ardhmen.

Prof. dr. Izber HOTI
(Prishtinë)

DISA ASPEKTE TË STUDIMIT TË HISTORISË SË SHQIPTARËVE GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Vështirësitë dhe skajshmëritë e shqyrtimit

Hulumtimi, studimi, shqyrtimi dhe trajtimi i kohës së re dhe më të re ka qenë gjithherë i vështirë dhe sprovë e madhe e historianëve dhe të tjerëve që rreken me të kaluarën. Vështirësitë e tilla shtohen në kohën e kthesave të mëdha historike, të cilat pothuajse u shoqëruan përherë me vlerësime të reja të zhvillimit të marrëdhënieve ekonomike, shoqërore, politike, arsimore e kulturore, si dhe të fushave të tjera. Kthesa e tashme historike, veç të tjerash, ndikoi edhe në rishikimin e së kaluarës e me këtë edhe në rivlerësime të reja. Mirëpo, si në të kaluarën, rishikimi i vlerave, mbështetur në rrethanat mbizotëruese, krahas rrjedhave normale, mund të bëhet edhe me skajshmëri të padëshiruara. Kjo bëhet për shkak të mungesës së njohurive për rrjedhat e gjithëmbarshme ekonomike dhe shoqërore, por edhe për qëllime apo interesa të caktuara ditore të individëve dhe qarqeve të ndryshme. Rivlerësimi i njëanshëm dhe i skajshëm, varësisht nga përhapja dhe thellimi i tij, mund të bëhet shumë i rrezikshëm për

shqyrtimin shkencor të së kaluarës dhe vënien e themeleve të një historiografie të re të dëmshme gjithëkombëtare, kundruall asaj të mirëfilltë dhe me interes kombëtar e më gjerë. Për këtë arsye, një dukurie të tillë i duhet prerë rrënjët sa më herët. Një veprimtari e tillë duhet bërë në mënyrë të organizuar dhe me argumente bindëse. Përkundrazi, nëse nuk veprohet kështu nuk mund të arrihen qëllimet e dëshiruara dhe dëmet për përparimin e shkencës dhe të shoqërisë do të ishin të mëdha. Me qëllim të kundërvënies së këtyre përpjekjeve u bë edhe ky punim, me shpresë se do të pasohet nga të tjerë.

Kahet e dëmshme të rivlerësimeve

Kahet e dëmshme të rivlerësimeve për të kaluarën dhe shkencën e historisë filluan që herët. Më parë ato u përhapën në qarqet e ashtuquajtura shkencore, por edhe të politikës e mediumeve të ditës, në Serbi e pastaj në Jugosllavi në tërësi. Në të vërtetë, pas ngjarjeve të vitit 1981 në Kosovë, qarqet e tilla që luftonin për ndikimin e tyre nuk lanë formë, mënyrë e mjete pa përdorur. Në këtë mënyrë furishëm u shkatërruan kriteret e trajtimit objektiv të shkencës së historisë pas Luftës së Dytë Botërore. Qëllimi kryesor i tyre ishte zhvlerësimi i çdo gjëje nga historia e kohës së re e më të re të Kosovës, për t'iu kundërvënë kërkesave të shqiptarëve të shprehura gjatë këtyre ngjarjeve, por edhe më vonë. Ata shkuan aq larg sa mohuan ekzistencën shekullore të shqiptarëve në trojet e tyre dhe përfunduan me mohimin e plotë të pjesëmarrjes së tyre në Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Mirëpo, qarqet e tilla serbe nuk u kënaqën vetëm me kaq. Ato zgjeruan rrafshin e mohimit të Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Kroaci e vise të tjera të Jugosllavisë, për të përfunduar me mohimin e kësaj lëvizjeje edhe në vetë Serbinë, duke harruar kështu se lanë anash një segment mjaft të rëndësishëm të pashkëputshmërisë së historisë së popullit serb. Për

ata që kishin orientime majtiste një mohim i tillë, madje, ishte prerje e degës në të cilën qëndruan një kohë të gjatë. Mirëpo, për një politikë të ditës, kur për arritjen e qëllimeve nuk zgjidhen mjetet, kjo ishte e natyrshme, apo shprehur figurativisht ata vepruan mbështetur në fjalën e urtë popullore “Për inat të së resë, më vdektë djali”. Si pasojë për disa shkencëtarë të Serbisë, nëse mund të quhen shkencëtarë, si dhe mediume dhe opinionin e caktuar të indoktrinuar me politikë të ditës, djepi i serbëve dhe i shtetit të tyre u caktua në Kosovë, sa në Sanxhak, sa në Knin, sa në Lluzhicë dhe një Zot e di se ku do të ndalet. Luhatjet e tilla, kuptohet, para së gjithash do të dëmtojnë historiografinë serbe, por edhe opinionin lexues në tërësi për të kaluarën e këtij populli. Duhet kohë e mund që një indoktrinimi të tillë qëllimkeq t’i ndërpritet hovi e pastaj sërish të vihet në binarë të mbarë rrjedha e hulumtimit, studimit dhe shqyrtimit të mirëfilltë të së kaluarës së këtij populli.

Ndikimet e kaheve negative në historiografinë serbe e jugosllave provokuan edhe historiografinë dhe mjetet e tjera të informimit dhe komunikimit masiv në gjuhën shqipe në Kosovë e gjetiu në Jugosllavi. Kështu, kohëve të fundit herë pas here, duke shqyrtuar e pastaj duke shkruar për çështje të ndryshme, të shtytur nga situata tejet e rëndë shoqërore dhe politike, drejtpërdrejt apo tërthorazi, shkruhet dhe flitet për të kaluarën tonë të hidhur me eufori, me emocione dhe shpesh edhe pa mbështetje. Në këtë frymë veprohet jo rrallë edhe me të në Shqipëri për periudhën e Luftës së Dytë Botërore. Fatkeqësisht, edhe aktualisht kjo periudhë, nga individë dhe grupe, po shqyrtohet njëanshëm. Pra, ndërsa deri dje e kaluara e shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore, u trajtua njëanshëm dhe pozitivisht, sot veprohet nga një skajshmëri tjetër – hulumtohen, studiohen e shqyrtohen vetëm ato anë që drejtpërdrejt apo tërthorazi njollosin pjesëmarrësit, kuadrot udhëheqëse të Partisë Komuniste e të ushtrisë Nacionalçlirimtare, si dhe personalitetet e tjera dhe ngjarjet e kësaj kohe. Shkurt,

bëhen përpjekje këmbëngulëse që sa më shumë të njolloset Lëvizja Nacionalçlirimtare në përgjithësi në Kosovë, në Jugosllavi dhe në Shqipëri. Një punë e tillë, veç trajtimit të njëanshëm, bëhet me nguti, pa kritere e kritikë, pa dokumentacion të mjaftueshëm proveniencash të ndryshme dhe disa individë, kryesisht kureshtarë të njohjes së kaluarës sonë, që zhvlerësojnë edhe më shumë këto përpjekje, ofrojnë të tilla materiale që pas një kohe mezi do të shfrytëzohen edhe si materiale e kujtime të terrenit. Që është edhe më keq, ndër zëdhënësit e veprimtarët e shumtë të mohimit të kësaj lëvizjeje janë bartësit kryesorë të saj.

Në krahun e mohuesve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare fatkeqësisht janë futur edhe disa shkencëtarë, që deri dje publikonin trajtesa të skajshme pozitive e afirmative për Lëvizjen Nacionalçlirimtare e Parinë Komuniste. Ka edhe të atillë që më parë për shkaqe të ndryshme nuk mund të publikonin hulumtimet e tyre të paverifikuara dhe tash mendojnë se ka ardhur koha e tyre e mund të botojnë çdo gjë. Pa dyshim, më të rrezikshmit janë bashkëkohanikët, pjesëtarët dhe ithtarët e organizatave, shoqatave, partive apo lëvizjeve të ndryshme të kohës, që sot përpiqen ta bindin opinionin se vetëm veprimtaria e tyre ishte patriotike, ndërsa të gjitha të tjerat ishin kundër interesave kombëtare e madje edhe tradhtare. Të tillët, shumë herë kërkojnë edhe koka për të bërat dhe të pabërat në të kaluarën. Për fat, të tillët janë të rrallë.

Kundërthëniet kryesore të shqyrtimit

Lufta e Dytë Botërore në Ballkan u zhvillua në rrethana specifike, prandaj edhe studimi i së kaluarës në këto vite duhet bërë mbështetur në to. Nëse nuk veprohet kështu vështirë mund të ruhet objektiviteti dhe studimi i së kaluarës nga distanca kohore, që është më se e nevojshme për shqyrtimin e së kaluarës aq të ndjeshme e të diskutueshme.

Pushtimi i Jugosllavisë nga forcat nazifashiste më 1941, që ishte kthesë e madhe shoqërore e politike. Në shikim të parë për shqiptarët nuk ishte humbje e lirisë kombëtare e as humbje e interesave sociale, ngase ata deri në këtë kohë nuk gëzonin të drejtat elementare kombëtare. Në anën tjetër, pas kësaj kthese të madhe në Kosovë nuk u keqësua as gjendja dhe as pozita ekonomike e shtresave të gjera popullore. Përkundrazi, shtresat e pasura me kohë forcuan pozitën e veta, ndërsa shtresat e mesme dhe ato të varfra shoqërore pas këtyre ndryshimeve as nuk fituan dhe as nuk humbën gjë. Në vitet e para të pushtimit, bile, mbizotëronte një kamje e konsiderueshme, e cila, pa dyshim, ndikoi shumë në qëndrimin e masave ndaj Lëvizjes Nacionalçlirimtare, në veçanti dhe ndaj rrjedhave të Luftës së Dytë Botërore, në përgjithësi.

Shpresa se ndryshimet e vitit 1941 në suaza ndërkombëtare do të ndikojnë në të mirë të pozitës së shumicës shqiptare në aspektin kombëtar nuk ishte e pambështetur dhe, për këtë arsye, u bë një levë e rëndësishme e përcaktimeve të ndryshme të kësaj periudhe të kthesave të mëdha. Madje, edhe tek anëtarët e simpatizantët e deriatëhershëm të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, falë rrethanave të reja dhe qasjeve të ndryshme të zgjidhjes së çështjes kombëtare, qysh në luftën e prillit më 1941 u bë çarje e madhe. Për rrymat dhe opsionet e asociacioneve të tjera nacionaliste as që mund të flitet. Ata zgjidhjen e çështjes kombëtare, mbështetur në të kaluarën e hidhur nuk e lidhnin kurrë me forcat e brendshme, veçanërisht jo me ato sllave dhe sllavo-komuniste, siç i quanin ata që nga fillimi i luftës. Të rrallë dhe të vetmuar ishin nationalistët që mund të angazhoheshin për opsione të tilla. Nacionalistët e të gjitha ngjyrave do të bashkëpunonin edhe me dreqin e zi vetëm të shpërnin njëherë e përgjithmonë sundimin e padrejtë të Jugosllavisë së Vjetër. Kështu, kuptohet, nuk veprohej në viset e tjera të Jugosllavisë dhe të Shqipërisë. Për ta pushtimi i këtyre viseve nga forcat nazifashiste ishte para së

gjithash humbja e lirisë kombëtare dhe për këtë arsye duhej bërë çdo gjë që të liroheshin nga ky pushtim dhe të rifitohej liria kombëtare e të kthehej sovraniteti shtetëror. Sipas tyre, në rrethanat mbizotëruese në këtë kohë, realizimi i qëllimeve të çlirimit kombëtar duhej bërë me forma dhe mënyra të ndryshme.

Format dhe mënyrat e ndryshme të çlirimit kombëtar u miratuan nga të gjithë antifashistët. Mirëpo, ishin të shumtë edhe ata që e quanin veten patriotë dhe që çlirimin kombëtar e shihnin dhe e propagandonin nën sjetullat e Paktit Trepalësh. Në këtë mënyrë gjatë Luftës së Dytë Botërore edhe në këtë anë, si dhe në Evropë dhe në mbarë botën, mbizotëruan kryesisht dy rryma për zgjidhjen e momentit krucial në të cilat gjendeshin - rryma e përkrahësve të Paktit Trepalësh dhe rryma e përkrahësve të aleatëve, pra antifashistët dhe ata që përkrahnin nazifashistët.

Në rrymën e përkrahësve të Paktit Trepalësh nuk pati përçarje të konsiderueshme, ndërsa në atë të aleatëve përçarjet ishin të shumta dhe të mëdha.

Përkrahësit e Paktit Trepalësh të shteteve e të vendeve të vogla, kuptohet, ishin të një mendimi se nuk duhej luftuar kundër pushtuesve nazifashistë, sepse këto fuqi duhej të fitonin e pas fitores ato do të rregullonin çështjet kryesore kontestuese, ndërsa dalloheshin pak në atë se kush duhej marrë pushtetin dhe se a duhej kthyer regjimi i mëparshëm, përkatësisht se si duheshin rregulluar marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore në të ardhmen. Në këtë frymë i kushtohej kujdes i madh të dhënës se kush dhe cila parti apo shtresë shoqërore ka gjasa më të mëdha për marrjen e pushtetit, duke u mbështetur pothuajse përherë në të dhënat se kush e kishte pushtetin në dorë në kohën e pushtimit. Kuptohet, në luftë për marrjen e pushtetit në atë kohë këto forca, të përkrahura nga pushtuesit, shfrytëzuan edhe forma e mënyra të palejueshme, të cilat ishin në kundërshtim me historinë dhe traditën e popullit shqiptar, ashtu edhe me normat ndërkombëtare e të së drejtës së shtetit. Të rrallë ishin individët, grupet, shoqatat e partitë

përkrahëse të Paktit Trepalësh, që nuk vepronin kështu duke ofruar zgjidhjet origjinale e tolerante të opsioneve të ndryshme.

Ndër përkrahësit e aleatëve e përbashkët ishte lufta e domosdoshme kundër Paktit Trepalësh. Te të gjithë aleatët mbizotëronte bindja se para së gjithash duhej dëbuar pushtuesi e pastaj çështjet kontestuese do të zgjidheshin në mënyrë demokratike dhe të shprehjes së vullnetit të popullit në të gjitha vendet. Megjithatë, përkundër kësaj bindjeje, gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore, për rrjedhën e Luftës, por edhe për zgjidhjen e çështjeve me interesa të kundërta u bënë një varg konferencash e tubimesh ndërkombëtare. Një veçori e tillë mbizotëroi pas hyrjes së BRSS në Luftën e Dytë Botërore.

Hyrja e BRSS në luftë ndikoi edhe në rrjedhën dhe qëllimet e Luftës së Dytë Botërore në Ballkan dhe në Evropë në tërësi, falë karakterit dhe qëndrimit ndaj kësaj lufte të BRSS, shtetit të parë socialist në botë. Kjo ndikoi edhe në cilësinë e re të aleancës kundër hitleriane, cilësi kjo që, drejtpërdrejt apo tërthorazi, ndikoi edhe në këto vise. Kështu, krahas luftës për çlirim kombëtar, filloi të përhapej lufta për çlirim social, e cila në këtë kohë në disa vende jo vetëm që u barazua, por edhe mbizotëroi. Orientimi i tillë, po kështu, ndikoi mjaft në opsionet e ndryshme të udhëheqjes dhe pjesëmarrjes në luftën kundër Paktit Trepalësh. Kjo kishte veçanërisht ndikim të madh në vendet heterogjene kombëtare, siç ishte Jugosllavia, si dhe në marrëdhëniet e ndera me çështje kontestuese territoriale ndërshtetërore, siç ishin ato të Jugosllavisë dhe të Shqipërisë.

Çështje kontestuese territoriale dhe të pazgjidhura vite me radhë në mes të Jugosllavisë dhe të Shqipërisë ishin territoret e banuara me shumicë shqiptare, veçanërisht Kosova. Po kështu, Kosova në aspektin kombëtar ishte heterogjene e me një të kaluar historike të pamohuar, prandaj, krahas opsionit të çlirimit kombëtar, ishte tejet i rëndësishëm dhe me ndikim ai i çlirimit social. Në anën tjetër, për shkak të pozitës gjeostrategjike, të pasurive me lëndë të parë

dhe të të mirave të tjera me interes të përgjithshëm, në prag dhe në fillim të Luftës së Dytë Botërore, Kosova, sikurse edhe vetë Shqipëria e Ballkani në tërësi, u bë joshëse për pushtuesit e asaj kohe. Në shtimin e joshjes së pushtuesve, ndikuan, pa dyshim, edhe kundërshtitë e së kaluarës së popujve të Ballkanit, të cilat ata i njihnin mirë dhe planifikonin t'i shfrytëzonin për interesat e tyre. Këto kundërshti i shfrytëzuan më së miri fashistët italianë, të cilët qysh herët, ndërsa veçanërisht në prag të pushtimit të Shqipërisë, premtuan bashkimin kombëtar të shqiptarëve dhe formimin e Shqipërisë etnike. Po këto premtime i dhanë edhe nazistët gjermanë, përkundër faktit se ata nuk ishin të informuar sa duhej për të kaluarën e shqiptarëve, për dëshirat dhe për interesat e tyre. Si fashistët ashtu edhe nazistët propagandën e tyre e mbështetnin në marrëdhëniet tradicionalisht të mira dhe ndihmën e ndërsjellë të popullit shqiptar me atë italian, përkatësisht gjerman, që nuk mund të mohohej lehtë.

Premtimet nazifashiste ishin tejet tërheqëse për shqiptarët, prandaj duheshin bindje shumë të forta individuale e kolektive që të mos përcaktoheshin për këtë dëshirë të kahershme të tyre. Për këtë arsye përkrahës të ideologjisë nazifashiste kishte nga radhët e shtresave të ndryshme shqiptare. Kjo ishte e natyrshme sepse deri në atë kohë as me vepra e as me premtime asnjë nga shtetet nuk i kishte afruar këtij kombi e shteti të vogël dhe këtij shteti të përvuajtur. Në anën tjetër, shtetet fqinje ballkanike gjatë tërë historisë, por edhe në këtë kohë, nuk kishin hequr dorë nga përpjekjet për pushtimin e territoreve shqiptare dhe për robërimin e popullit shqiptar. Ndarjet e territorit dhe pushtimin nga shtetet e mëdha e të vogla ballkanike, një pjesë e popullit shqiptar e përjetonin dhe në këtë kohë, por ata njëkohësisht kishin hetuar rrezikun dhe më të madh nga fqinjët, zhdukjen e tërësishme të popullit shqiptar dhe glabërmin e tokave të tyre. Fatkeqësisht, qëllimet dhe veprimet e tilla deri në këtë kohë, për interesat e veta

e nën petkun e pansllavizmit, i përkrahu Rusia, përkatësisht BRSS dhe aleatët e saj, që në Evropë nuk ishin të pakët.

Në përhapjen e ideologjisë në Shqipëri ndikoi mjaft edhe gjendja e vështirë ekonomike dhe indoktrinimi i një pjese të inteligjencies, e cila u shkollua jashtë vendit, veçanërisht në Itali. Në rrethanat në të cilat jetonin shqiptarët në Jugosllavi, ky indoktrim depërtoi dhe u përhap shpejt, kështu që një pjesë e madhe e tyre e përkrahën pushtimin nga Italia fashiste dhe Gjermania naziste. Pushtimin e kundërshtuan patriotët dhe komunistët, të cilët këtë akt fashist e konsideronin humbje të lirisë kombëtare, por edhe të trasesë së luftës për çlirim klasor.

Diferencimi i rrymave dhe i ideve për çlirimin kombëtar të shqiptarët, si dhe të popujt e tjerë në Ballkan dhe në Evropë, u thellua nga gjysma e dytë e vitit 1942. Në këtë kohë filluan luhatjet si dhe humbjet e Paktit Trepalësh, kurse koalicioni antihitlerian u konsolidua pothuajse tërësisht. Këto rrjedha ndikuan drejtpërdrejt në zhvillimin e Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Jugosllavi dhe në Shqipëri, por edhe në Kosovë, ndërsa ndryshimi i tyre cilësor e sasiar edhe në thellimin e përçarjes si në mes të rrymave kryesore, ashtu edhe brenda përbrenda këtyre rrymave. Në thellimin e përçarjes më vonë ndikoi mjaft edhe akreditimi i misionëve aleate dhe ndihma e Anglisë dhe e SHBA-ve, që i dhanë si forcave antifashiste, ashtu edhe forcave që fshehurazi apo haptazi bashkëpunonin me pushtuesit. Misionet aleate nga Anglia dhe SHBA u dhanë përkrahje edhe forcave të pakta nacionaliste, që nuk përkrahnin as nazifashistët dhe as antifashistët. Një dukuri e tillë shkaktoi hutim të madh të masat e gjera, veçanërisht sa i përket përcaktimit ndaj faktorit të jashtëm, i cili në këtë kohë ishte tejet i rëndësishëm. Në anën tjetër, në rrethanat e zhvillimit të Luftës së Dytë Botërore përcaktimi ndaj faktorit të jashtëm ndikonte drejtpërdrejt edhe në karakterin e luftës çlirimtare.

Përkrahja pa rezervë dhe ndihma që jepnin Anglia dhe SHBA nënkuptonte edhe të dhënë se veprimtaria luftarake zhvillohej nën ombrellën e fuqive të mëdha, që zhvishte çdo përpjekje të luftës së çlirimit klasor. Mirëpo, një përkrahje dhe një ndihmë e tillë mundësonte angazhimin në luftën çlirimtare kundër nazifashistëve të të gjitha shoqatave, organizatave dhe shtresave me qëndrime reaksionare dhe përparimtare, prej atyre më të maturave deri tek ato me qëndrim më të skajshëm. Një veprimtari e tillë e Anglisë dhe e SHBA-ve në shtetet e ndryshme të Evropës nuk bëhej vetëm me qëllim të masivizimit të luftës kundër Paktit Trepalësh, por, para së gjithash, me qëllim që pas Luftës së Dytë Botërore në forma dhe në mënyra të ndryshme t'ua imponojë sistemet e tyre ekonomike, shoqërore dhe politike. Mbështetur në këto qëndrime aleatët premtonin përkrahje edhe në të ardhmen. Nëpërmjet misionëve aleatë këto shtete shqiptarëve, si dhe të tjerëve, u premtonin liri, demokraci e vetëvendosje, pa kushtëzime të tjera, veç pjesëmarrjes në luftën e koalicionit antihitlerian. Demokraci të llojit të vet premtonin edhe forcat antifashiste që, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, ishin të lidhura me luftën antifashiste, në ballë së cilës ishte BRSS. Edhe këto forca pranonin domosdonë e luftës kundër koalicionit hitlerian, por ideonin në vijim edhe zhvillimin e revolucioneve socialiste.

Synimet e këtij krahi ndikuan në ndryshimet cilësore të luftës antifashiste dhe në diferencimin e forcave antifashiste të mbështetura në ideologji të caktuara. Thellimi i diferencave dhe shtimi i kundërthënieve me këtë rast u bë aq i madh sa sot vështirë mund të bëhet dallimi i luftës qytetare me luftën për çlirimin kombëtar, mbështetur në kahet e ndryshme të zgjidhjeve të çështjeve të kohës. Nuk ishin të rralla rastet që për angazhim në Lëvizjen Nacionalçlirimtare rol të rëndësishëm të kishte orientimi ideor i individit apo grupit. Këto luhatje dobësuan Frontin e Përbashkët Nacionalçlirimtar, kurse masat e gjera deri diku i përçanë. Po kjo ndarje ideologjike hetohej edhe te forcat e tjera

antifashiste të përkratura nga aleatët, por jo aq sa në Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Thënë shkurt, lufta antifashiste në vendet ku kishin drejtimin e rezistencës komunistët, veç çlirimit kombëtar kishte edhe karakterin social dhe ndryshimin e sistemit politik më pas. Falë rrethanave ekonomike, shoqërore dhe politike në disa vende mbizotëronte lufta për ndryshime të kësaj natyre. Ndër këto vende, ishin, pa dyshim, Jugosllavia dhe Shqipëria. Në këtë udhëkryq u gjend edhe Kosova.

Zhvillimi paralel i luftës për çlirim kombëtar e transformimin social gjatë Luftës së Dytë Botërore në shumë vende të Ballkanit dhe të Evropës, si dhe rrethanat në të cilat zhvillohej ajo, ndikuan në propagandimin e qëllimeve të kësaj lufte, por edhe në shumë marrëveshje, tubime e konferenca të vendeve e të rajoneve të tëra ku flitej për rrjedhën e luftës kundër koalicionit hitlerian, për caktimin e sferave të interesit e rregullimin shoqëror e politik të shteteve të ndryshme pas fitores.

Në frymën e rregullimi ekonomik e shoqëror dhe të kufijve etnikë të disa shteteve lindi dhe u bë përpjekje që të jetësohej edhe federata, përkatësisht Konfederata Ballkanike, e cila mbështetje kryesore kishte sistemin socialist e në të cilën do të bashkëngjiteshin disa shtete të barabarta, në mesin e të cilëve edhe Jugosllavia e Shqipëria. Konfederata, përkatësisht Federata Ballkanike ishte edhe njëri nga opsionet e zgjidhjes së çështjes shqiptare, të cilët gjendeshin në kuadrin e Jugosllavisë e të Greqisë, por edhe në Shqipëri. Mbështetja kryesore e zgjidhjes së çështjes shqiptare, por edhe çështjeve të popujve të tjerë në situatë të njëjtë, ishte parimi i vetëvendosjes dhe shkëputjes së popujve i cili do të realizohej me luftën e përbashkët të armatosur kundër nazifashistëve pushtues dhe bashkëpunëtorëve të tyre dhe me vendosjen e sistemit të ri shoqëror në këto vende.

Qëndrimet e miratuara në tubimet dhe në konferencat e shteteve aleate për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme kontestuese ndërshtetërore, si dhe ideja dhe veprimtaria e Konfederatës,

përkatësisht Federatës Ballkanike, bashkë me opsionet e saj të zgjidhjes së këtyre çështjeve, por edhe propaganda e Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe e Partisë Komuniste Shqiptare, ishin mbështetje kryesore e Konferencës së Parë të Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar për Kosovë dhe Dukagjin. Mirëpo, pasi shumë qarqe bartëse të Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Jugosllavi dhe në Kosovë veprimtarinë e tyre që nga fillimi e nisën me demagogji e makinacione politike, pas fitores, të përkrahura edhe nga disa shtete aleate, këto qëndrime e pretendime u mohuan. Pavarësisht dëshirës dhe interesave gjithëkombëtare, shqiptarët mbetën të ndarë, pikërisht ashtu si propagandonin dhe theksonin në platformat dhe programet e tyre mjaft kundërshtarë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare.

Mbështetjet e vetme të studimit

Hulumtimi, studimi, shqyrtimi dhe trajtimi i skajshëm dhe e njëanshëm i së kaluarës së çdo populli nuk është objektiv dhe me vlerë të qëndrueshme shkencore. Kjo vlen edhe për të kaluarën e shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Shqyrtimi i të dhënave arkivore të një provenience, pa materialet e proveniencave të tjera, domosdo shpie në rezultate të njëanshme. Kjo dukuri në të kaluarën është përsëritur mjaft dhe pothuajse kjo është e meta kryesore e historiografisë së njëmendësisë, hiç trajtimet me ngjyrimë dhe të qëllimta ideologjike. Kështu, deri më sot shumë studime shkencore për të kaluarën e shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore u trajtuan pothuajse mbështetur vetëm në të dhënat arkivore të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, si dhe u nxitën nga qasje ideologjike të kohës.

Në këtë mënyrë shumë nga këto studime mbetën të njëanshme dhe së paku me vlera të përgjysmuara shkencore. Në kohën e kthesave të mëdha e të një demokratizimi një dukuri e tillë nuk duhet përsëritur.

Theksimi dhe publikimi i rezultateve historiografike mbështetur vetëm në materialet e proveniencës së pa hulumtuar

gjithanshëm deri më tash, duke lënë anash materialet e shumta arkivore dhe rezultatet e deritashme shkencore rreth Lëvizjes Nacionalçlirimtare, paraqesin është një njëanshmëri dhe një skajshmëri e re, nga e cila nuk ka dobi askush e më së paku historiografia shqiptare. Veprimi i tillë është i palogjikshëm dhe, duke vepruar kështu, para të interesuarve për të kaluarën tonë shtrohen një varg çështjesh e pyetjesh sa të logjikshme aq edhe të pambështetura në rrethanat e kohës kur ndodhën ngjarjet apo vepruan asociacionet e ndryshme politike dhe shoqërore të kohës. Në këtë mënyrë, mbështetur vetëm në interesat kombëtare, shumëkush e kudo mund të shtrojë një varg pyetjesh për ngjarjet dhe rrjedhat e së kaluarës së kësaj kohe: Pse Balli Kombëtar, që bashkëpunoi me koalicionin antihitlerian, të trajtohet si organizatë tradhtare, kur dihet se Partia Komuniste Shqiptare bashkëpunoi me BRSS, Jugosllavinë dhe koalicionin kundër hitlerian, të cilët nuk ofronin asgjë më shumë se të parët në aspektin kombëtar? A thua vetëm pse Pakti Trepalësh e humbi luftën? Po të fitonte ai, çka do të fitohej në aspektin gjithëkombëtar? Anasjelltas: Pse Partia Komuniste Shqiptare në kohën e rënies së socializmit si proces botëror të rivlerësohet si tradhtare sepse bashkëpunoi më së shumti veçanërisht pas luftës me aleatët e Lindjes?! Pyetje të tilla për të kaluarën tonë do të shtroheshin deri në ditët e sotshme. S'do mend pyetjet e tilla janë provokative, por duan edhe përgjigje të argumentuara. Sinjalizimet e antifashistëve properëndimorë dhe të nacionalistëve të ndryshëm për rrezikun nga sllavo-komunizmi, që drejtpërdrejt apo tërthorazi u mishërua edhe në platformat dhe programet e tyre, në histori u vërtetuan, mirëpo askush nuk do të marrë me mend se si do të zgjidhej çështja kombëtare shqiptare sikur të fitonin forcat e koalicionit hitlerian, aq më parë kur dihet se koalicioni hitlerian, sikurse koalicioni antihitlerian, për qëllimet e veta propagandistike, deri diku u angazhuan për opsione të ndryshme të zgjidhjes së çështjes kombëtare. Mirëpo, interesat e ndryshme të ndërlidhura ndërkombëtare pas Luftës së Dytë

Botërore përfundimisht përkrahën apo hodhën poshtë edhe këtë çështje jetike, të drejtë, natyrale e të patjetërsueshme të kolektiviteteve dhe të popujve, disa prej të cilave madje në luftë kundër koalicionit antihitlerian sakrifikuan shumë si në njerëz, ashtu edhe në të mira materiale. Ndër të parët, siç dihet, janë shqiptarët. Shkurt, mund të thuhet se masë e vlerësimit për të kaluarën nuk mund të jetë humbja apo fitorja e betejës apo luftës. Gjithsesi autorë të ndryshëm preferojnë të shkruajnë historinë e fitimtarëve, por jo objektive, shkencore dhe afatgjate.

Historiografia e mirëfilltë, objektive dhe shkencore është vetëm ajo që mbështetet në fakte e argumente, të shqyrtuara në rrethana të kohës e me distancë të duhur kohore dhe e trajtuar shumanshëm, pa njëanshmëri e skajshmëri, pa paragjykime, të çfarëdo llojin qofshin. Në këtë mënyrë do të duhej të studiohej e të trajtohej edhe e kaluara e shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore, por edhe e kaluara e largët e tyre. Vetëm pas hulumtimeve të themelta shkencore do të mund të vlerësohej veprimtaria e disa personaliteteve, ngjarjeve dhe zhvillimi e kahet e rrjedhat e historisë së shqiptarëve gjatë kësaj lufte të madhe. Vetëm pas hulumtimeve të tilla do të mund të bëheshin konstatime relative, ngase për shkencat shoqërore e madje edhe për ato të natyrës dhe të teknikës nuk ka asgjë absolute, se gabimi kryesor i Ballit Kombëtar, Regjencës, Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe organizatave apo partive të tjera të lidhura drejtpërdrejt e tërthorazi me koalicionin hitlerian nuk qëndron në zgjidhjen e rrugëve të tjera për çështje kombëtare, në karakterin e tyre reaksionar, apo të ruajtjes dhe të ripërtëritjes së sistemeve të vjetra shoqërore e shtetërore, apo përkrahjes së këtij apo atij optionsi, por në përkrahjen (nëse kjo dokumentohet shkencërisht) e luftës së padrejtë dhe pushtuese të koalicionit hitlerian. Mirëpo, edhe një vlerësim i tillë duhet bërë me fakte dhe argumente e pa interesa të ditës. Edhe më me kujdes duhet studiuar, shqyrtuar e trajtuar e kaluara organizatave dhe e partive të pavarura nacionaliste, që

gjatë kësaj kohe nuk anuan haptazi, por që patën veprimtari të ndjeshme.

E kaluara dhe historia nuk është prerë vetëm bardh e zi, kurse personalitetet e saj nuk mund të jenë vetëm patriotë dhe tradhtarë. Si në të kaluarën, ashtu edhe në të tashmen, ka pasur dhe ka të tradhtuar, të mashtruar, të painformuar, të pa orientuar, politikanë të lindur e të mësuar, të atillë që nuk merreshin apo nuk merren me politikë, por u interesoi apo u intereson ajo. Fundi i fundit e kaluara e njerëzimit përjetoi edhe revolucione e kundërrevolucione, edhe progrese e regrese, por edhe evolucione dhe evolucione të moderuara, mirëpo asnjëra nga këto kategori shoqërore dhe filozofike nuk ishin të përbotshme dhe nuk do të thotë fare se të tilla do të mbeten. Shqyrtimet dhe studimet e organizuara këtë e kanë vërtetuar disa herë në të kaluarën dhe në ditët e sotshme. Këtë e kanë vërtetuar edhe studimet dhe hulumtimet e tjera në botë dhe Evropë. Nuk ka arsye që kështu të mos veprojnë edhe shkencëtarët dhe historianët shqiptarë.

Literatura

- Ballvora, Shyqri - Zhvillimet politike në periudhën e LANÇ-it – Vështrim historik (7 prill 1939 – 29 nëntor 1944), Dituria, Tiranë, 2004.
- Bernd J. Fischer, Shqipëria gjatë luftës 1939 - 1945, Çabej MÇM, Tiranë, 2000 .
- Butka Uran, Masakra e Tivarit dhe përgjegjësia e shtetit shqiptar, Tiranë, 2011.
- Elsie, Robert - Fjalor Historik i Kosovës, Scander Book, Tiranë 2011.
- Enciklopedijski leksikon, Istorija, Beograd, 1970.
- Frashëri, Kristo - Historiografia shqiptare në tranzicion, Meshari, Prishtinë, 2006.
- Hadri, Ali - Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë,

Rilindja, Prishtinë 1971.

- Hajdini, Xani Azem - Shaban Palluzha / Lëvizja për çlirim dhe Bashkim Kombëtar, 1941 – 1945, 1 - 3, Prishtinë, 2002/2003.
- Historia e Popullit Shqiptar, vëll. I, II, Universiteti Shtetëror i Tiranës (Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë), Tiranë, 1965, 1967.
- Historia e popullit shqiptar, vëll.III, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Shtëpia Botuese "Toena", 2007.
- Hoti, Izber - Në udhëkryqet e historisë dhe të historiografisë shqiptare, Instituti i Historisë, Prishtinë 2004.
- Hoti, Izber - Orientime dhe qëndrime të shqiptarëve në Kosovë Faik Konica, 2010.
- Jakomoni, Françesko - Politika e Italisë në Shqipëri, Tiranë, 2005.
- Shatri, Muhamet - Kosova në Luftën e Dytë Botërore, Toena, Tiranë 1997.

Prof. assoc. dr. Sabit SYLA
(Prishtinë)

QËNDRIMI I FORCAVE POLITIKE DHE USHTARAKE TË SHQIPËRISË NDAJ KOSOVËS GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Lufta e Dytë Botërore, riaktualizoi çështjen e Kosovës, si një çështje e cila do të shndërrohej në një pikë objeksionesh për shqiptarët dhe do të ndikonte në shkallën e rezistencës së shqiptarëve në Kosovë dhe në Shqipëri. Kosova do të ishte një çështje e rëndësishme, rreth së cilës do të bëheshin diferencime e polarizime forcash, madje një problem që do të përcaktonte orientimin e shtresave e të rrymave të ndryshme politike duke ndikuar në zgjerimin apo ngushtimin e koalicioneve antifashist, apo fashist.

Populli shqiptar në përgjithësi dhe ai i Kosovës në veçanti dëshironin çlirimin dhe zgjidhjen e çështjes kombëtare, pra bashkimin e kësaj treve me Shqipërinë. Përparësitë e vendosura nga forcat e ndryshme politike dhe ushtarake në Shqipëri dhe në Kosovë, përcaktuan shkallën e rezistencës ndaj pushtuesit, por edhe bashkëpunimin me të. Vendimet e aleatëve të mëdhenj dhe të kombeve të tjerë antifashiste i dhanë me të drejtë përparësi çlirimit

të vendeve të tyre, duke e lënë të hapur zgjidhjen e problemeve të tjera në periudhën e pasluftës. Fuqitë e Mëdha antifashiste nuk i njohën pushtimet e Forcave të Boshtit dhe u shprehën për restaurimin pas luftës të situatës së mëparshme. Përmes Kartës së Atlantikut, Rusvelti dhe Çerçilli hodhën idenë e vetëvendosjes, e cila zgjoi shpresat e kombeve të pushtuara. Pra, çështja e Kosovës do të duhej të ishte problem i vetë shqiptarëve të Kosovës, por edhe i forcave politike dhe ushtarake të Shqipërisë së pushtuar, i forcave politike dhe ushtarake të Jugosllavisë, më tej edhe i vendimeve të Aleatëve të Mëdhenj.

Bashkimi i pjesës më të madhe të Kosovës me shtetin amë, në gusht të vitit 1941, nuk u realizua nga shqiptarët, edhe pse ata aspironin një bashkim të tillë. Ai ishte rrjedhojë e politikës italiane dhe gjermane, që donin të lehtësonin qëndrimin e tyre në territorin shqiptar, të frenonin sa të mundnin rezistencën e shqiptarëve dhe mundësisht t'i përdornin shqiptarët si rezerva në luftën kundër fuqive aleate. Këto objektiva, të pleksura me njohjen e mirë të psikologjisë dhe kërkesave kombëtare të shqiptarëve, ku u dalluan në mënyrë të veçantë gjermanët, përcaktuan sjelljen dhe qëndrimin e tyre ndaj shqiptarëve gjatë LDB. Ky fakt ndikoi më pas edhe në qëndrimin e shqiptarëve ndaj blloqeve ndërluftuese.

Zgjidhjet nën pushtim gjatë LDB për shqiptarët mund t'i quajmë “fat në fatkeqësi”. Në kushtet kur pushtuesit italianë dhe gjermanë e bashkuan një pjesë të madhe të territorit shqiptar, për një pjesë të madhe të popullsisë shqiptare, sidomos në Kosovë, u përmbush një kërkesë kombëtare. Për fat të keq të tyre ajo mbeti një zgjidhje afatshkurtër, një zgjidhje jo e qëndrueshme dhe e realizuar me ndihmën e fuqive humbëse të luftës. Edhe për një pjesë të shqiptarëve që bashkëqeverisën me pushtuesin, atashimi i Kosovës me Shqipërinë u konsiderua një realitet i mirëqenë dhe zgjidhje e duhur për shqiptarët në përgjithësi. Për ta problemi i Kosovës ishte një çështje që ishte zgjidhur në kuadrin e pushtimit italian apo gjerman. Sidoqoftë, zgjidhja e pushtuesve, nuk mund të

thuhet se nuk pati efekt tek shqiptarët e Kosovës dhe tek rezistenca e tyre antifashiste. Këtu nuk mund të mos përmendet edhe fakti se një pjesë e madhe e territoreve etnike shqiptare mbeti nën sundimin e Bullgarisë fashiste dhe të Gjermanisë naziste që nga viti 1941, kur u ndanë sferat e interesit të forcave fashiste në Ballkan. Për sa i përket reagimit të forcave politike dhe ushtarake në Shqipëri, duhet thënë se ato ishin të ndara në qëndrimet e tyre.

Lëvizja Nacionalçlirimtare dhe PKSH që e drejtonte atë, e konsideroi çështjen e Kosovës si një problem që do të zgjidhej pas lufte. Ajo e artikuloi atë gjatë periudhës së Luftës, por pa këmbëngulur në arritjen e saj, duke shpresuar tek Partia Komuniste Jugosllave dhe Tito si drejtues i saj, me të cilën në vija të trasha ndante të njëjtën ideologji dhe filozofi për ndërtimin e shtetit të pasluftës, por dhe tek skemat e vendimet e Aleatëve të Mëdhenj. Nga ana tjetër, forcat nacionaliste shqiptare kërkuar garanci që gjatë kohës së luftës nga Aleatët e Mëdhenj që ata të shpreheshin për fatet e territoreve dhe të popullsisë shqiptare jashtë kufijve politike të shtetit shqiptar dhe e kushtëzuan në një farë mase rezistencën e tyre me dhënien e garancive për zgjidhjen e këtij problemi. Këto garanci për të ardhmen e Kosovës nuk u dhanë nga Aleatët e Mëdhenj, ashtu si nuk u shprehën haptazi edhe për restaurimin e shtetit shqiptar në kufijtë e paraluftës.

Forcat nacionaliste bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, në kohën e konfrontimit të madh botëror e konsideruan një shans historik që duhej shfrytëzuar nga ana e forcave politike shqiptare. Alternativa e bashkimit kombëtar në këtë moment historik, u përkrah më fuqishëm nga nacionalistët, të cilët edhe e përfshinë në programet e tyre. Sipas tyre alternativa, e cila synonte rivendosjen e shtetit të pavarur shqiptar, krijimin e Shqipërisë etnike, ose bashkimin e trojeve etnike shqiptare dhe zgjidhjen e çështjes së Kosovës duhej parë në këtë kuadër.

“Nacionalizma shqiptare”, ishte dokumenti e platforma e parë, i formuluar nga Mit’hat Frashri, i cili përbëhej nga tetë pika kryesore, të njohura ndryshe me emrin Oktolog¹. Sipas Oktologut, parësore ishte Independenca e Shqipërisë së vitit 1913. Ndërsa, çështja etnike e sidomos bashkimi i Kosovës me Shqipërinë zinte vend kryesor në platformë, por Kosova nuk përmendej si pikë e veçantë, por ajo konceptohej në kuadër të shtetit amë. Mbi këtë bazë, bashkimi do të realizohej duke u mbështetur në forcat e brendshme dhe me mbështetje parimore nga jashtë, qofshin nga nazifashistët, apo antifashistët. Në dokument nuk përmendet as lufta si mjet për ta realizuar bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Arritja e qëllimit final për bashkim kombëtar nuk artikulonte terma të një nacionalizmi ekstrem, por donte ta realizonte qëllimin kombëtar duke ruajtur miqësinë dhe mirëkuptimin e ndërsjellë me fqinjët.

Ndërkohë, pas bashkimit të realizuar nga fashizmi, u mbajt Mbledhja themeluese për Partinë Komuniste të Shqipërisë. Në Mbledhje u diskutua edhe lidhur me emrin që do të kishte partia, nëse ajo të quhej Partia Komuniste Shqiptare apo Partia Komuniste e Shqipërisë. Mirëpo, “me shumicë votash u vendos që Partia të quhej Partia Komuniste e Shqipërisë - PKSH”². Ky emërtim dukej se do ta linte anash çështjen e Kosovës. Në Rezolucionin e Mbledhjes Themeluese të PKSH-së³, nuk përmendet fare çështja e Kosovës dhe e bashkimit të shqiptarëve në një shtet të vetëm dhe në një front të përbashkët të luftës kundër fashizmit. Çështja e Kosovës, në mënyrë indirekte u lidh ngushtë me luftën kundër fashizmit përmes vëllazërim - bashkimit me popujt ballkanikë, duke mos u përmendur fare emri i saj. Edhe

¹Uran Butka, *Gjeniu i Kombit*, vëll. II, Tiranë: “Drier”, 2006, f. 348.

²Xhelal Gjeçovi, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës*, Tiranë: “Botimpex”, 1998, f. 42

³*Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH)*, Fondi 14, viti 1941, dos. 1, f. 15-16. Rezolucioni i Mbledhjes Themeluese të PKSH.

në Thirrjen e Parë që KQ i PKSH-së i drejtonte popullit shqiptar pas krijimit të Partisë⁴, e cila u përpilua në bazë të rezolutës së mbledhjes themeluese nuk flitej për Kosovën. Për Kosovën nuk u diskutua as në Konsultën e Parë të PKSH-së në prill të vitit 1942.

PKSH, nuk i njohu kufijtë e shtetit të bashkuar shqiptar nën pushtimin italian dhe gjerman⁵, për shkak të interesit të përgjithshëm të Luftës Antifashiste të udhëhequr nga Aleatët, të cilët siç dihet nuk i kishin pranuar ata kufij. Po ashtu duke u nisur edhe nga interesat e përgjithshme të komunizmit e të vartësisë politiko – ushtarake të PKSH-së nga PKJ. PKSH pranoi kërkesën e kësaj të fundit, që popullsia e Kosovës në Jugosllavi të ngrihej në luftë nën udhëheqjen e saj. Ishte tejet e vështirë që të bindje popullin e Kosovës që të luftonte nën udhëheqjen e PKJ. Një veprim i tillë do ta dobësonte mjaft rezistencën e shqiptarëve në ish - Jugosllavi dhe do ta zbehte të ardhmen e saj së bashku me Shqipërinë. PKSH nuk mori përsipër të udhëhiqte luftën në Kosovë, por e quajti të drejtë e të arsyeshme bashkëpunimin vëllazëror midis PKSH dhe PKJ⁶. Lëshimi i pranuar me këtë rast nga KQ i PKSH-së, do të thoshte që çështjen kombëtare të Kosovës ta lije në mëshirën e kohës dhe në besimin e alternativës jugosllave për zgjidhjen e çështjes nacionale.

⁴ *PPSH Dokumenta Kryesore*, vëll. I, 1941-1948, botimi i dytë, Tiranë: “8 Nëntori”, 1971, f. 28-32.

⁵ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AMPJ*), viti 1960, dos. 530/2, f. 62-63. Të dhëna nga gazeta *Zëri i Popullit*, nr. 2 dhe 8, viti 1942, mbështetur në qëndrimin e PKSH-së, gjatë Luftës së Dytë Botërore.

⁶ Enver Hoxha, *Titistët* (Shënime historike), Tiranë: “8 Nëntori”, 1982, f. 74-77.

Konferenca e Pezës

Më 16 shtator 1942, u mbajt Konferenca e Pezës. Në Konferencë u rrah edhe çështja e Kosovës, duke mos e njohur pushtimin nga fashizmi dhe kufijtë e realizuar prej tij⁷. Vendimi i Konferencës së Pezës që i kushtohej Kosovës ishte më tepër atribut i forcave nacionaliste se sa të komunistëve që drejtuan lëvizjen. Për çështjen e Kosovës, që më 12 shtator, komunistet ishin shprehur në një mbledhje të tyre paraprake në Pezë, se “çështja e Kosovës nuk mund të lihet në heshtje, se këtë çështje nacionalistët do ta hapin”⁸, sikurse ndodhi me të vërtetë pak ditë më mbrapa. Siç dihet arritje e kësaj konference që zgjedhja e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar. Në Proklamatën e këtij Këshilli, drejtuar Popullit Shqiptar, u përcaktuan edhe qëllimet e Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Ky Këshill, në organin e vet të shtypit “*Bashkimi*”, në numrin e parë, përcaktoi detyrat e përgjithshme demokratike⁹. Në të zgjidhja e çështjes së Kosovës nuk përmendej fare, madje nuk përmendej as Shqipëria etnike si zgjidhje, por anohej më tepër drejt rikrijimit të shtetit shqiptar të vitit 1913. Konferenca e Pezës, përfundimet e punës së saj i pasqyroi në një rezolutë¹⁰, në të cilën, përveç termit e “pandarë”¹¹, po ashtu, nuk përmendej në mënyrë të veçantë Kosova.

⁷ AQSh, Fondi 14/AP, viti 1943, dos. 10/2, f. 15. Rezolucion i Konferencës së Pezës.

⁸ Xhelal Gjeçovi, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës*, Tiranë: “Botimpex”, 1998, f. 177.

⁹ Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Tiranë: “Ideart”, 2004, f. f. 239.

¹⁰ *Historia e Shqipërisë*, vëll. III, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: “Toena”, f. 517.

¹¹ *Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës* (më tej: ASHAK), Fondi Komiteti Krahinor i L. K. të Kosovës - i Shqipërisë, viti 1942-44, kutia 36, dokumenti nr. 521, f. 1-4. Rezolucion i Konferencës për zgjedhjen e Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar.

Në fund, në këtë konferencë mbështetur në parimet që garantonte Karta e Atlantikut e 14 gushtit 1941, u arrit në marrëveshje që, “çështja e Kosovës të zgjidhej në bazë të parimit të vetëvendosjes së popujve...”¹². Pra, mbështetje për zgjidhje të çështjes së Kosovës, mbi parimin e Kartës së Atlantikut. Mbi këtë bazë pavarësisht divergjencave të thënieve e debateve që u shprehen në konferencë, konkludimi për Kosovën ishte i njëjtë nga ana e nacionalistëve me qëndrimin apo aprovimin edhe të komunistëve për zgjidhjen e çështjes së saj. Po ashtu, delegatët nacionalistë të kësaj konference (si komunistët), lidhur me çështjen e Kosovës, “dënuan përpjekjet e pushtuesve fashiste Italian dhe të qeverisë së ngritur të Mustafa Krujës, për ta paraqitur Kosovën si vend të çliruar”¹³. Andaj as nga nacionalistët nuk njihej pushtimi nga fashizmi dhe kufijtë e realizuar prej tij. Kështu, e ardhmja e Kosovës shihej nën frymën e Kartës së Atlantikut, duke mos pranuar zgjidhjen e fashizmit dhe duke e lënë zgjidhjen pas mbarimit të luftës, në bazë të parimit të vetëvendosjes së popujve. Ndërkohë më vonë nga disa grupe nacionaliste që ishin në gjirin e Ballit Kombëtar, kufijtë e rinj u njohën pavarësisht mënyrës e formës në të cilat ishin të realizuar.

Balli Kombëtar formësoi programin politik të njohur me emrin “Dekalog”, ose 10 pikat, në nëntor të vitit 1942¹⁴. Mbi bazë të programit, kjo organizatë nacionaliste, me alternative politike për bashkim kombëtar, i ftonte shqiptarët, “për mobilizimin e të gjithë fuqive të gjalla të kombit, kundër pushtuesit për realizimin e idealit të naltë kombëtar, për të harmonizuar dhe bashkuar

¹² *Historia e Shqipërisë*, vëll. III..., f. 517-518.

¹³ AQSh, Fondi 14/AP, viti 1943, dos. 10/2, f. 15. Rezolucion i Konferencës së Pezës.

¹⁴ AQSh, Fondi 556, viti 1944, dos. 49, f. 1. Dekalogu i Organizatës Nacionaliste “Balli Kombëtar”.

energjitë e kombit me gatue bashkimin mendor e shpirtëror të të gjithë shqiptarëve, për një Shqipëri të lirë, etnike, demokratike, me baza shoqërore moderne”. Program i cili kishte si pikë referimi simbolet kombëtare; “flamurin kuq e zi”, “Shqipërinë e lirë etnike”, idealin e naltë kombëtar¹⁵.

Mbështetur në programin e lartpërmendur, për BK, çështja e Kosovës, kishte shansin historik të zgjidhej përmes bashkimit të saj me Shqipërinë (pasi që ajo ishte bashkuar), duke qenë “Kosova pjesë e pandashme e Shqipërisë”¹⁶. Çdo formë çlirimi që nuk kurorëzohej me bashkimin me Shqipërinë, konsiderohej se është për Kosovën një zgjedhë e dytë. Kësisoj, duke pasur si alternativë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës bashkimin e saj me Shqipërinë, Balli Kombëtar lëshoi kushtimin për bashkim kombëtar rreth flamurit kuq e zi, për të garantuar bashkimin e Kosovës me Shqipërinë dhe mbrojtjen e saj nga terrori çetnik. Me parullën: “Ja Kosova Shqipni! Ja vdekje ja liri!”, bëhej thirrje për bashkim shpirttrash e zemrash, pa dallim krahine e feje, por me një besë e me një ideal për të ruajtur Independencën e Shqipërisë, si dhe për të mbrojtur Kosovën, nën flamurin e shenjtë Shqiptar, “i cili vërteton e siguron para gjithë botës pavarësinë tonë si shtet e si komb i bashkuem”¹⁷. Lidhur më realizimin e këtij qëllimi final, në një dokument të kohës thuhej se: “Balli Kombëtar”..., nuk është dhe nuk do të jetë kurrë në shërbimin e fuqive të huaja...”¹⁸. Kësisoj, programi i BK nuk përcaktonte se cila do të ishte politika e jashtme që do të ndiqej për të realizuar bashkimin kombëtar. Qëndrimin e vet për Kosovën pas Konferencës së Pezës, PKSH do ta bënte publike përmes shtypit, në të cilat do të popullarizohej lufta nacionalçlirimtare e popujve fqinjë ballkanikë e në veçanti ai

¹⁵ *Po aty*, dos. 21, f. 5.

¹⁶ *AQSh/AP*, Fondi 270, dos. 69, f. 10.

¹⁷ *ASHAK*, Fondi Komiteti Krahinor i L. K. të Kosovës - i Shqipërisë, viti 1942-44, kutia 36, dokumenti nr. 2118, f. 1. Thirrje drejtuar shqiptarëve në Kosovë.

¹⁸ *AQSh*, Fondi 556, viti 1944, dos. 21, f. 13. Trakt i Ballit Kombëtar.

greko - jugosllav. Popullit i bëhej thirrje për vëllazërim, përkrahje e solidaritet të luftës së tyre. Por, Komiteti Qendror i PKSH-së, çështjen e Kosovës nuk e diskutoi në Konferencën e Parë të Vendit, që u mbajt në Labinot të Elbasanit më 17 - 22 mars të vitit 1943. Po ashtu, ajo nuk u përmend fare as në Deklaratën e Këshillit të Përgjithshëm të FNÇL dhe të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇL-së, lëshuar më 10 qershor të vitit 1943, që kishte të bënte me, “domosdoshmërinë e krijimit të një organizate çlirimtare kombëtare, e cila nënkuptonte bashkimin e të gjithë patriotëve”¹⁹.

Mbledhja e Mukjes

Një fazë me shumë interes në qëndrimin ndaj Kosovës përfaqëson Mbledhja e Mukjes, e paraprirë nga ajo e Tapizës, e mbajtur më 26 korrik 1943. Në takimin e Tapizës, të përfaqësuesve të delegacioneve të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe delegacionit të organizatës “Balli Kombëtar”, i cili i parapriu takimit të Mukjes, u diskutua edhe problemi i Kosovës. Në këtë takim, pika C, fiksoi formulimin për independencën e plotë të Shqipërisë në kufijtë e 1913 dhe realizimin e bashkimit me atdheun shqiptar, të viseve të banuara prej shqiptarësh, në virtyt të parimit të përgjithshëm të vetëvendosjes së popujve, të njohur universalisht dhe të garantuar prej Kartës së Atlantikut²⁰.

Ky ishte një ndryshim radikal i Nacionalçlirimtares, krahasuar me qëndrimet e mëparshme për sa i përkiste çështjes së Kosovës, sepse theksonte restaurimin e shtetit shqiptar të vitit

¹⁹ Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Tiranë: “Ideart”, 2004, f. 255.

²⁰ AQSh, Fondi 14/AP, viti 1943, dos. 21, f. 8. Procesverbal i Mbledhjes së Tapizës, korrik 1943.

1913 dhe bashkimin me të viseve të banuara nga shqiptarët, ndonëse pa përmendur me emër Kosovën. Pra, u pëlqye një formulë, që duke u mbështet në Kartën e Atlantikut, të sigurohej Shqipëria etnike, pa u përmend në marrëveshje kjo fjalë²¹. Kjo formulë u adoptua bashkërisht edhe me nacionalistët, të cilët gjithashtu ju referuan Kartës së Atlantikut.

Pak ditë më pas dhe pikërisht më 1 deri në 3 gusht 1943, u mbajt Mbledhja e Mukjes, ku u takuan delegacionet e Ballit Kombëtar dhe të Frontit Nacionalçlirimtar. Mukja përfaqëson një ndër përpjekjet me serioze të forcave politike shqiptare për bashkim e pajtim kombëtar, në të cilën u shtruan për diskutim shumë probleme që lidheshin me bashkëpunimin, që duhej të arrihej në dobi të luftës për çlirim e bashkim kombëtar.

Mid'hat Frashëri së bashku me përfaqësuesit e Ballit Kombëtar, në Mukje e ripohuan domosdoshmërinë e shkëputjes së Kosovës dhe viseve tjera shqiptare nën Jugosllavi dhe bashkimin e tyre me shtetin amë, brenda kornizës së Shqipërisë etnike²². Nacionalistët e konsideruan bashkimin e Kosovës me Shqipërinë si të pjesshëm e të realizuar nga okupatori për interesat e tyre, megjithëse ngulnin këmbë se: “pavarësisht se kush e kish bashkuar, ky ishte një fakt që duhej pranuar dhe shfrytëzuar për të lidhur fijet e këputura me gjysmën tjetër të Shqipërisë, për të bërë bashkimin shpirtëror, për të ngritur institucionet shqiptare, të cilat do të organizonin luftën, do të përfaqësonin institucionalisht popullin e këtyre trevave pas luftës dhe do të kërkonin e do të realizonin zgjidhjen në bazë të së drejtës kombëtare dhe ndërkombëtare”²³.

²¹ Faik Quku, *Qëndresa shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botnore 2 (1941-1944)*, Tiranë: “Ilar”, 2006, f. 248.

²² U. Butka, *Gjeniu i Kombit...*, f. 371.

²³ *Po aty*, f. 370.

Sipas nacionalisteve pushtuesit italian e gjerman ishin të përkohshëm, ndërsa sllavët ishin pushtues të përhershëm, të cilët e quanin të tyren Kosovën e viset e tjera shqiptare dhe synonin t'i aneksonin. Ballistët nuk kishin besim tek armiqtë sllavë, historikisht antishqiptarë me politikat e tyre pushtuese²⁴. Mbi këtë bazë, ballistët më tepër kishin si synim të ruanin gjendjen ekzistuese të tokave shqiptare të bashkuara nga pushtuesi, por nuk e linin mënjatë edhe alternativën e zgjerimit të tyre me territore shqiptare, të cilat kishin mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë. Pra, bashkimi për ta nënkuptonte qëllimin final të shqiptarëve bashkim i cili duhej të ruhej edhe pas luftës duke kundërshtuar edhe me armë pushtuesin jugosllavë për të garantuar arritjen e tij.

Pas një serë debatesh në pikën 2 të procesverbalit u pranua formulimi: “Luftë për një Shqipëri independente dhe për zbatimin e parimit të njohur universalisht e të garantuem nga Karta atlantike, të vetëvendosjes së popujve, për një Shqipëri etnike”²⁵. Arritja e kësaj formule e pranimi i saj nga dy forcat kryesore të rezistencës në Shqipëri ishte fitore për Shqipërinë dhe për popullin shqiptar. Me Shqipërinë etnike nënkuptoheshin Kosova e Çamëria. Palët po ashtu ranë dakord për zhvillimin e një plebishiti (referendumi) në Kosovë, i cili do të përcaktonte të ardhmen e saj, pas përfundimit të luftës²⁶. Në fakt kjo formulë u artikulua në disa raste edhe nga Lëvizja Nacionalçlirimtare gjatë Luftës. Krerët e

²⁴ Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin Italian 1939-1943*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë & Instituti i Historisë, Tiranë: “Mësonjëtorja”, 2005, f. 241.

²⁵ AQSh, Fondi 14/AP, viti 1943, dos. 21, f. 9. Procesverbal i Mbledhjes së Mukjes, gusht 1943.

²⁶ Afrim Krasniqi, *Partitë Politike në Shqipëri (1920-2006)*, *Historia dhe tiparet e partive parlamenteve dhe të zhvillimeve politike*, Instituti shqiptar i studimit të politikave, Tiranë: “Edlor”, 2006, f. 126; Reginald Hibbert, *Fitorja e hidhur-Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë*, Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë: “A. Z. Çajupi”, 1993, f. 93.

²⁶ *Po aty*, f. 294-295.

Ballit Kombëtar ndaheshin tërësisht nga ata të LNÇL kur flitej për shtetin ekzistues shqiptar në pushtim të krijuar nga Italia dhe Gjermania. Të parët e pranonin atë, por e shihnin si krijesë jetëshkurtër, ndërsa dytët e konsideronin si pjellë të dështuar të pushtuesit. Megjithatë, nacionalistët ndanin të njëjtin opinion me krerët e Lëvizjes Nacionalçlirimtare se “çështja e Kosovës, si pjesë e çështjes shqiptare, duhej të rihapej e të zgjidhej në fund të Luftës së Dytë Botërore”, dhe se bashkimi i Kosovës me Shqipërinë ishte një akt i pjesshëm dhe i realizuar nga fashizmi për interesat e tyre²⁷. Duket se Balli Kombëtar i ratifikoi qëndrimet për këtë çështje jo thjesht për hir të kompromisit me Lëvizjen Nacionalçlirimtare, por ai mori në konsideratë edhe qëndrimet e Aleatëve, vendimet e mëvonshme të cilëve do të ishin vendimtarë për të ardhmen e territoreve shqiptare nën Jugosllavi. Fitorja e aleatëve kishte filluar të përvijohet në këtë periudhë dhe ajo do të ndikonte edhe në të ardhmen politike dhe pushtetin që do të qeveriste Shqipërinë e pasluftës.

Në mbledhjen e Mukjes, në dokumentin përfundimtar nuk u përmend fjala Kosovë por Shqipëri etnike, duke e mbështetur në Kartën e Atlantikut²⁸. Kërkesa për Shqipërinë etnike, shpallej se ishte e bazuar tek Karta e Atlantikut dhe parimi i vetëvendosjes i pranuar prej saj. E rëndësishme ishte gjithashtu se kjo shoqërohej me detyrimin e forcave shqiptare për luftë të përbashkët dhe të menjëhershme përkrah aleatëve të mëdhenj anglo - sovjeta - amerikanë. Interpretimi i Kartës së Atlantikut në Mukje duhet thënë se është i diskutueshëm, sepse i njëjti dokument nuk njihte ndryshimin e kufijve të bërë nga Fuqitë e Boshtit, dhe në këtë kontekst as bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, por sidoqoftë ai linte të hapur parimisht problemin e vetëvendosjes pas luftës. Kështu, formulimi i Kartës së Atlantikut linte shpresa për të gjitha palët, por vendimet reale do të merreshin vetëm pas luftës. Duhet

²⁷ U. Butka, *Gjeniu i Kombit...*, f. 369-370.

²⁸ F. Quku, *Qëndresa shqiptare gjatë Luftës...*, f. 253.

pranuar se Karta e Atlantikut ishte dokument shumë i rëndësishëm për të tërhequr popujt në rezistencën antifashiste, por ajo e linte të diskutueshme të ardhmen e tyre.

Më 3 gusht Komiteti Provizor për Shpëtimin e Shqipërisë publikoi proklamatin e dalë në emër të dy organizatave përbërëse të tij, BK dhe Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Në të flitej edhe për luftën që duhej të zhvillohej krahas aleatëve, për një Shqipëri të pavarur, për parimin e vetëvendosjes sipas Kartës së Atlantikut dhe për një Shqipëri etnike²⁹. Bashkë me forcat e majta të rezistencës shqiptare edhe nacionalistët u bashkuan dhe pranuan në Mukje parimin që zgjidhja e çështjes së Kosovës të bëhej sipas parimit aleat të vetëvendosjes, të pranuar në Kartën e Atlantikut, por duke e zgjeruar atë më tej, deri në pranimin e idesë së Shqipërisë etnike. Në këtë mënyrë të dyja forcat politike dhe ushtarake në Shqipëri pranuan një opsion të përbashkët për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Nacionalistët shqiptarë pranuan në Mukje zgjidhjen e çështjes së Kosovës në bazë të parimit të vetëvendosjes, duke përjashtuar ndryshimin e kufijve me dhunë. Në këtë mënyrë ata nuk e merrnin të mirëqenë ndryshimin e kufijve të realizuar nga pushtuesit. Por për të synuar në atë zgjidhje ishte premisë e domosdoshme që populli shqiptar në Shqipëri e në Kosovë, të ngrihej në luftë kundër pushtuesve antifashiste, përkrah koalicionit antifashist botëror. Pas luftës synohej që do të fitohej kapitali politik i nevojshëm për të kërkuar, pas dëbimit të pushtuesve fashiste, zbatimin e parimit të vetëvendosjes për Kosovën e viset e tjera shqiptare.

Por, vendimet e Mukjes u anuluan e u dënuan nga Enver

Hoxha dhe udhëheqja e lartë e PKSH-së, në prapavijë të së cilës qëndronte udhëheqja e PK të Jugosllavisë dhe emisarët e saj në

²⁹ AQSh, Fondi: 14/AP, viti 1943, dos. 21, f. 10. Procesverbal i Mbledhjes së Komitetit Provizor, 3 gusht 1943.

Shqipëri³⁰. Pika më e papranueshme për Komitetin Qendror të PKSH dhe Enver Hoxhën, do të ishte ajo e Shqipërisë etnike³¹. Udhëheqja e PKSH-së, nuk donte ta ndante pushtetin me krerët nacionalistë të Ballit Kombëtar, me pretekstin se ky i fundit nuk po luftonte kundër okupatorit fashist. Ky ishte një gabim i rendë i PKSH-së, gabim të cilin Balli nuk diti ta shfrytëzojë në dobi të vet dhe as të çështjes kombëtare. Balli Kombëtar pas deklaratës së Fronit Nacionalçlirimtar për t'i shpallur luftë atij në tetor 1943, jo vetëm që e pezulloi rezistencën kundër pushtuesit, por bashkëpunoi në një masë të rëndësishme me gjermanët kundër LNÇL. Kjo i dha një armë të fuqishme në dorë kësaj të fundit dhe çoi gradualisht në largimin e Ballit nga skena reale e rezistencës shqiptare dhe në abandonimin e tij nga aleatët anglo - amerikanë.

Është fakt i pamohueshëm, se prishja e marrëveshjes së Mukjes, shkaktoi përçarje e konfrontime të thella në Shqipëri. Pasojë e saj ishte dalja e Abaz Kupit nga FNÇL. Abaz Kupi shpalli shkëputjen nga komunistet në nëntor 1943 në fshatin Zallher të Tiranës dhe krijoi organizatën e “Legalitetit”, një organizim politik dhe ushtarak që kishte si qëllim restaurimin e Monarkisë dhe rikthimin e Mbretit Zog në krye të Shqipërisë. Ndër pikat më të spikatura të programit të tij do të përmendnim ato që kishin të bënin me krijimin e Shqipërisë etnike, vendosjen e regjimit mbretëror në Shqipërinë e pasluftës, por edhe disa kërkesa për zbatimin e reformave shoqërore në vend³². Në programin e “Legalitetit”, si edhe në shumicën e programeve tjera të kohës së luftës, nuk përmendet “Kosova” si problem i veçantë, por ajo nënkuptohet në pikën 2 të programit kur flitet për Shqipërinë etnike. Parimi i vetëvendosjes shprehet përmes termave se “fati i trevave të Kosovës, Çamërisë dhe Maqedonisë

³⁰ Ndreqi Plasari e Luan Malltezi, *Politike Antikombëtare e Enver Hoxhës*, Plenumi i 2-të i KQ të PKSH, Berat 23-27 nëntor 1944, Tiranë: 1996, f. 224; 238.

³¹ AQSh, Fondi: 556, viti 1944, dos. 34, f. 96. Trakt’ i I-rë, nga Xhelal Staravecka.

³² A. Krasniqi, *Partitë Politike në Shqipëri...*, f. 356.

mos të vendosej pa u marrë parasysh dëshirat e banoreve të tyre”³³.

Në përgjithësi, Balli Kombëtar dhe nacionalistët e tjerë e shikonin Jugosllavinë dhe Greqinë me dyshim dhe urrejtje, ndërsa komunizmin si një kërcënim për Shqipërinë, duke menduar se me të kompromisi do të ishte i vështirë. Ndërkaq, Anglia dhe misionet e saj në Shqipëri shiheshin nga ballistët dhe legalistët, si një aleat i mundshëm, por krahas kësaj edhe me mosbesim dhe frikë për shkak të qëndrimeve të tyre mbështetëse ndaj fqinjëve të fuqishëm jugosllavë dhe grekë, dhe mungesës së garancisë për kufijtë e shtetit shqiptar të vitit 1913 dhe problemit të së ardhmes së Kosovës. Dëshira e mirë për zgjidhjen e çështjes kombëtare ishte akt për t’u vlerësuar, por një pjesë e mirë e anëtarëve të BK ose qëndruan inaktivë, ose bashkëpunuan në periudha të caktuara me gjermanët, duke humbur kredibilitetin në sytë e aleatëve. Sidoqoftë, brenda tij pati forca të cilët luftuan kundër pushtimit gjerman dhe kontribuan në kauzën e çlirimit të vendit dhe për kauzën e aleatëve antifashistë. Arritja e qëllimit final, pra bashkimi i Kosovës me Shqipërinë, duke qenë inaktivë, apo duke bashkëpunuar me pushtuesin gjerman, nuk përkonte me interesat e aleatëve të mëdhenj e as me dokumentet e nënshkruara prej tyre.

Çështja e Kosovës u shtrua edhe në Konferencën e Dytë Nacionalçlirimtare të mbajtur në Labinot të Elbasanit nga 4 deri 8 shtator të vitit 1943. Në këtë Konferencë u fol edhe për Kosovën por në një mënyrë tjetër nga ajo e artikuluar në Mukje. Në Konferencë bashkimi i Kosovës me Shqipërinë u konsiderua, si një vepër e fashizmit³⁴. Zgjidhja e çështjes së Kosovës, sipas

³³ Julian Ameri, *Bijtë e Shqipes*, Tiranë: 2002, f. 127, 147.

³⁴ AQSh/AP, Fondi: 40, viti 1943, dos. 4, f. 37. Diskutim i Enver Hoxhës në Konferencën e Dytë Nacionalçlirimtare, 4-8 shtator 1943.

referatit të mbajtur nga Enver Hoxha³⁵, ishte në duart e vetë shqiptarëve të Kosovës, nëse ajo do t'i bashkëngjitej Shqipërisë apo Jugosllavisë. Por kjo kushtëzohej me pjesëmarrjen e tyre në luftë kundër okupatorit fashist e në fund edhe kundrejt atij jugosllav, në rast se i mohonte atij të drejtën e vetëvendosjes. Në Rezolucionin e Konferencës së Labinotit për problemin e Kosovës u arrit në përfundimin se: “Çështja e Kosovës dhe e Çamërisë do të zgjidhet në bazë të Kartës së Atlantikut, në bazë të parimit të vetëvendosjes së popujve, dhe garancia më e madhe për triumfin e këtij principi është vetë lufta që bëjnë dhe do të bëjnë Kosova e Çamëria, krah për krah me popujt jugosllavë e atë grek...”³⁶. Pra zgjidhja e çështjes së Kosovës edhe njëherë u theksua se do të realizohej brenda kuadrit të pranuar nga Aleatët në bashkëpunim me forcat antifashiste të vendeve fqinjë. Edhe sipas Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, “çështja e Kosovës, pas luftës së përbashkët që do të bëjnë shqiptarët të vëllazëruar me Serbët e Malazeztë, do të zgjidhet me drejtësinë më të madhe.... Dhe Partitë Komuniste motra Jugosllave e Shqiptare, do të jenë një garanci tjetër, për zbatimin e kësaj drejtësie”³⁷.

Idea se Kosovën do ta lënë vetë të lirë jugosllavët, që ajo të vendosë rreth së ardhmes së saj u prit me skepticizëm dhe mosbesim të thellë tek një pjesë e madhe e shqiptarëve të Kosovës. Ajo ishte rrjedhojë e drejtpërdrejtë e marrëdhënieve të këqija të shqiptarëve me serbët, e shtypjes së popullit shqiptar dhe

³⁵ Enver Hoxha, *Vepra*, vëll. I, Tiranë: “8 Nëntori”, 1983, f. 464; *Çështje të revolucionit dhe të ndërtimit socialist* (përmbledhje veprash), vëll. I (1942-1961), Tiranë: “8 Nëntori”, 1978, f. 103-104; *Dokumente të Organeve të Larta të Pushtetit Revolucionar Nacional-Çlirimtar 1942-44*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1962, f. 50.

³⁶ AQSh, Fondi: 14/AP, viti 1943, dos. 19, f. 4. Rezolucion i Konferencës së Labinotit.

³⁷ ASHAK, Fondi: Komiteti Krahinor i L.K. të Kosovës, viti 1943, kutia 7, dokumenti nr. 78, f. 1. Thirrje drejtuar popullit shqiptar të Kosovës nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Shqiptare.

mungesës së lirive dhe të drejtave të tyre kombëtare. Ishte shumë e vështirë të kapërceje realitetet e shkuara dhe të bashkoje në një front shqiptarët dhe serbët. Esenca e mosbesimit të shqiptarëve te serbët shprehej qartë në një serë dokumentesh të kohës³⁸. Me këtë rast vlen të theksohet fakti se një pjesë e popullit shqiptar të Kosovës, nuk kishte besim as tek partizanët komunistë të Titos, për çlirimin e tyre kombëtar.

Jo vetëm për komunistët shqiptarë gjatë Luftës së Dytë Botërore, por edhe për Lëvizjen Nacional - çlirimtare të drejtuar prej saj, fjalët “Shqipëri etnike” dhe “Shqipëri e Madhe”, ishin parulla të fashizmit italian e të nazizmit gjerman për të gënjyer popullin shqiptar³⁹. Sipas saj, “Kosovarët duhej të bashkëpunonin me Nacionalçlirimtarët jugosllavë, kundër armikut okupator, e ata vetë do t’a lënë të lirë Kosovën të vendosë mbi fatin e vetë në bazë të Kartës së Atlantikut...”⁴⁰. Edhe Shtabi i Brigadës së I-rë i Ushtrisë Nacional - çlirimtare të Shqipërisë, bënte thirrje, për luftime kundra fashizmit gjerman përkrahë aleatëve të mëdhenj, Sovjeto - Anglo - Amerikan dhe luftës së popujve Jugosllav, Grek, Bullgar⁴¹, etj. Një qëndrim i tillë, se vetë nacionalçlirimtarët jugosllavë, do t’i japin lirinë popullit shqiptar të Kosovës, ishte paradoksal. Ai shprehte besim të verbër dhe të tepruar te udhëheqja jugosllave. PKSH bëri një luftë të madhe kundër mosbesimit e përçarjes së thellë, që ishte krijuar në të kaluarën midis popullit

³⁸ AMPJ, viti 1949, dos. 202, f. 2.

³⁹ ASHAK, Fondi: Komiteti Krahinor i L.K. të Kosovës, viti 1937-44, kutia 38, dokumenti nr. 1314. N. “Kosova”, *Lirija*, Organ i Këshillit Nacional-Çlirimtar të Kosovës e Metohisë, nr. 15-16-17-18, shtator 1944, f. 10.

⁴⁰ AMPJ, viti 1960, dos. 530/2, f. 63. Relacion; AIH, “Çështja e Kosovës”, *Bashkimi*, tetor 1943, f. 3-5.

⁴¹ ASHAK, Fondi Komiteti Krahinor i L.K. të Kosovës, viti 1943, kutia 7/A, dokumenti nr. 770, f. 1-2. Shtabi i Brigadës së I-rë, Ushtrisë Nacional-Çlirimtare.

shqiptar dhe atij serb. Megjithatë kjo nuk do të thotë se ishte edhe aq e pandërgjegjshme për gjendjen e së kaluarës së Kosovës nën Jugosllavi dhe për vuajtjet e saj, dhe po kështu për honin që ndante shqiptarët nga serbët, megjithatë ajo e shihte shpëtimin e saj tek bashkimi me kauzën e Aleatëve dhe tek rezistenca antifashiste. Për këtë realitet dëshmon edhe artikulli i mëposhtëm i botuar në gazetën “Bashkimi”, organ i Këshillit Nacional - çlirimtar të Shqipërisë, në numrin 5, nën titullin “Kosova e vërtetë dhe “kosovarët” e Xhafer Devesë”⁴², gazeta “Lufta e Rinisë” - organ i Rinisë Antifashiste Popullore Shqiptare⁴³, etj. Megjithatë duhet shtuar se, konstatimet e këtyre gazetave në fjalë në vetvete duken edhe paksa kontradiktore. Në njërën anë flisnin për bashkim, në anën tjetër për vëllazërim të shqiptarëve me pakicat serbo - malazeze, turke etj.

Besimi tek udhëheqja e PKJ-së, e cila do ta linte Kosovën të bashkohej me Shqipërinë në periudhën e pasluftës ishte në fakt, siç dëshmoi e ardhmja, një iluzion i PKSH-së dhe mosnjohje e gjendjes reale dhe e synimeve të udhëheqjes jugosllave, nacionaliste apo komuniste. Duket se PKSH ishte pak ose aspak e informuar për synimet reale të forcave të ndryshme në Jugosllavi ndaj Kosovës. Por, ajo tregonte edhe për mungesën e forcës së saj dhe të mbështetjes ndërkombëtare, sikurse e kishte Jugosllavia gjatë LDB. Krah asyeve të tjera duket se klasa e re e politikës shqiptare ishte edhe e papërvojë dhe ndoshta edhe idealiste në vështirimet e veta rreth çështjes së Kosovës dhe zgjidhjes së problemit të saj brenda kornizave ideologjike komuniste. Sidoqoftë, në rrethanat e LDB vështirë të gjejë zgjidhjen e duhur sipas dëshirave dhe vullnetit të shqiptarëve. Shqiptarët nuk kishin shumë alternativa për të zgjidhur dhe kemi bindjen që cilado rrugë

⁴² ASHAK, Fondi Komiteti Krahinor i L. K. të Kosovës, viti 1937-44, kutia 38, dokumenti nr. 1314, *Lirija*, Organ i Këshillit Nacional-Çlirimtar të Kosovës e Metohisë, nr. 15-16-17-18, f. 19.

⁴³ *Po aty*.

që do të ndiqej (qoftë e PKSH-së, apo e BK) nga shqiptarët prapë se prapë do të kishin të njëjtin fat që e pësuan pas luftës.

PKSH, i përshëndeti vendimet e Konferencës së Bujanit, të cilat hidhnin idenë e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, përmes dy artikujve të botuar në shkurt të vitit 1944, në buletinin “Zëri i Popullit” dhe “Bashkimi”. Madje në njërin prej artikujve, u botua edhe pasazhi i plotë i Rezolutës së Bujanit⁴⁴. Por, pas kësaj kohe idetë e Konferencës së Bujanit u lanë në harresë. Pas traktatit e përshëndetjes së Bujanit, çështja e Kosovës nga ana e PKSH-së, do të vijë duke u zbehur dhe duke u lënë në harresë. Për Kosovën nuk u diskutua fare në Plenumin e KQ të Helmesit në maj 1944. Ndërsa, më 27 maj në Kongresin e Përmetit, Omer Nishani në fjalën e hapjes do të shprehej: “Kosovarët, nëse duan të fitojnë të drejtën e vetëvendosjes, në bazë të Kartës së Atlantikut dhe të politikës që ndjek lëvizja nacional - çlirimtare e popujve të Jugosllavisë, e udhëhequr prej Mareshalit Tito..., Vetëm me këtë udhë Kosova, pas luftës, do të ketë të drejtën të vendosi mbi fatin e saj gjer në shkëputje”⁴⁵. Kongresi madje edhe përshëndeti marshallin Tito, për politiken e ndritur e luftën heroike, si garancia e vëllazërimit të popujve ballkanas, e realizim i idesë se madhe të një Konfederate Ballkanike”⁴⁶. Edhe më 23 shtator 1944, Komiteti Qendror i PKSH-së, i dërgoi një letër komandantit suprem të UNÇ e AP të Jugosllavisë, duke i thurur lavde Partisë Komuniste të

⁴⁴ Xh. Gjeçovi, *Shteti Shqiptar dhe çështja...*, f. 52; Lefter Nasi & Ana Lalaj, “Qëndrimi udhëheqjes së PKJ-së dhe PKSH-se ndaj vendimeve të Konferencës së Bujanit”, *Konferenca e Bujanit* (Materiale nga Seshioni Shkencor kushtuar 50-vjetorit të Konferencës së Bujanit, mbajtur në Tiranë më 7 janar 1994), Instituti i Historisë-Prishtinë: 1998, f. 50.

⁴⁵ *ASHAK*, Fondi Komiteti Krahinor i L. K. të Kosovës - i Shqipërisë, viti 1942-44, kutia 36, dokumenti nr. 2102, f. 2-3. Fjala e Omer Nishanit në hapjen e Kongresit të Parë Antifashist Nacional Çlirimtar.

⁴⁶ *Po aty*, dokumenti nr. 2111, f. 1.

Jugosllavisë e marshallit Tito⁴⁷. Po ashtu edhe Shtabi Operativ i Brigadës III dhe V, në shtator të vitit 1944⁴⁸.

Në Plenumin e KQ të PKSH-së, mbajtur në Berat nga 23 deri 27 nëntor 1944, çështja e Kosovës nuk u zu fare në gojë. Po ashtu, për Kosovën nuk u diskutua zgjidhje e as nuk u fol për të në mbledhjen e Dytë të KANÇ e as në ditën e 28 nëntorit, kur Qeveria e Enver Hoxhës, hyri në Tiranë dhe mbajti një fjalim të gjatë aty, para masës. Kjo me të vërtetë që nga traktati i dhjetorit që një tërheqje në shtrimin kombëtar. Aq më tepër, kur në fundin e vitit 1944 dhuna e terrori i ushtruar në Kosovë nga pushteti ushtarak serb, u shoqërua me masakra çnjerëzore, duke u justifikuar në spastrimin e saj nga “bandat shqiptare” e nga “njësitë e armatosura prej tradhtarëve shqiptarë”. Madje për fat të keq, në emër të luftimit të reaksionit, bashkëpunuan e bashkëvepruan edhe disa njësitë të armatosura të UNÇSH-së. Kjo nënkuptonte me të vërtetë edhe braktisjen e çështjes së Kosovës nga PKSH-ja, që ajo të zgjidhej në kuadër të atyre premtimeve të bëra gjatë luftës. Shprehjet e PKSH-së për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, se “në rast të kundërt do ta luftonte Jugosllavinë”, mbetën një slogan shterp.

Qeveria Mitrovica

Zëvendësimi i pushtimit italian me atë gjerman në Shqipëri u shoqërua me politika të reja, më të stërholluara dhe më “kombëtare”⁴⁹. Kështu, prishja e marrëveshjes së Mukjes, politika

⁴⁷ I. Hoti, *Çështja e Kosovës gjatë Luftës...*, f. 62.

⁴⁸ ASHAK, Fondi Komiteti Krahinor i L. K. të Kosovës - i Shqipërisë, viti 1942-44, kutia 36, dokumenti nr. 1234, f. 1-4. Thirrje nga Shtabi Operativ i Brigadës III-V Sulmuese, Komandant Major Shefqet Peçi, Komisar Politik Nito Çako.

⁴⁹ AQSh, Fondi 556, viti 1944, dos. 21, f. 27/2. Thirrje drejtuar popullit shqiptar nga Kryekomandanti i trupave gjermane.

e veçantë e ndjekur nga gjermanët në Shqipëri, si dhe rreziku i përhershëm sllav ndaj tokave shqiptare, bëri që disa nacionalistë të përqafonin idenë e ngritjes së organeve qeverisëse në Tiranë.

Menjëherë pas vendosjes së regjimit të pushtimit gjerman në Shqipëri, u krijua një Komitet Ekzekutiv provizor, me në krye Ibrahim Biçakun. Ky Komitet më 11 shtator 1943, rishpalli Pavarësinë e Shqipërisë, kurse më 14 shtator ai i drejtoi një thirrje popullit shqiptar e cila përfundonte, “Rroftë Shqipëria e Lirë”⁵⁰. Lidhur me këtë çështje ky Komitet i lëshoi popullit shqiptar edhe një shpallje⁵¹. Po ashtu në thirrjen, “Luftë Bolshevizmit...”⁵², i shpjegohej popullit për bolshevizmin, si dhe i bëhej thirrje atij dhe komunistëve që të largohen e të mos mashtrohen si vegla të verbëta të Moskës e të radhiten përkrahë Asamblesë Kombëtare. Ndërkohë, më 16 tetor u mbledh në Tiranë Kuvendi Kombëtar i cili shpalli “Këshillin e Lartë të Regjencës”. Ky Kuvend përbëhej nga 243 delegatë, që përfaqësonin të gjitha prefekturat e Shqipërisë, 163 prej të cilëve ishin nga Kosova dhe nga trevat e tjera shqiptare jashtë kufijve të shtetit shqiptar të vitit 1913⁵³.

Kabineti qeveritar do të kryesohej nga Rexhep Mitrovica, i

cili shpalosi edhe programin e Qeverisë. Në pikën kryesore të programit thuhej: “Mbrotjtja e pavarësisë së plotë dhe tërësisë tokësore të Shqipërisë, si dhe ngulmimi për të qenë zot i vendeve shqiptare, ku të sundojë respekti dhe e drejta etnike dhe jetike e Kombit shqiptar”⁵⁴. Qeveria, duke pasur si qëllim kryesor mbrojtjen e pavarësisë dhe integritetit të tërësisë territoriale

⁵⁰ AQSH, Fondi 556, viti 1944, dos. 21, f. 2. Thirrje Kombit Shqiptar!

⁵¹ ASHAK, Fondi Komiteti Krahinor i L. K. të Kosovës - i Shqipërisë, viti 1942-44, kutia 36, dokumenti nr. 2143, f. 1. Thirrja e Komitetit Ekzekutiv, Popullit Shqiptar.

⁵² Po aty, dokumenti nr. 2141.

⁵³ *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar 1939-1944*, vëll. III..., f. 82-83.

⁵⁴ AQSh, Fondi: 147, viti 1943, dos. 146, f. 1. Programi i Qeverisë Mitrovica.

shqiptare, e konceptonte Kosovën në këtë kuadër, pra të Shqipërisë etnike. Kështu Qeveria e përqendroi aktivitetin në dy drejtime kryesore: Në ngritjen dhe konsolidimin e shtetit shqiptar të cunguar dhe në përpjekjet për shpëtimin e Kosovës e viseve të tjera shqiptare, përmes programit të aprovuar, “mbrojtja e integritetit tokësor të Shqipërisë, brenda kufijve të saj Etnikë”.

Ashtu si Qeveritë e tjera të ngritura në Tiranë gjatë kohës së luftës edhe kjo Qeveri ishte një kundërshtar e rreptë e lëvizjes komuniste shqiptare dhe idetë e saj për zgjidhjen e çështjes së Kosovës ishin krejt të ndryshme nga ato PKSH-së dhe të Frontit Nacionalçlirimtar. Me këtë rast vlen të theksohet, se orientimet dhe qëndrimet e kësaj qeverie për zgjidhjen e çështjes së Kosovës qenë të ndryshme edhe nga qeveritë e tjera të ngritura në Tiranë gjatë kohës së luftës.

Në themel të programit të Qeverisë Mitrovica, qëndronte çështja e Kosovës e cila konceptohej si një çështje në krye të të gjitha problemeve. “Një Shqipëri pa Kosovë asht si një trup pa krye dhe pa krah që, shpejt a vonë, për një arsye ose për një tjetër, do të hidhet fatalisht me krahun e më të madhit, ose ma të voglit, prej fqinjëve të saj. Çështjen e Kosovës ne mund ta shtrojmë në tryezën e bisedimeve por me konditat tona e në themel të parimeve etnike, historike, gjeografike dhe ekonomike..., Kosova ka qenë, është dhe do të jetë shqiptare ajo, “ja do të mbetet Shqipëri, ja do të bëhet gur dhe hi”⁵⁵.

Qeveria Mitrovica për të arritur qëllimin imediat, bashkimin kombëtar, bënte thirrje që të liheshin mënjanë grindjet dhe ideologjitë politike, e të shpëtohej kombi⁵⁶. Te parimi i këtij programi, që mbështeste interesat nacionale, shihej edhe rruga e vetme për shpëtimin e kombit, duke qenë prioritare vetëm rruga e

⁵⁵ Eqrem Telhaj, “Programi ynë: Bashkim rreth Flamurit”, *Kombi*, Organ i Komitetit Ekzekutiv Provizor, 28 shtator 1943, nr. 5, f. 1-2. Konferencë e mbajtur prej anëtarit të Komitetit Ekzekutiv të Përkohshëm, Eqrem Telhaj në Radio Tirana.

⁵⁶ AQSh, Fondi 147, viti 1943, dos. 146, f. 2-5. Programi i Qeverisë Mitrovica.

realizimit të Shqipërisë etnike, në bashkëveprim me të gjitha forcat politike të vendit e larg frymëzimeve të ideologjive.

Duke i kushtuar një rëndësi të veçantë bashkimit ndërshtetëror, e duke i bërë thirrje popullit shqiptar që të ulte armët dhe të hiqte dorë nga vëllavrasja, nga lufta për klasë dhe ideologji dhe për t'u mbledhur rreth shtetit, i cili konsiderohej prej saj si administrator i pasurisë kombëtare, lëshonte thirrje: "Tani është koha për vendim të njëzashëm të kombit shqiptar për mbrojtjen e kufijve tonë të shenjtë etnikë"⁵⁷.

Shqiptarët duhej të ishin të përgatitur e të bindur se: "Lufta jonë fillon at'here kur të tjerët e përfundojnë"⁵⁸. Kështu, çështja e Kosovës do të shtrohej për bisedime pas mbarimit të luftës. Lidhur me këtë çështje, të drejtat kombëtare do të mbroheshin, me të gjitha forcat. Një nga masat e kësaj mbrojtjeje konsiderohej, ajo e regjistrimit të popullsisë në Kosovë, Dibër, Strugë etj. Gjithashtu duhej të përgatiteshin dokumente, të çdo natyre qofshin, që vlenin për të provuar shpërdorimet, shpërnguljet, kolonizimet, torturimet, terrorizimet e masakrimet. Me të tilla dokumente, kombi shqiptar duhej të dilte përpara Konferencës së ardhshme të Paqes e të kërkojë të gjitha ato të drejta që i takonin⁵⁹.

Me sa duket, Qeveria Mitrovica sakrifikoi për idealin e bashkimit kombëtar duke bashkëpunuar në mënyrë indirekte me gjermanët, të cilët u konceptuan si pushtues, por në të njëjtën kohë dhe si mundësi për realizimin e aspiratave për bashkim kombëtar e jo si rezultat i simpatisë ideologjike ndaj nazizmit. Ndonëse u ngrit në kohë të pushtimit, në kohën e kësaj qeverie nuk u ndërmorën veprime të rënda nga ana e autoriteteve gjermane si: ndryshim i flamurit apo simboleve tjera kombëtare, ndërhim i emrave të rrugëve e shesheve, nuk u krijua as parti dhe

⁵⁷ *Po aty*, f. 1-3.

⁵⁸ E. Telhaj, "Programi ynë: Bashkim...", f. 1.

⁵⁹ Fletorja zyrtare, 17 mars 1944, nr. 12, f. 4. Statuti i Organizatës "Lidhja e Dytë e Prizrenit".

as rini naziste me ekspozime të ideologjisë së Rajhut. Flamuri, gjuha, monedha, nëpunësit, administrata, uniformat, të gjitha ishin shqiptare.

Gazeta, “Kombi”, fillimisht si organ i “Komitetit Ekzekutiv Provizor” e më pas si organ “Kombëtar”, një rëndësi të veçantë i kushtonte përmes artikujve çështjes së Kosovës, si: “Drejtësi për Kosovën Shqiptare”, “Kosova Shqiptare se Shqiptare!”, “Cila është ardhëshmija e Kosovës?”⁶⁰, etj.

Qeveria Mitrovica ashtu si forcat e tjera nacionaliste, duke pasur si qëllim sendërtimin e krijimit të Shqipërisë Etnike, patën përballë një koalicion të fuqishëm ushtarako-politik, përkatësisht komunizmin shqiptaro-ballkanik, nacionalizmin sllavo-grek por ndeshi edhe mosmbështetjen ndërkombëtare. Në anën tjetër mospërkrahja nga Aleatët, ndaj qeverisë Mitrovica tregonte se nuk ishin të favorshme koniukturat ndërkombëtare për të krijuar një shtet kombëtar mbarëshqiptar në rrethanat e Luftës së Dytë Botërore dhe sidomos nën suazën e gjermanëve, të cilët në fund të vitit 1943 ishin në tërheqje, të mundur dhe të paaftë të zgjidhnin problemet e veta, pa le më ato ndërkombëtare e aq më pak ato shqiptare

⁶⁰ P. Prespa, “Cila është e ardhshmija e Kosovës?”, *Kombi*, Organ i Komitetit Ekzekutiv Provizor, 23 tetor 1943, nr. 13, f. 3.

Prof. dr. Fehmi REXHEPI
(Prishtinë)

**LUFTA E SHQIPTARËVE PËR VETËVENDOSJE E
BASHKIM KOMBËTAR GJATË LUFTËS SË DYTË
BOTËRORE**

Lufta dhe përpjekjet e popullit shqiptar të Kosovës dhe të viseve të tjera në ish-Jugosllavi për vetëvendosje, për çlirim e bashkim kombëtar, nuk kanë pushuar pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë (28 Nëntor 1912) e deri më sot. Kjo luftë ka baticat dhe zbaticat e veta, varësisht nga rrethanat e brendshme dhe ato ndërkombëtare. Një ngritje dhe një formë më të organizuar ajo do ta ketë gjatë Luftës së Dytë Botërore kur rrethanat ishin më të favorshme, si për forcat që gjendeshin në anën e Koalicionit Antihitlerian të udhëhequr nga komunistët, ashtu edhe për ato që mbanin një neutralitet, por që nuk donin të lidheshin me Lëvizjen komuniste përmes BRSS-së e Jugosllavisë ngase, siç konstatonte me të drejtë Emin Duraku, masat shqiptare “Komunizmin e konsideronin pansllavizëm”.¹

¹ Shih diskutimin e Emin Durakut në Këshillimin e KK të PKJ për Kosovë, shkurt 1942 në Vitomiricë të Pejës. Originali gjendet në: *Arkivi i Institutit të Historisë së Kosovës* (më tej: *AIHK*), Fondi i Gjakovës, sig, 29, d.nr.1190

Kur është në pyetje kjo luftë patjetër duhet të kthehemi në gjysmën e parë të shekullit XIX kur zënë fill apetitet hegjemoniste serbomëdha dhe malazezomëdha ndaj trojeve shqiptare, të cilat filluan të realizohen krahas konsolidimit dhe zgjerimit territorial të Mbretërisë malazeze dhe të Principatës serbe, sidomos me projektin e Naçertanies së Grashaninit të 1844-ës. Synimet serbo-malazeze u realizuan pjesërisht në vitet 1878 - 1881 dhe më 1912, kur Kosova dhe viset tjera shqiptare u pushtuan nga ushtritë serbe e malazeze. Konferenca e Londrës, më 1913, ia njohu Serbisë dhe Malit të Zi, Kosovën dhe territore të tjera shqiptare.

Me shpartallimin e Jugosllavisë më 1941, edhe njëherë trojet shqiptare u copëtuan, si rezultat i Marrëveshjes së Vjenës,² kur ministrat e Punëve të Jashtme të Gjermanisë dhe Italisë caktuan zonat e interesit të tyre në territorin e Jugosllavisë, duke përfshirë edhe vise të banuara me shqiptarë. Pas disa korrigjimeve të kësaj marrëveshjeje, në maj të vitit 1941 Kosova dhe viset e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi u copëtuan në dobi të tri shteteve: Italisë, Bullgarisë dhe Gjermanisë.

Pjesa më e madhe e trojeve shqiptare i takuan zonës okupuese italiane, të cilat iu bashkuan të ashtuquajturës Shqipëri e Madhe (me dekret të mëkëmbësit të mbretit nr. 264, datës 12. VIII. 1941) me 4 prefektura: Pejë, Prishtinë, Prizren dhe Dibër, me 14 nënprefektura dhe 143 komuna. Kësaj zone iu bashkuan edhe trevat e Ulqinit dhe Tuzit. Ky territor kishte mbi 11.780 km², me rreth 520.000 banorë, ku 75% ishin shqiptarë.³

Zonës okupuese gjermane iu bashkëngjitën Qarku i Mitrovicës, ku u përfshinë rrethet e Mitrovicës, Podujevës, Vushtrrisë dhe Tregut të Ri, që hynë në kuadër të Serbisë së

² Kjo marrëveshje u nënshkrua më 21-22 prill 1941 në Vjenë.

³ "Fletorja zyrtare" nr.129, 29.VIII.1941; Ali Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë 1941-1945*, Prishtinë 1971, f.97-98.

Nediqit. Në këtë zonë jetonin 135.000 banorë, prej të cilëve 81.000 ose 60% ishin shqiptarë.⁴

Bullgarisë fashiste veç rrethit të Shkupit e Kumanovës, i takoi një pjesë e rrethit të Gjilanit, Kaçanikut, Vitia si dhe Presheva e Bujanoci, ku jetonin rreth 130.000 shqiptarë.⁵

Pas këtij copëtimi të ri të trojeve shqiptare në ish-Jugosllavi, populli shqiptar edhe më tej mbeti i ndarë në disa shtete. Pakënaqësinë e arsyeshme të popullit (sidomos në ato zona që ishin nën Bullgarinë e Serbinë) i shfrytëzoi me kujdes edhe PKJ për të rritur ndikimin e vet.

Edhe shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera në ish-Jugosllavi, duke u mbështetur në Kartën e Atlantikut⁶, ku garantohej e drejta për vetëvendosje në bazë të pjesëmarrjes në luftë kundër fashizmit, si dhe në bazë të premtimeve të PKJ-së dhe të garancive të PKSH-së, iu përgjigjën thirrjes së PKJ-së për luftë të armatosur kundër fashizmit, me besim se do të realizojnë të drejtën për vetëvendosje dhe bashkim kombëtar.

Krahas zhvillimit të luftës antifashiste në Shqipëri dhe në Jugosllavi, edhe në Kosovë e në viset e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, filloi lufta e armatosur kundër fashizmit. S'ka dyshim se më të disponuar për luftë kundër fashizmit, për shkak të kushteve e rrethanave, më të vështira, ishin shqiptarët e zonës okupuese bullgare. Atje pothuajse nuk kishte nevojë për t'i bindur për luftë kundër pushtuesit, ngase të gjitha rrymat gjenin pajtueshmëri për çlirim. Kjo provohet edhe me faktin se dëshmori i parë shqiptar dhe heroi i popullit i shpallur në ish-Jugosllavi

⁴ Ali Hadri, *Narodnooslobodilacki pokret na Kosovu 1941-1945*, Prishtinë 1970, f. 82-84; Statisticki godisnjak AKMO 1953, Pristina 1955, f.22.

⁵ Po aty.

⁶ Deklaratë e përbashkët nga takimi Ruzvelt - Chërçhill (14.VIII.1941) mbi parimet e të drejtës së popujve për vetëvendosje, kundër eksploatimit ekonomik dhe nevojën e formimit të OKB-së. Më gjerësisht Vojna Enciklopedija I, Beograd 1970, f.289.

është Bajram Shabani nga Kumanova, i cili u vra në luftë kundër bullgarëve më 14 tetor 1941.⁷

Ndikimi i komunizmit te shqiptarët e këtyre viseve filloi të intensifikohet pas themelimit të PKSH-së. Idetë komuniste i propagandoi një numër jo i vogël nëpunësish e intelektualësh, sidomos mësuesish të ardhur nga Shqipëria pas vitit 1941, shumica e të cilëve ishin simpatizues të PKSH.⁸

Lidhur me organizimin dhe udhëheqjen e luftës së armatosur kundër fashizmit në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, mendojmë se ishte vetëm një rrugë e drejtë dhe e arsyeshme, që PKSH të ftonte dhe ta organizonte edhe popullin e Kosovës dhe të viseve të tjera përreth në luftë kundër nazifashizmit, ashtu siç e organizoi dhe e udhëhoqi popullin e Shqipërisë. Po të udhëhiqej kjo luftë nga PKSH do të eliminohet deri në minimum ndikimi i PKJ-së. Kësisoj njëherë e përgjithmonë qysh gjatë luftës do të bëhet integrimi dhe bashkimi, jo vetëm luftarak i forcave shqiptare, por duke u inkuadruar në të gjitha qelizat e pushtetit, gradualisht do të realizohet edhe e drejta e vetëvendosjes dhe e bashkimit kombëtar i të gjitha trojeve etnike shqiptare, me çka do të evitohet edhe konflikti në mes të rrymave politike shqiptare.

Vendimi i imponuar nga rrethanat ndërkombëtare, “që të pranohej kërkesa e PKJ-së që popullsia e Kosovës dhe e viseve të tjera shqiptare në ish-Jugosllavi të ngrihej në luftë nën udhëheqjen e saj, duke besuar se PKJ do të zbatonte pas lufte, ashtu siç e kishte shpallur, parimin e vetëvendosjes deri në shkëputje”⁹, i kushtoi mjaft shtrenjtë popullit tonë, pasojat e të cilit edhe sot e kësaj dite po ndihen.

⁷ Për rrethanat, disponimin e popullit dhe veprimtarinë e Bajram Shabanit shih gjerësisht: Ramiz Abdyli, *Bajram Shabani*, Shkup 1976.

⁸ Fehmi Rexhepi, “Me ditar dhe pushkë në revolucion”, *Shkëndija*, nr.18 dhe 19, Prishtinë, nëntor, dhjetor 1990, f.20.

⁹ Xhelal Gjeçovi, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, nëntor 1941-nëntor 1944*, Tiranë 1986, f.147.

PKJ dhe udhëheqja e saj përmes instruktorëve, të deleguarve e njerëzve të vet që në start u mundua me të gjitha forcat dhe në mënyrë më perfide të përçajë çdo përpjekje për afrim dhe bashkim kombëtar të shqiptarëve.¹⁰ Komunistët jugosllavë kishin gjithnjë parasysh që interesi kombëtar e shtetëror të vihej mbi atë klasor e partiak, çka na duket se nuk ishte karakteristikë edhe për të gjithë komunistët shqiptarë.

Duke u mbështetur në bashkëpunimin e ngushtë që ekzistonte në mes të dy partive komuniste dhe dy lëvizjeve, shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare iu përgjigjën ftesës së PKJ-së për luftë kundër okupatorit, aq më tepër kur këto ftesa bëheshin edhe nga ana e PKSH-së. Dihet se PKJ në këtë kohë (1941 - 1944) në të gjitha ftesat drejtuar popujve të Jugosllavisë (përfshirë bën vetëm ftesa për kryengritje të armatosur e KQ të PKJ më 4 korrik 1941 ku shqiptarëve fare nuk iu drejtohet), edhe shqiptarëve iu drejtohej si popull e jo si kombësi apo pakicë kombëtare. Në mbështetje të parimeve të vetëvendosjes së popujve, që u afirmua edhe me Deklaratën e njohur të Josip Brozit, të botuar në gazetën “Proleter” më 1942, komunistët shqiptarë dhe simpatizuesit e tyre iu besuan premtimeve dhe iu përgjigjën ftesës së PKJ-së për luftë të armatosur, ndonëse në rrethanat e reja gëzonin shumë më tepër të drejta kombëtare dhe ekonomike se sa në Jugosllavinë e vjetër.¹¹

Kësisoj në zhvillimin e Luftës Antifashiste edhe në Kosovë shqiptarët do të formonin njësitet e tyre të armatosura thjeshtë kombëtare si: Aradha Partizane Nacionalçlirimtare Shqiptare “Zejnel Hajdini”, aradha partizane “Emin Duraku”, Batalioni partizan “Bajram Curri” etj. Ndërsa, shqiptarët e Ulqinit e të Maqedonisë Perëndimore ngushtësisht bashkëpunonin me UNÇSH në një anë, dhe me UNÇJ në anën tjetër.

¹⁰ Fehmi Rexhepi, “Si u tradhtuan shqiptarët gjatë Luftës dhe pas Luftës së Dytë Botërore”, *Veprimi*, nr. 2, Preshevë, 1993, f.12.

¹¹ *Po aty*, f.13.

Ndërkohë, edhe në viset e Tetovës, Dibrës Strugës etj., të banuara kryesisht me shqiptarë, Lëvizja Antifashiste Çlirimtare me gjithë pengesat e vështirësitë me të cilat u ndesh, po vinte duke u rritur. Mbledhja e parë e KQ të PK të Maqedonisë, që u mbajt në mars të vitit 1943, territorin e saj e ndau në pesë zona operative. Viset e Dibrës, Tetovës, Kërçovës etj., që nga pranvera e vitit 1943, përbënin Zonën e Parë Operative të Maqedonisë. Ato në sajë të qëndrimit të shqiptarëve, ishin rajonet ku Lëvizja Antifashiste Çlirimtare mori zhvillim të madh në krahësim me të gjitha viset e tjera të Maqedonisë. Por, megjithatë, komunistët shqiptarë, ndonëse ishin të parët që i dhanë shkëndijën e Luftës Antifashiste Çlirimtare në këto territore, nuk kishin anëtarë të KQ të PK të Maqedonisë, në Komitetin e Partisë të Zonës së Parë Operative dhe, për më tepër, as edhe në sekretariatet e rajoneve Tetovë, Gostivar, Mavrovë dhe Kërçovë, Strugë e Dibër.¹²

Më vonë shprehje konkrete e rritjes së luftës së armatosur të popullsisë shqiptare në territorin e Maqedonisë padyshim ishin edhe luftimet në Dibër nga repartet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë e ato Maqedonase, ndihma e drejtpërdrejtë e popullsisë së Dibrës, Tetovës, Gostivarit etj., për çlirimin e këtyre qendrave, si dhe formimi në shtator të vitit 1944 i Brigadës së IV me bijtë e popullit shqiptar të këtyre viseve, që ishte nën komandën e Shtabit kryesor të UNÇJ të Maqedonisë. E gjithë kjo ridhte nga fakti se shqiptarët mendonin se do t'i realizonin synimet e veta të kamotshme për çlirimin e bashkimit kombëtar.

Më vonë në Kosovë do të krijoheshin edhe njësi të veçanta më të mëdha ushtarake, politike dhe organe të pushtetit popullor e ushtarak, që paraqisnin një strukturë të mëvetësisë shtetërore e politike, sikurse te popujt e tjerë të Jugosllavisë: Komiteti Krahinor i Kosovës, Shtabi Kryesor i Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Kosovës deri te organi më i lartë i pushtetit popullor, Këshilli

¹² Vlado Ivanovski, *Osloboditelna vojna vo zapadna Makedonija, 1941-1944*, Skopje, 1973, f. 129-130.

Krahinor Nacionalçlirimtar për Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit. Të gjitha këto organe e institucione në një farë mënyrë ishin për popullin shqiptar në ish-Jugosllavi edhe një provë e garanci se pas përfundimit të luftës do të realizohej e drejta e patjetërsueshme për vetëvendosje dhe bashkim kombëtar.

Tito dhe KQ i PKJ-së përmes të deleguarve të vet, në cilësinë e instruktorëve e veprimtarëve në Shqipëri e Kosovë, si S. Vukmanoviq - Tempo, M. Popoviq, D. Mugosha, V. Stojnić etj., kishin në mbikëqyrje tërë situatën në trojet shqiptare. Përmes tyre ata me mjeshtri ia dolën të minojnë zhvillimin e mëvetësishëm të Luftës Antifashiste në Shqipëri e Kosovë, duke shkaktuar përçarje në mes të rrymave të ndryshme politike shqiptare, si dhe duke minuar çdo aspiratë të bashkimit që në start dhe, kështu, duke nxjerrë gjithmonë në plan të parë çështjen klasore e përkatësinë partiake si formë më të përshtatshme për ekspansionizëm neosllav.¹³ Tito gjithashtu nuk la gur pa lëvizur vetëm për të bindur Drazha Mihajloviqin që të mos luftonte kundër UNÇJ-së, duke i ofruar edhe koncesione jo të vogla, ndërsa kur ishin në pyetje shqiptarët vepronte të kundërtën. Me urdhër të tij u mor vendimi i Kryesisë së KAÇKJ-së më 20. X. 1944 për amnistinë e çetnikëve ku thuhej: “U jepet amnisti e përgjithshme të gjithë personave që kanë marrë pjesë në njësitet e Drazha Mihajloviqit”,¹⁴ të cilët pastaj hynë në radhët e UNÇJ-së dhe së bashku me partizanët e Titos kryen gjenocid mbi popullin shqiptar në Kosovë dhe më gjerë.

Një përpjekje drejtë realizimit praktik të së drejtës për vetëvendosje të shqiptarëve të të gjitha viseve u bë në Mbledhjen e Mukjes më 1 - 2 gusht 1943. Aty u arrit marrëveshja në mes të përfaqësuesve të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar të

¹³ Fehmi Rexhepi, “Si u tradhtuan shqiptarët gjatë Luftës dhe pas Luftës së Dytë Botërore”, *Veprimi*, nr. 2, Preshevë, 1993, f.12.

¹⁴ Fehmi Rexhepi, “Gjenocidi serbomadhi mbi shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore”, *Fjala*, nr.27, qershor 1991, 11.

Shqipërisë dhe të Ballit Kombëtar, për krijimin e Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë, i cili përbëhej nga 6 përfaqësues të Ballit Kombëtar dhe 6 përfaqësues të Frontit Nacionalçlirimtar.¹⁵

Krijimi i një Fronti të përbashkët antifashistë gjithëkombëtar nuk i konvenoi udhëheqjes së PKJ-së, meqë synonte gllabërimin jo vetëm të Kosovës e të viseve të tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, por edhe të vetë Shqipërisë. Prandaj, Tito dhe KQ i PKJ-së menjëherë u angazhuan për shkatërrimin e kësaj bërthame të mirëfilltë të unitetit kombëtar. Kjo u realizua kryesisht përmes të deleguarve të PKJ-së, Svetozar Vukmanoviq Tempos, Miladin Popoviq-it, Dushan Mugoshës etj.¹⁶

Një gjë dihej e sigurt: formimi i një komitetit për shpëtim kombëtar me përfaqësues të Ballit Kombëtar, ua prishte planet Titos dhe PKJ-së, ngase përfaqësuesit e Ballit Kombëtar, jo vetëm që nuk do të bënin kurrfarë koncesioni në dëm të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, por do të pengonin edhe realizimin e këtyre planeve djallëzore.¹⁷

Pra, me insistimin e PKJ-së dhe të dërguarve të saj në Shqipëri, KQ i PKSH-së dhe Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtarë hodhën poshtë vendimet e Mukjes, çka e vërtetoi më vonë edhe Konferenca e Dytë Nacionalçlirimtare në Labinot (shtator 1943).¹⁸ Në një situatë të tillë forcat nacionaliste e demokratike shqiptare, kur panë se nuk ishte e mundur të krijohej një front i përbashkët me komunistët, për shkak të varësisë së madhe të tyre nga PKJ, u detyruan të bënin plane dhe përpjekje të reja, për të realizuar të drejtën e vetëvendosjes, sidomos të shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera në ish-Jugosllavi. Në kushte e rrethana të reja që u krijuan pas kapitullimit të Italisë, në

¹⁵ *Historia e popullit shqiptar*, vëll. II, Prishtinë 1969, f. 174; Ali Hadri, *Historia e popullit shqiptar*, Prishtinë 1971, f. 134-136.

¹⁶ F. Rexhepi, "Si u tradhtuan shqiptarët gjatë Luftës ...", f.13.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ *Historia e popullit shqiptar...*, vëll.II, f.715-716; A. Hadri, *Historia e popullit shqiptar...*, f.136.

Prizren, më 16 shtator 1943 u mbajt Kuvendi Themelues i Lidhjes së Dytë të Prizrenit, ku morën pjesë përfaqësuesit të Dibrës, Prizrenit, Prishtinës, Pejës, Mitrovicës dhe Sjenicës.¹⁹

Në bazë të statutit, Lidhja e II e Prizrenit “kishte për qëllim mbrojtjen e tokave të liruara si dhe të tokave të tjera në ish-Jugosllavi. Si mjet për këtë qëllim do të përpiqet të mbledhë dokumente për shqiptarësinë e viseve në fjalë dhe të organizojë popullin fizikisht e moralisht për mbrojtjen...”²⁰. Këtë qëndrim forcat e Lidhjes së II të Prizrenit e zbatuan edhe në praktikë, sidomos pas kapitullimit të Bullgarisë fashiste, kur vija e kufirit në periudhën shtator nëntor 1944 u shty përgjatë hekurudhës Shkup, Bujanoc. Këta kufij që përafërsisht ishin edhe kufij etnikë u mbrojtën nga forcat ushtarake të Lidhjes prej sulmeve të njësiteve partizano - çetnike, serbo - maqedonase dhe bullgare deri në gjysmën e nëntorit 1944, kur edhe u shua veprimtaria e saj. Lidhja e Dytë e Prizrenit nuk ishte organizatë tradhtare për krijimin e Shqipërisë së Madhe, siç e konsideron Sinan Hasani në librin e tij pamflet “Kosova të vërtetat dhe mashtrimet, Prishtinë 1986, por një organizatë që përpiquej për një Shqipëri etnike, pra as të madhe as të vogël, por normale.

Përmes organizatës Lidhja e Dytë e Prizrenit forcat nacionaliste e demokratike të kombit bënë një përpjekje konkrete për të realizuar për Kosovën dhe viset e tjera në ish-Jugosllavi, ruajtjen e bashkimit me shtetin amë, ani pse ai ishte realizuar në rrethana specifike të Luftës së Dytë Botërore si dhe të ruajtjes së integritetit të trojeve shqiptare. Në organet e Lidhjes bënë pjesë përfaqësuesit e të gjitha trojeve shqiptare në bazë të delegimit.²¹

Aktiviteti dhe veprimtaria e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, si duket ua kishte çrregulluar mjaft planet forcave komuniste dhe udhëheqësve të Luftës Nacionalçlirimtare në Kosovë e Shqipëri,

¹⁹ Tahir Zajmi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit*, Bruxelles, 1964, f.39.

²⁰ *Po aty*, f.45.

²¹ Shih statutin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, T. Zajmi, *Lidhja e II ...*, f.45-51.

që ishin nën tutelën e PKJ-së. Kështu, për të minimizuar sa më shumë autoritetin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, që kishte arritur sidomos te populli i Kosovës, Fadil Hoxha në fletushkën “Liria” në tetor 1944 botoi artikullin me titull “Qëllimet e kolonës së pestë dhe Kongresi i Prizrenit”, ku me një fjalor fyes sulmon udhëheqësit e kësaj organizate. Ai gjithashtu në këtë artikull paralajmëron se “popujt e Kosovës do të organizojnë një konferencë (ligë), ndoshta jo në Prizren, e cila do të ketë rendësi më të madhe se ajo e vitit 1878 (.....). Kjo do të jetë konferencë e vërtetë e popullit tonë e cila do të na sigurojë lirinë dhe pavarësinë e plotë”.²²

S’ka dyshim se ky ishte një paralajmërim për organizimin e Konferencës së Bujanit. Si duket mbajtja e saj jo vetëm u përshpejtua, por ishte edhe një kundërvënie ndaj Lidhjes së II të Prizrenit, që kishte për qëllim edhe minimizimin e rezultateve të saj.

Vendimi për mbajtjen e Konferencës Themeluese, gjegjësisht për formimin e Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar, u mor në Këshillimin e Komitetit Krahinor për Kosovë, të mbajtur në Sharr më 4, 5 e 6 nëntor 1943. Konferenca u mbajt në Bujan të Malësisë së Gjakovës më 31. XII. 1943 dhe 1 e 2 janar 1944.²³ Në Konferencë morën pjesë 49 delegatë që përfaqësonin të gjitha viset shqiptare në ish-Jugosllavi, prej të cilëve 43 ishin shqiptarë e 6 të tjerë. Kjo strukturë i përgjigjej plotësisht edhe strukturës së popullsisë së trojeve etnike shqiptare në këtë kohë.

Konferenca ishte kuvend i përfaqësuesve të rrymave dhe të gjithë popujve të Kosovës ku u vendos për të ardhmen e Kosovës në bazë të të drejtës për vetëvendosje. Ky vendim u mor në kohën dhe në momentin e duhur ngase tashmë shumica e komunistëve

²² Lirija - Slloboda, Organ i Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar të Kosovës, tetor 1944; Zbornik I, libri XIX. Dok. 55 f.296-300.

²³ Shih *Këshillat nacionalçlirimtare në Kosovë e Metohi 1943-1953*, Prishtinë, 1955 f. 7-212.

dhe të organizatorëve të LNÇ-së në Kosovë kishin filluar t'i hetojnë djallëzitë e PKJ-së ndaj shqiptarëve dhe trojeve të tyre.

Dokumenti më i rëndësishëm me të cilin shprehet qartë kërkesa e shqiptarëve për vetëvendosje e bashkim kombëtar, është Rezoluta ku konstatohet se: “Kosova e Rrafshi i Dukagjinit është një krahinë e banueme në pjesë më të madhe nga populli shqiptar, i cili si gjithmonë, ashtu edhe sot dëshiron me u bashkue me Shqipërinë. Prandaj e ndiejmë për detyrë me i tregue rrugën e drejtë që duhet me e ndjekë populli shqiptar për me i realizue aspiratat e veta. Rruga e vetme, pra, që populli shqiptar i Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit të bashkohet me Shqipërinë është lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër okupatorit dhe rrobtarëve të tij, sepse kjo është e vetmja rrugë për me fitue lirinë, kur të gjithë popujt, pra edhe shqiptarët do të kenë mundësi të deklarohen mbi fatin e vet, me të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje. Garancion për këtë janë UNÇJ, si dhe UNÇSH, me të cilën është ngushtë e lidhur. Pos kësaj për këtë garantojnë aleatët tanë të mëdhenj: Bashkimi Sovjetik, Britania e Madhe, dhe Amerika²⁴ (Karta e Atlantikut, Konferenca e Moskës dhe e Teheranit)”,²⁵ përfundon Rezoluta.

Përkundër këtyre garancive të forta të Rezolutës, si dhe fakti se në konference mori pjesë edhe përfaqësuesi i misionit ushtarak anglez pranë Shtabit Kryesor të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Kosovës e Dukagjinit, i cili pasi iu lut

²⁴ Këshilli popullor i KAKM, 1943-1953, Prishtinë 1955, f.10.

²⁵ Prej 19-20 tetor 1943 në Moskë u takuan ministrat e Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe, Bashkimit Sovjetik dhe SHBA-ve që në esencë ishte takim përgatitor për konferencën e tre të mëdhenjve në Teheran që u mbajt prej 28.XI. - 1.XII.1943, ku u shqyrtuan të gjitha çështjet ushtarake dhe politike botërore. Evropa ishte në qendër të vëmendjes. Aty u diskutua për zhvillimin e luftës, hapjen e Frontit të Dytë dhe ndarjen e botës në sfera të interesit. Pati mospajtime sidomos rreth hapjes së Frontit të II. Aleatët vendosën t'i shtojnë ndihmat UNÇJ-së në material ushtarak, ushqim, pajisje dhe në bartjen e të plagosurve në Itali. Kjo do të thotë pranim i UNÇ-së si ushtri aleate, sidomos nga SHBA (shih: *Vojna Enciklopedija*, 9, Beograd 1975, 668-669).

përfaqësuesve të popullit që të vazhdojnë luftën për liri e pavarësi të vendit, premtoi se për këtë “përpjekje fisnike do të keni përkrahjen tonë të plotë si aleat”.²⁶ Përkundër premtimeve dhe garancive ndërkombëtare, siç dihet, Rezoluta dhe vendimet e Bujanit u kontestuan menjëherë nga ana e KQ të LKJ-së, të cilët në strategjinë e vet qysh me kohë kishin vijëzuar jo vetëm ruajtjen e kufijve të Jugosllavisë së vjetër, por edhe zgjerimin e tyre²⁷.

Kështu, në letrën e 28 marsit të vitit 1944, KQ i PKJ-së ia tërhoqi vërejtjen Komitetit Krahinor të Kosovës se “nuk është dashtë të krijoni Komitet Krahinor, nga se territori juaj nuk asht një qark kompakt. Nga Rezoluta nuk asht i qartë karakteri i Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar. Ky Këshill mund të jetë vetëm iniciativ, vetëm organ i unitetit politik të masave, por nuk guxojmë t’i japim atij karakter pushteti, edhe pse ai duhet të udhëheqë këshillat aty ku ekzistojnë”.²⁸ Në vazhdim të letrës jepen sugjerime se si t’i qasen kosovarët çështjes nacionale, duke e popullarizuar KAÇKJ-në dhe vendimet e tij, të cilat: “u sigurojnë barazi të gjithë popujve dhe u mundësojnë të drejtën për vetëvendosje”.²⁹ Më tutje në letër insistohet që të mos “flitet për bashkimin me Shqipërinë dhe për caktimin e kufijve në mes të Shqipërisë e Jugosllavisë - të dyja të okupuara”.³⁰ Me këtë letër, siç shihet, KQ i PKJ-së haptas u mohonte të drejtën e vetëvendosjes shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera në ish-Jugosllavi, duke u mundur t’i lidhë me vendimet e Mbledhjes së

²⁶ Arkivi i Institutit të Historisë së Kosovës (më tej: AIHK), d.1316; A. Hadri, *Këshillat Nacionalçlirimtare në Kosovë...*, f. 84.

²⁷ Këtë qëllim ajo e realizoi në praktikë duke i zgjeruar kufijtë e vet në bregdetin Adriatik për 8262 km². Krah. *Vojna Enciklopedija...*, 4, f.79.

²⁸ ZBORNIK, 1. XIX, Beograd, 1969, d.104, f.462-463, letra e dërguar dhe e nënshkruar nga Milovan Gjlasi në emër të KQ të PKJ-së.

³ *Po aty*, f.463.

³⁰ *Po aty*, f.464

II të KAÇKJ-së, edhe pse ata nuk kishin marrë pjesë dhe as që u përmendën në këtë mbledhje³¹.

Kundërvënie e drejtpërdrejtë ndaj vendimeve dhe Rezolutës së Bujanit, në këtë frymë, është edhe artikulli i Pavle Joviqeviçit “Kosova dhe Metohia dhe vendimet e Mbledhjes së II të KAÇKJ-së”, që u botua në fletushkën “Lirija” në nëntor të vitit 1944³². Në këtë artikull programatik në frymën dhe vijën politike të PKJ-së, Pavle Joviqeviçi përpigëj me çdo kusht që çështjen e shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera ta lidhë sa më fortë me vendimet e Mbledhjes së Dytë të KAÇKJ-së, në mënyrë që më vonë të realizoheshin më lehtë qëllimet ekspansioniste ndaj viseve shqiptare. Ai nuk ngurroi të shkojë aq larg sa edhe të konstatonte se me vendimet e mbledhjes së II të KAÇKJ-së “shqiptarëve të Kosovës u garantohen të drejtat e pakicave kombëtare”³³. Është me interes të theksohet fakti se për herë të parë gjatë Luftës së Dytë Botërore shqiptarët e Kosovës nominohen si pakicë kombëtare. S’ka dyshim se ky është një degradim i çështjes kombëtare shqiptare. Të drejtën për vetëvendosje shqiptarët, sipas Pavlit, do ta siguronin “vetëm me luftën e vet kundër okupatorit”. Gjithashtu ai konstaton se “të gjithë çështjet kontestuese vetë popujt përmes përfaqësuesve të vetë të vërtetë mund dhe do t’i zgjidhin me marrëveshje”³⁴.

Pavle Joviqeviçi harronte se vetë kishte marrë pjesë në Konferencën e Bujanit, ku përfaqësuesit e popujve të Kosovës kishin vendosur për të gjitha këto çështje. Si rezultat i atyre vendimeve të drejta të Bujanit, LANÇ në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare kishte marrë hov dhe tani, në nëntor të vitit 1944, si

³¹ Mbledhja e II e KAÇKJ u mbajt në Jajcë të Bosnes më 29-30 nëntor 1943 që d.m.th. një muaj para Konferencës së Bujanit. Shih Branko Petranovic – Č – Štrbac, Istorija socialisticke Jugoslavije, Dokumenti, Beograd, 1977, f.20.

³² Zbornik I, libri 19, dok. 205, f.714-724.

³³ Po aty, f.723

³⁴ Po aty, f.724.

Shqipëria ashtu edhe Kosova, me forca të veta, u çliruan ndër të parat nga pushtuesit fashistë.

Pas çlirimit të Kosovës nga fashizmi forcat shoviniste partizano - çetnike, që kishin depërtuar në të gjitha porët e organeve të PKJ-së dhe që nuk mund të pajtoheshin me gjendjen e krijuar, sidomos kur duhej të realizoheshin në praktikë vendimet e Bujanit, filluan të depërtonin në trojet shqiptare duke inskenuar edhe konflikte të armatosura për të pasur alibi për të bërë masakra, terror, dhunë, deri në gjenocid, mbi popullin shqiptar³⁵. Në këto kushte populli i Kosovës edhe një herë, që nga tetori i vitit 1944 e deri në pranverë 1945, u masakrua pamëshirshëm, këtë herë nga njësitë partizane të UNÇJ-së, në kuadrin e të cilave nuk ishte i vogël numri i çetnikëve, të cilët, në vend të kurorës mbretërore, kishin vënë në ballë pesëcepëshin e kuq, komandantët e të cilëve urdhëronin ushtarakët e vet në teren që “t’i përçajnë sa më shumë shqiptarët”³⁶. Apo ata që deklaroinin me mburrje se “kemi urdhër me i vra 50% të shqiptarëve”³⁷.

Në një situatë të tillë që ishte e padurueshme, populli shqiptar u detyrua të bëjë rezistencë spontane, e cila u përhap gati në të gjitha viset e banuara me shqiptarë në ish-Jugosllavi, rezidencë e cila në disa vise mori përmasa të kryengritjes popullore. Në këto rrethana komandanti I SHKAP të UNÇJ-së Josip Brozi, për t’i realizuar plotësisht qëllimet pushtuese ndaj viseve etnike shqiptare edhe për të penguar bashkimin e Kosovës me Shqipërinë më 8 shkurt 1945, vendosi administrimin ushtarak në Kosovë dhe kështu krijoi të gjitha parakushtet për aneksimin e saj.

³⁵ Fehmi Rexhepi, *Teror i žrtve naroda Kosova 1941-1945, Kosova zrtva*, Zagreb, 1991, f.44-45.

³⁶ Arkivi i Maqedonisë, Shkup, Dokumenti 3313.

³⁷ Arkivi i Institutit të Historisë, Prishtinë me tej aihp, d. 335, nr.1305, letër e Melihate Dedës dërguar Komitetit Krahinor, dhjetor 1944.

Pra, në fund të Luftës së Dytë Botërore, edhe njëherë shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera në ish-Jugosllavi, jo vetëm që nuk u bashkuan me Shqipërinë, sipas vendimeve të Lidhjes së II të Prizrenit dhe të Konferencës së Bujanit, por u copëtuan dhe u ndanë në katër njësi të Federatës Jugosllave (Kosovë, Serbi, Mali i Zi dhe Maqedoni). Për të ligjësuar pushtimin e trojeve shqiptare para opinionit botëror, udhëheqja më e lartë e PKJ-së në bashkëpunimin me udhëheqjen partiake e ushtarake të Kosovës (në të cilën kishte bërë ndryshime të mëdha kuadrosh dhe tani ishte kryesisht në duart e kuadrove serbo - malaziase), organizoi Konferencën e njohur të Prizrenit në korrik të vitit 1945, ku me forcën e armëve u mor vendimi mbi aneksimin e Kosovës nga ana e Serbisë.

Mund të përfundojmë se të gjitha forcat e organizuara politike shqiptare kishin një qëllim: çlirimin dhe bashkimin kombëtar. Të gjitha palët kishin garanci nga aleatët e vet, mirëpo me të përfunduar lufta këto garanci do të shkeleshin nga vetë ata që i kishin dhënë, vetëm e vetëm për t'i kënaqur apetitet serbomëdha ndaj trojeve shqiptare.

Kështu populli ynë i ndarë u detyrua të vazhdojë luftën për të realizuar të drejtën e tij të natyrshme për vetëvendosje dhe bashkim kombëtar.

Ma. Etleva BABAMETO
(Tiranë)

REZISTENCA SHQIPTARE GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE NË KËNDVËSHTRIMIN E BRITANIKËVE

Këndvështrimi britanik për rezistencën në Shqipëri ndryshon jo pak nga ai i historiografisë së para viteve '90 dhe, disi, edhe nga i sotmi. Britanikët kanë theksuar mbështetjen e shtetit të tyre për rezistencën shqiptare dhe veçanërisht për Lëvizjen Nacionalçlirimtare, aq sa kanë shtruar pyetjen: se a do të kishte fituar ajo pa ndihmën britanike dhe të aleatëve në përgjithësi? Gjykime të ndryshme kanë studiuesit britanikë deri diku, edhe për forcat e rezistencës dhe luftën civile në Shqipëri. Sidoqoftë, ka një pikë ku ata bashkohen me historiografinë shqiptare, kur pranojnë se Lëvizja Nacionalçlirimtare ishte forca kryesore e rezistencës në Shqipëri.

Kumtesa është mbështetur kryesisht në burime dokumentare britanike, të botuara dhe të pabotuara. Rëndësi të veçantë paraqesin të dhënat për ndihmën totale në materiale luftarake, të holla e veshmbathje të dhënë nga Britania e Madhe në favor të forcave të rezistencës në vend, gjykimet për forcat politike e ushtarake në vend, etj.

Rezistenca shqiptare dhe Britania e Madhe deri në 1943

Politika e Britanisë së Madhe në prag të LDB, si qendër e lojës diplomatike në shkallë botërore, karakterizohej në pjesën më të madhe nga improvizime të minutës së fundit dhe diktohej nga faktorë të jashtëm negativë të tillë si: frika e zemërimit të Musolinit, më pas e provokimit të parakohshëm të Hitlerit, si dhe frika e zemërimit të Stalinit.¹

Britania e Madhe e pranoi në heshtje pushtimin italian të Shqipërisë, sikurse shumica e vendeve të tjera evropiane. Më 6 prill 1939, një ditë para pushtimit të Shqipërisë, kryeministri britanik Chamberlain do të deklaronte në Dhomën e Komuneve se “Qeveria e Madhërisë së Tij nuk ka interesa direkte në Shqipëri, por interesin e përgjithshëm të paqes në të gjithë botën”.² Duket se, pushtimi italian i Shqipërisë për britanikët, nuk përbënte një arsye të fortë në atë periudhë për të prishur marrëdhëniet e mira me Italinë.

Megjithatë, populli shqiptar nuk iu nënshtrua lehtë pushtimit italian. Gradualisht rezistenca e armatosur erdhi gjithnjë në rritje, ndërkohë që pushtuesit italianë u munduan ta shtypin duke përdorur terrorin, ekspeditat ndëshkuese dhe bombardimet ajrore³.

¹ Elisabeth Barker, *British Policy in South-East Europe in the Second World War*, The Macmillan Press LTD, 1976, f. 5.

² Bisser Petrov, *Great Britain and the Resistance in Albania, April 1939-1941*, (Ettudes Balkaniques, no.1. Bulgaria: 2004), f. 54. Megjithatë, Chamberlain iu drejtua Mussolinit që t’i përmbahej politikës së paqes dhe ruajtjes së *status-kuosë* në Mesdhe, sipas marrëveshjes së arritur ndërmjet Italisë dhe Britanisë së Madhe në vitin 1938.

³ *The National Archives*, (më tej: TNA), HS 7 70, 1942-1945, Misioni Aleat, *Historia e Rezistencës Shqiptare*, f. 82.

Më 10 qershor 1940 Italia u deklaroi luftë Francës dhe Anglisë.⁴ Në këtë fazë Britania e Madhe mund ta quante veten të lirë nga kjo deklaratë⁵ dhe të ndryshonte pozicionin e saj.

Në fakt, që në pranverën e vitit 1940 kur po bëhej e qartë se Italia do të hynte në luftë, interesimi për Shqipërinë u shfaq nga Ministria e Luftës. Degët e organizatave të saj që vepronin në këtë kohë në territoret e Jugosllavisë dhe të Greqisë, i kthyen sytë edhe nga Shqipëria⁶.

Konkretisht, MI (R) dhe Seksioni “D”, (departamenti i vogël i shërbimit inteligjent), i cili më vonë u shndërrua në SOE (Drejtoria e Operacioneve të Posaçme) u ngarkuan të studionin gjendjen në Shqipëri, kushtet e përgjithshme për rezistencë në këtë vend, grupazhet e ndryshme, të njihnin udhëheqësit më të rëndësishëm si dhe të përgatitnin planet operative të ardhshme⁷.

Por edhe Foreign Office, e shqetësuar nga kërcënimi i Italisë kundër Greqisë, nisi të interesohej në gusht 1940 për mundësinë që t’u shkaktonte turbullira italianëve në Shqipëri⁸.

Për më tepër, sulmi italian kundër Greqisë nga territori shqiptar në vjeshtë bëri që politikëbërësit dhe ushtarakët britanikë të shtonin vëmendjen për të nxitur rezistencën guerile në Shqipëri. Në këtë situatë, Zogu propozoi nga Londra që të organizonte një forcë me 14.000 shqiptarë në Stamboll, që do të zbarkonte në Selanik me pëlqimin e Qeverisë greke dhe kështu të

⁴ Beqir Meta, *Tensioni Greko-Shqiptar*, Globus R, Tiranë: 2007, f. 39.

⁵ Arben Puto, *Nëpër Analet e Diplomacisë Angleze*, Albin, Tiranë: 2001, f. 30; Në tetor 1939 Britania e Madhe e kishte njohur pushtimin e Shqipërisë nga Italia.

⁶ Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Toena, Tiranë 2009, f. 678.

⁷ Reginald Hibbert, *Fitorja e Hidhur*, Pinter Publisher, London and New York, 1991, f.74

⁸ R. Hibbert, *Fitorja e hidhur...*, f. 76.

krijonte një front lufte⁹. Por, ky propozim nuk u pranua nga kryeministri grek, Metaxas, duke menduar se nëse përkrahnin Zogun “kjo do të angazhonte për rimëkëmbjen e pavarësisë së Shqipërisë pas lufte”¹⁰. Kështu u ngrit varianti tjetër për një kryengritje në Veri të Shqipërisë me territorin Jugosllav si pikënisje¹¹. Sipas këtij plani, oficerët britanikë kontaktuan me 4 shqiptarë: Ganiun, Hasanin dhe Said Kryeziun, si dhe major Abaz Kupin me shpresë që këta të kalonin nga Kosova në Veri të Shqipërisë dhe të ngrinin në këmbë fiset vendase¹². Ganiu, si figura kryesore në organizimin e rezistencës, do të pushtonte Kukësin dhe do të krijonte një ushtri shqiptare. Këtu ai do të shpallte krijimin e “qeverisë kombëtare shqiptare” të kryesuar prej tij¹³.

Por, oficerët britanikë hasën në disa vështirësi në realizimin e këtij plani. Problemi kryesor ishte furnizimi me material ushtarak¹⁴. Gjithashtu, sipas Oakley-Hill-it, prania e trupave të rregullta të Ushtrisë jugosllave, që kishin hyrë në të njëjtën zonë, krijoi një situatë armiqësore të shqiptarëve ndaj jugosllavëve, me të cilën u ndeshën oficerët ndërlihdës britanikë në veriperëndim të maleve veriore. Kjo ua hoqi atyre shanset për të pasur sukses në planin e parashikuar atje¹⁵.

Për më tepër, fitorja rrufe e Vermahtit hitlerian ndaj Jugosllavisë dhe Greqisë, në prill të vitit 1941, bëri që të dështonte

⁹ E. Barker, *British Policy ...*, f. 50.

¹⁰ A. Puto, *Nëpër analet...*, f. 37.

¹¹ *Po aty*.

¹² Dayrell Oakley-HILL, *Një Anglez në Shqipëri*, Botimet Koçi, Tiranë 2006, f.8 - 9.

¹³ A. Puto, *Nëpër Analet...*, f.37.

¹⁴ Dayrell Oakley-HILL, *Një Anglez...*, f. 133-134; Në atë periudhë SOE nuk ishte në një pozitë të tillë sa të tërhiqte material ushtarak.

¹⁵ *Po aty*, f. 139; Madje Veriu i largët mendonte se oficerët britanikë ishin vegla të jugosllavëve dhe ky qe një grusht fatal për oficerët britanikë lidhur me organizimin e kryengritjes në këtë zonë.

plani për një kryengritje në Shqipërinë e Veriut¹⁶. Bërthamat e seksioneve të SOE për Shqipërinë, që vepronin në Beograd e Athinë, u shpërndanë¹⁷.

Megjithatë mund të thuhet se kryengritja në Shqipëri dështoi kryesisht për faktin se Britania e Madhe ishte e ndjeshme ndaj pretendimeve greke kundër Shqipërisë¹⁸. Këtë konkluzion e konfirmoi Eden (Sekretar i Shtetit për çështjet e jashtme) më 23 janar 1941, kur deklaroi se, ndërsa Qeveria e Madhërisë së Tij ishte në favor të pavarësisë së Shqipërisë, për momentin politika e kësaj qeverie duhej të përputhej me dëshirat e grekëve¹⁹.

Megjithatë ajo që vërehej në Shqipëri gjatë pushtimit italian ishte rritja e veprimtarisë së grupeve guerile në mbarë Shqipërinë, e në mënyrë të veçantë në jugun e saj²⁰.

Rezistenca shqiptare dhe politika britanike: 1943-1944

Në vitin 1943, SOE u përgatit për veprimtari të zgjeruar në Ballkan meqenëse vatra e luftës në Mesdhe u zhvendos nga Afrika e Veriut në Evropën e Jugut²¹. Në këtë periudhë drejtuesit

¹⁶ Hubert Neuwirth, *Qëndresë dhe bashkëpunim në Shqipëri: 1939-1944*, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë, f. 37.

¹⁷ R. Hibbert, *Fitorja e hidhur...*, f. 79; Për rrjedhojë veprimtaria e SOE lidhur me Shqipërinë ra mjaft poshtë për të rifilluar në pranverën e vitit 1943.

¹⁸ *Arkivi Qendror Shtetëror* (më tej: *AQSH*), Fondi 1510/1, viti 1943, dosja 97, f.1, Harry Hodgkinson collection: Shqipëria e Jugut – Pretendimet Greke.

¹⁹ E. Barker, *British Policy*, f.51.

²⁰ TNA, HS 7 70, 1942-1945, *Historia ...*, f. 82-83; sipas këtij dokumenti në vjeshtë të vitit 1942 në gjithë Shqipërinë numëroheshin 10-12 grupe guerile ku më të rëndësishmet ishin ato të kryesuara nga M.Peza, Baba Faja, etj. Po kështu aktiviteti gueril u shtua gjithnjë e më shumë në Korçë, Skrapar, Kurvelesh ku nga mesi i muajit janar 1943 fuqia totale guerile është vlerësuar 3.000-4.000 vetë me armë dhe pajisje të marra nga burime italiane, jugosllave dhe gjermane.

²¹ R. Hibbert, *Fitorja e hidhur...*, f. 80-81; Si rrjedhim i vendimeve strategjike ndërmjet Anglisë e SHBA zbarkimi i Aleatëve në Afrikën e Veriut më 1942 kishte hapur rrugën për operacione që do ta flaknin Italinë jashtë lufte. Gjithashtu gjatë

ushtarakë britanikë filluan të mendonin seriozisht për ngritjen e lëvizjeve të rezistencës në Evropën Juglindore²². Në këtë kuadër, gjatë këtij viti u rrit më tej interesimi dhe angazhimi i Britanisë së Madhe edhe në Shqipëri²³.

Për këtë qëllim, në pranverën e vitit 1943 zbarkuan një numër oficerësh anglezë të SOE për të rritur më tej efikasitetin e rezistencës shqiptare, për të bashkërenduar dhe nxitur kundërshtimin ndaj italianëve dhe, pas kapitullimit të tyre, ndaj pushtimit gjerman. Objektivi i tyre ishte grumbullimi i informacioneve të fshehta, kryerja e veprimeve sabotuese kundër fuqive të Boshtit etj,²⁴. Oficerët e SOE-së ishin udhëzuar të ndihmonin çdo grup që luftonte forcat e Boshtit, pavarësisht nga besnikëria politike²⁵.

Furnizimet e para britanike për rezistencën shqiptare filluan më 17 prill 1943 dhe përfunduan në korrik 1944 përmes avionëve Halifax të Forcave Ajrore Mbretërore²⁶.

gjysmës së dytë të këtij viti u bë e qartë se operacionet e posaçme do të ishin e vetmja formë që Aleatët do t'ia kushtonin Ballkanit.

²² E. Barker, *British Policy ...*, f. 111-114. Në të vërtetë që nga fundi i vitit 1941 Eden dhe Forin Ofis e konsideruan rikthimin ushtarak në Evropën Juglindore, ndoshta si mjetin e vetëm për të ndaluar ekspansionin e rusëve pas lufës në këtë rajon.

²³ *Historia e Popullit Shqiptar, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj*, Vëllimi IV, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Toena, Tiranë 2008, f. 106; Deklaratat e tri Fuqive Aleate të Dhjetorit 1942 janë dëshmi se që nga viti 1942 Shqipëria ishte njohur si pjesëtare e Koalicionit Antifashist.

²⁴ Stephane Schwandner-Sievers and Bernd J. Fischer, *Albanian Identities, Myth and History* (C. Hurst & Company, London, 2002), Roderick Bailey, *Smoke without fire? Albania, SOE and the Communist Conspiracy Theory*, f. 143-144.

²⁵ Po aty.

²⁶ TNA, HS 7 70, 1942-1945, f. 147-148; Rrjedhimisht në SEAVIEW vinin vetëm furnizime për Misionin, ushqime dhe një sasi e vogël armësh për mbrojtje lokale. Në bregdetin e Borshit, që u konsiderua pikë më e përshtatshme, më 22 maj u hodhën 30 ton furnizime për LANÇ dhe 36 ton më 24 Maj. Në qershor për LANÇ u dërguan 70 ton furnizime dhe në gusht dy dërgesa me nga 70 ton secila. Gjithashtu në Shtator, Spile që ishte zënë nga partizanët shërbeu si vend i sigurt ku

Në periudhën midis pranverës së vitit 1943 dhe fundit të vitit 1944 në Shqipëri u dërguan rreth 50 oficerë anglezë. Gjithashtu për organizimin dhe nxitjen e rezistencës aktive në Shqipëri (prill 1943-janar 1945) u dërguan sasi të mëdha të hollash prej 77.600 sovrina*, 6.050 napolona ari dhe 36.000 napolona florinj²⁷.

Ndërkohë në fillim të gushtit 1943, pranë drejtuesve të lartë partizanë dhe njërive të veçanta ishin vendosur 4 misione britanike, të cilat organizuan dhe trajnuan edhe Brigadën I partizane²⁸. Gjithashtu, dokumentet britanike vënë në dukje sulmet e kryera nga Abaz Kupi që vepronte në Shqipërinë Qendrore. Kështu më 20 gusht 1943, 400 italianë u sulmuan në veri të Elbasanit dhe pësuan shumë humbje²⁹.

Në shtator 1943, pas armëpushimit të Italisë me aleatët, kolonat gjermane filluan të pushtojnë Shqipërinë, duke kryer veprime arbitrare. Ato pushtuan pikat e forta dhe çarmatosën oficerë dhe ushtarë italianë në të gjithë Shqipërinë. BLO-të (Oficerët Ndërlidhës Britanik) bënë përpjekje për të koordinuar veprimet me partizanët dhe me divizionin e Gjeneral Dalmacos kundër gjermanëve në Tiranë dhe Durrës, por plani dështoi kryesisht për shkak të pavendosmërisë dhe mungesës së organizimit të forcave partizane³⁰. Duhet thënë se në këtë periudhë në Foreign Office mendonin akoma për zbarkimin e Britanisë së

u hodhën 200 ton furnizime në tre dërgesa. Që prej nëntorit 1944 porti i Sarandës ishte çliruar dhe shërbeu si pikë për dërgesat ku gjatë këtij muaji zbarkuan dy dërgesa me 146 ton ushqime dhe veshje. Më vonë në Vlorë, marrja e dërgesave organizohej nga BLO-të ku gjatë nëntorit 1944 zbarkuan dy dërgesa me 172 ton.

* Monedha e mëparshme britanike me vlerë një paund.

²⁷ TNA, HS 7 70, 1942-1945, f. 162.

²⁸ TNA, HS 7 70, 1942-1945, f. 85-86.

²⁹ Po aty.

³⁰ TNA, HS 7 70, 1942-1945, f. 68-70.

Madhe në vendet e Evropës Juglindore³¹. Edhe pasi ky plan ishte pezulluar, BLO-të në Shqipëri ishin udhëzuar që në kuadrin e strategjisë së rreme (*deception strategy*) për Evropën Juglindore, të përhapnin idenë se Ballkani do të pushtohej nga aleatët³². Dokumente britanike të pabotuara citojnë, se pushtimi i Shqipërisë nga Gjermania solli në mënyrë të pashmangshme dallimin ndërmjet dy palëve kryesore të rezistencës: Frontit Nacionalçlirimtar dhe Ballit Kombëtar³³. Në qëndrimet ndarëse ndërmjet tyre ka pasur ndikim edhe propaganda gjermane gjithnjë në rritje, në mbështetje të çështjes së Kosovës.

Pas denoncimit të marrëveshjes së Mukjes në gusht 1943 dhe pushtimit gjerman në shtator 1943, përplasjet ndërmjet tre grupimeve, tashmë të krijuara: komuniste, zogiste dhe jozogiste çuan deri në luftë civile ndërmjet tyre.

Megjithatë, duke synuar bashkimin e të gjithave kahjeve politike kundër forcave të Boshtit, oficerët e SOE-së kërkuan bashkimin dhe angazhimin në luftë kundër gjermanëve të të gjitha grupimeve, pasi ata nuk e dëshironin vëllavrasjen³⁴.

³¹ E. Barker, *British Policy ...*, f. 122-23.

³² Po aty; Elisabeth Barker ka vënë në dukje se strategjia e rreme e aleatëve në Ballkan përfshinte jo vetëm përqendrimin e sa më shumë forcave armike në Shqipëri, por edhe një sulm imagjinar (*notional assault*) në bregdetin shqiptar. Duke patur parasysh kompleksitetin e kësaj strategjie, Barker mendon se pikërisht kjo strategji çorientoi vetë oficerët britanikë, të cilët e kishin të vështirë të zbulonin se çfarë ishte reale dhe çfarë ishte pjesë e planit të mbulimit (*cover plan*), duke shkaktuar kështu konfuzion dhe paqartësi në veprimet dhe qëndrimet e tyre ndaj forcave të ndryshme të rezistencës shqiptare.

³³ TNA, HS 7 70, 1942-1945, f. 86-87; Ballin Kombëtar u krijua në nëntor 1942, i përbërë kryesisht nga bajraktarë, çifligarë, pronarë, të bashkuar nga ndjenja nacionaliste dhe antikomuniste.

³⁴ AQSH, Fondi 421, Letër e Enver Hoxhës më datë 2.11.1943, viti 1943, dosja 15/1, f. 100 -109; Madje në një takim të Majorit Riddell me forcat partizane kur këto të fundit i konsideronin ballistët dhe legalistët tradhtarë, është shprehur se 'mund t'i bëjmë për vete dhe t'i kthejmë kundër Gjermanëve, prandaj duhet të palëtoheni e të bashkoheni me ta'.

Megjithatë, britanikët dhanë ndihmesën më të madhe për forcat partizane e veçanërisht nëpërmjet R.A.F në qershor 1944, periudhë gjatë së cilës dukej se forcat partizane po e mbizotëronin rezistencën dhe ishin gati të merrnin pushtetin kur të tërhiqeshin nazistët³⁵. Kjo mbështetje vazhdoi edhe gjatë muajve tetor - nëntor 1944, duke shkatërruar planet gjermane të evakuimit. Sipas dokumenteve britanike, gjatë kësaj kohe vazhduan furnizimet ajrore. U hodhën afërsisht 2^{1/2} ton furnizime, armë, veshje dhe ushqime dhe një sasi e madhe të hollash³⁶.

Në dokumentacionin britanik nënvizohet se duke filluar nga muaji gusht 1944 aktiviteti ushtarak gjerman në Shqipëri ra ndjeshëm, ndërsa në shtator 1944 rezistenca partizane po arrinte gradualisht majat e saj³⁷. Sipas të dhënave të disa oficerëve britanikë, operacionet kundër armikut u zhvilluan vetëm nga partizanët dhe oficerët e Ndërlidhjes Aleate³⁸, të cilët për periudhën korrik 1943 - nëntor 1944 u shkaktuan gjermanëve 6.000 -7.000 të vrarë dhe 500 të plagosur³⁹. Rrjedhimisht në shtator 1944 në Foreign Office u vendos që mbështetja duhej të kalonte tërësisht për LNÇL, si e vetmja forcë që luftonte kundër gjermanëve.

Ndërkaq, sipas dokumentacionit britanik, vlerat e Ballit Kombëtar dhe Legalitetit në rezistencën shqiptare po zbeheshin gjithnjë e më shumë. Sipas disa oficerëve britanikë “Lëvizja e Legalitetit” ishte e papjekur dhe nuk gëzonte popullaritet, ndërsa

³⁵ TNA, HS 7 70, 1942-1945, f. 132-134.

³⁶ TNA, HS 7 70, 1942-1945, f. 132-134; Sipas të njëjtit burim, si rezultat i ndihmës së Aleatëve ka të ngjarë që arritjet më të suksesshme të forcave partizane u bënë në Qershor 1944 kur forcat Gjermane u detyruan të sillnin në Shqipëri Divizionin më të mirë në SEE, Divizionin I Malor, për të eliminuar kërcënimin në rritje.

³⁷ TNA, Military Liaison—Albania, CAB 106459, f. 324.

³⁸ TNA, HS 7 70, 1942-1945, f. 135.

³⁹ Po aty, f. 107.

për Ballin Kombëtar theksohej se vepronte si milici e qeverisë kukull⁴⁰. Megjithatë, disa oficerë të tjerë britanikë, përkrahës të kampit nacionalist, e shpjeguan humbjen e forcave nacionaliste shqiptare për shkak të “tradhtisë” së Britanisë së Madhe, të cilat me qëndrimin dhe mbështetjen materiale të dhënë në këtë vend i shërbyen fitores së komunizmit⁴¹.

Megjithëse gjatë muajit shtator 1944 ballistët dhe zogistët ndërmorën një seri lëvizjesh kundër gjermanëve, veçanërisht disa prita në rrugën Shkodër - Tiranë më 26 shtator, Foreign Office ishte e detyruar të pranonte të vërtetën e hidhur se këto veprime ishin të pakta dhe të vonuara dhe se pas luftës Shqipëria do të binte nën regjimin e Hoxhës⁴².

Si për t'i dhënë fund çështjes së Ballkanit, Çurçilli dhe Stalini nënshkruan në tetor 1944 marrëveshjen e njohur të “përqindjes”, e cila në të vërtetë, dëshmoi njohjen dhe pranimin nga ana e britanikëve të dominimit sovjetik në Evropën Qendrore dhe Lindore⁴³.

Në mbarim të luftës britanikët u ndodhën në dilemë për të ardhmen e Shqipërisë dhe vendosën të ndiqnin taktikën e modifikimit nga brenda të Frontit Nacionalçlirimtar dhe qeverisë së dalë prej tij.

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ Bisser Petrov, *Great Britain...*, f. 115-117.

⁴² Po aty.

⁴³ Beretzky Agnes, *British Confederation Plans concerning Central and Eastern Europe, 1939-1945*.

Prof. dr. Hamit KABA
(Tiranë)

STUDIME BRITANIKE PËR KUFIJTË SHQIPTARO - JUGOSLLAV GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Gjatë Luftës së Dytë Botërore (LDB) janë përgatitur një numër studimesh për kufijtë veriorë të shtetit shqiptar të pasluftës, të cilat gjenden në arkivat britanike e amerikane. Studimet u përgatitën kryesisht nga institucionet e specializuara për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe kufijtë, në shërbim të Foreign Office apo të Departamenti i Shtetit (Department of State). Shumica e studimeve që njohim u hartuan nga Instituti Mbretëror i Marrëdhënieve Ndërkombëtare pranë Oxfordit në Londër. Studimet e ndërmarra synonin t'u paraprinin vendimeve të pritshme të Fuqive të Mëdha aleate, për riorganizimin e Ballkanit e, më gjerë, të Evropës e të botës. Një vështrim i thjeshtë krahasues i dokumentacionit britanik dhe amerikan për problemin e kufijve të Shqipërisë me Jugosllavinë, të çon në përfundimin se alternativat e ofruara nga SHBA ishin më realiste e të pranueshme se ato britanike, por asnjëherë të mjaftueshme për të përmbushur aspiratat e shqiptarëve.

Studimet e para britanike për të ardhmen e Shqipërisë dhe kufijtë e saj i ndeshim që në fillim të vitit 1941, para shpalljes së Kartës së Atlantikut, deklaratës së Kombeve të Bashkuara (janar 1942) dhe deklaratave të dhjetorit 1942 të aleatëve të mëdhenj,

për ringritjen e shtetit shqiptar pas mbarimit të luftës. Studimet, për arsye të njohura shtohen veçanërisht në vitet 1943 - 1944. Dokumentacioni britanik i viteve 1941 - 1942 priret nga ideja e rinjohjes së kufijve të shtetit jugosllav të periudhës së parapushtimit dhe copëtimit të Jugosllavisë, si dhe cedimit të mëtejshëm të kufijve të shtetit shqiptar. Në studimet e mëvonshme shtohen dozat e realizmit, por në asnjë rast nuk parashikohet ndonjë alternativë që do të çonte në bashkimin e plotë të territoreve shqiptare. Një tjetër karakteristikë që më duhet të përmend, ka të bëjë me faktin se në dokumentet britanike ishte skicuar ideja e ringritjes së shtetit të pavarur shqiptar, përpara daljes së Kartës së Atlantikut dhe deklaratës së bërë nga Ideni në Dhomën e Komuneve, më 17 dhjetorit 1942.

Në studimet britanike mbizotëron ideja se shteti shqiptar do ta kishte të vështirë të qëndronte në këmbë i vetëm, pa ndihmën e të tjerëve, për shkak të orekseve nacionaliste të fqinjëve grekë e jugosllavë, vështirësive ekonomike e financiare, aftësive jo të arrira qeverisëse të shqiptarëve etj. Për të ruajtur interesat britanike në Ballkan dhe për të “garantuar” të ardhmen e shtetit shqiptar, janë hartuar projekte të ndryshme, brenda të cilave do të gjente zgjidhje edhe problemi shqiptar: përkatësisht në formën e një Federate apo Konfederate; Bashkimi apo Pakti Ballkanik; Federatë të Vendeve të Evropës Lindore. Janë projektuar gjithashtu skema të tilla, si vënia e shtetit shqiptar nën një mandat britanik apo amerikan, protektorat, madje edhe qenien e tij nën mbikëqyrjen e një organizmi kolektiv, të ngjashëm me Lidhjen e Kombeve, e cila mund të krijohet pas mbarimit të LDB. Duhet të përmendim se Jugosllavia e veçanërisht Greqia përfshiheshin në zonën e interesit britanik, ndërsa Shqipëria ishte në periferi të interesave britanike e amerikane.

Më poshtë po ju referohem disa studimeve konkrete për të ardhmen e Shqipërisë dhe kufijtë e saj pas LDB, të gjetura në Arkivat Kombëtare Britanike në Londër. ***Studimi i parë*** që kam

pasur mundësi të njoh titullohet: **“Realizueshmëria e shtetit të ardhshëm shqiptar”**¹. Ai u hartua më 18 shkurt 1941 nga zoti Andry Rajan (Sir Andreë Rayan²), me porosi të Institutit Mbretëror të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Departamenti: Kërkimi i Jashtëm dhe Shërbimi i Shtypit pranë Balliol College në Oxford. Autori në përgjithësi mendon se, shteti shqiptar i pasluftës duhet të ketë të njëjtët kufij si të paraluftës. Por, Britania e Madhe, shton Rajan, nuk duhet ta privojë Jugosllavinë nga ndonjë pjesë e rëndësishme e territorit të saj, duke ia dhënë atë Shqipërisë. Përkundrazi, arsyeton ai, Jugosllavia mund të aspirojë pjesë të veriut të Shqipërisë. Duke dashur ta legalizojë cedimin e kufijve të Shqipërisë në favor të Jugosllavisë, ai sjell një referencë të gazetës *“The Times”*, sipas të cilës edhe Hitleri u kishte ofruar ministrave jugosllavë, që e vizituan atë më 14 shkurt 1941, në shkëmbim të një aleance me Jugosllavinë, territore shqiptare, që përfshinin qytetin e Shkodrës dhe pjesën e luginës së Lumit Drin. Për autorin ndonjë cedim i kufijve të Shqipërisë në veri nga pikëpamja ekonomike, do ishte më pak i ndjeshëm, se sa ndonjë cedim në jug, në favor të Greqisë. Rajan mendonte se shtetit shqiptar të pasluftës, për të mbijetuar do t’i duhej të përfshihej në një Pakt Ballkanik, ku do të aderonin edhe vendet e tjera të këtij rajoni. Sidoqoftë, Rajan dukej më realist kur arrinte në përfundimin se “Shqipëria nuk zotërohet me forcë, por ajo duhet lënë e lirë që të pranojë ose refuzojë kontrollin [e huaj], për të përfituar apo lënë mënjandë ndihmën e tyre”³.

Studimi i dytë “mbi kufijtë shqiptaro - jugosllavë” u hartua në janar 1942 nga R.G.D. Laffan⁴, i të njëjtit institut të

¹ *The National Archives (London)* (më tej: *TNA*), FO 371/29711, Realizueshmëria e shtetit të ardhshëm shqiptar, shkurt 1941, f. 77-88.

² Andrew Rayan, konsulli i Përgjithshëm i Britanisë së Madhe në Shqipëri në vitet 1936-1939.

³ *TNA, po aty.*

⁴ *TNA*, FO 371/33107, Kufijtë shqiptaro-jugosllavë, përgatitur nga R.D.G. Laffan më 6 janar 1942.

përmendur më lart. Pjesën kryesore e tij e zë problemi i kufijve shqiptaro - jugosllavë. Autori sjell dy versione për të ardhmen e Shqipërisë dhe problemin e kufijve të saj: 1. Shqipëria - shtet tërësisht i pavarur. 2. Shqipëria - shtet i pavarur, por i përfshirë në një Federatë Ballkanike, apo në një Federatë të gjerë të vendeve të Evropës Lindore. Autori analizon dy situata hipotetike në lidhje me kufijtë e Shqipërisë: Në situatën parën Jugosllavia presupozohet të merrte një minimum territoresh shqiptare; ndërsa në versionin tjetër asaj duhet që t'i përmbusheshin të gjitha pretendimet tokësore ndaj Shqipërisë. Të dyja versionet analizohen nga pikëpamja etnologjike, strategjike dhe ekonomike. Autori mendon se nga pikëpamja etnologjike nuk mund të justifikohen pretendimet jugosllave, sepse brenda kufijve të shtetit shqiptar nuk ka pakica sllave. Përkundrazi, mbështetur në këtë kriter do të ishte Jugosllavia ajo që duhet t'i kthente Shqipërisë territoret ku banonin shqiptarët. Autori mendonte se Jugosllavia kishte avantazhe strategjike me kufirin e parapushtimit të saj, ndërkohë që ndryshimet e mëtejshme do të ishin komplet në favor të saj, dhe krejt në disfavor të Shqipërisë. Duke e parë të pamundur daljen e Serbisë në portin e Selanikut, ai mendon se Jugosllavisë i duhet një rrugë komunikimi përmes Shkodrës dhe zonës rreth saj, që do të përfshinte edhe Lezhën. Edhe nga pikëpamja ekonomike Laffan gjykon se Serbisë i duhet të siguronte një dalje në Adriatik, duke ndërtuar rrugë hekurudhore, që do të kalonte në Shkodër, duke përfshirë ultësirën e Drinit dhe portin e Shëngjinit (Medua). Sipas tij, Jugosllavia do të bënte të mundur atë që nuk e kishin bërë shqiptarët, përmirësimin dhe drenazhimin e tokave rreth liqenit të Shkodrës. Në variantin tjetër parashihej dhënia Jugosllavisë jo vetëm e Shkodrës dhe e Shëngjinit, por e gjithë Shqipëria Veriore. Pyetjes se a do të ishte në gjendje të mbijetonte shteti i pavarur shqiptar, duke e gjymtuar më tej trupin e tij, ai do t'i përgjigjej në mënyrë cinike, se edhe nëse Shqipëria humbet veriun e saj, ajo mund të mbijetojë, sepse

në fund të fundit, “në çdo rast ajo duket e paaftë të ekzistojë”. Autori e përfundon studimin me parashikimin ogurzi se “fat i ardhshëm i Shqipërisë përfundimisht është ndarja e saj nga fqinjët, ose përfshirja në një Federatë të gjerë të vendeve të Evropës Lindore, por të pa dominuar nga fqinjët”.

Majori Barbruk (Barbrook), një ish oficer britanik në xhandarmërinë shqiptare gjatë kohës së Zogut, u ngarkua t’u bënte oponencën dy studimeve më të fundit për “kufijtë shqiptaro - jugosllavë” dhe për “Shqipërinë”. Ai do të sillte mendimet e tij, të cilat në thelb e kundërshtonin projektin mbi kufijtë në disa pika të rëndësishme. Barbruk nuk shihte ndonjë arsye që Shkodra t’i bashkohej Jugosllavisë, për të garantuar daljen e Serbisë në det përmes ndërtimit të ndonjë hekurudhe. Sidoqoftë, ai besonte se Jugosllavia nuk do të pajtohej me kufijtë ekzistues dhe prandaj e quante të arsyeshme krijimin e një federate ballkanike, kufijtë e brendshëm të së cilës do ta humbnin rëndësinë⁵.

Studimi i tretë i titulluar: “**Shqipëria si një problem ndërkombëtar**” u përgatit më 23 shkurt 1943⁶, nga dy studiues me emër të Institutit Mbretëror të Marrëdhënieve Ndërkombëtare - Mekartni (Macartney) dhe Laffan. Studimi analizon më në thellësi problemin e së ardhmes së Shqipërisë. Në të një vend të konsiderueshëm zë edhe problemi i kufijve të ardhshëm të Shqipërisë. Rikthimi i Shqipërisë në kufijtë e vitit 1926, do të linte nën Jugosllavi një numër të madh shqiptarësh, të përfshirë në këtë kohën e këtij studimi në Shqipërinë e Madhe të krijuar nga Fuqitë e Boshtit. Sipas dy autorëve të përmendur, tek shqiptarët e këtyre zonave ishte rritur ndërgjegjja kombëtare, në mënyrë të veçantë në Dibër, Strugë, Kosovë dhe rrafshinën e Metohisë. Jugosllavia në mbarim të luftës do të rikërkonte territoret e bashkuara me Shqipërinë nga Fuqitë e Boshtit, por mund të pretendonte më tej

⁵ TNA, FO 371/37135, Shënime për Shqipërinë, Nënkomiteti Ushtarak, Sekretariati i Rindërtimit drejtuar FO, më 30 dhjetor 1942.

⁶ TNA, FO 371/37135, Shqipëria si problem ndërkombëtar, shkurt 1943.

për Shkodrën dhe luginën e Lumit Drin. Situata që do të krijohej do të ishte e vështirë, dhe detyrimi ndërkombëtar për të vendosur kufij të arsyeshëm ndërmjet dy vendeve mund të mos pranohej nga asnjëri prej tyre, gjë që do të sillte mungesë stabiliteti në Ballkan.

Siç del nga dokumentacioni britanik, qeveritë mbretërore jugosllave e greke në marrëveshjen e nënshkruar prej tyre, më 15 janar 1942, kishin pranuar ringritjen e shtetit të pavarur shqiptar të pasluftës dhe përfshirjen e tij në Bashkimin Ballkanik. Qeveria mbretërore jugosllave në emigracion nuk kishte paraqitur pretendime territoriale direkt për Shqipërinë, por nëse Greqia do ta bënte këtë gjë edhe Jugosllavia do të paraqiste kërkesat e veta. Në mënyrë të veçantë, qeveria jugosllave në emigracion ishte shprehur e prerë, për të mos lënë “asnjë inç nga territori i saj për Bullgarinë, Shqipërinë e Greqinë”. Ndihmës ministri i Jashtëm i qeverisë jugosllave në emigracion, Gavril Stojadinoviç, në bisedimet e zhvilluara në Kajro me delegacionin bullgar më 6 shtator 1943, kishte deklaruar, “në lidhje me pretendimet e nënkuptuara të Shqipërisë për krahinën e Kosovës e Metohisë, do të duhej një tjetër 28 qershor 1389 për të lënë Kosovën.., dhe më tej shtonte: “serbët më parë lënë Beogradin se sa Kosovën”⁷.

Së katërti, një studim i posaçëm **për kufijtë shqiptaro - jugosllavë** u hartua nga Departamenti i Kërkimeve në Foreign Office, më 31 korrik 1943, i cili mori formë të plotë në gusht 1944⁸. Duke gjykuar mbi bazën e kriterit etnik pranohej se, kufijtë e vendosur në vitin 1941 ishin në të vërtetë edhe kufij politikë ndërmjet të dy vendeve, të cilët ndanin realisht shqiptarët dhe sllavët. Por, po qe se merreshin në konsideratë kriteret gjeografike dhe ekonomike, do të duhej që Ulqini dhe lugina e sipërme e

⁷ *National Archives and Record Administration (NARA)*, RG 226, Raport informativ i Harold E. Prude dhe T.A. Thornton, shtator 1943.

⁸ *TNA*, FO 371/37135, Kufijtë shqiptaro-jugosllavë, Departamenti i Kërkimit (FO), 26 gusht 1944.

Drinit të Zi t'i jepeshin Shqipërisë, ndërsa Jugosllavia duhej të mbante Gucinë, Plavën, Fushën e Kosovës dhe zonën e sipërme të Vardarit. Përmendej se rrafshinës së Metohisë duhej t'i kushtohej një vëmendje e veçantë. Sipas këtij studimi si kufi natyral ishte kurrizi vijëndarës ndërmjet rrjetit të Drinit dhe rrjeteve të Vardarit dhe Danubit. Tharja apo drenazhimi i liqenit të Shkodrës kërkonte trajtim të veçantë ndërkombëtar dhe serbët kishin interesa të veçanta për lidhjet ekonomike ndërmjet Shqipërisë së Veriut dhe Adriatikut, prandaj u duhej siguruar një dalje në Adriatik. Nga pikëpamja strategjike vija kufitare ndërmjet të dy vendeve gjykohej si krejt në favor të Jugosllavisë. Sipas këtij studimi, për të ruajtur të ndarë shqiptarët dhe sllavët do të kishte qenë më mirë që i tërë baseni i Drinit t'i jepej Shqipërisë. Por, Jugosllavia kishte interesa strategjike për të vendosur lidhje ndërmjet Shqipërisë së Veriut dhe portit të saj të Kotorrit. Studimi e shihte problemin edhe në prizmin e së drejtës historike, duke justifikuar pretendimet e historianëve serbë për të mbajtur tokat shqiptare nën Jugosllavi, si dhe zotërimin e Shkodrës dhe rrethinave të saj. Në studim pranohet si e drejtë që Shqipëria të merrte disa territore nga Jugosllavia, të cilat përfshinin një popullsi rreth 80.000 banorë, ndërsa 350.000 të tjerë do të vazhdonin të mbeteshin nën Jugosllavinë. Por edhe ato pak ndryshime që rekomandoheshin shiheshin si të vështira për t'u realizuar. Si rezultat, gjykohej si e pamundur që të ndryshonin kufijtë e vendosur në vitin 1926. Si rrugëzgjdhje, për të kënaqur të dyja palët shihej mundësia e vendosjes paraprake të Shqipërisë nën drejtimin e një fuqie të paimentuar, dhe më pas anëtarësimi i saj në një Federatë Ballkanike, anëtare e së cilës do të ishte edhe Jugosllavia.

Në periudhën prill - shtator 1943 në mjediset ushtarake e diplomatike të Britanisë së Madhe ka pasur diskutime mbi zbarkimin e trupave aleate në Shqipëri e Kosovë, brenda kuadrit të një zbarkimi në Ballkan. Në dokumentacionin e deklasifikuar së fundi, vihet në dukje dilema, se si do t'i konsideroheshin tokat e

bashkuara shqiptare, një territor armik apo mik, dhe si do të administroheshin ato nga aleatët. Për ushtarakët e lartë britanikë Shqipëria duhej konsideruar një territor armik, ndërsa për Ministrinë e Jashtme një vend mik. Në rrethanat kur rikthimi i territoreve shqiptare konsiderohej një alternativë e pamundur, aleatët anglo - amerikanë i trembeshin hakmarrjes së trupave jugosllave pas kthimit të tyre në Kosovë. Në një dokument të FO mbi “situatën shqiptare” të datës 25 gusht 1944 parashikohej që në Kosovë të ndërhnin 5000 forca amerikane, detyrë kryesore e të cilëve do të ishte shmangia e hakmarrjes së tmerrshme dhe mbrojtja e kosovarëve irredentist nga trupat jugosllave⁹. Por ky shqetësim i drejtë nuk u materializua, dhe më vonë ndodhën ato që priteshin. Në DSH dhe në FO duket se kishte një besim të pajustificuar tek Titoja. Masakrat jugosllave mbi shqiptarët nën Jugosllavi duket se nuk i shqetësuan britanikët, të cilët sipas një raporti të ambasadorit britanik në Beograd në pranverë 1945, ishin plotësisht në dijeni të tyre, por qëndronin në rolin e soditësit.

Në rrethanat kur britanikët u detyruan të hiqnin dorë nga zbarkimi në Ballkan, kur forcat e brendshme si në Jugosllavi dhe në Shqipëri po fitonin prioritet, dhe kur Bashkimi Sovjetik po futej ushtarakisht në vendet e Ballkanit, diplomacisë britanike, përveç Greqisë, i mbeteshin pak ose aspak mundësi për të vendosur për të ardhmen e popujve të këtij rajoni. Në gusht 1944, në FO do të pranonin se problemi i kufijve Shqipëri-Jugosllavi do të ishte atribut kryesisht i forcave që do të vinin në pushtet në Jugosllavi. Nëse në Jugosllavi do të vinin në pushtet pak a shumë forcat e para vitit 1941, nuk do të kishte kërkesa për territore shqiptare, por as do të lëshohej ndonjë pjesë nga ato që kishte pasur para pushtimit. Nëse Tito dhe kolegët e tij do të kishin forcën kryesore në qeverinë e ardhshme, Shqipërisë mund t'i bëheshin disa

⁹ Paskal Milo, “Fuqitë e Mëdha dhe çështja e Kosovës gjatë dhe në përfundim të Luftës së Dytë Botërore”, në *Konferenca e Bujanit*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 1999, f.50.

koncesione territoriale. Në mbështetje të kësaj teze përmendet një raport i muajit prill 1944, që vinte nga Misioni Britanik pranë Titos, në të cilin thuhej: “e ardhmja e Kosovës do të vendoset në një plebishit, ndërsa kufijtë e saj po të jetë e nevojshme do të rregullohen në favor të Shqipërisë”. Si variant i fundit shihej shpërbërja e Jugosllavisë dhe dalja më vete e shtetit serb. Në këtë rast jo vetëm që s’do t’i lëshohej asnjë territor Shqipërisë, por do Serbia të kishte pretendime territoriale ndaj tij.

Deklarata e Konferencës së Jaltës në shkurt 1945 vulosi përfundimisht restaurimin e Jugosllavisë në kufijtë paraluftës, duke i lënë disa qindra mijë shqiptarë të Kosovës dhe viseve të tjera nën Jugosllavi. Aspiratat e shqiptarëve për bashkim morën sërish një goditje të madhe, ndërsa shteti i pafuqishëm shqiptar ishte i rrezikuar nga pretendimet greke për Shqipërinë e Jugut. Shqipëria shkante në Konferencën e Paqes së Parisit, duke mos pasur një qeveri të njohur nga ish - aleatët anglo - amerikanë, e cila nuk ishte pranuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe pa status juridik si vend aleat.

Prof. dr. Sabile KEÇMEZI - BASHA
(Prishtinë)

KARAKTERI KOMBËTAR I PROGRAMIT TË LIDHJES SË DYTË TË PRIZRENIT, 1943

Lidhja Shqiptare e Prizrenit e vitit 1878, u dha shqiptareve programin kombëtar për ruajtjen e tërësisë tokësore të atdheut dhe bashkimin kombëtar, kërkesat që edhe më pas do të përbënin themelin e programeve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ato mbetën të tilla edhe në përpjekjet e mëvonshme për liri dhe shtetformim dhe vazhduan si të tilla edhe gjatë Luftës së Dytë, po ashtu edhe pas përfundimit të saj. Kërkesat e sipërpërmendura në këtë kohë u përfshinë në programet e Lëvizjes Ilegale të shqiptarëve të mbetur nën sundimin jugosllav.

Kërkesat kryesore të Lidhjes së Dytë të Prizrenit ishin: çlirimi nga pushtuesit sllavë, pavarësia kombëtare dhe bashkimi i të gjitha trevave shqiptare. Ato buronin nga e drejta legjitime dhe e natyrshme e çdo populli për të qenë i bashkuar dhe i barabartë me popujt e tjerë. Në Evropën e sotme nuk gjendet ndonjë komb tjetër, i cili të jetë cunuar aq rëndë, dhe që t'i jetë bërë një padrejtësi aq e madhe sa ajo që pësuan shqiptarët në përfundim të Luftës së Dytë Botërore.¹

¹ Kristaq Prifti, "Konsiderata etnike dhe historike rreth çështjes së bashkimit kombëtar të shqiptarëve", në botimin: *Çështja e Kosovës- një problem historike dhe aktual*, Tiranë 1996, f. 233.

Gjatë LDB, në jetën politike të Kosovës u kristalizuan dy rryma politike.² Në njërën prej tyre hynin komunistët dhe një pjesë e vogël e nacionalistëve që u bashkuan me Lëvizjen Antifashiste, të cilët shpresonin se pas luftës trevat shqiptare do të çliroheshin nga çdo zgjedhë e huaj, nga ajo nazifashiste dhe nga ajo serbo - jugosllave.

Ndërsa në grupin e dytë merrnin pjesë të gjithë nacionalistët, të cilët nuk besonin se komunistët jugosllavë do të sillleshin ndryshe nga nacionalistët sllavë. Ata mendonin se bashkëpunimi i Lëvizjes Antifashiste me LNÇJ dhe PKJ do të përfundonte me rivendosjen e pushtetit jugosllav në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare. Për këtë arsye ata kërkonin të mbronin me çdo mjet kufirin e favorshëm të vendosur nga Fuqitë e Boshtit, që korrigjonte dukshëm padrejtësitë e 1913-ës, nga synimet grabitqare serbo – malazeze - bullgare. Okupatorin italian e gjerman, ky grup e konsideronte si të keqen më të vogël në krahasim me atë që do të vinte pas tërheqjes së tyre³.

Përfaqësuesit e këtij grupimi, pas kapitullimit të Italisë, dolën me idenë për thirrjen e një Kuvendi kombëtar në Prizren, i cili do të hidhte bazat për krijimin e një organizate kombëtare, me mision të ngjashëm me atë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të vitit 1878. Nismëtarët për thirrjen e kuvendit, Xhafer Deva⁴ dhe Asllan Boletini⁵, materializuan idenë e tyre më 16 - 19 shtator, me thirrjen Kuvendit të Prizrenit, i cili vendosi krijimin e një organizate me të

² Jahja Drançolli, "Lidhja e Dytë e Prizrenit dhe veprimtaria e saj (shtator 1943-nëntor 1944)", në botimin: *E djathta shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë etnike*, vëll. I, Prizren- Hamburg, 2005, f. 73

³ *Po aty*, f. 75.

⁴ Xhafer Deva u lindi në Mitrovicë më 21 shkurt 1904. U shkollua në Mitrovicë, në Selanik, në Stamboll në "Robert College" dhe u diplomua për inxhinieri në Vjenë. Në vitin 1943 ishte ndër nismëtarët kryesor për krijimin e "Lidhjes së Dytë të Prizrenit Nga gjysma e dytë e vitit 1944 dhe deri në mbarim të luftës ishte kryetar i saj. Në vitin 1944 u emërua Ministër i Punëve të Brendshme në qeverinë e Tiranës. Në vitin 1960 shkoi në Kaliforni. Në vitin 1966 rikrijoi organizatën "Lidhja e Dytë e Prizrenit në Mërgim", që propagandoi çlirimin e Kosovës e të trojeve të tjera shqiptare në Jugosllavi.

⁵ Asllan Boletini ishte djali i Isa Boletinit.

njëtin emër, si dhe të Komitetit Qendror të saj me kryetar Rexhep Mitrovicën.⁶ Lidhja e Dytë e Prizrenit ishte organizata më e rëndësishme politike - ushtarake në Kosovë e krijuar gjatë Luftës së Dytë Botërore.⁷ Ajo u angazhua deri në fund për çlirimin dhe bashkimin e trojeve etnike shqiptare në një shtet të përbashkët duke përcaktuar qartë vijën që duhej ndjekur për arritjen e qëllimit final, bashkimin e Kosovës me shtetin amë. Kjo organizatë politike ishte e vetmja në këtë kohë e cila të gjitha pikat në Statut ia kushtoi Kosovës dhe zgjedhjes së mënyrave për realizimin e bashkimit.

Në kuvendin e parë themelues të Lidhjes, me angazhimin e 45 përfaqësuesve nga Ohri, Struga, Gostivari, Dibra, Shkupi, Tetova, Prizreni, Sharri, Suhareka, Kolesjani, Rahoveci, Gjilani, Prishtina, Ferizaj, Mitrovica, Rugova, Peja, Istogu, Drenica, Pazari i Ri, Senica, Rozhaja, Plava, Gucia, Gjakova dhe Malësia e Gjakovës u vunë themelet e organizatës.⁸

Mbështetur në frymën politike të shkrimeve autentike të pjesëmarrësve në Kuvendin themelues, fillimisht Kuvendi kishte zgjedhur kryesinë prej 7 vetëve, por me miratimin e Statutit ishin caktuar 14 veta. Duhet përmendur se në Kuvend me propozimin e Tahir Zajmit⁹, Kuvendi Themelues proklamoi Bashkimin e Kosovës, Dibrës, Tetovës, Strugës, Ulqinit dhe Tuzit me Shqipërinë, si pjesë integrale të saja dhe kërkoi bashkimin edhe të Qarkut të Mitrovicës që i takonte Zonës gjermane të pushtimit. Ndërsa delegati nga

⁶ Zekiria Cana, *Shpalime Historike*, Prishtinë, 1998, f. 543.

⁷ Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*, Instituti I Historisë, Prishtinë 2012, f. 88.

⁸ Tahir Zajmi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit dhe lufta heroike e popullit për mbrojtjen e Kosovës*, Bruksel, 1964, f. 43-44.

⁹ Tahir Zajmi u lind në Gjakovë. U shkollua në vendlindje e më tej në Shkup. Ideja e pavarësisë e shtyu t'i bashkohej çetave të Bajram Currit. Veprroi pranë Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës". Në vitin 1941 u kthye në Kosovë. Ishte njëri ndër drejtuesit e Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Nga fundi i vitit 1944, mori rrugën e mërgimit politik. Është autor i veprës *Lidhja e Dytë e Prizrenit dhe lufta heroike e popullit për mbrojtjen e Kosovës*, Bruksel, 1964 dhe *Tallazet e jetës dhe lotët e zemrës*, Bruksel, 1970.

Gjilani, avokati Esat Berisha¹⁰, kërkoi nga Kuvendi që të ndërhynte për rishikimin e vijës së demarkacionit me Bullgarinë, gjë që nënkuptonte përfshirjen brenda kufijve të Shqipërisë të trevave shqiptare të cilat ndodheshin nën pushtimin bullgar. Po ashtu edhe delegati nga Rugova, Sali Rama¹¹, kërkoi që Shqipërisë t'i bashkohen edhe tokat shqiptare të mbetura nën Malin e Zi¹².

Në bazë të vendimeve që kishte marr kuvendi i Dytë i LD të Prizrenit, më 21 janar 1944, veç të tjerave, u vendos të zgjerohej KQ në 14 anëtarë dhe u miratua Statuti i Lidhjes, i cili gjatë tërë kohës shërbeu edhe si Program i saj.

Sipas Statutit, organizimi i Lidhjes përfshinte Kuvendin dhe Komitetin Qendror me seli në Prizren, pastaj komitetet e qarkut, rrethit, komunës dhe katundit. Komiteti Qendror u kryesua së pari nga Rexhep Mitrovica¹³ (18 - 26 shtator 1943), së dyti nga Bedri

¹⁰ **Esat (Ymer) Berisha** (1913 - 1944) u lind në Gjilan më 14 prill 1913. Shkollën fillore e kreu më 1926 në Gjilan. Më 1935 përfundoi Medresenë e Madhe "Kral Aleksandri" të Shkupit, kurse më 1943 u diplomua jurist në Universitetin e Zagrebit. Në Kuvendin Themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit u zgjodh anëtar i Komitetit Qendror. Organet e OZN-së e arrestuan më 17 dhjetor 1944, dhe e pushkatuan të nesërmen, më 18 dhjetor 1944, me të vetmin "faj" se kishte qenë anëtar i Komitetit Qendror të Lidhjes II të Prizrenit.

¹¹ **Sali Rama** lindi në Bogë të Rugovës me 1892. Udhëheqës i shquar i Rugovës që luftoi për mbrojtjen e kufirit shqiptar kundër forcave malazeze të Knjaz Nikollës dhe Mark Milanit. Sali Rama mori pjesë në të gjitha ngjarjet e rëndësishme të viteve 1911-1923 dhe u dallua si personalitet i rëndësishëm. Më 1947 Sali Rama u dënua nga pushteti i pasluftës dhe kreu 16 vite burg. Po kështu ka pësuar mjaft edhe familja e tij. Më 1993 është dekoruar nga Presidenti i Republikës me Urdhrin për veprimtari patriotike të Klasit të I (parë).

¹² Z. Cana, *Shpalime historike...*, 550

¹³ Rexhep bej Mitrovica lindi në Mitrovicë në një familje me origjinë podgoričane. Më 1908 udhëhoqi një fushatë propagandistike parapërgatitje për Kongresin e Manastirit. Ishte pjesëmarrës në Kongresin e Dytë të Manastirit, më 1910, mandej në Shpalljen e Pavarësisë në Vlorë, më 1912 ku firmosi me siglën *Rexhep*. U zgjodh kryetar i KQ të Lidhjes së Dytë të Prizrenit më 16 shtator 1943. "Këshilli i Lartë i Regjencës" i përbërë nga Mehdi Frashëri, Fuat Dibra, Atë Anton Harapi, Lef Nosi, më 5 nëntor 1943 miratuan qeverinë nën drejtimin e tij. Në maj 1944, dha dorëheqjen dhe u kthye në Kosovë. Në gjysmën e nëntorit 1944 mori rrugën e mërgimit. Vdiq më 1967 në Turqi.

Pejani¹⁴ (12 tetor - 26 korrik 1944) dhe së fundi nga Xhafer Deva¹⁵, deri më 19 nëntor 1944.

Për të vërtetuar se Programi apo Statuti i Lidhjes së Dytë të Prizrenit kishte karakter kombëtar duhen sjellë pjesë nga Statuti, i cili qartë flet për detyrat, për rolin dhe për rëndësinë e Lidhjes si organizatë gjithëkombëtare, participuese në aktivitetin politik, diplomatik, ushtarak, propagandistik e çlirimtar të trojeve shqiptare. Lidhja nuk i përkiste asnjë grupimi (tarafi) politik antifashist të kohës si: LANÇ-së, Ballit Kombëtar, as Legalitetit. Lidhja e Dytë e Prizrenit ishte një mekanizëm logjistik i gjithanshëm i instancave çlirimtare - kombëtare dhe këtë e dëshmojnë kërkesat të cilat u ngritën në Programin e saj.¹⁶

Kërkesat kryesore të Lidhjes së Dytë të Prizrenit ishin: çlirimi nga pushtuesit sllavë, pavarësia kombëtare dhe bashkimi i të gjitha trevave shqiptare me shtetin amë. E tërë kjo buronte nga e drejta legjitime dhe e natyrshme e çdo populli për të qenë i bashkuar dhe i barabartë me popujt e tjerë.

Në nenin 1, të Statutit, Lidhja pasqyronte çështjen e themelimit, organizimit dhe të funksionimit të saj. Ndërsa neni 2. paraqiteshin kompetencat dhe qëllimet e saja, ndaj ky nen ishte

¹⁴ Bedri Pejani u lindi më 10 tetor 1885 në Pejë. Shkollën e Mesme e kreu në "Robert College" dhe studimet e larta në Degën e Historisë në Universitetin e Stambollit. Ishte delegat në Kongresin e Manastirit (1908), organizator dhe Kryetar i Kongresit të Dytë të Manastirit dhe sekretar i Komitetit të Kosovës (1918-1924). Firmosi aktin e pavarësisë më 28 Nëntor 1912 me siglën *Bedri Pejan*. Më 1920 ishte redaktor i gazetës *Populli* me qendër në Shkodër. Përkthen "Kujtimet" e Hasan Prishtinës nga frëngjishtja, të cilit i ndiqte moton "*edhe me djallin do të bashkëpunojsha për me bashkue Kosovën me nanën Shqipni*". Gjatë harkut kohor 1921 - 1923 ishte Kryetar i Partisë Popullore. Mbështeti kryengritjen e Fan Nolit dhe më 1924 u largua nga Shqipëria. U angazhua në mbrojtjen e të drejtave të Kosovës dhe Çamërisë. Gjithë jetën e vuri në shërbim të kombit e të atdheut dhe për këtë qëllim bashkëpunoi edhe me Kominternin dhe me LNÇ. Nga janari deri në mes të qershorit 1944 ishte kryetar i Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Më 1945 u arrestua nga Sigurimi i Shtetit Shqiptar. Vdiq i helmuar, në spitalin e Prizrenit, më 6 korrik 1946.

¹⁵ T. Zaimi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit...*, f. 56.

¹⁶ J. Drançolli, *Lidhja e Dytë e Prizrenit...*, f. 74

titulluar "Qëllimi". Ai konsistonte, para se gjithash, në mbrojtjen e trevave të çliruara, në çlirimin e krahinave të tjera shqiptare dhe në bashkimin e tyre me Shqipërinë. Në të thuhej: *"Kjo organizatë ka për qëllim mbrojtjen e tokave të lirueme, si edhe të tokave të tjera t'ish Jugosllavis. Si mjet për këtë qëllim do të përpiqet të mbledhi dokumenta për Shqiptarësin e visevet në fjalë dhe t'organizojë popullin fizikisht e moralisht për mbrojtjen e këtij dheu"*.¹⁷

Ndërsa në pjesën e 3, në të cilën përfshihen Kompetencat toksore, Lidhja e Prizrenit përcaktonte: *"Kompetencat toksore të kësaj organizate, të shtrihen mbi të gjitha tokat e sipershenueme, d.m.th. mbi Kosovën e lirueme, mbi qarkun e Dibres, si edhe mbi viset tjera Shqiptare t'ish Jugosllavisë. Malsinat mbrenda kufijve të 1913-tës, që ma parë varrëshin prej qyteteve të Gjakovës, Prizrenit dhe Dibrës s'Madhe, me qënë se ekonomikisht dhe gjeopolitikisht janë fare ngushtas të lidhuna me qytetët në fjalë, mund të përfaqesohen në Kuvend vullnetarisht dhe mund të marrin pjesë në organizatën e « LIDHJES S'II-të TE PRIZRENIT »*.¹⁸ Vihej në përfundim se Lidhja do të punonte si në organizimin ushtarak dhe politik, ashtu dhe në propagandimin e nevojave, për ruajtjen e Shqipërisë Etnike.

Në pikat në vijim, Statuti paraqiste organizmin e brendshëm të organizatës, si të KQ, të Komiteteve të qarqeve, komunave, fshatrave etj. Por në pikën 11 të Statutit "Organizata e LIDHJES së II-të të PRIZRENIT ka tagër": paraqiteshin udhëzimet se si duhet të përgatitej popullata shqiptare, si në aspektin moral, material e luftarak për t'i mbrojtur tokat shqiptare kudo që janë. Në nenin 1. Lidhja porosiste se si duhej bërë organizimi i propagandës intensive me qëllim që populli shqiptar të përgatitej shpirtërisht, materialisht edhe fizikisht për mbrojtjen e tokës së vet.

Më tej kërkohet me këmbëngulje të bëhej përgatitje për luftën diplomatike në Konferencën e Paqes të pasluftës, duke grumbulluar

¹⁷ Statuti i Lidhjes së Dytë të Prizrenit.

¹⁸ Po aty.

të dhëna e dokumente të cilat dëshmonin e vërtetonin shqiptarësinë e atyre viseve.

Kërkohej gjithashtu të organizohej aparati administrativ, në të gjitha viset e kompetencës së saj tokësore, me organe të çdo prefekturë, komune, bashkie e katundi.

Po ashtu në pikën 4 kërkohej organizimi i stërvitjes paraushtarakë të djelmoshave të pa rekrutuar, në konformitet me ligjin që ishte në fuqi rreth organizimit të paraushtarakëve.

Pastaj kërkohej organizimi i stërvitjes së të gjithë meshkujve deri në moshën 60 vjeçe, veç atyre nën armë, duke i inkuadruar sipas organizimit të përshtatshëm. Pjesëtarët e këtyre grupeve nuk do të mbaheshin në stërvitje të vazhdueshme, por do të regjistroheshin, do të jepnin betimin dhe do të qëndronin në shtëpitë e veta duke u thirrur herë pas here për ushtrime, ose veprime të tjera.

Më tej anëtarët e Lidhjes do të kujdeseshin për sigurimin e mjeteve të transportit, të ushqimit dhe nevojave të tjera për veprimtarinë e organizatës.

Do të kërkohej prej autoriteteve shtetërore e parashtetërore ndihma dhe përkrahja, etj.

Në vazhdim po e botojmë Statutin e organizatës "Lidhja e II e Prizrenit", themeluar më 16 - 19 shtator 1943 në tokat e çliruara nga Jugosllavia dhe e miratuar nga qeveria shqiptare më 14 mars 1944 pa asnjë ndryshim.

STATUTI

i Organizatës

« LIDHJA e II-të e PRIZRENIT »¹⁹

I

Themelimi

Në bazë të vendimevet, që morri kongresi i Prizrenit me 16 - 19 Shtatuer 1943, ku u-perfaqesuen tokat e lirueme siedhe të tokave

¹⁹ AQSH. RF: DBV07091,VT: 1943, OR.

të tjera t'ish mbretnis Jugosllave, thëmelohet organizata « LIDHJA E II-të E PRIZRENIT ».

II

Qëllimi

Kjo organizatë ka për qëllim mbrojtjen e tokave të lirueme siedhe të tokave të tjera t'ish Jugosllavis. Si mjet për këtë qëllim do të përpiqet të mbledhi dokumenta për Shqiptarësin e visevet në fjalë dhe t'organizojë popullin fizikisht e moralisht për mbrojtjen e këtij thezi.

III

Kompetenca tokësore

Kompetenca tokësore e kësaj organizate shtrihet mbi të gjitha tokat e sipershenueme, d.m.th. mbi Kosoven e lirueme, mbi qarkun e Dibres, siedhe mbi viset tjera Shqiptare t'ish Jugosllavis. Malsinat mbrenda kufijve të 1913-tës që ma parë varrëshin prej qytetëve të Gjakovës, Prizrenit dhe Dibrës s'Madhe me qënë se ekonomikisht dhe gjeopolitikisht janë fare ngushtas të lidhuna me qytetët në fjalë, mund të përfaqesohen në Kuvend vullnetarisht dhe mund të marrin pjesë në organizatën e «LIDHJES s'II-të TE PRIZRENIT».

IV

Organizimi, kompetenca dhe funksionimi

Organizimi i Lidhjes së Prizrenit përfshin:

1) Kuvendi i Lidhjes me qëndër në Prizren përbahet prej antarvet nga një delegat për çdo rreth administrativ (Qendra e Prefekturavet dhe e N/Prefekturavet).

2) Komiteti Qendruer, me seli në Prizren, përbahet prej katërmëdhjetë (14) antarësh.

Kryetari, dy N/Kryetarët dhe gjithë antarët tjerë të Komitetit Qendruer zgjidhen prej Kuvendit.

Kryetari dekretohet prej Keshillit të Naltë mbi proponimin e Kryeministrit.

3) Komiteti Qarkuer, me seli në kryevendim e çdo Prefekturë perbahet prej shtatë (7) vetvet, të cilët zgjidhen si mbas procedurës së caktueme prej qarkorës së Komitetit Ekzekutiv të Tiranës me datë 24-IX-1943 mbi rregullimin e zgjedhjes s'Asemblistevet.

Po kjo procedurë ndiqet edhe për zgjedhjen e antarve të Komitetit Rrethuer.

Antarët e komitetit komunal zgjidhen prej Kryeplesqive të katundeve të komunes me seli-qendra e komunës; kurse Kryetari caktohet prej Komitetit Qendruer në mes t'antarve të zgjedhun si ma sipër.

4) Komiteti Rrethuer, me seli kryevendin e çdo N/Prefekturë, perbahet prej pesë (5) vetësh, të cilët zgjidhen si ma sipër, kurse Kryetari caktohet prej Komitetit Qarkuer.

5) Komiteti komunal, me seli në kryevendin e çdo komune, perbahet prej tre (3) vetvet, të cilët zgjidhen si ma sipër, kurse Kryetari caktohet prej komitetit Rrethuer.

6) Komiteti katunduer, me qendër katundin, perbahet prej pleqsis së katundit.

V

Nëpunësat, në shërbim t'organizatës, emnohen prej Komitetit Qendruer mbi proponimin e Komitetit përkatës.

Në qoft se nuk gjinden nëpunësa në numer të mjaftueshëm për kryemjen e shërbimeve t'organizatës me lejën e kryetarit t'administratës së vendit, mund të ngarkohen me detyrat përkatse sekretarët Bashkijak ose komunal, kundrejt një shperblimi prej arkës s'organizatës.

VI

Në marrëveshje me Komandën e përgjithëshme të Mbrojtjes kombtare, organizata merr në shërbim si instruktorë oficerë dhe N/oficerë të cilët si mbas gradës, vehen në dispozitë të komiteteve të ndryshëm.

Instruktorët pranë Komitetit Qendruer përbajnë shtabin e Komitetit.

VII

Funksjonet e kësaj organizate dhe kompetencat e organeve të sajë, rregullohen si mbas dispozitavet qi pasojnë :

1) Kuvendi i Lidhjes, i zgjedhun prej popullit, përfaqëson vullnetin e këtij dhe mblidhet tri herë në mot. Jashtëzakonisht Kuvendi mblidhet, kur thirret prej komitetit Qendruer, në rasë nevojë për me marrë vendime me randësi, ase mbi kërkesën e shumicës s'antarve të Kuvendit.

2) Komiteti Qendruer i zgjedhun prej kuvendit si ma sipër asht auktoriteti ma i naltë ekzekutiv i kësaj organizate; përfaqëson organizaten, komunikon vendimet e Kuvendit, jep udhezime dhe urdhna komiteteve te ndryshem gjerarhikisht, kontrollon komitetet ase urdhnnon gjerarhikisht kontrollimin e tyne; plotson organizimin e Lidhjes; organizon stërvitjet, emnon funksjonarë të çdo natyre dhe çdo kategoriaje t'organizatës, merr masa diciplinore dhe ndëshkimore kundër këtyne dhe harton buxhetin e organizatës.

3) Komitetët janë auktoritete t'organizatës; këto përfaqesojnë në vendin e vet Komitetin Qendruer dhe veprojnë si mbas udhëzimeve dhe urdhnave te tij, që jepen e transmetohen gjerarhikisht.

Komitetët eprorë kan të drejtë inspektimi e kontrolli mbi Komitetët inferiorë. Gjerarkija e komiteteve asht analoge me ato t'auktoriteteve clvile të Shtetit. Kompetenca toksore e tyne koinçidon me atë t'auktoriteteve civile të shtetit.

VIII

Funksjonët e mbrendëshme të Kuvendit dhe zgjedhja e Paris së tij rregullohen me vendimet e këtij kuvendi.

IX

Funksjonet e mbrendëshme të Komitetit Qëndruer e të komiteteve të tjera të varruna prej këtij, zgjedhje e antarvet zevendës t'atyne, që për arsye të randa largohen prej Komitetit, themelimi i komiteteve ku ende s'janë themelue, plotsimi i organizimit si mbas ketij Statuti, rregullohen me vendimet e Komitetit Qendruer.

X

Emnimi, transferimi, gradimi dhe pushimi i nëpunsave të kësaj organizate kryhet me vendimet e Komitetit Qendruer si mbas normave ligjore në fuqi për nëpunsat e shtetit. Denimet dicipline kundër nëpunsave t'organizates zbatohen prej Komitetit Qendruer si mbas ligjeve të shtetit mbi procesin e Komitetit Qendruer ose komiteteve të ndryshëm, si mbas ligjeve të shtetit. Në rasë se nëpunsat në fjalë kryejn një faj që hyn në rrethin e ndeshkimeve penale, me proces verbalin përkatës çashtja i referohet gjyqit përkatës për veprim.

XI

Organizata e LIDHJES së II-të të PRIZRENIT ka tagër:

- 1) Me organizue propogandë intensive me qëllim të përgatitës shpirtnisht, materjalisht edhe fizikisht popullin për mbrojtjen e tokës së vet.
- 2) M'u përgatitë për luftën diplomatike në konferencën e paqës tue organizue mbledhjen e dokumentave provuese të karakterit shqiptar t'atyne visevet.
- 3) Me organizue aparatit e vet administrativ, si mbas këtij statuti,

ndër të gjitha viset e kompetencës së sajë toksore me organe të çdo Prefekturë, komune e Bashki dhe katund.

4) Me organizue stërvitjen paraushtarake të djelmoshave ende të parekrutuem, në konformitet me ligjën rreth organizimit të paraushtarakve që është në fuqi.

5) Me iu përveshë organizimit për stërvitjen e të gjithë mashkujve deri me 60 vjeç, veç atyre nën armë, të inkadruar si mbas organizimit të pershtatshëm. Pjestarët e këtyre grupeve nuk mbahen në stërvitje të vazhdueshme, por rregjistrohen, betohen dhe qëndronjë ndër shtëpijat e veta dhe thërriten herë pas here për ushtrime ose veprime të tjera.

6) M'u kujdesë për sigurimin e mjeteve të transportit, t'ushqimit dhe të tjera pajime të nevojshme për veprimin e organizatës.

7) Me kërkuar prej autoriteteve shtetnore e parashtetnore ndihmën dhe përkrahjen e tyre, të cilët për sa të jetë e mundur u akordojnë.

8) Me kërkuar dhe me marrë në dispozitë oficerë dhe nënoficerë prej ushtrisë e Gjindarmerisë dhe rrogat e këtyre do të vazhdojnë të paguhen prej arkës së shtetit.

XII

Financat

T'ardhunat e kësaj organizate, për me u-ba ballë shpenzimeve të sajë janë:

1) T'ardhuna nga ndihma të ndryshme të dhurueme prej patrijotëve, emnat e të cilve do të rregjistrohen e do të shpallen. Këta shenohen edhe si antar ndëri, kur dhurata e tyre është e konsiderueshme.

2) T'ardhunat nga shitje e pullave fakultative, të cilat do të jenë

Postare prej pësë (5) qindarka dhe per lutje zyrtare prej njizete (20) qindarka.

3) T'ardhunat nga fushata të hapuna herë pas here, me vendim të Komitetit Qendruer.

4) T'ardhunat nga pasunija e ish organizates serbe « SOKOL ».

5) T'ardhunat nga kontributi i Bashkive dhe i Komunevet të tokave te lirueme, kontribut icili dotë jetë dhetë për qind (10 %) mbi t'gjitha t'ardhunat vjetore brut të tyne. Bashkit dhe komunet në fillimin e çdo vjeti financjarë kur pregatisin buxhetin e tyne, janë të detyrueme me caktue në pjesën e shpenzimeve përqindjen e ma sipërme të sajueme në favorin e kësaj organizate dhe shuma qi do te rezultojë do te derdhet n'arkën ma t'afërme të financës së shtetit, në llogari të arkës së Komitetit Qendruer.

6) T'ardhunat nga shitje e shëjeve (distingtive) t'organizatës.

XIII

Dispozita të posaçme

Shka nuk parashifet në kët statut dhe që nuk asht në kundreshtim me dispozltat e tij as me qellimin dhe misjonin e kësaj organizate rregullohet me vendimet e Komitetit Qendruer.

XIV

Marredhanjet e kësaj organizate me qeverrin kryhen nepërmjet Kryesis së Këshillit Ministuer.

XV

Organizata ka vulen e vet, ku shënohen fjalët: « LIDHJA e II-të E PRIZRENIT » dhe emni i zyrës. Po ashtu ka edhe shëjen (distingtiven) dhe pullat e veta, ku shenohen fjalët : « LIDHJA E II-të E PRIZRENIT ».

XVI

Organizata ka zyrat e veta në qëndër ashtu edhe nepër krahinat, ku janë themelue Komitetet. Këto gëzojnë përjashtimin nga taksat postare, telegrafike dhe telefonike, si mbas ligjes autorizuese.

XVII

Organizata asht person juridik dhe i gëzon të gjitha të drejtat përkatse ligjore.

XVIII

Vendimet, rregulloret, qarkoret dhe urdhat e kësaj organizate të daluna prej komiteteve dhe organeve të sajë kompetente, dhe në konformitet me këtë statut, kan fuqi obliguese si për organët e veta dhe antarët e vet.

XIX

Kur e lyp nevoja Komiteti Qendruer i organizatës ka tagër me i tërhjekë vrëjtjen qeverris mbi sjelljet e nëpunsave të shtetit për të cilët kujton se u-nxjerrin pëngime aktivitetit t'organizatës.

XX

Mos-marreveshtjet eventuale midis autoriteteve lokale shtetnore dhe kësaj organizate zgjidhen në marrëveshtje midis tyre dhe, në rasë deshtimi, në marrëveshtje midis Kryetarit të Keshillit Ministrues dhe te Kryetarit te Komitetit Qendruer.

XXI

Organizata e naltëpermendun vazhdon deri në kryemjen e plotë t'aprovimit të sajë. Në mbarim të këtij qellimi organizata syprimohet me dekret të Pushtetit Sovran dhe pasunit e sajë destinohen në favor të shtetit.

XXII

Ky Statut i paraqitët Qeverris për aprovim dhe hyn në fuqi prej datës së shpalljës të Dekretit aprovues, Prizren, me 21 Kallnuer 1944.

Vertetohet se asht një me origjinalin.

Kryetar' i K.Q. i L.II-të TE PRIZRENIT
Bedri Peja d.V.

Sipas dokumenteve thuhej se pas miratimit të Statutit nga ana e delegatëve, Statuti iu dërgua shtetit shqiptar- Këshillit të Naltë, për miratim në të cilën thuhej

SHTETI SHQIPTAR
KËSHILLI I NALTË

Mbi propozimin e bamun me shkresën Nr. 324 datë 14-11-1944 të Kryeministrit,
Si ndigjoj dhe pëlqeu vendimin Nr. 96 datë 12-11-1944 të Këshillit Ministuer,

DEKRETON

Aprovimin e Statutit t'Organizatës « LIDHJA E II-të E PRIZRENIT » , dhe urdhnon zbatimin e tij

Tiranë, Më 14 Mars 1944

KRYETARI:

Mehdi Frashëri d.v.

ANTARË:

P. Anton Arapi d.v.

Lef Nosi d.v.

KRYEMINISTRI:

Rexhep Mitrovica d.v.

Formimi i Organizatës "Lidhja II e Prizrenit" - Komiteti Rinisë Intelektuale të Prizrenit, 1944

Sipas gazetës “Lidhja e Prizrenit”²⁰, në shkrimin “Mbi organizimin e strukturave të brendshme të organizatës "Lidhja II e Prizrenit", rezultojnë këto të dhëna.

Pas formimit të organizatës politike e ushtarake të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, Kryesia e Lidhjes kishte marrë përsipër që të formonte edhe **Komitetin Rinisë Intelektuale**. Më 7 mars, në ora 17:00, 1944, ajo ftoi të gjithë intelektualët e qytetit në një mbledhje në sallën e shkollës Bajram Curri.

Kryetari i Komitetit - Bedri Pejani, hapi mbledhjen dhe me pak fjalë foli mbi programin e gjatë të Komitetit, mbi veprimtarinë e zhvilluar deri në atë moment, mbi shkakun e mbledhjes dhe mbi kontributin që duhet t’i jepte atdheut çdo shqiptar, dhe veçanërisht çdo intelektual, në ato çaste me rëndësi të historisë Kombëtare.²¹

Mbas referatit të mbajtur, Bedri Pejani, së bashku me anëtarët tjerë të kryesisë të Komitetit Qendror u larguan nga mbledhja duke i lënë vetëm intelektualët që të ishin sa më të lirë që ta zgjidhnin vetë, ipas dëshirës së tyre, Komitetin e Rinisë Intelektuale prej shtatë vetësh.

Votimi për kryetar dhe anëtarët e rinj zgjati deri në orën 20:00 dhe unanimisht delegatët zgjedhën për kryetar z. Kudret Kokoshin²², ndërsa z. Selman Riza, Ibrahim Fehmiu, dr. Durmish

²⁰ Gazeta *Lidhja e Prizrenit*, viti I, nr. 2 më 26.3.1944; <https://vargmal.org/km/dbv11101>.

²¹ *Po aty*.

²² Kudret Kokoshi lindi në Vlorë, më 18 shtator 1908. Arriti gradën Doktor i shkencave juridike. Kishte pasion letërsinë dhe kreu edhe këtë fakultet. Në moshën 26 vjeçare në vitin 1934 u kthye të shërbente në atdheun e tij. Më 1939, u emërua gjykatës në Korçë, më pas në Shkodër dhe Tiranë. Më 1941, u emërua Kryeprokuror në Prizren. Më 28 nëntor 1942, mori pjesë në udhëheqje të demonstratës antifashiste në Prizren. Në vitin 1943, ishte një nga eksponentët e Ballit Kombëtar në Vlorë. Më 5 qershor 1945, u arrestua, u dënua dhe vuajti 19 vjet në burgun e Burrelit. Vdiq më 26 prill 1991.

Celina, dr. Byrhan Shporta, Sylejman Aliu dhe Shefqet Veliu u zgjodhën anëtarë të Komitetit të Rinisë Intelktuale.

Më 11 mars 1944, Komiteti i Rinisë Intelktuale filloi rregullisht veprimtarinë e tij. Po atë ditë miratoi programin e vet dhe vendosi, së pari, botimin e një gazete të përjavshme si organ të vetin, e cila u pagëzua me emrin simbolik “LIDHJA E PRIZRENIT”. Në shkrimet e gazetës u propagandua me të madhe ideja e krijimit të Shqipërisë Etnike dhe mbrojtja me çdo mjet e kufijve të saj. Gazeta trajtonte tema me shumë interes për kombin dhe shtetin shqiptar. Që nga numri i 12 prillit 1944, kishte hapur edhe rubrikën “Tragjedia e Kosovës” në të cilën njoftonte opinionin e gjerë për krimet e masakrat që ishin bërë dhe bëheshin në Kosovë. Gazeta botohej nga Komiteti Intelktual shqiptar, me pjesëmarrjen e penave më të mira të kohës.

Ndërsa nën pikën 2, u vendos që të formohej “Grupi Kulturuer”. Gjithashtu u mor vendim që çdo javë të mbaheshin konferenca për çështje të ndryshme; u mor qëndrimi që të bëhej grumbullimi i dokumenteve e të dhënave që argumentonin krimet e serbëve e të italianëve në tokën shqiptare të Kosovës; për organizimin e Bibliotekës; për formimin e Grupit Artistik (Fildramatik e Muzikor); për formimin e Grupit Sportiv; për çeljen e kurseve për të rriturit (burra e gra); për organizimin e Gruas Shqiptare; së fundi u vendos që të thirreshin me ftesa të veçanta, të gjithë intelektualët në një mbledhje të përgjithshme, në të cilën të caktohej përfundimisht programi dhe të ngarkoheshin detyrat për secilin.²³

Më 13. III. 1944, në orën 16, ishte caktuar një takim me intelektualët. Ftesave për pjesëmarrje iu ishin përgjigjur gati që të gjithë, burra e gra, të rinj e të reja. Kryetari i Rinisë Intelktuale, Kudret Kokoshi²⁴, pasi e kishte hapur mbledhjen, kishte paraqitur programin që grupi kishte përgatitur dhe të pranishmit kishin aderuar aty ku dëshironin dhe ku e gjenin veten më së miri.

²³ Gazeta, *Lidhja e Prizrenit*, viti I, nr.2, më 26.3.1944.

²⁴ Po aty.

Në Grupin Kulturuer u regjistruan mbi 40 vetë, ndër të cilët 17 për gazetë, 6 për konferenca dhe 17 për mbledhje dokumentesh dhe për organizimin e Bibliotekës.

Në Grupin Artistik u regjistruan 56 vetë, ndër këta 28 në degën Filo-dramatike dhe 28 në Degën Muzikore.

Mbas kësaj u caktua dita e konferencave dhe radha e tyre. Në fund të mbledhjes, nga grupi artistik u formua një orkestër prej 12 vetësh dhe një kor prej 20 vetësh. Ky grup javë për javë, mbas konferencës, do të jepte një koncert për argëtimin e rinisë. Po ashtu u organizua mbledhja e ndihmave vullnetare në dobi të ushtarit të të nesërmes.

Në mbledhjen e datës 15 mars, që zgjati mëse dy orë, Komiteti i Rinisë Intelktuale kishte marrë këtë vendim:

1. Hapjen e kurseve për të rriturit më 21.III.1944, duke i ndarë në katër kategori. Në dhënien e mësimit ndër këto kurse, përveç arsimtarëve, do të marrin pjesë vullnetarisht edhe një grup intelektualësh jo arsimtarë.

2. Krijimin e një grupi për avancimin (emancipimin) e Gruas Shqiptare. Për këtë u caktua një komision i veçantë, që të përgatiste projektin e organizimit dhe listat përkatëse.

3. Mënyrën e organizimit të manifestimit të datës 19. III. 1944 dhe mbi ndihmën që me atë rast do të mbledhet në favor të Ushtrisë Kombëtare.

Për të pas një frytë të shpejtë në punë dhe që të shkonte çdo gjë me rregull e disiplinë, më 16 mars 1944, të tre grupet u mbledhën në sallat e ndryshme të shkollës “Bajram Curri” për të zgjedhur secili këshillin e vet. Këto këshilla do ta kishin përgjegjësinë e grupeve të tyre dhe do të interesoheshin për mbarrëvajtjen e grupeve që dirigjonin.

U formua Këshilli Kulturuer, Këshilli Gazetar, Këshilli për Përpilimin e Programit të Mësimeve, që do të jepeshin ndër seksione të ndryshme, Këshilli Artistik dhe Këshilli Sportiv.²⁵

²⁵ Po aty.

Çdo këshill në krye të javës do të mblidhej për të bisedua mbi veprimtarinë e zhvilluar dhe për të caktuar punën që do të kryhej në javën e ardhshme.

Në mbarim të çdo muaji, u mor vendimi që secili këshill, i secilit grup, do t'i paraqiste raportin përkatës Kryesisë së Rinisë Intelktuale rreth aktivitetit të zhvilluar.

Sipas të dhënave, thuhej se sipas programit të parashikuar, më 19. III. 1944, ishte bërë shfaqja e parë e veprimtarisë së Rinisë Intelktuale. Ceremonia ishte hapur para autoriteteve civile e ushtarake të vendit me një elitë burrash e grash të zgjedhur, si edhe të Rinisë. Programi kishte filluar me ekzekutimin e Himnit të Flamurit prej korit dhe me një fjalim inaugurues të atdhetarit Ibrahim Fehmiut, i cili, në vija të përgjithshme, kishte prezantuar programin që synonte të zhvillonte Rinia Intelktuale.

Po ashtu, në këtë tubim ishte prezantuar me një fjalë rasti edhe Kryetari i Rinisë Intelktuale, patrioti i madh, Kudret Kokoshi, që kishte bërë një përshkrim të gjendjes politike të Kosovës dhe të Shqipërisë, duke theksuar rolin e rëndësishëm që mund të lozte një rini e mirë, e shëndoshë, atdhetare, e organizuar në shërbim të Kombit, sidomos në këto rrethana të vështira të jetës kombëtare.

Në këtë tubim kishte marrë pjesë dhe kishte ligjëruar profesor Lukë Çuni. Tema e titulluar: “A asht Kosova shqiptare?”, kishte zgjuar mjaft interes te të pranishmit.

Profesori e kishte ligjëruar temën me një kompetencë të padiskutueshme, me argumente historike, duke filluar prej dardanëve e ilirëve, duke dokumentuar me emrat shqip të lumenjve dhe të qyteteve të Kosovës, të cilat megjithëse kishin kaluar shekuj, ruanin karakterin e fizionominë e tyre kombëtare.²⁶

Në mbarim të Konferencës ishte dhënë një koncert i pasur kulturor, i përgatitur nga grupi artistik nën drejtimin e kujdesshëm të prof. Lorenc Antonit. Ndërsa për datën 26 mars, në ora 16:00, ishte paraparë një konferencë të cilën do ta organizonte z. Tahir Zaimi me temën: “Bajram Curri simbol i atdhetarizmit shqiptar”, në shenjë

²⁶ Po aty.

përkujtimi të heroit të maleve të Kosovës, me rastin e 19 vjetorit të vrasjes së tij.

Dhe krejt në fund, duke parë e analizuar Statutin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, dhe veprimtarinë e organizatës së Rinisë Intelktuale Shqiptare, mund të konkludojmë se Statuti dhe veprimtaria e organizatës kishin karakter kombëtar dhe demokratik. Në pikat e tyre, mbi të gjitha, qëndronte çështja kombëtare. Luftohej për një Shqipëri Etnike dhe përmes Statutit bëhej organizimi i forcave popullore dhe intelektuale për të realizuar programin e lëvizjes kombëtare mbarë shqiptare dhe për të shpëtuar vendin nga më e keqja. Dhe është demokratike sepse në asnjë dokument apo material, që del nga kjo organizatë, gjatë periudhës sa veproi ajo, askund nuk ka asnjë shenjë sado të vogël që të shfaqte ndjenjën, pikëpamjen dhe qëndrimin shovinist, të cilat deri në fund ngelën të huaja për parimet themelore të Lidhjes.

Dr. Ledia DUSHKU
(Tiranë)

**SITUATA POLITIKE DHE SHOQËRORE NË KOSOVË
SIPAS RAPORTIT TË MAZAR SOPOTIT (12 NËNTOR - 9
DHJETOR 1941)**

Pushtimi gjerman i Ballkanit (prill 1941) dhe marrëveshja e Vjenës mes Ribentropit dhe Cianos që e pasoi atë, solli ndryshime të rëndësishme për kufijtë e shtetit shqiptar. Shqipërisë Londineze iu bashkuan, sipas marrëveshjes së Vjenës, pjesa më e madhe Kosovës, territoret shqiptare të Ulqinit, Tuzit, Plavës, Gucisë, Rozhajës, si dhe viset lindore nga Dibra në Strugë.¹

Në vjeshtë të vitit 1941, situata në rajonin e Kosovës nuk ishte e qetë. Njoftime të shumta për shqetësime të rendit, probleme ekonomike dhe pakënaqësi të banorëve i vinin shpesh qeverisë së Tiranës. Në përpjekje për të mësuar më shumë, një numër nëpunësish të administratës qendrore u dërguan në Kosovë. Midis tyre ishte dhe Masar Sopoti, shef seksioni në Ministrinë e Kulturës Popullore.

¹ Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore (1941-1945)*, Prishtinë: “Dukagjini”, 1997, f. 19.

I dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shtypit, ai u nis më 12 nëntor 1941 në një udhëtim në Kosovë. Qëllimi i udhëtimit ishte studimi i gjendjes politike e shoqërore në këtë rajon. Udhëtimi tre javor vazhdoi deri më 9 dhjetor 1941 dhe përkon me periudhën e largimit të qeverisë së Shefqet Vërlacit dhe formimin më 4 dhjetor të qeverisë së Mustafa Krujës. Interesantja e raportit është se, hartuesi i tij jep një pasqyrim të imët të realitetit mbështetur në opinionin dhe perceptimet e shqiptarëve. Megjithatë, ai mban firmën e një nëpunësi të administratës fashiste, gjë që është e dukshme si në frymën edhe në përmbajtjen e tij. Raporti shumëfaqësh ruhet në Arkivin Qendror të Republikës së Shqipërisë në fondin e Perikli Semit, dosja 974.²

Disa nga çështjet e trajtuara në raport po i paraqesim më poshtë:

Administrata: Puna e Komisariatit të Lartë Civil të Lartë

Udhëtimi i M. Sopotit nisi nga Tropoja, Bicaj e Luma, zona këto të cilësuar problematike sa i përket qetësisë për shkak të trazirave dhe ngatërresave që shkaktonin çetat shqiptare, të cilat i bënë rezistencë italianëve. Ndonëse flet në shumës, raporti veçon vetëm njërin prej tyre, atë të Gani Kryeziut.³ Si mënyrën më evikase për rivendosjen e rendit dhe të qetësisë, banorët e zonës sugjerorin faljen për të tërë të arratisurit për faje politike në zonat e Kukësit, Tropojës, Bicajt e Lumës.

Më tej udhëtimi ka vijuar në drejtim të Prizrenit, Prishtinës e Pejës. E përgjithshmja e konstatimeve në të tre këto qytete ishte një pakënaqësi e shprehur hapur kundrejt punës së Komisariatit të

² *Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: AQSh), Fondi (më tej: F) Perikli Semi, Dosja (më tej: D) 974, Parashtrësë mbi gjendjen e tanishme në Kosovë, nga Mazar Sopoti, shef seksioni i Ministrisë së Kulturës Popullore, fl. 1-43.

³ *Po aty*, fl. 3-4.

Lartë Civil. Banorët evidentonin një sërë problemesh edhe në lidhje me administratën vendore.

Pikë së pari, ata ankoheshin se administrata vuante mos punësimin e vendasve, ndonëse, sipas Mazar Sopotit, nuk mungonin njerëzit e shkolluar e me përvojë. Po ashtu raporti evidencon se edhe shumë kosovarë të shkolluar ishin hequr nga puna, siç ishte rasti i nënprefektit të Ferizajt, zotit Ismail Gorani. Sikur të mos mjaftonte kjo, nëpunësit e emëruar nga Komisari i Lartë në Tokat e Liruar në pjesën më të madhe ishin pa integritet. Ata kishin qenë nëpunës që ishin pushuar nga administrata e Ahmet Zogut për shpërdorim detyre, mungesë morale, shpërdorim besimi, përvetësim të hollash nga arka e shtetit. Nga ana tjetër, një pjesë e madhe e nëpunësve ishin të papërgjegjshëm, merreshin me tregti dhe, të zënë pas etheve të arit e të fitimit, kishin lënë pas dore detyrat shtetërore.

Mosnjohja e zonës nga pjesa më e madhe e nëpunësve, ishte një arsye tjetër e mosfunksionimit si duhet të administratës. Arsyeja e emërimit të një mase kaq të madhe nëpunësish të papërshtatshëm lidhej me emërimet nepotike. Sipas raportit, shumica e nëpunësve vinin nga Prefektura e Gjirokastrës dhe zonat përreth, farë dhe fis i Komisarit të Lartë, Fejzi Alizoti apo të njohur të tij të ngushtë. Ata ishin pa përvojë në administratë dhe në disa raste edhe të pashkolluar. Sjellja e tyre i kishte dhënë shkas mërisë krahinore, që sipas Mazar Sopotit “duhej denoncuar si një e keqe, të cilës po nuk ia pre hovi në kohë, mund të hapte plagë të rënda dhe të rrezikshme për mbarë kombin shqiptar”.⁴

Sjellja e nëpunësve të të gjithë niveleve kundrejt vendasve ishte e dëshpërueshme nga çdo pikëpamje. Sorollatja nëpër korridoret e administratës, formalitetet e gjata, hetimet dhe pyetjet e shumta shoqëronin ankuesit në zyrat e Komisariatit. Ankesat e tyre nuk merreshin parasysh çka sillte moszgjidhjen e shumicës së tyre. Sjelljet arrogante të drejtuesve ishin një tjetër konstatim. Në

⁴ *Po aty*, fl. 5.

raport vihet gishti tek sjellja e nënprefektit të Gjilanit, i cili duke mos patur kurrfarë mbikëqyrjeje nga qendra, nuk kishte ngurruar të burgoste nën pretekste gjithfarësh, vendas që në të shkuarën, sipas raportshkruesit, kishin përfaqësuar shtyllat e nacionalizmit shqiptar.⁵ Nënprefekti kishte sjellë aty tërë farefisën e tij dhe nëpërmjet tyre i ishte kushtuar tregtisë, e cila në kushtet kur mbështetej nga autoriteti shtetëror sillte fitime kolosale.

Problemet arsimore dhe mënyra e jetesës në Kosovë

Problematike paraqitet në raport edhe gjendja arsimore. Pavarësisht hapjes së disa kurseve kishte ende shumë punë për të bërë. Mungesa e mësuesve dhe e shkollave evidentohet qartë prej Mazar Sopotit. Ndonëse kishte kohë që priteshin mësues nga Shqipëria, mbërritja nuk kishte ndodhur. Nga ana tjetër, përqindja e shkollave të hapura në krejt Kosovën nuk i përgjigjej as $\frac{1}{4}$ së kërkesa.⁶ Nevoja është e madhe sepse një pjesë e konsiderueshme e popullsisë ishte analfabete. Kështu, Prefektura e Mitrovicës me të tërë qarqet e saj kishte nevojë për një gjimnaz dhe 12 shkolla fillore, ndërkohë që për momentin kishte vetëm një shkollë fillore. Në Vushtri kishte nevojë për 18 shkolla fillore kur për momentin kishte vetëm një të tillë. Në Podujevë nevojiteshin 16 shkolla fillore, ndërkohë që nuk është hapur asnjë shkollë. Shkollat ekzistuese kishte shumë nxënës dhe mësuesit ishin të pamjaftueshëm.⁷ Për të lehtësuar ardhjen e mësuesve nga Shqipëria, vendasit merrnin përsipër t'u siguronin mësuesve banesë dhe ushqim me shpenzimet e tyre, duke ja lënë tërë rogen të paprekur.

Shtrenjtësia e jetesës dhe mungesa e higjienës ishte një tjetër problem i hasur nga Masar Sopot në udhëtimin e tij.

⁵ *Po aty*, fl. 6.

⁶ *Po aty*, fl. 27.

⁷ *Po aty*, fl. 28.

Ndonëse Kosova ishte një vend i begatë sa i përket drithërave, mishit dhe bulmetit, ajo vuante së tepërmi mungesën e kripës, vajgurit, orizit dhe sheqerit. Natyrshëm, mungesat e skajshme ndikonin drejtpërsëdrejti në rritjen e çmimeve dhe padyshim në cilësinë e jetës së qytetarëve. Kështu 1 kg kripë shitej deri në 60 lekë, ndërsa 1 litër vajguri 20 franga shqiptare, 1 kg sheqer 7 franga shqiptare dhe 1 kg oriz 15 lekë.⁸

Kjo gjendje pjesërisht vinte edhe për shkak të mungesës së rrjetit rrugor dhe mjeteve të transportit. Malli i sapo blerë duhet të priste deri në 2 - 3 muaj për të mbërritur në destinacion, ndërsa një udhëtar 3 - 4 ditë për të gjetur një automjet. Ndërkohë çmimet e biletave të udhëtimit ishin të larta. Shkak për këtë ishte edhe shtrenjtësia e benzinës, litri i së cilës shkonte deri në 4 - 5 franga.

Raporti shpreh shqetësim për mungesën e reciprocitetit në shkëmbimin e mallrave midis Kosovës dhe Shqipërisë. Sipas disa kosovarëve “Kosova i ep anës së këtijme të Shqipërisë të tana prodhimet e veta: drithë, grun, gja të gjallë, prodhime bulmetore etj. Tirana asgja. Ajo mundet dhe duhet të përpiqet t’i sigurojë sa më parë popullit kosovar këto pak elemente qi janë të një nevoje kryesore”.⁹ Me të drejtë, arsyetonin ata, zgjidhja e këtij problemi duhej kërkuar në një interesim më i gjallë nga ana e shtetit. Në lidhje me sigurimin e kripës, sheqerit dhe vajgurit, Drejtoria e Rezervave të Shtetit duhej të merrte masa dhe të dërgonte vetë me mjetet e saj, mallrat e mësipërme. Furnizimi i tregut me to do t’i priste hovin edhe valës së madhe të spekulimeve, çka do të rriste thellësisht simpatinë dhe përkrahjen e qeverisë nga populli.

Lëvizja komuniste dhe marrëdhëniet e shqiptarëve të Kosovës me serbët

⁸ *Po aty*, fl. 29.

⁹ *Po aty*, fl. 30.

Lëvizja komuniste në Tokat e Liruar është një tjetër problem i evidentuar në raport. Kjo lëvizje nuk kishte gjetur terren tek shqiptarët e Kosovës dhe për momentin mbështetës të saj ishin sllavët: serbët e malazezët. Ata ishin të organizuar nën komitetet e tyre drejtuese dhe organet që siguronin lidhjet e përditshme midis qendrës dhe qarqeve. Anëtarët e Komitetit Drejtues të serbëve në Prishtinë ishin oficerë aktivë në luftën kundër Fuqive të Boshtit, që kishin zhvilluar veprime të dhunshme ndaj popullsisë shqiptare të Kosovës. Mbanin lidhje me organizatat simotra komuniste dhe paguheshin nga qeveria e Beogradit. Raporti bën me dije se propaganda organizatave komuniste sllave ishte në rritje.

Organizata serbe e Prishtinës kishte gjetur një mjet të fuqishëm dhe tepër të dobishëm për zhvillimin e veprimtarisë së saj, që ishte hekurudha. Nga Preluzha deri në Kaçanik, në shërbimin hekurudhor ishin të punësuar 270 nëpunës, nga të cilët 180 italianë, 88 serbë dhe vetëm 2 shqiptarë. Nëpunësit serbë, konsideroheshin njohës të specializuar të punëve dhe të vendit, dhe si të tillë mbanin funksione drejtuese. Nga ana tjetër, nëpunësit shqiptarë paguheshin më pak dhe ishin gjithnjë të përbuzur nga drejtuesit serbë. Në raport veprimtaria e nëpunësve serbë të hekurudhës konsiderohet si kryekëput politike dhe në të mirë të lëvizjes komuniste.

Disa nga konstatimet e raportit janë¹⁰:

Hekurudha ishte bërë “një strehë shumë e madhe propagande dhe veprimtarie komuniste”. Nëpunësit sllavë merrnin prej organizatave të ndryshme proklamata, broshura, të cilat, nëpërmjet hekurudhës, i përhapnin nëpër qendrat e Kosovës. Ata mbanin edhe kontaktet mes degëve të ndryshme të organizatave serbe brenda kufijve të Shqipërisë dhe jashtë saj, duke marrë dhe sjellë urdhra, dispozita dhe informacione të ndryshme mbi situatën e momentit. Ata kishin si detyrë të vinin në dijeni periodikisht organizatat revolucionare sllave edhe mbi lëvizjen e trupave italo -

¹⁰ *Po aty*, fl. 24-26.

shqiptare dhe gjermane. Informacionet jepeshin edhe për zonën e Mitrovicës ku serbët sërish kishin drejtimin e hekurudhës.

Edhe transportimi i njerëzve të rekrutuar nga organizatat komuniste kryhej nëpërmjet linjës hekurudhore. Në vagonët e mallrave fshehurazi zinin vend të rekrutuarit, të cilët ishin të destinuar për të plotësuar rishtazi çetat komuniste nga humbjet e pësura në luftë me forcat e Boshtit. Në të njëjtën mënyrë kryhej edhe transporti i ushqimit për organizatat revolucionare sllave.

Nëpunësve serbë dhe malazezë kishin në duart e tyre edhe zyrat telegrafike të stacioneve hekurudhore, me anën e të cilave bënin njoftimet e rastit. Nga ana tjetër, ata nuk ia lejonin shqiptarëve përdorimin e këtyre zyrave dhe ia mbanin të fshehtë korrespondencën.

Nëpunësit e hekurudhës ndihmonin lëvizjen komuniste, duke marrë përsipër edhe shkatërrimin e urave. Në momentin që organizatat revolucionare sllave, për nevoja taktike e strategjike të lëvizjes së tyre, vendosnin të hidhnin në erë ndonjë urë, këtë punë e kryenin nëpërmjet nëpunësve sllavë të hekurudhës. Në vende të caktuara përgjatë udhëtimit hekurudhor, ata merrnin minat e destinuar për shkatërrim, të cilat i sillnin pranë urave, pikërisht aty, ku të tjerë aktivistë kryenin shpërthimin. Kjo ishte praktika që ishte përdorur për hedhjen në erë të urës së Sllatinës.

Marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe serbëve në Prishtinë, Mazar Sopot i konsideron të ndera. Shqiptarët e Kosovës i perceptonin serbët si armikun e tyre të përjetshëm. Sipas një banori të Prishtinës: “Tani po e shihni mirë zotni, deri ku ka mbërritë durimi jonë. Kemi pranuar në heshtje dhe me disiplinë shembullorë të durojmë që vrasësit e padrejtë, zbatuesit e kërdive shkatërrimtare mbi vëllezërit, motrat, bijt dhe bijat tona, të gjejnë strehë dhe të gëzojnë jetë të lirë në mesin tonë. Po të duam, të tërë këta katila, i bëjmë pluhur brenda pak orëve. Por kemi pritur dhe

do të presim që drejtësia e qeverisë shqiptare të bëjë detyrën kundrejt tyre”.¹¹

Hebrenjtë në Prishtinë

Një vend të veçantë i ka dhënë në raport M. Sopoti edhe trajtimin të hebrenjve. Ai tregon se në tetor 1941, komanda gjermane në Serbi kishte marrë një varg masash energjike kundër elementit hebre. Masat kishin karakter totalitar dhe përfundimtar, me qëllim që “ta dlireshin njëherë e mirë krejt vendin nga ai element”.¹² Në një situatë të tillë, të tërë hebrenjtë e Serbisë shpejtuan të largoheshin nga vendi me çdo kusht, duke marrë udhët nëpër shtetet e Ballkanit. “Ia dolën të depërtounin ku me të mirë, ku me anë ndërrim emrash, ku ndërrim nënshtetësie, ku me anë të hollash me qëllimin e vetëm kalimin e kufirit” - shprehet Sopot. Deri më 15 nëntor 1941 në Prishtinë kishin mbërritur 150 hebrenj, disa prej tyre së bashku me familjet. Por mënyra sesi ata kishin depërtuan aty ishte krejt e veçantë. Burrat zbrisnin prej automjeteve 2 - 3 km jashtë qytetit, ndërsa familjet e tyre vazhdonin udhëtimin me vetura deri brenda në qytet. Ata vazhdonin udhën në këmbë duke u përzier me turmën e njerëzve, me qëllim që të mos binin në sy. Sipas fjalëve të përhapura në popull, vetëm për pak kilometra me automobil, hebrenjtë kishin paguar shuma marramendëse, që shkonin deri në 45 napolona. Mbasi ishin sistemuar në Prishtinë, kishin filluar të merreshin me tregti. Ndikimi i politikës së Boshtit karshi popullsisë hebreje është i dukshëm në raport, ku nuk i mungojnë etiketime të skajshme karshi kësaj popullsie. Hebrenjtë konsiderohen si “një element ushejzash që do t’i pijnë tharmën e gjakut krejt Kombit shqiptar”, një arsye kjo e qenësishme për Sopotin, që në emër të

¹¹ *Po aty*, fl. 9.

¹² *Po aty*, fl. 13.

shqiptarëve të Kosovës të kërkonte “masa energjike dhe shumë të shpejta kundra instalimit të tyne në vend”.¹³

Çfarë pret Kosova nga qeveria e Mustafa Krujes

Masar Sopot gjendej në Kosovë në një moment ndërrimi qeverish. Më 10 nëntor 1941, Vërlaci largohet si kryeministër dhe emërohet si ministër shteti në Romë. Në fund të nëntorit, u mor vesh se ai do të zëvendësohej nga Mustafa Kruja, i cili e mori zyrtarisht detyrën më 4 dhjetor. Sipas raportit qeveria Kruja ishte pritur me kënaqësi dhe optimizëm dhe kjo për shkak të kryeministrit.¹⁴ Për shqiptarët e Kosovës, Mustafa Kruja përfaqësonte një ndër eksponentët më të shquar të jetës politike, që kishte luftuar gjithmonë për Shqipërinë Etnike. Gjatë gjithë karrierës së tij politike kishte bashkëpunuar ngushtë me nacionalistë të zellshëm prej Kosove si me Hasan Prishtinën, Bajram Currin e Hoxha Kadri Prishtinën. Si deputet kishte qenë gjithnjë i guximshëm për të ngritur zërin në Parlamentin shqiptar në mbrojtje të vëllezërve kosovarë në robëri.

Të larta ishin edhe pritshmëritë e opinionin publik shqiptar të Kosovës, karshi qeverisë së porsaformuar. Ata kërkonin:

Armatimin e gjithë popullsisë shqiptare gjatë vijës së kufirit etnik “të Shqipërisë së vërtetë”, për të qenë në gjendje që në çdo rrethanë të përballonin çdo përpjekje të armiqve, pra të sllavëve.

Krijimin dhe organizimin e një xhandarmërie thjesht shqiptare, e cila do të lehtësonte marrëveshjen mes popullsisë dhe administratës shtetërore. Vetëm kështu do të vendosej qetësia në vend dhe do të plotësoheshin nevojat e popullsisë.

Çarmatimin sa më parë të malazezëve në Pejë, të serbëve në Prishtinë dhe të bullgarëve [kupto: maqedonasve] në Tetovë,

¹³ Po aty, fl. 14.

¹⁴ Po aty, fl. 41.

Gostivar dhe Kërçovë. Dëbimin e shpejtë të të gjithë sllavëve nga të gjitha viset shqiptare sipas shembullit që ishte duke dhënë prefektura e Mitrovicës dhe krahinat e varura prej saj.

Luftë pa kompromis kundër nëpunësve që shpërdoronin autoritetin shtetëror dhe përvetësonin të ardhurat e shtetit. Largimin e të gjithë nëpunësve me një të kaluar të errët dhe korruptive. Emërimin e punonjësve të zotë nga të gjitha viset e Kosovës, me integritet dhe njohës të mirë të zonës. Përpjekje për një shërbim më të mirë ndaj popullsisë dhe shmangien një herë e mirë të sjelljeve të frymëzuara nga një mëri e hapur kundrejt shqiptarëve të Kosovës.

Zgjidhjen përfundimtare të problemit arsimor në Kosovë duke dërguar kudo mësues, sipas nevojave të krahinave.

Sigurimin e qetësisë, e cila në zona të caktuara konsiderohej si e çartur.

Realizmin konkret të vëllazërisë kombëtare pra bashkimit kombëtar.

“Në qoftë se kabineti Kruja do të arrijë të plotësojë dhe të përmbushë plotësisht shpresat që ka mbështetur mbi të populli i Kosovës - shprehej një zotëri prishtinas - z. Kruja do të ketë kryer veprën shpëtimtare të krejt kombit shqiptar dhe të të gjithë Shqipërisë Etnike. Kjo vepër, vazhdonte ai - do të shkruhej me të vërtetë me shkronja të arta në histori të Shqipërisë dhe breznitë e ardhshme, shekuj pas shekujsh do të frymëzoheshin nga kryevepra kombëtare”.¹⁵ Zhvillimet e mëtejshme historike treguan se kryeministri Kruja nuk ia doli.

¹⁵ *Po aty*, fl. 43.

Dr. Sonila BOÇI
(Tiranë)

MINORITETET NË SHQIPËRI PËRBALLË SFIDAVE TË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Lufta e Dytë Botërore solli ndryshime në statusin e minoriteteve. Sistemi i mbrojtjes juridike i krijuar nga Lidhja e Kombeve, *de facto* pushoi së ekzistuari së bashku me këtë organizatë. Fillimi i Luftës së Dytë Botërore prishi *status quo*-në politike të vendosur nga Traktati i Versajës i vitit 1919. Shtetet ballkanike, të cilat kishin mbetur të pakënaqura nga përcaktimi i kufijve në përfundim të Luftës së Parë Botërore, e konsideruan fillimin e luftës së re si mundësi për të ndrequr “padrejtësitë” territoriale dhe etnike. Kjo i dha Luftës së Dytë Botërore në Ballkan, një karakter të shumëfishtë, që studiuesi francez Bernard Lory, me të drejtë, e ka përcaktuar si katër konflikte brenda një lufte¹.

Minoritetet me ose pa dashjen e tyre e gjetën veten të përfshirë në secilin prej këtyre konflikteve. Mbi të gjitha ato u gjendën mes dilemës se cilit prej llojeve të identitetit duhej t’i

¹ Bernard Lory, *Evropa Ballkanike nga 1945 në Ditët e Sotme*, Tiranë: “Dituria”, 2007, f. 18.

jepnin rëndësi: identitetit të tyre kombëtar apo identitetit qytetar. Si pjesë e shkëputur nga trugu i vet kombëtar, minoritetet kombëtare ruanin në ndërgjegje ndjesinë se besnikëria e tyre duhej t'i përkushtohej kombit amë. Nga ana tjetër, kushtetuta e vendit ku jetonin dhe shumë akte ndërkombëtare i detyronin minoritetet të ishin qytetarë luajalë ndaj shtetit nën juridiksionin e të cilit ishin përfshirë.

Pas pushtimit italian, minoriteteve në Shqipëri iu desh të përshtateshin me ndryshimet e ndodhura në planin e brendshëm. Nacionalizmi shqiptar, tradicionalisht mbrojtës, ndryshoi nën presionin e Italisë duke u bërë gjithmonë dhe më irredentist. Përballë kësaj situatë, minoritetet, veçanërisht ai grek, e gjetën veten të mbijetonin midis “shqiptarizmit” të Italisë dhe presionit të vazhdueshëm nationalist që vinte nga shteti amë. Të dyja qasjet nuk ishin lineare. Ato përcaktoheshin në një masë të madhe nga pozicioni i Italisë në konfliktin botëror.

Në periudhën nga prilli deri në shtator 1939, pra para se të fillonte zyrtarisht Lufta e Dytë Botërore, Greqia e papërgatitur për konfliktin dhe e trembur për vijimin e agresionit të Italisë edhe ndaj saj vendosi të kontrollojë mirë situatën dhe të qëndrojë në pritje të zhvillimeve të ardhshme. Madje, ajo u përpoq të shpaloste një politikë “dashamirëse” ndaj Italisë². Më 11 prill 1939, qeveria greke nxitoi ta përshëndeste pushtimin e Shqipërisë, duke shprehur kënaqësinë që tashmë Greqia dhe Italia ndanin dhe kufijtë tokësorë³. Ndryshe nga ç'kishte ndodhur në të kaluarën, Greqia u tregua e kujdesshme në nxitjen e ndjenjave separatiste brenda minoritetit grek.

Nacionalistët shqiptarë menduan të shfrytëzonin pozicionin e ri të marrë nga Greqia, për të zbutur pasojat e propagandës dhe veprimtarisë shumëvjeçare helenizuese në popullsinë e krishterë të

² Beqir Meta, *Tensioni greko-shqiptar 1939-1949*, Tiranë: “GEER”, 2000, f. 47.

³ Vasil Kondis, *Greqia dhe Shqipëria në shekullin e XX*, Selanik: “Paratiritis” 1997, f. 126.

Shqipërisë së Jugut. Ata patën mirëkuptimin, madje dhe nxitjen e administratës italiane të pushtimit. Në fokus të nacionalistëve shqiptarë ishte neutralizimi i instrumenteve që Athina zyrtare kishte përdorur vazhdimisht në propagandën dhe veprimtarinë e saj nacionaliste në dëm të interesave kombëtare shqiptare, siç ishin shkollat të financuara prej saj, kishat, shtypi dhe mjetet e tjera propagandistike. Për këtë qëllim, nga qeveria shqiptare nën pushtim u përdorën mjete financiare, administrative dhe konsulta të vazhdueshme me personalitete me autoritet në Shqipërinë e Jugut.

Shpallja e Italisë si shtet jo ndërluftues në konfliktin botëror⁴ (shtator 1939), largoi disi frikën e Greqisë për një sulm të menjëhershëm italian ndaj saj. Në të njëjtën kohë, i shtoi shpresat greke se historia mund të përsëritej. Një marrëveshje e ngjashme me Traktatin e Fshtë të Londrës të vitit 1915, për ndarjen e territoreve shqiptare, do të ishte një shans i lakmueshëm. Diplomacia greke iu vu punës për arritjen e një qëllimi të tillë. Fillimisht, ajo u përpoq t'i tregonte Italisë se dëshironte të mbante marrëdhënie miqësore me të, duke qetësuar kështu situatën në kufirin e saj verior. Këtë situatë të qetë, Greqia e përdori për t'iu rikthyer synimeve të saj nacionaliste afatgjata.

Për këtë Greqia përdori përsëri shkollat në gjuhën greke në Shqipëri dhe arsimimin e fëmijëve minoritarë në Greqi. Por,

⁴ Më 21 maj 1939 Italia ishte pranuar të nënshkruante Paktin e Çelikut me Gjermaninë, por ia kishte bërë të qartë kësaj të fundit se nuk ishte ende për t'u angazhuar në veprimet luftarake. Italia i kishte deklaruar Gjermanisë se, në rast se Anglia dhe Franca hyjnë në luftë përkrah Polonisë, ajo do të shpallte mospjesëmarrjen në të, deri sa të ishte e përgatitur për të hyrë në luftë. Më 1 shtator 1939, kur Gjermania sulmoi Poloninë, Anglia dhe Franca menjëherë i shpallën luftë asaj. Më 5 shtator 1939, duke u mbështetur në këtë marrëveshje, Musolini shpalli mospjesëmarrjen (nonbelligeranza) e Italisë në konfliktin që sapo kishte nisur.

tashmë, nuk ishte vetëm zona e banuar nga minoritarët grekë në fokus të politikës së Athinës. Duke qenë se territori i pretenduar nga Greqia e kalonte disa herë territorin ku jetonte minoriteti grek, synimi i saj ishte të krijonte turbullira në rajonet e tjera të Shqipërisë së Jugut. Në vëmendjen e agjentëve grekë, si dhe më parë, ishte Himara. Ata përhapnin në popull parulla se nga muaji shkurt 1940, “do të vijë Greqia deri në Llogara tue pjestue Shqipërinë [midis Italisë dhe Greqisë]”⁵. Nëse ka pasur ndonjë gjë të vërtetë në këto parulla të lëshuara në këtë kohë, kjo është ende një çështje e diskutueshme. Pavarësisht kësaj, dokumentohet tregojnë qartë se në disa krahina të Shqipërisë së Jugut, kjo propagandë pati rezultat nxitjen e nacionalizmit të popullsisë grekofone.

Pranvera e vitit 1940 shkatërroi çdo iluzion të Greqisë për ndonjë marrëveshje të mundshme me Italinë. Gjithmonë e më shumë po kuptohej se ajo po përgatitej seriozisht të hynte në Luftë. Lajtmotivi i ditës i pushtuesve italianë dhe bashkëpunëtorëve të tyre ishte realizimi i ëndrrës për bashkim kombëtar të shqiptarëve dhe rregullimi i të gjitha padrejtësive të bëra ndaj tyre. Shenjat e para të kësaj fushate u dukën që në mars të vitit 1940. Në fillim të marsit, nënsekretari i Partisë Fashiste Shqiptare (PFSH), Kol Bibë Mirakaj zhvilloi një tur në disa qytete të jugut të Shqipërisë, midis të tjerave dhe në krahinat e Gjirokastrës dhe Sarandës. Në mitingjet e organizuara me këtë rast, autoritetet lokale dhe i dërguari i PFSH-së, u përpoqën të evokonin shqiptarizmin e shqiptarëve dhe faktin se, sipas tyre, vetëm nën regjimin fashist, ai ishte i mbrojtur. Në fjalimin e tij në Gjirokastrë, z. Mirakaj nuk la pa përmendur rastet kur Italia kishte shpëtuar këtë rajon nga aneksimi i Greqisë. Ai u përmendi gjirokastritëve vendimin e 3 qershorit 1916 që njihte pavarësinë e

⁵ *Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë* (me tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) Ministria e Brendshme, Viti (më tej: V.) 1940, Dosja (më tej: D.) 13, Fleta (më tej: fl.) 5, Relacioni i Faik Qukut për Ministrinë e Brendshme.

Shqipërisë⁶, si dhe veprimtarinë dhe sakrificën e gjeneral Telinit për të shpëtuar këtë krahinë nga trupëzimi me shtetin grek⁷. Kol Bibë Mirakaj vizitoi dhe fshatra të jugut, të banuara nga minoritarë grekë, si: Dervicanin, Finiqin, Kranenë, Ymerefendinë, Vurgun etj., në të cilat, të paktën në pasqyrimin që u bëri atyre shtypi i kohës, nuk u bë asnjë dallim etnik. Në të gjitha mitingjet e organizuara në këto fshatra u valëvitën flamujt italianë dhe shqiptarë dhe u fol në emër të shqiptarizmit⁸. Të krijohet përshtypja se autoritetet e pushtimit e “kishin harruar” ekzistencën e minoritetit grek në Shqipëri, dhe vëmendja ishte përqendruar te “mbrojtja e çështjes shqiptare nën suazën e Dinastisë Savoja”.

Me shtimin e vrullit të përgatitjeve për fushatën ushtarake italiane kundër Greqisë minoritetet u vendosën sërish në qendër të vëmendjes, por me një zhvendosje në hapësirë. Athina e vendosur nën një presion sa diplomatik, aq edhe ushtarak dhe propagandistik, nuk mund të mendonte më, për të nxitur irredentizmin grek midis ortodoksëve të Jugut dhe minoritetit grek brenda kufirit shqiptar. Vëmendja e qeverisë greke ishte të rregullonte situatën e saj të brendshme. Popullsia shqiptare që jetonte në Çamëri filloi kështu të ishte në qendër të një situatë, të cilën nuk e kishte krijuar ajo, por që po vuante pasojat. Ajo u vu në shënjestër të qarqeve qeveritare greke, të cilat ndërmorën një varg masash të ashpra për spastrimin e atdhetarëve çamë⁹. Edhe pushtuesit italianë kishin nevojë për të siguruar prapavijat e tyre. Duke vlerësuar se një pjesë e minoritarëve grekë mund të

⁶ Është fjala për Protokollin e Gjirokastrës të 3 qershorit 1916, sipas të cilit Italia njihte pavarësinë e Shqipërisë nën egjiden e Perandorisë Italiane.

⁷ *Gazeta Tomori*, 8 mars 1940.

⁸ *Po aty*, 9 mars 1940.

⁹ Për më tepër në lidhje me trajtimin e çamëve në këtë periudhë nga politika greke shih: B. Meta, *Tensioni ...*, f. 146-147; si dhe Hajredin Isufi, *Musa Demi dhe Qëndresa Çame 1800-1947*, Tiranë: “Dudaj”, 2002, f. 221-224.

shërbenin si “kolonë e pestë” ndaj ushtrisë italiane në Shqipëri, ata morën masa për t’i internuar disa nga krerët nacionalistë të minoritetit grek. Procesi u mbështet ligjërisht nga një dekret i ri “Për internimin e personave të dyshimtë”¹⁰, i cili u miratua pikërisht në atë kohë. Ai do të qëndronte në fuqi gjatë gjithë pushtimit italian dhe do të përdorej si ndaj shqiptarëve dhe minoritarëve.

Lufta italo - greke e cila u zhvillua kryesisht në Shqipërinë e Jugut, ndikoi negativisht në ekuilibrin e brishtë etnik të rajonit, ekuilibër ky i vendosur me shumë kujdes nga administrata shtetërore shqiptare në periudhën midis dy luftërave. Edhe pse sjelljet e ushtrisë greke nuk shënuan episodet e dhunshme të viteve 1912 - 1914, përsëri politika me dy standarde e Greqisë zgjoi divergjencat e fjetura të rajonit. Në krahinat e banuara nga minoritarë apo ato me popullsi të përzier, autoritetet ushtarake greke ndoqën politikën e nxitjes së armiqësive etnike, madje nuk munguan dhe episodet e dhunshme. Nasho Vllaho dhe Kristo Qerici, dy minoritarë nga Delvina, të ndihmuar edhe nga ushtarët grekë ishin shumë aktivë në këtë drejtim. Kështu, në gjithë zonën e Delvinës u dogjën flamujt shqiptarë dhe italianë¹¹. Gjithashtu, ushtarët grekë vranë disa patriotë të njohur të kësaj zone së bashku me familjen e tyre¹². Situata e krijuar gjatë luftës italo - greke, do të përdorej më vonë nga italianët për të rikrijuar konflikte të tjera etnike, por, që për fat, falë dhe ndërhyrjes së autoriteteve shqiptare, siç ishte p.sh. rasti i Faik Qukur, prefektit të Gjirokastrës, asnjëherë nuk morën përmasa të mëdha¹³.

¹⁰ Thoma Jani Karamelo, *Marrëdhëniet shqiptaro-greke*, Tiranë: “Albtipografia”, 2008, f. 51.

¹¹ *Po aty*.

¹² Faik Quku, *Qëndresa Shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore 1939-1944*, Vëll. 2, Tiranë: “Ilar”, 2006, f. 70.

¹³ Sipas kujtimeve të prefektit të atëhershëm të Gjirokastrës, Faik Quku, ndiheshin ndasitë midis myslimanëve dhe të krishterëve, si dhe ato midis minoritarëve grekë dhe popullsisë shqiptare. Kështu, në Delvinë disa shqiptarë të besimit mysliman

Sulmi i Gjermanisë në rajonin e Ballkanit, më 6 prill 1941, e shpëtoi Italinë nga disfata e plotë në frontin grek dhe çoi në një riformatim të ri politik të Gadishullit. Më 20 - 21 prill 1941, ministrat e Jashtëm të Gjermanisë dhe Italisë, Ribentrop dhe konti Çiano, u takuan në Vjenë për të ndarë territoret e pushtuara në Ballkan, marrëveshje e cila zgjeroi territorialisht shtetin shqiptar, pothuajse në kufijtë etnikë¹⁴. Rritja e sipërfaqes së shtetit shqiptar çoi në ndryshimin e numrit të minoriteteve që jetonin në të. Numri i minoritetit grek nuk pësoi ndonjë ndryshim. Minoritetet sllave patën një rritje në numër, pasi minoritetit malazez dhe atij bullgar/maqedonas, iu shtua dhe minoriteti serb që jetonte në territoret shqiptare të Kosovës, si dhe ai maqedonas i krahinave lindore shqiptare.

Gjithashtu, ndryshoi dhe harta politike e shteteve fqinje me Shqipërinë. Shqipëria vetë e pushtuar, kufizohej nga formacione të reja juridike - kushtetuese të pushtuara nga gjermanët në veri e jug dhe nga bullgarët në lindje. Kufizimi me Bullgarinë, një nga

kishin formuar një organizatë të quajtur “Dora e Zezë”, por për veprimtarinë e saj ka pak të dhëna. Duket se ajo ishte krijuar si kundërpërgjigje ndaj përndjekjeve dhe vrasjeve të kryera nga ushtria greke në bashkëpunim me elementë nacionaliste minoritarë gjatë Luftës Italo-Greke. Qëllimi i saj ishte të eliminonte krerët grekë apo grekomanë të zonës. Në pranverë të vitit 1942, organizata kishte kryer dhe disa atentate dhe kishte vrarë disa nga krerët nacionalistë të minoritetit grek, midis të cilëve dy tregtarë Thoma Lazen dhe Miho Qiricin.

¹⁴ Në bazë të Marrëveshjes së Vjenës të 21-22 prillit 1941, Kosova u nda në tri zona: italiane, gjermane dhe bullgare. Zona italiane e pushtimit ishte më e gjera. Ajo përfshiu pjesën më të madhe të Kosovës, si dhe viset shqiptare të Malit të Zi, si dhe Tetovën, Dibrën, Kërçovën e Strugën që sot janë në përbërje të Maqedonisë. Pra, Hitleri si arkitekt i vërtet i hartës së Ballkanit, pjesën më të madhe të trojeve shqiptare ia dha Italisë dhe kjo e fundit ia bashkoi administratës së Tiranës. Më 29 qershor 1941, Musolini krijoi me një dekret të posaçëm Komisariatin e Lartë Civil për Kosovën, Dibrën e Strugën, për drejtimin e të cilit u ngarkuar Fejzi Alizoti. Më 12 gusht 1941, me një dekret mbretëror, këto territore iu bashkuan Shqipërisë së krijuar, në Londër në vitin 1913.

shtetet ballkanike përkrahëse të Boshtit në Lindje, rihapi çështjen maqedonase¹⁵. E si pasojë, ridoli në sipërfaqe diskutimi mbi përkatësinë etnike dhe identitetit kombëtar të minoritetit sllavo - maqedonas që jetonte në fshatrat e Prespës dhe popullsisë sllavishtfolëse të krahinës së Gollobordës.

Bullgaria ishte e pakënaqur me territoret që i akordoi asaj Marrëveshja e Vjenës. Ajo zgjeroi dukshëm territorin, por e frymëzuar nga ideja e Bullgarisë së Madhe, kërkoi që vija e demarkacionit italo - bullgar të arrinte në liqenet e Ohrit dhe të Prespës. Një sërë polemikash u shkëmbyen ndërmjet Bullgarisë dhe Italisë në lidhje me ravijëzimin e kufirit për territoret shqiptare të kontrolluara nga italianët dhe ato shqiptaro - maqedonase, të kontrolluara nga bullgarët¹⁶. Mosmarrëveshjet italo - bullgare ishin në thelb konflikte territoriale. E, kur territoret janë në diskutim, popullsia e tyre, veçanërisht ajo minoritare shndërrohen në “pataten e nxehtë” të situatës. Pikërisht për këtë arsye, minoritetet kanë pasur një vend të rëndësishëm në politikën bullgare gjatë Luftës së Dytë Botërore. Brenda Ministrisë së Jashtme të Bullgarisë u krijua një drejtori e posaçme që do të merrej si me minoritetet e huaja që i ishin bashkuar shtetit bullgar, ashtu dhe me minoritetin bullgar pjesë e shteteve të tjera¹⁷.

¹⁵ Gjatë prillit 1941, territoret maqedonase, pjesë të Serbisë dhe të Greqisë, u pushtuan nga ushtria bullgare dhe u vunë nën administratën bullgare të pushtimit. Ato u deklaruan si territore bullgare, të banuara nga popullsi etnikisht bullgare. Në vijim të bindjes së tyre për mosekzistencën e kombit maqedonas Sofja zyrtare filloi një proces “bullgarizimi” të dhunshëm mbi popullsinë e territoreve të pushtuara. Për më tepër për administrimin bullgar të territoreve maqedonase dhe greke shih: Misha Glenny, *Histori e Ballkanit, 1804-1999, nacionalizmi, luftërat dhe Fuqitë e Mëdha*, Instituti i Dialogut dhe i Komunikimit, Tiranë: Botimet “Toena”, 2007, f. 509-511.

¹⁶ Çështja e kufirit lindor mes Italisë dhe Bullgarisë mbeti e pazgjidhur deri në maj të vitit 1943. Për më tepër mbi këtë çështje shih: Sonila Boçi, “Përplasjet italo-bullgare gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe çështja e minoriteteve”, në: *Kumtesat (I) (përmbledhje kumtesash nga Java e Shkencës)*, Prishtinë: 2013, f. 475-480.

¹⁷ *Archivio Storico e Diplomatico del Ministero Degli Affari Esteri* (më tej:

Bullgaria u përball me çështjen e minoriteteve duke përdorur metodat tradicionale ballkanike. Përballja kishte dy kahe: nga njëra anë manifestonte sjellje brutale ndaj minoriteteve në territoret që ishin bërë rishtazi pjesë e shtetit bullgar, midis të tjerave dhe ai shqiptar; nga ana tjetër, ngrinte pretendime për persekutim të minoritetit bullgar [ku përshihej dhe minoriteti maqedonas në Shqipëri] nga autoritetet shqiptare dhe italiane, pretendime të cilat, kohë pas kohë, u bënë shkak për kontradikta jo të vogla ndërmjet administratës italiane dhe asaj bullgare.

Sfida e minoriteteve gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte vendosja e një raporti të drejtë me grupet e rezistencës. Pavarësisht në cilin shtet jetojnë minoritetet, ëndërrojnë për bashkimin me shtetin amë. Në këtë fokus, sfida më e vështirë për minoritetet gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte sigurisht zgjidhja e çështjes së tyre kombëtare dhe nga kjo buronte dhe dilema e tyre më e madhe. A duhet të përfshiheshin minoritetet në politikën e Boshtit dhe të bëheshin pjesë e miklimeve nacionaliste të tij, apo të përqafojnë idenë e Aleatëve të Kombeve të Bashkuara për rezistencën kundër Fuqive të Boshtit si e vetmja mënyrë për të fituar të drejtën e vetëvendosjes, një propagandë kjo shumë e përhapur gjatë LIIB.

Sërish minoriteti grek si minoriteti më i madh në Shqipëri mori rëndësi parësore. Grupet e rezistencës në Shqipëri dhe Greqi bënë përpjekje për ta afruar në krahun e tyre minoritetin grek. Ata pretendonin se përfshirja e tij në rezistencë ishte një nevojë ushtarake, por, më në të vërtetë prevalonte interesi politik. Për grupet e rezistencës shqiptare, anëtarët e minoritetit grek ishin shtetas shqiptarë. Për forcat greke, veçanërisht ato të djathta,

rezistenca e minoritetit grek pretendohej të përdorej si parakusht për sigurimin e së drejtës së vetëvendosjes të minoritetit dhe të

mbështetjes së ardhshme nga Aleatët për pretendimet greke ndaj të ashtuquajturit “Epir të Veriut”. Në maj të vitit 1942, pothuajse në të njëjtën kohë me krijimin e formacioneve ushtarake të EDES-it në Greqi, u bënë përpjekjet e para në zonën e minoritetit grek për ngritjen e njërive të rezistencës kundër pushtuesit italian. Dy oficerë të ushtrisë greke, me prejardhje nga fshati Leshnicë e Poshtme e Delvinës¹⁸, Spiridhon Lito dhe Jani Videli, u përpoqën të krijojnë në to një çetë të ashtuquajtur të rezistencës “vorio epirote”¹⁹. Nuk ka të dhëna që çeta të ketë pasur ndonjë aktivitet gjatë vitit 1942 dhe në vazhdim. Ka shumë mundësi të jetë shpërndarë. Në janar të vitit 1944 njëri nga themeluesit e saj, Spirodon Lito, u vra në afërsi të Prevezës, duke luftuar kundër gjermanëve në formacionet e EDES-it²⁰.

Përpjekjet për të organizuar rezistencën në minoritetin grek, si dhe për ta shtrirë atë në gjithë zonën e “vijës Venizelos”, vazhduan dhe më vonë. Në korrik të vitit 1942, nga një komision i përbërë prej minoritarësh grekë u krijua një organizatë e quajtur “Fronti i Çlirimit të Vorio Epirit” (MAVI)²¹. Midis themeluesve dallohen disa elemente greke që ishin mjaft aktivë në organizimin e lëvizjes vorio - epirote edhe gjatë periudhës midis dy Luftërave, si Vasil Shahini, Mihal Mano, Çavo Kokali²², etj. Qëllimi i kësaj organizate ishte të vihej në krye të rezistencës “greke” kundër pushtuesit italian në të ashtuquajturin Epir i Veriut. MAVI-a ishte e lidhur me shtabin e EDES-it dhe vepronte nën urdhrat e tij. Ajo

¹⁸ Leshnica e Poshtme është fshat i Sarandës, ku jeton popullsi me kombësi greke.

¹⁹ Pyrrhus Ruches, *Albania's Captives (Chicago Essays on World History and Politics)*, Chicago: Argonaut, Inc., Publisher, 1965, f. 156.

²⁰ *Po aty*.

²¹ Σπυρίδων Πλουμίδης, “Το βορειοηπειρωτικό ζήτημα στα πλαίσια της βρετανικής πολιτικής και των ελληνοαλβανικών σχέσεων την περίοδο της ιταλογερμανικής κατοχής (1941-1944)”, [Spiridon Plumidis “Problemi vorioepirot në kuadrin e politikës britanike dhe marrëdhënieve greko-shqiptare në periudhën e pushtimit italo-gjerman (1941-1944)”, në: *Ιστορ*, 13 (2002), f. 96.

²² K. Dervishi, *Shërbimi sekret shqiptar, historia nga fillimi deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore*, Tiranë: “55”, 2007, f. 166.

u përpoq të shtrinte ndikimin e saj në të gjithë zonën e pretenduar nga qeveria greke, por pa ndonjë rezultat.

Si çeta e krijuar nga Spiridon Lito dhe Jani Vedeli, ashtu dhe MAVI-a, dështuan në projektin për të shtrirë veprimtarinë e tyre përtej zonës ku minoriteti grek jetonte me shumicë. Drejtuesit dhe anëtarët e organizatave të sipërpërmendura e kishin prejardhjen nga zona të Shqipërisë së Jugut, ku banonte minoriteti grek. Madje, mbështetja e MAVI-së dhe në zonën e minoritetit grek nuk ishte e plotë, për shkak të ndikimit të krahut tjetër të rezistencës greke, EAM-it, si dhe të së majtës shqiptare. MAVI-a dhe EDES-i patën mbështetje në disa fshatra me popullsi minoritare si: Dhrovjan, Rrëza e Zezë, Pogoni, Leshnicat etj., ku propaganda greke dhe në periudhën midis dy Luftërave kishte qenë më e fuqishme. MAVI-a nuk arriti të krijonte formacione të armatosura e të qëndrueshme në asnjë nga zonat e pretenduara.

Sipas studiuesit britanik, James Pettiferit, një “meritë” në dështimin e MAVI-së dhe EDES-it për tërheqjen e minoritetit grek në radhët e tyre kishin komunistët grekë dhe ata shqiptarë. Ata “mundën të ndalonin kontaktet midis minoritetit grek dhe andartëve të djathtë grek të Napoleon Zervasit²³ të Epirit të Jugut, i cili kërkonte t’ia bashkëngjiste Epirin e Veriut, Greqisë”²⁴. Rolin

e komunistëve shqiptarë për të penguar planet e Napoleon Zervasit në Shqipërinë e Jugut e pranon dhe studiuesi grek Spiridon

²³ Napolon Zervas (Ναπολέον Ζέρβας 1881-1956), gjeneral grek me prejardhje shqiptare. Ai u përjashtua nga ushtria greke për shkak të pjesëmarrjes në grushtin e shtetit të vitit 1926. Gjatë Luftës së Dytë Botërore organizoi grupimin e djathtë të rezistencës greke EDES. Në shtator 1944 forcat ushtarake të drejtuara prej tij ndërmorën masakrat kundër popullsisë çame në Greqi, gjë që çoi në largimin e dhunshëm të saj nga trojet e veta. Për më tepër shih: Ibrahim N. Hoxha, “Zerva Napoleon”, në: *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, botim i Akademisë së Shkencave, Vëll. III, Tiranë 2009, f. 2987-2988.

²⁴ James Pettifer “The Greek minority in Albania in the aftermath of communism”, në *The South Slav Journal* vol. 22, Autumn-Winter, f. 17.

Plumidis, por ai mendon se faktorët përcaktues për dështimin e Zervës në të ashtuquajturin “Epir të Veriut” janë dhe politika penguese e britanikëve dhe angazhimi i EDES-it në luftën civile që shpërtheu në Greqi²⁵.

Në të vërtetë, FNÇ u tregua shumë mendjehapur për afrimin e minoritetit grek. Sipas përcaktimit të studiuesit të mirënjohur anglez, Erik Hobsbaum, Lufta e Dytë Botërore ishte jo vetëm një luftë frontale e armatosur ndërmjet forcave ushtarake të dy blloqeve kundërshtarë, por edhe një luftë civile - ideologjike me karakter ndërkombëtar²⁶. Një karakter i tillë i Luftës ndryshoi në një farë mase dhe karakterin e nacionalizmit. Duke qenë se shtetet pushtuese mbështeteshin në ideologjinë fashiste, lufta për çlirim kombëtar, veçanërisht pas hyrjes në Luftë të BRSS-së, mori edhe karakter ideologjik antifashist²⁷. Kështu lindi një nacionalizëm antifashist, bartësit e të cilit u bënë komunistët. Duke propaganduar luftën antifashiste dhe jo nacionalçlirimtare në zonat minoritare, gjë që e la në një fare mënyrë të hapur çështjen kombëtare të minoritetit, FNÇ arriti të depërtojë më lehtë te kjo popullsi.

Nga ana tjetër, bashkëpunimi intensiv mes EAM-it dhe FNÇ ishte një tjetër faktor për suksesin. Në vjeshtë të vitit 1943, të PKSH dhe PKG vendosën të bashkërendonin veprimet dhe të dërgonin përfaqësues të tyre për të punuar me minoritetet respektive. Përfaqësues të EAM-it u dërguan në zonat ku jetonte minoriteti grek në Shqipëri, ndërkohë që FNÇ dërgoi përfaqësuesit e vet në krahinat shqiptare të Çamërisë. Këta përfaqësues do të vepronin në kuadër të Shtabeve të Përgjithshme të vendeve përkatëse: kështu përfaqësuesit greke do të udhëzoheshin nga shtabi shqiptar dhe ata shqiptarë nga ai grek. Kjo lëvizje solli si

²⁵ Σ. Πλουμίδης, “Το βορειοηπειρωτικό ...”, f. 98.

²⁶ E. Hobsbaum, *Kombi dhe nacionalizmi që nga 1870-a: programi, miti, realiteti*, Tiranë: “Toena” & Fondacioni Soros, 1996, f. 146.

²⁷ *Po aty*.

rezultat përfshirjen e minoriteteve shqiptare e greke në rezistencën kundër pushtuesit.

Bashkëpunimi pati ulje - ngritjet dhe mund të kishte edhe pasoja për integritetin territorial të Shqipërisë. Në shkurt të vitit 1944, nën presionin britanik, EAM-i dhe EDES-i në Greqi u detyruan të nënshkruajnë një marrëveshje bashkëpunimi. EAM-i, nën presionin e opinionit publik grek, u detyrua të përfshijë në programin e tij çështjen e kufijve²⁸. Këto ngjarje patën reflektim të menjëhershëm në rezistencën e minoritetit grek. EDES-i dhe EAM-i u bënë thirrje përkrasësve të tyre në minoritet që “të bashkoheshin me partinë më të fortë dhe të mos luftonin”²⁹. Ndryshimi i politikës së EAM-it solli si rezultat të menjëhershëm kërkesën që shtabi miks i krijuar për minoritetin, të zëvendësohej me një shtab plotësisht minoritar, që vepronte i pavarur. Duke përfituar nga konfuzioni që krijoi operacioni i pushtuesve dhe mungesa e vëmendjes së shtabit shqiptar të Zonës I Operative, të dërguarit e EAM-it për të organizuar rezistencën e minoritetit grek, krijuan një situatë të rrezikshme. Komiteti qarkor i qarkut të Gjirokastrës ankohej për veprimtarinë e të dërguarit të PKG-së, Aleks Janjarit në krahinat minoritare. Ata theksonin se ai punonte “në formë bajraktarllëku” dhe se e kishte bërë minoritetin t’i drejtonte sytë nga Greqia.

Peço Kagjini, anëtar i komitetit qarkor të Gjirokastrës, shprehte shqetësimin se veprimtaria e përfaqësuesve të EAM-it kishte bërë që minoriteti grek të kërkonte bashkim me Greqinë. Në

një miting në krahinën e Dhrovjanit, “u ngrit një dhe tha se ne pranojmë të jemi në një Greqi qoftë komuniste, qoftë djalliste, por

²⁸ *AIH*, koleksion i dokumenteve britanike, A-V-159, Studim i Departamentit të Kërkimeve të Forin Ofis (Foreign Office), 30 qershor 1944.

²⁹ *AQSH*, F. 14/AP, V. 1944, D. 115, fl. 3, Letër e komitetit qarkor të Gjirokastrës për KQ të PKSH-në, 23 mars 1944.

vetëm në Greqi të jemi”³⁰. Kjo politikë e re shkëputëse dhe pritëse e emisarëve të EAM-it kishte shkaktuar pasivitet në rezistencën e minoritetit grek. Koço Tashko, i dërguari i KQ të PKSh-së në Zonën I Operative, ngrinte me forcë shqetësimin se gjatë dimrit 1943 - 1944, formacionet ushtarake të minoritetit jo vetëm nuk luftonin kundër pushtuesit, por dhe ishin “bërë barrë në kurriz të popullsisë së thjeshtë”³¹. Koço Tashko, krahas veprimtarisë së emisarëve të EAM-it, ngarkonte me përgjegjësi dhe shtabin shqiptar, i cili “nuk ishte interesuar për të [batalionin Thanas Ziko]”³². Pasi Koço Tashko ia kishte raportuar çështjen Bedri Spahiut, komandantit të Zonës I Operative, ai shkarkoi anëtarët e shtabit të batalionit Thanas Ziko dhe e bashkoi atë me batalionin shqiptar Thoma Lulo.

Më 2 prill 1944, Enver Hoxha i shqetësuar nga gjendja në minoritetin grek i dërgoi një letër PKG-së. Ai mendonte se kishte ardhur koha që të bëhej një takim ndërmjet përfaqësuesve të dy partive. Sipas E. Hoxhës takimi ishte i “nevojshëm dhe urgjent për të diskutuar mbi çështje të ndryshme që na përkasin dhe sidomos çështjen e minoriteteve”³³. Enver Hoxha kërkoi të dërgohen njerëz të cilët të punojnë për “vëllazërimin e popujve tanë” dhe pranoi që ishin bërë gabime si “nga shokët tanë, ashtu dhe nga shokët grekë që punonin së bashku me minoritetin grek në Shqipëri”³⁴. Duke pasur frikë se marrëveshja midis EAM-it dhe EDES-it mund të shkaktonte ndërhyrjen e kësaj të fundit në zonën e minoritetit, PKSH-ja u shpreh fare qartë se nuk do të lejonte që marrëveshja e bashkëpunimit midis EAM-it dhe EDES-it të shtrihej dhe në

³⁰ *Po aty*, F. 14/AP strukturë, V. 1944, D. 115, fl. 10, Letër e komitetit qarkor të Gjirokastrës për KQ të PKSH-së, 14 maj 1944.

³¹ *Po aty*, F. 14/AP, V. 1944, D. 94, fl. 1, Raport i Koço Tashkos për Enver Hoxhën, mbi punën në qarkun e Gjirokastrës, 14 shtator 1944.

³² *Po aty*.

³³ E. Hoxha, *Dy popuj miq*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1985, f. 18.

³⁴ *Po aty*.

minoritetin grek³⁵. Pas kësaj, PKG-ja tërhoqi Aleks Janjarin nga zona e minoritetit dhe dërgoi përfaqësues të tjerë për të ndihmuar në organizimin e rezistencës në këtë zonë. Gjithashtu, u dërguan dy oficerë të EAM-it për batalionin “Thanas Ziko”³⁶, që vazhdonte të ruante mëvetësinë e tij në bashkimin që kishte bërë me batalionin “Thoma Lulo”.

Pavarësisht vështirësive dhe problematikave, minoritetet në Shqipëri, veçanërisht ai grek duke u përfshirë në rezistencën kundër pushtuesve përkrah Lëvizjes Nacionalçlirimtare krijuan kushtet e nevojshme për të promovuar bashkëjetesën dhe marrëdhëniet e mira me popullin shqiptar. Kjo, gjithashtu, u bë një themel i shëndoshë mbi të cilat u ngritën edhe politikat e mëvonshme të shtetit komunist shqiptar ndaj minoriteteve.

³⁵ *Po aty*.

³⁶ *Arkivi i Institutit të Historisë (më tej: AIH), A-VIII-80, Komunikatë e FNÇ-së për qarkun e Gjirokastrës, 24 korrik 1943.*

Prof.dr. Muhamet SHATRI
(Prishtinë)

ÇLIRIM APO RIPUSHTIM JUGOSLLAV I KOSOVËS DHE TROJEVE TË TJERA ETNIKE MË 1944

Lufta e Dytë Botërore krijoi kushte të reja gjeopolitike në Ballkan dhe në trojet etnike shqiptare. Gjatë kësaj lufte Kosova dhe trojet e tjera etnike shqiptare u pushtuan nga Italia, Gjermania dhe Bullgaria dhe u ndanë ndërmjet tyre. Në bisedimet rreth ndarjes u theksua se kriter themelor për përcaktimin e kufijve të rinj, do të ishte përkatësia kombëtare e popullsisë, kriter i shkelur shumë nga Fuqitë e Mëdha gjatë caktimit të kufijve të Shqipërisë më 1913.¹

Për Kosovën dhe trevat e tjera etnike bashkimi me Shqipërinë, edhe pse jo i plotë, ishte shembull i bashkimit kombëtar, që u krye në rrethanat e konfliktit botëror. Copëtimi i Jugosllavisë bëri të mundur që shqiptarët e pjesës më të madhe të Kosovës dhe trevave të tjera të përfitonin për të realizuar ëndrrën e tyre për bashkimin kombëtar. Veprimtaria që zhvilluan ata për ta materializuar e konkretizuar këtë bashkim ishte e njohur dhe e

¹ Me gjerësisht *Dokumente britanike për çështjen shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër 1912-1913*, përgatitja dhe redaktimi Muhamet Shatri, botim i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë, 2012.

zakonshme. Por, ajo që e vinte në dyshim këtë realitet ishte fakti se bashkimi i trojeve u realizua me dhunë dhe nga shtetet e bllokut fashist, ndërsa pjesëtarët e Aleancës antifashiste u shprehën në parim kundër këtyre ndryshimeve territoriale. Aspirata e popullit shqiptar për bashkim kombëtar u realizua në periudhën e luftës, në rrethana që nuk u krijuan dhe nuk u përcaktuan prej shqiptarëve. Duke konfirmuar këtë të vërtetë studiuesi P. Moulton shkruante se "është ironi e fatit që në këtë kënd të errët të Evropës, vetëm fashizmi ndreqi atë që ishte dhe vazhdoi të jetë padrejtësi".²

Pozita e shqiptarëve, por edhe të etnikumeve të tjera që jetonin në Kosovë, në zonat pushtuese ishte e ndryshme, varësisht nga qëndrimet që historikisht kishin formuar italianët, gjermanët dhe bullgarët ndaj shqiptarëve. E gjithë kjo shoqërohej me luftën për territore dhe mbizotërim në zonat e pushtuara në mes shqiptarëve në njërën anë dhe serbëve e malaziasve në anën tjetër. Për shqiptarët s'do mend gjendja dhe pozita më e mirë ishte në zonën italiane të pushtimit, ndërsa më pak në atë gjermane, sepse atje rreziku nga çetnikët ishte më i madh, ndërsa në zonën bullgare shqiptarët rrezikoheshin, veç çetnikëve, edhe nga vetë pushtuesit bullgarë, të cilët herë pas here organizonin veprime gjenocidiale.³

Shqipëria, ndonëse e pushtuar nga Italia, ishte një mburojë e qenies etnike shqiptare dhe një mundësi për rigjallërimin e aspiratave kombëtare dhe kohezionin mbarëshqiptar. Nuk duhet harruar se në Kosovë dhe viset e tjera nuk ishte parë flamuri kombëtar që nga kapitullimi Austro - Hungarisë më 1918 dhe në disa qytete si Mitrovica, Prizreni, Shkupi etj., flitej me të madhe gjuha turke. Dhuna dhe terrori i Mbretërisë së Jugosllavisë

² Moulton Mayer, "Albanian Irredentism", The New Leader, 6 august 1962.

³ Adem Murati, *Ramadan Agushi 1919-1991*, Prishtinë, 2003, f. 66-67; Ramadan Asllani, *Hasan Remniku, luftëtar për etninë shqiptare*, Prishtinë, 2011, f. 68.

detyruan që të shpërnguleshin me qindra mijëra shqiptarë, kurse ata që mbetën në vend jetonin në skamje e mjerim dhe të ekspozuar ndaj asimilimit dhe asgjësimit fizik.⁴

Krahu i djathtë atdhetar i Lëvizjes Kombëtare që nga fillimi i luftës përpiloi platformën për bashkimin e të gjitha trojeve etnike, ndonëse pjesa më e madhe e tij, mbështetej në forcat e Boshtit. Aq me tepër kur Gjermania paraqitej si çlirimtare, sepse bashkë me aleatët kishte shpartalluar Mbretërinë e Jugosllavisë. Krahas kësaj ajo konsiderohej si pasuese e Austro - Hungarisë, që kishte përkrahur fuqimisht Shqipërinë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër dhe e kishte dëbuar sundimin serb gjatë Luftës së Parë Botërore nga pjesa më e madhe e Kosovës.⁵

Për jetësimin platformës çlirimit dhe të bashkimit kombëtar me përkrahjen e Gjermanisë, vepruan dhe luftuan *Komiteti Kosovës, Lidhja Popullore Shqiptare* dhe sidomos Lidhja e Dytë Shqiptare e Prizrenit, e cila, nga shtatori i vitit 1943 deri në gjysmën e dytë të nëntorit të vitit 1944, arriti të mbronte pjesën më të madhe të Shqipërisë së Sipërme, përfshirë edhe gati tërë Sanxhakun. Por një pjesë e tij, përkatësisht bërthama e Lëvizjes Nacional Demokratike (grupi i irridentes me në krye Selman Rizën, duke ndjekur përcaktimin programatik e rilindësve, e shihte vendin e Shqipërisë në botën demokratike perëndimore.⁶

Parimisht shqiptarët anonin kah aleanca Perëndimore, sepse që nga Lidhja Shqiptare e Pejës, Haxhi Zeka p.sh. Anglinë e shihte si një vend i cili mund ta merrte në mbrojtje Shqipërinë. Nuk duhet harruar mbrojtja që i bëri Shqipërisë presidenti Vilson në Konferencën e Paqes në Paris.

⁴ Shih më gjerësisht Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, Prishtinë, 1997.

⁵ *Arkivi i Institutit të Historisë Ushtarake* (AIHU), Pragë 8, f. 492-495; Tahir Zajmi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit*, Bruxelles, 1965, f. 40; Muhamet Shatri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Prizren dhe rrethinë (1941-1945)*, Prishtinë, 1987, f. 146.

⁶ Xhafer Deva, *Jeta dhe veprimtaria*, New York, 1980, f. 45.

Nga ana tjetër, bashkimi i Kosovës me Shqipërinë krijoi mundësinë e depërtimit të ideve komuniste, por këto ide për shkak të përvojës së hidhur nën pushtetin serbo - jugosllav, si dhe për faktin se ato vinin nga Rusia, projektuese e zbatuese e platformës dhe e strategjisë shekullore antishqiptare, nuk patën mbështetje e pretenduar në popullin shqiptar të Kosovës dhe të trevave të tjera shqiptare veriore e lindore. Prandaj, komunistët shqiptarë të Kosovës dhe të viseve për rreth, përfshirë këtu edhe ata të ardhur nga Shqipëria, mbetën deri në fund të luftës ujdhesë e izoluar në detin e komunistëve sllavë dhe përpjekjet e pjesës së tyre atdhetare për jetësimin e idealeve të çlirimit kombëtar në bashkëpunim me armiqtë shekullorë ishin një utopi.⁷

Udhëheqja e Partisë Komuniste Shqiptare (PKSH), nën diktatin e emisarëve të Partisë Komuniste Jugosllave (PKJ), që në fillim pranoi vlerësimet globale të PKJ për Shqipërinë, si plasdarmë e imperializmit italian në Ballkan dhe si bazë e kundërrevolucionit. Ajo, gjithashtu në bazë të vendimeve të fuqive drejtuese të koalicionit antifashist, nuk i njohu kufijtë e caktuar nga Italia, Gjermania dhe Bullgaria, si kufij të vendosur me luftë nga pushtuesit fashistë, dhe për interesat e tyre.⁸ PKSh theksonte se "zgjerimi i Shqipërisë është parullë e fashizmit dhe e tradhtarëve të vendit, për të ngjallur ndjenjat shoviniste, për të forcuar armiqtësinë e popullit tonë me popujt fqinjë jugosllavë e grek dhe për ta larguar atë nga lufta".⁹

Qëndrimet e komunistëve shqiptarë nga Kosova dhe trevat e tjera për lidhje organizative me PKSh u kritikuan në të gjitha këshillimet e Komitetit Krahinor (KK) të PKJ në të cilat, në vend që të demaskohej shovinizmi e sektarizmi i kuadrove serbo - malazeze, akuzoheshin komunistët e pakët shqiptarë për

⁷ Arkivi i Institutit të Historisë së Kosovës (më tej: AIHK), d. 1615, 155 dhe 305.

⁸ Enver Hoxha, *Titistët (Shënime historike)*, Tiranë, 1982, f. 72.

⁹ Po aty.

oportunizëm, për rënie në pozitat e masave, madje edhe për irredentizëm shqiptaro - madh. Këto akuza u drejtuan edhe kundër komunistëve të ardhur nga Shqipëria, të cilët u përpoqën ta orientonin popullin shqiptar të Kosovës dhe të trevave të tjera shqiptare drejt luftës së përbashkët antifashiste me popujt e Jugosllavisë.¹⁰

Nga ana tjetër Komiteti Qendror (KQ) i PKSh i urdhëronte komunistët shqiptarë që erdhën në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare të viheshin nën urdhrin e KK të PKJ për Kosovën, si dhe të KK të PKJ për Serbinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi. KQ i PKSh nuk pranoi asnjë kërkesë për lidhjen e organizatave partiake të Kosovës dhe të trevave të tjera shqiptare me KQ të PKSh, edhe pse shumë prej tyre ishin ngritur në sajë të punës së komunistëve të ardhur nga Shqipëria dhe veprimtarëve shqiptarë të këtyre trevave. Në porositë e KQ të PKSh vihej në dukje se komunistët shqiptarë me kalimin në "trevat jugosllave do të bëheshin anëtarë të PKJ dhe se për punën e tyre duhej t'u përgjigjeshin organizatave dhe forumeve udhëheqëse të PKJ".¹¹

Kjo vijë dhe këto porosi të dhëna në atë kohë, të cilat ishin kushtëzim nga trojka drejtuese e koalicionit antifashist, u bënë argumente themelore për të refuzuar, në pranverën e vitit 1942, kërkesën e komunistëve shqiptarë Shqip Mustafa, Abdullah Krashnica dhe Jahja Osmani që organizatat e partisë të Tetovës, Gostivarit, Dibrës, Kërçovës dhe të Strugës të lidheshin me KQ të PKSh. Atyre iu sugjerua që të bashkoheshin në luftë kundër pushtuesve nën udhëheqjen e PKJ. Madje kërkesa e tyre u kualifikua nacionaliste dhe Komiteti Vendi i PKJ të Tetovës e përjashtoi Sh. Mustafën nga radhët e veta.¹²

¹⁰ Zbornik I, knj. 19, d. 129, st., 475 i 543.

¹¹ Arkivi i Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës (AKK të LKK), Stenogrami IV, 44.

¹² Masar Kodra, *Albanska narodnost u organizacijama KPM i organima NOP-a, Vjetari i Arkivit të Kosovës XXI-XXII*, Prishtinë, 1986, f. 215.

Organizata e partisë e qarkut të Shkodrës, në përputhje me direktivat dhe udhëzimet e KQ të PKSh, që organizimin e lëvizjes në Kosovë dhe trevat e tjera shqiptare ta bënte PKJ dha një ndihmë të madhe për organizimin e Lëvizjes në Ulqin, Tivar, Plavë e Guci dhe trevat e tjera shqiptare, vetëm duke besuar në një zgjidhje të drejtë e me mirëkuptim për të ardhmen e tyre. Veprimtarët antifashistë që u dërguan në ato rajone, si Ahmet Haxhia, Naim Gjylbegu, Daniel Matlia, Hajrulla Kastrati, Reshit Rusi etj., dhanë ndihmesën e tyre në organizimin e Partisë, të njësive partizane që u vunë nën komandën e PKJ dhe të Ushtrisë Nacional çlirimtare të Jugosllavisë.¹³

Edhe në këto treva pengesë kryesore për pjesëmarrjen e shqiptarëve në lëvizje ishte mungesa e platformës së qartë për zgjidhjen e çështjes nacionale dhe qëndrimi shovinist dhe sektar i veprimtarëve malazez ndaj popullit shqiptar. Organizata e PKJ e Ulqinit, që përbëhej ekskluzivisht nga malazeztë, nuk mund të bëhej interpretuese e aspiratave të shqiptarëve, që përbënin shumicën absolute të popullsisë në këtë trevë. Veprimtarët dhe simpatizantët e lëvizjes nga radhët e shqiptarëve u shfrytëzuan vetëm si ndërlidhës me Lëvizjen në Shqipëri dhe me ithtarët e saj në radhët e ushtarëve dhe të oficerëve të garnizonit të ushtrisë shqiptare në Ulqin.¹⁴

Ndërkohë, në vitin 1942, KK i PKJ për Kosovën kishte 12 anëtarë, dhe prej tyre vetëm 4 ishin shqiptarë, kurse në Byronë Politike prej 5 anëtarëve vetëm njëri ishte shqiptar (F. Hoxha).¹⁵ Kjo gjendje e përfaqësimit të komunistëve shqiptarë ishte edhe në viset e tjera shqiptare nën ish - Mbretërinë Jugosllave. Me këtë

¹³ *Historia e Shqipërisë*, III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 1984, f. 630-631.

¹⁴ *AKK të LKK*, Stenogrami III, f. 478, 483.

¹⁵ *Arkivi Qendror i Ushtrisë* (AQU), Fondi (F) Shtabi i Përgjithshëm(ShP), Trakt i KK të PKJ të Kosovës, shkurt 1943.

pjesëmarrje natyrisht ishte e vështirë të realizohej pjesëmarrja masive e shqiptarëve në Lëvizjen Antifashiste.

Për më tepër, KQ i PKJ kishte deklaruar që nga fillimi i luftës se angazhohej për ruajtjen e tërësisë dhe unitetit të shtetit jugosllav. Prandaj, nuk qëndron as slogani se komunistet jugosllavë na tradhtuan. Në raportet ndërshtetërore dhe ndërmjet lëvizjeve të ndryshme ka diplomaci e veprime që lejohen në kushte të luftës.

Komunistët jugosllavë, ndonëse i thërrisnin shqiptarët që t'i kundërviheshin fashizmit, nuk ishin të kënaqur me demonstratat antifashiste, që u organizuan në Kosovë dhe trevat e tjera shqiptare gjatë viteve 1941 - 1943. Atyre nuk u pëlqente pse këto demonstrata përkujtonin përvjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Ata shin kundër parullave me karakter patriotik e antifashist: “Poshtë Italia”!, “Rroftë Shqipëria”!, të shoqëruara me këngët atdhetare “Vlora, Vlora, bini djem ju lumtë dora”!, “E mbrojmë me gjak, se lëshojmë aspak”! etj.¹⁶

Në analizën që KK i PKJ për Kosovën u bëri këtyre demonstratave, u kritikua pjesëmarrja e komunistëve dhe e veprimtarëve shqiptarë të lëvizjes Antifashiste në to dhe u nënvizua se ky aktivitet kishte qenë i njëanshëm dhe në dobi të interesave të nacionalizmit shqiptar.¹⁷

Nga ana tjetër, Konferenca e Parë e Vendit e marsit të vitit 1943 e PKSH nuk e shtroi fare çështjen e Kosovës dhe të trevave të tjera shqiptare, edhe pse ky problem ishte i pranishëm që nga hapat e parë të jetës e të veprimtarisë së kësaj partie. Kjo nuk kish si të ndodhte kur dihet se strukturën organizative të organeve më

¹⁶ Arkivi Qendror i Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi (F). Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), viti 1942, dos. 1582, fl. 2, Prefektura e Prizrenit për Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), më 15. XII. 1942.

¹⁷ Arkivi i Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, (AKK të LKK), Dragutin Djordjeviç, *Borba komunista i ostalih rodoljuba u okupiranoj Djakovici* (dorëshkrim), f. 32.

të larta të Partisë dhe përbërjen e tyre e vendosën emisarët jugosllavë, Milladin Popoviqi dhe Dushan Mugosha.¹⁸

Në korrikut 1943, delegati i Shtabit Suprem (ShS) të UNÇJ dhe Komitetit Qendror (KQ) të PKJ, Svetozar Vukmanoviç Tempos, në vazhdim të përpjekjeve për të kontrolluar e shfrytëzuar luftën e popullit shqiptar, kishte arritur me drejtuesit e Lëvizjes Antifashiste Çlirimtare (LAÇ) të Shqipërisë një marrëveshje, e cila parashikonte "bashkëpunimin" në zonat kufitare, marrjen e masave të përbashkëta politike e ushtarake për aktivizimin e shqiptarëve në ato vise në luftën e armatosur kundër pushtuesit dhe "forcimin e vëllazërim - bashkimit të serbëve, malazezve dhe shqiptarëve".

Në këtë mënyrë, ndërsa komunistët shqiptarë të Kosovës me vise luftonin kundër luftës vëllavrasëse ndërmjet popujve dhe angazhoheshin për bashkëpunim të ndërsjellë, shumica e komunistëve jugosllavë e veçanërisht kuadrot e tyre udhëheqëse, synonin përçarjen e forcave drejtuese të popullit shqiptar dhe gjunjëzimin e tyre. Këtë e ilustron qartë edhe letra e M. Popoviqit dërguar sekretarit të KK të Kosovës, Pavle Joviçeviçit, më 11 korrik 1943. Në letër midis të tjerash, theksohej: "ne kemi për qëllim që fillimisht Ballin ta copëtojmë në grupe e pastaj ta shkatërrojmë deri në fund".¹⁹

Siç dihet në Mbledhjen e Mukjes u arrit marrëveshja historike për luftë të përbashkët e të menjëhershme kundër pushtuesve fashistë për një Shqipëri të lirë, demokratike e popullore e për zbatimin e parimit të vetëvendosjes për një Shqipëri Etnike. Është meritë e krahut demokrat brenda FNÇ të përfaqësuar nga Abaz Kupi, Mustafa Gjinishi, Ymer Dishnica, Myslim Peza, Sulo Bogdo, Omer Nishani, Shefqet Beja etj., që në

¹⁸ Arkivi i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë (AKQ të PKJ) 1943/1944, Letër e Milladin Popoviqit e dt. 29. VII. 1943, dërguar Ivan Millutinoviqit.

¹⁹ Zbornik I/19, d. 42, f. 230.

kundërshtim me frymën dhe veprimet e komunistëve, me në krye E. Hoxhën dhe në bashkëpunim me nacionalistët Mithat Frashëri, Thoma Orollagaj, Hasan Dosti, Vasil Andoni, Hysni Lepenica, Skënder Muço, Nexhat Peshkëpia etj., arritën të realizojnë marrëveshjen e Mukjes më 1 - 2 gusht 1943.²⁰

Mirëpo, sapo mësuan për vendimet e Mukjes, emisarët e PKJ pranë PKSh, reaguan ashpër sepse ajo ishte e papranueshme për udhëheqjen jugosllave. M. Popoviq ka pranuar vetë se ka ndikuar në PKSh dhe në LAÇ që gjithsesi të prishnin Marrëveshjen e Mukjes.²¹

Pra, është e qartë se rolin vendimtar në prishjen e marrëveshjes e pati PKJ. Ajo nuk mund të lejonte që PKSh, të cilën ajo e konsideronte se e kishte krijuar vetë, "të bënte pazarllëk me nacionalizmin shqiptar të tipit irredentist". Ky përfundim shprehet edhe nga parashtrimi që i bën Vladimir Dedijeri Marrëveshjes së Mukjes, të cilën e paraqet si shembull të "deviacionit shqiptaro - madh".²²

Akti antikombëtar i prishjes së Marrëveshjes mbarë shqiptare u konfirmua më 8 gusht 1943, kur E. Hoxha në emër të KQ të PKSh lëshoi një qarkore me porosinë e përgjithshme se

²⁰ *Historia e Popullit Shqiptar për shkollat e mesme*, Tiranë, 1994, f. 200-201.

*Përfaqësuesit e komunistëve në delegacionin e KPNÇ, Ymer Dishnica dhe Mustafa Gjinishi, ngurruan në fillim të pranonin platformën e ofruar nga bashkëbiseduesit e tjerë që të luftohej për Shqipërinë Etnike. Ata i kishin porositur se nuk mund të pretendohej që të kërkohej Kosova dhe trevat e tjera shqiptare." Nuk e duam Kosovën, u kishin thënë në KQ të PKSh se na e ka falur armiku", "nuk mund ta kërkojmë Kosovën, sepse vemi në kundërshtim me Kartën e Atlantikut në të cilën nuk përmendet fjala etnike dhe se po të kërkojmë Kosovën bëhemi edhe ne si Mustafa Kruja, sepse edhe ai kërkon Kosovën" etj. Këto teza ishin të M. Popoviqit e të D. Mugoshës, të cilët vazhdimisht bënë presion në KQ të PKSh që të mos pranonte kurrfarë marrëveshjeje me *Ballin Kombëtar* dhe me forcat e tjera atdhetare (*Marrëveshja e Mukjes, Flamuri*, viti I, 5, 1944)

²¹ R. Rajoviq, *Autonomia e Kosovës*, Beograd, 1985, f. 293.

²² Reginald Hibbert, *Fitorja e hidhur, Lufta Nacional Çlirimtare e Shqipërisë*, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë 1993, f. 94.

”çfarëdo bashkëpunimi me Ballin duhej ndërprerë”. Nën presionin e emisarëve të PKJ, Marrëveshja e Mukjes u dënua edhe nga Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar (KPNÇ), i cili gjithashtu e quajti si ”qëndrim që nuk përputhet me interesat e popullit shqiptar dhe me vijën e LNÇ”! Edhe në Konferencën II Nacionalçlirimtare e cila aprovoi vendimin e KPNÇ, dënohet marrëveshja që bëri delegacioni i Këshillit të Përgjithshëm me përfaqësuesit e Ballit Kombëtar në Mukje.²³

Dënimi i Marrëveshjes së Mukjes nga PKSh nuk ishte një gjë e lehtë dhe e thjeshtë e që mund të kalonte pa probleme edhe në radhët e Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar (FANÇ). Për këtë arsye, E. Hoxha u detyrua që në referatin e mbajtur në Konferencë të fusë një paragraf nëpërmjet të cilit përpiket të shpjegojë qëndrimin e PKSh për mënyrën e trajtimit të problemit kombëtar. Sipas tij: ”KNÇ ka pas një vijë e një politikë të qartë për Kosovën dhe qëndron tek ajo politikë, se është e drejtë. Lufta jonë Nacionalçlirimtare është një luftë popujsh, e përbashkët, krahas me aleatët, kundër Boshtit. Aleanca e shëndoshë me luftë e me gjak vlen më tepër se kartat. Qëllimi është që tok të bashkuar të ndjekim këtë luftë, duke harruar gjithë të kaluarën, se mbi tokën tonë na turret një armik i njëjtë, pastaj ne që kemi luftuar së bashku, me dashurinë më të madhe do t’i ujdism moskuptimet. Populli shqiptar që ka vuajtur nuk do të skllavërojë e copëtojë tjetrin që ka vuajtur si ai kësisoj reciprokisht”.²⁴

Prishja e Marrëveshjes së Mukjes goditi rënd interesat kombëtare të popullit shqiptar dhe ndihmoi në realizimin e interesave të shovinistëve fqinjë ndaj Shqipërisë, shënoi shmangien e PKSh dhe të FANÇ nga parimi i bashkimit pa dallim

²³ Xhelal Gjeçovi, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare* (nëntor 1941–nëntor 1944), Tiranë, 1986, f. 162.

²⁴ *Dokumente e materiale të organeve të larta të pushtetit revolucionar nacionalçlirimtar 1942-1944*, Tiranë, 1962, f. 50.

feje, krahine e bindjeje politike dhe fillimin e konfrontimit të hapur ndërshtiptar.²⁵

Qëndrimin e vet për Kosovën udhëheqja e PKSh e paraqiti edhe në një trakt, në dhjetor të vitit 1943, me anën e të cilit i bëhej thirrje popullit shqiptar të Kosovës të rrokte armët e të bashkohej me serbët, malazezët dhe të godiste okupatorin e tradhtarët, që kërkonin t'i ndanin e t'i përçanin. E vetmja rrugë e shpëtimit dhe e përmbushjes së dëshirave tuaja, thuhej në trakt, është lufta që do t'i bëni okupatorit tok me popujt e Jugosllavisë. Është Lufta nacionalçlirimtare ajo që do t'iu sigurojë të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje”.²⁶

Trakti i PKSh i dhjetorit të vitit 1943 u shkrua dhe u shpërnda me porosinë e M. Popoviçit dhe me lejen e KK të PKJ për Kosovën. Për sa i përket të drejtës për vetëvendosje, kjo u fut në trakt pasi në Shqipëri e në Kosovë nuk kishte ende njoftime për vendimet e Mbledhjes së Dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë (KANÇJ) në Jajcë. Këtë trakt udhëheqësit shqiptarë të Kosovës e interpretuan si një akt që u garantonte shqiptarëve të drejtën për vetëvendosje deri në shkëputje dhe për bashkim me Shqipërinë.²⁷

Por, shqiptarët e Kosovës nuk mund të bindeshin vetëm me anë të një deklarate të PKSh, e cila nuk jepte asnjë garanci për të siguruar të drejtën për vetëvendosje deri në shkëputje.

Siç shihet, qëndrimet që u mbajtën ishin të vakëta ose evazive kur ishte fjala për aspiratat e e ligjshme të shqiptarëve të Kosovës, të atyre të trevave shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi, në Sanxhak dhe Çamëri për të qenë të lirë dhe të bashkuar me

²⁵ “Rreth Marrëveshjes së Mukjes”, *Liria*, 9, prill 1992. Shih edhe Muharrem Dezhgiu, *Çështja kombëtare në programin e forcave politike shqiptare, jashtë Frontit Nacionalçlirimtar, në vitet e Luftës II Botërore*, f. 9.

²⁶ Ndreçi Plasari, “Politika e udhëheqjes së PKSh dhe e Enver Hoxhës ndaj çështjes së Kosovës”, *Studime historike*, 3-4, Tiranë, 1995, f. 80, 81.

²⁷ Po aty.

Shqipërinë. Të drejtat e tyre, madje, duke përsëritur qëndrimin e fuqive drejtuese të koalicionit antifashist kushtëzoheshin me luftën kundër fashizmit italian dhe nazizmit gjerman që në rastin e shqiptarëve do të duhej bërë së bashku me armiqtë shekullorë. Zhvillimi i ngjarjeve më vonë tregoi se edhe pse kosovarët e shprehën qartë vullnetin e tyre për bashkim me Shqipërinë, edhe pse luftuan kundër asaj Jugosllavie që i skllavëroi në vitet 1944 - 1945, PKSh dhe E. Hoxha nuk e shtroi këtë problem për diskutim me PKJ, e as në forumet ndërkombëtare të pasluftës.²⁸

Edhe Malësia dhe trevat tjera shqiptare në Mal të Zi, ndonëse formuan formacione të fuqishme vullnetare, aspirata themelore e të cilëve ishte zgjidhja e çështjes kombëtare, nuk kishin mbështetje nga LANÇ e Shqipërisë. Përkundrazi, ndërsa popullsia shqiptare e kësaj treve i kundërshtonte energjikisht përpjekjet e çetnikëve, po edhe të partizanëve malazezë, që të filtrohen në vatrat e saj, komunistët e ardhur nga Shqipëria hynë në lidhje me komunistët dhe me partizanët malazezë, u dhanë atyre një ndihmë të madhe për t'u organizuar e vepruar, i furnizuan me armë e me municion. Krahës kësaj ata i ndihmuan organizmat partiake dhe njësitë malazeze të shfrytëzonin edhe lidhjet tradicionale ndërmjet fiseve dhe vëllazërive shqiptare e malazeze, institucionin e besës dhe bujarinë tradicionale të malësorëve, për ripushtimin e këtyre viseve.

Pas kapitullimit të Italisë më 1943, Nacionalçlirimtarja në Kosovë bëri përpjekje për shtimin e radhëve, për intensifikimin e aksioneve të armatosura dhe për konsolidimin e strukturave politike dhe ushtarake. Nga fundi i vitit 1943 KK i PKJ-së për Kosovën dhe strukturat e tjera drejtuese të Nacionalçlirimtares, për të parandaluar veprimtarinë e hovshme të forcave nacionaliste, propaganduan me të madhe në popull parimin e vetëvendosjes, duke u referuar në Kartën e Atlantikut dhe duke trumbetuar se do

²⁸ Muharrem Dezhgiu, "Forcat politike shqiptare nga Peza në Mukje", *Studime historike*, 3-4, Tiranë, 1991, f.111.

të formonin një Lidhje më të denjë se ajo e Prizrenit e vitit 1878. Me këtë turk propagandistik ato arritën të përfitonin një pjesë të rinisë shqiptare për platformën e tyre në esencë projugosllave.²⁹

Në Konferencën e Bujanit përveç trevës së Plavës dhe të Gucisë, që u trajtua si pjesë e pandarë e Kosovës, nuk u ftuan përfaqësuesit e trevave të tjera shqiptare jashtë Kosovës, çka dëshmon për një vizion jo të plotë për zgjidhjen e çështjes shqiptare. Në këtë aspekt ky forum vihej në pozitë inferiore në krahasim me Lidhjen e Dytë të Prizrenit, në të cilën u përfaqësuan gati të gjitha trevat shqiptare nën ish - Jugosllavi. Sipas përkatësisë kombëtare në Konferencë morën pjesë gjithsej 43 delegatë shqiptarë, 4 serbë, 3 malazezë dhe 1 boshnjak, kurse 12 delegatë nuk erdhën për arsye të kushteve të vështira. Pjesëmarrësit në shumicën e tyre ishin komunistë, por krahas tyre nuk munguan nacionalistët dhe atdhetarët demokratë, përfaqësues të forcave të armatosura, të rinisë e të gruas antifashiste dhe të tjerë.³⁰

Udhëheqja jugosllave, që ishte përpjekur të shfrytëzonte Konferencën e Bujanit si kundërpeshë ndaj Lidhjes së Dytë të Prizrenit, kur e pa se ajo doli jashtë rathëve të pretendimeve të saj, e pengoi me të gjitha mjetet realizimin e vendimeve të Rezolutës së Konferencës dhe përfundimisht i hodhi poshtë ato.³¹

Materialet e Konferencës së Bujanit iu dërguan edhe KQ të PKSh dhe udhëheqjes së LANÇ të Shqipërisë, por ajo i kaloi ato në heshtje, duke mos bërë asnjë përpjekje për jetësimin e tyre. Atë që nuk e bëri udhëheqja e PKSh për Kosovën dhe trevat e tjera shqiptare e bëri udhëheqja e PKJ për territoret sllovene dhe kroate të pushtuara nga Italia në fund të Luftës së Dytë Botërore. Në

²⁹ Izber Hoti, “Çështja e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore”, *Ora*, 31, 17 maj 1996, f. 46.

³⁰ Sami Repishti, Rezoluta e Bujanit, *Studim* (1), *Rilindja*, Zofingen, 11. IV.1994, f. 6.

³¹ *Zbornik I*, knj. 19, d. 104, st. 464-466.

Mbledhjen e Dytë të KANÇJ, ajo sanksionoi vendimet e KANÇ të Sllovenisë dhe të Kroacisë për bashkimin e bregdetit slloven, të Istries dhe të viseve të tjera bregdetare me Kroacinë e Slloveninë, përkatësisht me Jugosllavinë.³²

Me këtë politikë, udhëheqja e PKSH dhe e LAÇ të Shqipërisë, jo vetëm që e injoroi tërësisht Rezolutën e Bujanit, por e rrezikoi seriozisht edhe pavarësinë dhe sovranitetin e vetë Shqipërisë. Megjithatë, këto veprime nuk mund të shuanin aspiratën historike kombëtare të popullit shqiptar, kudo që ndodhej, për vetëvendosje, për pavarësi dhe për bashkimin kombëtar.

Prandaj, nuk qëndron aspak slogani i njohur se gjoja PKSh, nëpërmjet përfaqësuesve të saj në Konferencën e Bujanit e shtroi drejt zgjidhjen e problemit të Kosovës, por, e ndodhur përballë tradhtisë së titistëve jugosllavë dhe mosangazhimit të Aleatëve të Mëdhenj për këtë çështje. Kundër këtij pohimi dëshmon i gjithë dokumentacioni i kohës. Kështu, E. Hoxha dhe partia që ai udhëhoqi, si gjatë luftës, ashtu dhe më pas, nuk e shtruan asnjëherë energjikisht çështjen kombëtare të Kosovës dhe të trevave të tjera shqiptare. Për më tepër, ajo e shkatërroi që në embrion Marrëveshjen e Mukjes, e cila e shtronte drejt çështjen e bashkimit të popullit shqiptar. Kjo parti dhe udhëheqësi i saj nuk mund të pretendojnë se ishin inspirues dhe organizatorë të Konferencës së Bujanit. Për këtë Konferencë E. Hoxha nuk foli asnjëherë as gjatë luftës, as pas luftës, as në Kongresin I të PKSh, ku denoncohej veprimtaria armiqësore e udhëheqjes jugosllave kundrejt Shqipërisë, as në ndonjë kongres tjetër. Vërtet E. Hoxha ka shkruar për vendimet e Konferencës së Bujanit më 1982, kur botoi librin "Titistët", por e bëri këtë në një mënyrë krejt hipokrite, sikur paskësh ndier "gëzimin e madh", kur kishte marrë

³² Lefter Nasi, "Tetë muaj nga historia e luftës së popullsisë shqiptare në Jugosllavi (nëntor 1944-korrik 1945)", në: *E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Tiranë, 1990, f. 408.

lajmin për mbajtjen e saj, duke menduar “se më në fund KQ i PKJ e kishte parë drejt problemin e Kosovës e të trevave të tjera shqiptare”. Prononcimin e duhur ai nuk e bëri në kohën kur u mbajt Konferenca, apo kur duhej të zbatoheshin vendimet e saj, por dhjetëra vite më pas, për të justifikuar veten në rivalitet me Josip Broz Titon, se cili prej tyre do të ideonte socializmin më “autentik”.³³

Çka mund të priste populli i Kosovës dhe trevave të tjera nga E. Hoxha, i cili në letrën drejtuar sekretarit të Komitetit Qarkor të PKJ për Rrafshin e Dukagjinit, Ismet Shaqirit, në prill të vitit 1944, shkruante: “Kosova është bazë e reaksionit shqiptar e jugosllav dhe kundër tyre duhet luftuar pamëshirshëm”. “Nga Kosova, theksonte ai, do të rekrutohen një numër i madh forcash, të cilat armiku do t’i dërgojë kundër partizanëve të Jugosllavisë dhe të Shqipërisë”. Prandaj, ai u bënte thirrje formacioneve partizane në Kosovë që të bëjnë çmos për vëllazërinë e popujve të Jugosllavisë, për t’u bashkuar në luftën e përbashkët dhe për t’u ruajtur prej grackave, të cilat do t’ua bëjnë shovinistët duke i nxitur në grindje reciproke”.³⁴

Në kuadrin e përpjekjeve për instrumentalizimin e plotë të LANÇ të Shqipërisë, udhëheqja jugosllave insistonte pandërprere për dërgimin e njësisve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë (UNÇSh) në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare, ku pritej një rezistencë e fuqishme kundër okupimit serbo-jugosllav. Kërkesa e parë u bë në qershor të vitit 1944. Këtë kërkesë ia bëri njëkohësisht ShP të UNÇSh edhe Shtabi Kryesor i Ushtrisë Nacionalçlirimtare (SHK i UNÇ) të Kosovës. Lidhur me këtë, në letrën e ShK të UNÇ të Kosovës, datë 26. VI. 1944, dërguar ShP të UNÇSh, veç tjerash, theksohej se “në Kosovë urrejtja shoviniste

³³ Dode Progni, “Në konferencën e bujanit u realizua në mënyrë të ligjshme dhe demokratike pavarësia e Kosovës nga Serbia”, në *Rilindja Demokratike*, Tiranë, 2. XII. 1994, f. 5.

³⁴ N. Plasari, *Politika e udhëheqjes së PKSh dhe e Enver Hoxhës...*, f. 80, 81.

e mbjellë nga shovinistët serbomëdhenj dhe e manipuluar nga okupatorët dhe tradhtarët...frika nga kthimi i së vjetrës bëjnë që Kosova të bëhet baza më e rrezikshme e reaksionit kundër Lëvizjes sonë dhe asaj tujes, por ardhja e brigadave shqiptare në këtë trevë kishte për t'i mposhtur planet e okupatorit dhe të reaksionarëve, duke e kthyer këtë trevë prej bazës së reaksionit në bazë liridashëse". Pastaj vazhdonte se "shkaktarë që Kosova është bërë bazë e reaksionit janë hegjemonistët serbë". Por, më poshtë pohonte se shumica e popullit të Kosovës nuk kishte besim tek PKJ dhe tek shtabi jugosllav.³⁵

Në këto rrethana qarqet shoviniste serbomadhe filluan sulmin frontal për ripushtimin e Kosovës. Shtabi Kryesor i Serbisë, në Proklamatën e gushtit të vitit 1944 drejtuar shqiptarëve të Kosovës, i akuzonte dhe kërcënonte njëkohësisht: "Ju deri më tash keni qenë të mashtruar prej gjermanëve dhe u keni ndihmuar. Ata ju kanë hedhur në luftë për llogari të vet në Mal të Zi, në Maqedoni dhe më në fund në Shqipëri. Në këtë mënyrë ju jeni bërë pjesëmarrës në krimet që ka bërë okupatori gjerman. Së bashku me pushtuesit fashistë ju keni ngritur dorën kundër popujve fqinjë, dhe në këtë mënyrë keni bërë turpin më të madh. Për shkak të qëndrimit të këtyllë, ju deri më tash nuk keni fituar të drejtën të jetoni në barazi dhe vëllazëri me popujt e Jugosllavisë".³⁶

Megjithatë, as këto vlerësime të Shtabit Kryesor i Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Serbisë dhe as kërcënimet e tij për të depërtuar me dhunë në Kosovë nuk e shqetësuan udhëheqjen e PKSh. Përkundrazi, bashkëpunimi ushtarak mori formën konkrete. Me kërkesën e PKJ-së, disa njësi të armatosura të Ushtrisë

³⁵ AQU, F. ShP, f. l. 23, Letër e Shtabit Kryesor të Kosovës për Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional çlirimtare të Shqipërisë, 26. VIII. 1944.

³⁶ Zbornik I, knj. 19, d.164, st. 618-622.

Nacionalçlirimtare të Shqipërisë, u bënë gati të kalonin në veri të lumit Drin.³⁷

Problemi i së ardhmes së Kosovës u shtrua në nivelin më të lartë edhe gjatë vizitës së delegacionit të KQ të PKSh, të kryesuar nga Ramadan Çitaku në ishullin e Visit, në gusht të vitit 1944. Me këtë rast delegacionit iu bë e ditur se Jugosllavia ngadhënjimtare nuk do të lejonte të humbiste territoret e veta, dhe gjithashtu iu tha se edhe Kosova patjetër do të mbetej në kuadrin e saj. Për më tepër, J. B. Titoja kërkonte nga pala shqiptare që ta ndihmonte palën jugosllave për ripushtimin e Kosovës dhe të trevave të tjera shqiptare, sepse sipas tij, reaksioni që kishte zënë rrënjë në atë vend, paraqiste rrezik jo vetëm për synimet e komunistëve jugosllavë, por edhe të atyre shqiptarë.³⁸

Këtu E. Hoxha vinte shenjën e barazimit midis popullit shqiptar të Kosovës së shtypur dhe popullit serb shtypës, të drejtën e të parit për vetëvendosje e quante akt skllavërimi, të dytit, të drejtën për shkëputje ia quante copëtim, kurse të drejtën për të mbështetur synimin e kahershëm për bashkimin e popullit shqiptar dhe trojeve të tij e cilësonte si shovinizëm.

Në vazhdim E. Hoxha mundohet ta "ndërgjegjësojë" popullin e Kosovës, kur, veç tjerash, thotë: "Pra, vetë popullsitë në mes tyre në Kosovë do të merren vesh dhe do të vendosin se nga të shkojnë. LNÇ ka për detyrë ta bëjë popullin e Kosovës të ndërgjegjshëm për aspiratat e tij, duke i thënë se ka për të shpëtuar vetëm me luftë kundër okupatorit fashist dhe okupatorit eventual jugosllav, si Drazha Mihajloviqi. Duhet ta bëjmë popullin e Kosovës të vendosë vetë nga ka për të vajtur, siç e duam edhe ne, dhe të luftojë atë Jugosllavi që do ta skllavërojë..."³⁹ Por këto fjalë

³⁷ Arkivi i Institutit të Historisë Ushtarake (AIHU), Fondi (F). Lëvizja Nacionalçlirimtare (LNÇ), d. 103, f. 307

³⁸ Nijaz Dizdareviç, *Albanski dnevnik*, Sarajevo, 1988, st. 49.

³⁹ Ndreçi Plasari, *Politika e udhëheqjes së PKSh dhe e E. Hoxhës...*, f. 81.

drejtoreshin kundër D. Mihajloviqit dhe jo kundër PKJ dhe J. B. Titos.

Po ky qëndrim rreth kësaj çështjeje u shpreh edhe në Rezolutën e Konferencës së Labinotit: ” Çështja e Kosovës dhe e Çamërisë do të zgjidhet në bazë të Kartës së Atlantikut, në bazë të parimit të vetëvendosjes së popujve, ku garancia më e madhe për triumfin e këtij principi është vetë lufta që bëjnë Kosova e Çamëria krah për krah me popujt jugosllav e grek, për ta zhdukur fashizmin italian e gjerman, dhe bashkë me të gjitha tendencat imperialiste e shoviniste kudo në botë, veçanërisht në Ballkan”.⁴⁰

Udhëheqja jugosllave nga fundi i gushtit 1944 dërgoi në Shqipëri misionin e vet ushtarak, i cili arriti atje më 6 shtator 1944. Misioni i tij i posaçëm, siç del qartë nga fjala e Velimir Stojniqit në Plenumin e Beratit, ishte të përgatitej terreni për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë, d.m.th. të arrihej ajo që s’kishte qenë e mundur të kryhej nga M. Popoviq dhe Dushan Mugosha. Ky mision kërkoi nga ShP i UNÇSh, që të ”dërgonte sa më parë forcat e veta në veri të Drinit, për të bashkëvepruar me njësitë e UNÇJ në Kosovë, për mobilizimin e luftëtarëve të rinj, për formimin e njësive të reja, si dhe për shpartallimin e reaksionit në Shqipërinë e Veriut dhe në Kosovë”.

Shtabi Suprem i UNÇJ, duke synuar të gllabëronte Kosovën në një kohë sa më të shpejtë, e informoi Shtabin Operativ të Kosovës se ai e kishte urdhëruar ShK të UNÇ të Maqedonisë për t’i vënë në dispozicion të gjitha njësitë kosovare që gjendeshin atje dhe se i kishte propozuar ShP të UNÇSh që të dërgonte forcat e tij në veri të Drinit.⁴¹

Kërkesat për dërgimin e formacioneve të UNÇSh në Kosovë udhëheqja jugosllave i shoqëroi me urdhrin e 2 shtatorit 1944 për shndërrimin e ShK të UNÇ të Kosovës në Shtab

⁴⁰ *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar (1939-1944)*, vëllimi IV, prill 193-n-ntor 1944, 8 Nëntori, Tiranë : 1984, f. 534.

⁴¹ Zbornik I, knj. 19, d. 164, st. 618-620.

Operativ dhe për vënien e tij nën komandën e ShK të UNÇ të Serbisë. Katër ditë më pas J. B. Tito kërkoi që ky shtab të drejtonte aksionet në Rrafshin e Dukagjinit dhe në Kosovë, sepse rëndësia e Kosovës për Jugosllavinë ishte e madhe. Ai nënvizonte se "po qe se do të zinte vend reaksioni në Kosovë atëherë do të vështirësohej, jo vetëm pozita jonë në Kosovë, por edhe në Shqipërinë e Veriut dhe në trevat kufitare të Malit të Zi".⁴²

E. Hoxha mori vendim ta plotësonte kërkesën këmbëngulëse të J. B. Titos. Më 12 shtator 1944 ai e urdhëroi komandën e Korparmatës I të UNÇSh të niste menjëherë për në Kosovë Brigadën III dhe V për të bashkëvepruar me njësitë e UNÇJ, me qëllim që të dëbonin prej andej trupat gjermane dhe për të ndihmuar vendosjen e pushtetit jugosllav. Për drejtimin e operacioneve ushtarake, me insistimin e palës jugosllave, u krijua edhe Shtabi i Përbashkët Operativ, me udhëheqës ushtarakë e politikë të brigadave të UNÇSh dhe të atyre kosovare. Hysni Kapoja, me cilësinë e komisarit të Korparmatës I dhe anëtarit të KQ të PKSh u shtronte komisarëve të këtyre brigadave si detyrë parësore: "Të popullarizohet miqësia e popullit shqiptar me popujt e Jugosllavisë" etj. Në këto materiale të E. Hoxhës e të H. Kapos nuk gjen asnjë fjalë për të drejtën e popullit të Kosovës për vetëvendosje dhe për statusin e Kosovës pas lufte, e mos të flasim për çështjen e bashkimit me Shqipërinë. Gjithë theksi vihej tek vëllazërimi me popujt jugosllavë.⁴³

Ndërkaq, në letrën dërguar KQ të PKJ, më 23 shtator 1944, me rastin e kthimit të M. Popoviqit nga Shqipëria në Jugosllavi, E. Hoxha do të shkruante: "...Në këtë luftë të përbashkët kundër armikut të përbashkët, të dy partitë tona vëllazërore, i vunë themelet e vëllazërimit të te dy popujve tanë, Partia jonë e re, që

⁴² Po aty.

⁴³ *Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë* (Vëll. 2), 8 Nëntori, Tiranë 1976, f. 960-961.

udhëhoqi luftën çlirimtare, ndjehet e fortë, sepse me të është Partia e Madhe Komuniste e Jugosllavisë dhe udhëheqësi i saj i mençur Mareshali Tito, i cili nuk do mungojë të na ndihmojë, siç na ka ndihmuar në çastet më të vështira të luftës sonë, që në këtë mënyrë dorë për dorë të përparojmë drejt fitores përfundimtare, për humanizmin e ri”. Në vazhdim ai nuk do të harronte as emisarët jugosllavë në Shqipëri, kur theksonte: ”Do të tregoheshim shumë të pamiradijshëm sikur në këtë vend të mos shprehnim falënderimin e madh që Partia jonë gjithashtu ndien ndaj dy shokëve jugosllavë, Milladinit e Dushanit, të cilët që nga hapat e parë të Partisë sonë e deri sot i angazhuan të gjitha forcat e veta dhe tërë përvojën e tyre që Partia jonë të forcohet dhe të jetë efikase”.⁴⁴

Vlen të theksohet se derisa J. B. Tito dhe udhëheqja jugosllave zhvillonin një veprimtari diplomatike intensive me aleatët, veçanërisht me anglezët dhe sovjetikët, KQ i PKSh mbajti një qëndrim të tillë që çoi në izolimin politik të Shqipërisë. Siç dihet, anglezët sollën misionet ushtarake në Shqipëri, përpara se t'i çonin ato në Jugosllavi. Por E. Hoxha shkoi aq larg me politikën e vetizolimit, sa të mos pranonte edhe ftesën e kryetarit të Misionit britanik për të dërguar në Londër një delegacion për përfaqësimin e Shqipërisë në Komisionin aleat për çështjen e Italisë dhe të territoreve të pushtuara prej saj. Për këto veprime ai nuk ngurroi t'i mburrej edhe M. Popoviqit. Kësi qëndrimi mbajti më pas E. Hoxha edhe ndaj Misionit amerikan dhe perspektivave që hapte bashkëpunimi i barabartë me tri Fuqitë e Mëdha të Koalicionit antihitlerian. Në këtë mënyrë J. B. Tito arriti synimin e tij djallëzor e antishqiptar për ta mbajtur Lëvizjen Antifashiste Shqiptare të izoluar e plotësisht nën kontrollin e tij.⁴⁵

⁴⁴ *Libri i bardhë mbi politikën armiqësore të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë ndaj Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë*, Beograd, 1961.

⁴⁵ E. Hoxha, *Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë*, Tiranë, 1984, f. 314-315.

Në vjeshtë të vitit 1944 Kosova dhe viset për rreth kishin rëndësi të veçantë si në aspektin ushtarak ashtu edhe politik. Në këtë kohë u rrezikua pozita e grupit gjerman të armatave "E" në Greqi, kështu që trupat gjermane u detyruan të tërhiqeshin nëpër Maqedoni, Kosovë, Rrafshin e Dukagjinit, Sanxhak, Mal të Zi dhe Bosnjë. Po kështu, Komiteti i Çlirimit Kombëtar të Jugosllavisë ishte marrë vesh me Moskën për pjesëmarrjen e Ushtrisë së Kuqe në operacionet ushtarake në Jugosllavi dhe me Frontin Patriotik të Bullgarisë që në luftime kundër forcave gjermane të merrnin pjesë edhe forcat bullgare. ShS i UNÇJ u mor vesh edhe me ShK të UNÇSH-së që njësitet e saj të merrnin pjesë në po këto operacione ushtarake. Pas këtyre marrëveshjeve filluan luftimet për kinse çlirimin e Kosovës dhe të viseve të tjera etnike shqiptare, por në të vërtetë ishte fjala për ripushtimin klasik të tyre.⁴⁶

Forcat e UNÇSH-së ishin të parat që hynë në Kosovë. Kjo u bë pasi më 01. X. 1944, komandanti i ShS të UNÇJ e APJ-së i dërgoi telegram ShK të UNÇ dhe AP të Shqipërisë që të dërgojë në Kosovë e vise të tjera brigadat shqiptare. Në planin e Shtabit Operativ të Kosovës ishte paraparë që Brigada I dhe IV kosovare dhe Brigada III dhe V të UNÇSH të marshonin në drejtim të Rrafshit të Dukagjinit.⁴⁷

Më 13. X. 1944 pjesë të Divizionit V të UNÇSH-së kapërcyen kufirin politik të paraluftës pranë Gjakovës. Po në këtë kohë në Kosovë hynë edhe forcat e Brigadës IV të UNÇ e AP për Kosovë e Metohi. Këto brigada zhvilluan luftime të rrepta kundër njësiteve të grupit luftarak "Skënderbeu" dhe forcave të shumta vullnetare. Në rrugën Prizren-Shkodër dhe Prizren Deçan ato luftuan kundër forcave gjermane, të cilat tërhiqeshin nga Shqipëria dhe siguronin krahun e majtë të grupit të armatave "E", kurse në fshatra dhe në Gjakovë kundër vullnetarëve shqiptarë. Brigada I e

⁴⁶ Izber Hoti, "Kosova dhe viset e tjera shqiptare nga kapitullimi i Italisë Fashiste deri në fund të nëntorit 1944", *Kosova* 26, Prishtinë, 2005, f. 220.

⁴⁷ Po aty.

UNÇ e AP për Kosovë e Metohi dhe Brigada III e UNÇSH-së vepronin në drejtim të Deçanit dhe të Pejës, kurse Brigada IV e UNÇ e AP për Kosovë e Metohi dhe Brigada V e UNÇSH-së në drejtim të Prizrenit. Njësitet që depërtuan në drejtim të Dragashit, Gjakovës, Prizrenit dhe Pejës "çliruan" së pari Dragashin më 5 X. 1944, pastaj Hasin, kurse më 14. X. 1944 sulmuan Gjakovën. Këtë qytet e sulmuan Brigada IV e UNÇ e AP për Kosovë e Metohi dhe Brigada V e UNÇSH-së, të cilat u shkaktuan dëme të konsiderueshme forcave gjermane dhe vullnetare, mirëpo qytetin nuk e morën për shkak se njërive kundërshtarë u erdhën në ndihmë forca nga Prizreni e Peja.⁴⁸

Shqiptarët e Kosovës dhe viseve të tjera në Mal të Zi dhe në Sanxhak nuk mund të vazhdonin luftën kundër vëllezërve të tyre nga Shqipëria edhe pse këta kishin ardhur t'u ndihmonin serbëve dhe malazezëve për ripushtimin e këtyre trevave. Komandat e dy brigadave shqiptare hynë në bisedime me komandat e forcave patriotike, të cilat dhanë besën se nuk do të luftonin më tutje brigadat shqiptare: "Me zemër e me pushkë jemi me ju, jemi gati që edhe pushkët tona t'i bashkojmë në luftë kundër gjermanëve, por gjithnjë kemi frikë nga forcat serbe, sepse serbët janë të pabesë"⁴⁹. Ata njëkohësisht shprehnin edhe drojën se mos brigadat shqiptare i tradhtonin. Megjithatë, "shqiptarët u vëllazëruan shpejt me shqiptarë" dhe, pas 28 tetorit, luftimet në Kosovë u zhvilluan pothuaj plotësisht me forcat gjermane.⁵⁰

Luftimet në Rrafshin e Dukagjinit zgjatën deri më 17 nëntor 1944, kur forcat gjermane, nën presionin e fuqishëm të njërive të përmendura dhe të vetë zhvillimit të ngjarjeve në frontet kryesore të luftës, u detyruan ta lëshojnë në të njëjtën ditë Pejën

⁴⁸ Po aty, f. 222.

⁴⁹ N. Plasari, *Politika e udhëheqjes së PKSH dhe e Enver Hoxhës...*, f. 89.

⁵⁰ Po aty.

dhe Prizrenin.⁵¹

Përafërsisht në të njëjtën kohë vazhdoi depërtimi i forcave pushtuese malazeze në viset veriperëndimore shqiptare. Më 16 tetor 1944 Brigada IX malazeze ripushtoi Plavën dhe, duke bashkëvepruar me partizanët vendës, zuri rrugën Murinë-Pejë. Më 11 nëntor 1944 u ripushtua Gucia. Në Vuthaj u erdhi në ndihmë Batalioni i 3-të i Brigadës XXV të UNÇ të Shqipërisë, i cili zuri rob krerët e forcave patriotike të Plavës e Gucisë në krye me Shaban bej Rexhepagajn dhe të nesërmen i pushkatoi në Zall të Koçisë (Krushevë), si dhe mobilizoi të gjithë meshkujt e aftë për pushkë.⁵²

Repartet e Brigadës I të Bokës së Kotorrit, duke shkuar pas forcave gjermane që po tërhiqeshin, më 24 nëntor 1944 ripushtuan Tivarin, pikën më të skajshme të trevave bregdetare shqiptare. Batalioni II i Brigadës I të Bokës dy ditë më vonë, përkatësisht më 26 nëntor ripushtoi edhe Ulqinin dhe bregdetin deri në kufi me Shqipërinë.⁵³

Pas kësaj, nën pretekstin e ndjekjes së forcave "reaksionare" të Hasan Isufit u shpall shtetrrethimi dhe gjendja e jashtëzakonshme, e cila u shoqërua me terror dhe gjenocid masiv.

Me insistimin e palës jugosllave, Divizioni i 5-të dhe ai i 6-të i UNÇSH-së u angazhuan në luftime kundër forcave gjermane në Sanxhak, në Mal të Zi dhe në Bosnjën Lindore. Këto luftime filluan më 12 dhjetor 1944 dhe ndihmuan për pushtimin e Tutinit, Pazarit të Ri, Senicës, Prijepoljes, Podgoricës, Pribojit dhe Vishegradit nga forcat serbo-jugosllave.⁵⁴

Po më 12 dhjetor 1944, Brigada XXII e Divizionit të 6-të

⁵¹ Zbornik I, knj. 19, d. 144, st.. 361-362.

⁵² Rexhep Dedushaj, *Krahina e Plavës dhe Gucisë nëpër shekuj*, New York, 1994, f. 278.

⁵³ Riza Rexha, "Lëvizja Nacionalçlirimtare në Ulqin dhe rrethinë më 1941-1945", *Kosova*, 6, Prishtinë 1977, f. 289.

⁵⁴ Po aty.

të UNÇSH çliroi Deçiqin, kurse dy ditë më vonë Tuzin. Popullsia shqiptare e kësaj treve e detyroi shtabin e kësaj brigade të ngrinte flamurin shqiptar në Majën e Deçiqit, si në kohën e kryengritjes antiosmane të vitit 1911 dhe kërkoi me forcë që Tuzi, Hoti e Gruda, të bashkoheshin me Shqipërinë. Mirëpo, në bisedimet e zhvilluara në Shkodër më 21 janar 1945 midis përfaqësuesve të këtyre trevave dhe Shtabit të Truparmatës III të UNÇSH-së, përfaqësuesit e UNÇSH-së, krejtësisht ndryshe me shpresat dhe aspiratat e popullsisë shqiptare në këto troje, firmosën që këto treva nga pikëpamja administrative do të vireshin nën administrimin jugosllav. Popullsia do të kishte të drejtën e përdorimit të flamurit shqiptar dhe të dygjuhësisë, ndërsa komandanti dhe komisar i komandës së vendit në Tuz do të ishin shqiptarë. Përkohësisht do të pezullohej mobilizimi i popullsisë së këtyre trevave në UNÇJ. Marrëveshja do të hynte në fuqi pasi të miratohej nga qeveria shqiptare dhe ajo jugosllave. Në këtë mënyrë, komunistët shqiptarë të të dy palëve në janar 1945 pajtoheshin që kjo pjesë e tokës së tyre t'i mbetej Jugosllavisë.⁵⁵

Luftimet në Sanxhak, në Mal të Zi dhe në Bosnjën Lindore u zhvilluan në kohën kur në Kosovë forcat ushtarake jugosllave kishin ndërmarrë operacione të gjera ushtarake për shpartallimin e forcave nacionaliste shqiptare të qëndresës. Pra, ndërsa partizanët shqiptarë luftonin në Mal të Zi, në Bosnjën Lindore etj., forcat ushtarake serbe e malazeze terrorizonin e masakronin trevat e pambrojtura shqiptare.⁵⁶

Në historiografinë e Kosovës ka dominuar teza e diskutueshme (e paqëndrueshme) së Lëvizja partizane në Kosove dhe në trevat shqiptare për rreth (1941-1945) ka qenë Lëvizje Çlirimtare dhe se këto troje në nëntor të vitit 1944 u çliruan. Sikur

⁵⁵ Lefter Nasi, *Ripushtimi i Kosovës (shtator 1944-korrik 1945)*, Tiranë, 1996, f. 71.

⁵⁶ Po aty, f. 724.

ky problem të trajtohet me një qasje kritike e në mbështetje të argumenteve të qëndrueshme , do të rezultonte së Kosova dhe trevat shqiptare për rreth nuk u çliruan në nëntor të vitit 1944, por u ripushtuan nga forcat partizane jugosllave e bullgare (këto të fundit të konvertuara nga fashistë në antifashistë brenda natës). Për ironinë e gjërave këto forca u mbështeten fuqimisht edhe nga formacionet partizane të Shqipërisë. Prandaj qëndresa kundër zgjedhës jugosllave dhe lufta për çlirim kombëtar e demokraci që udhëhoqi Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare në të gjitha trojet etnike, gjatë dhe menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, u shndërrua në Lëvizje të fuqishme për çlirimin dhe bashkimin kombëtar. Kjo qëndresë e radhiti Kosovën dhe trevat e tjera shqiptare në Jugosllavi në pararojë të forcave prodemokratike të Ballkanit dhe të Evropës Lindore, që iu kundërvunë që nga fillimi sistemit totalitar komunist, por që nuk patën mbështetjen e Aleancës Antifashiste. Si rrjedhim, vazhdimi i dhunës dhe terrorit mbi pjesën e popullit shqiptar për disa dhjetëvjetësja e mbajti të ndezur zjarrin e frymës e rezistencës dhe të kryengritjes e të luftës për liri e pavarësi, e cila mori intensitet sidomos në vitet e 90-ta dhe kulmoi me Luftën Çlirimtare të viteve 1998-1999, me të cilën mori fund pushtimi i Kosovës nga Serbia. Por, Maqedonia Shqiptare, Kosova Lindore, dhe treva të tjera mbeten nën sundimin e huaj.

Dr. Skender ASANI
(Shkup)

**ZHVILLIMET POLITIKE NË SHKUP PAS
KAPITULLIMIT TË BULLGARISË (SHTATOR - NËNTOR
1944)**

Shkupi me rrethinë pas tërheqjes së ushtrisë bullgare në pjesën e dytë të vitit 1944, kontrollohej nga forca të ndryshme politike e ushtarake. Në veriperëndim dhe jugperëndim të Shkupit, shtriheshin forcat vullnetare të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, në juglindje dhe verilindje qëndronin forcat partizane maqedonase, në vendbanimet serbe në veri dhe verilindje shtriheshin çetnikët, ndërsa në qytet qëndronin gjermanët. Krahas gjermanëve, Shkupin e kontrollonte edhe Komiteti i VMRO-së (Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - S.A.), si edhe paria shqiptare, respektivisht Myftinia e Shkupit, që i prinin Myftiu Sait Hoxha, Hasan Shukriu, drejtor i Vakëfit, Emin Beu, Ismail hoxhë Kaçaniku etj.¹ Paralelisht me tërheqjen e trupave bullgare nga Shkupi, gjermanët organizuan një konferencë, me qëllim që të themelohej një komitet maqedono-shqiptar, i cili do ta merrte pushtetin në duart e tij. Në atë konferencë ishin të ftuar një numër i madh i maqedonasve,

¹ *Државен Архив на Република Македонија* (më tej: ДАРМ).Ф.УДБ-РСВР.Д.53000448, Записник од саслушањето на окривенијот Саид Идриз Саид, бивш Муфтија од Скопје, работено за УДБ за Македонија на 4.1.1949 год.

ndërsa nga paria shqiptare merrte pjesë vetëm Said Efendiu. Konferencën e udhëhoqi një gjerman i quajtur Dirigell, i cili do të kërkonte nga myftiu i Shkupit, që t'i "përfaqësonte myslimanët (shqiptarët) e këtij qyteti". Mirëpo, duke e pasur parasysh se pjesëmarrja e shqiptarëve ishte tejet simbolike, në krahasim me të krishterët, Said Efendiu, refuzoi të emërohej në atë komitet. Ai në fjalimin e tij, veç tjerash, vuri në dukje se, do të mbaj një konferencë nga krerët më me ndikim të myslimanëve, duke shtuar se: "këtu do t'i zgjedhim, se cilët persona do të futen në komitet, të cilët do të mund ta udhëheqin punën, individë të ri që e njohin punën dhe që do të mund të vrapojnë e ngjashëm..."²

Nuk vonoi shumë dhe Said Hoxha thirri një konferencë me krerët shqiptarë të Shkupit. Konferenca u mbajt në sallën e Myftinisë. Interesimi ishte shumë i madh, saqë një numër i madh ngelën jashtë sallës. Ndër personalitetet që morën pjesë në konferencë, krahas Said Efendiut, duhen veçuar: Emin Beu, Ismail hoxhë Kaçaniku, Riza Aga-Kaçaniku, Feta efendi Raufi, Hafëz Irfani, Hafëz Aliu, Besim Sahatçiu, Reshit Xhavitin, Ali Nexhipi, Halit Berberi, Nuri Fetahu, etj. Në konferencë foli Said Hoxha, i cili më gjerësisht i informoi pjesëmarrësit, rreth themelimit të Komitetit myslimano - kristian, dhe se siç vuri në dukje, "duhen zgjedhur disa personalitete të cilët do të hynin në komitet me qëllim që bashkëpunimi i ynë të rezultojë në

² ДАРМ.Ф.УДБ-РСВР.Д.53000448,Записник од саслушањето на окривенијот Саид Идриз Саид, бивш Муфтија од Скопје, работено за УДБ за Македонија на 4.1.1949 год., Said Hoxha, lidhur me mbajtjen e kësaj konference në procesverbal thekson: "Menjëherë pas kapitullimit të Bullgarisë, në myftini erdhi një person nga dhoma e tregtarëve dhe më ftoi që të shkoj atje, sepse është thirrur një konferencë. Kur shkova atje salla ishte e stërmbushur. Më shumë ishin qytetarë të krishterë, si tregtarë, mjekë etj., ndërsa prej myslimanëve pati shumë pak. Nga gjermanët ishte Dirigell. Konferenca qe thirrur për të themeluar një komitet për Shkupin dhe rrethinën, i cili do ta merrte pushtetin dhe në bashkëpunim me gjermanë do ruante rendin. Komiteti duhet të ishte i përzier me atë të krishterë ashtu edhe me myslimanë. Mu ofrua që edhe unë të marr një vend të rëndësishëm, që t'i përfaqësoja myslimanët. Me këtë propozim nuk u pajtova, thash se do të thërras një konferencë në myftini me myslimanë më me ndikim dhe këtu të vendosnin, se cilët njerëz do të hynin në komitet, të cilët do të mund ta drejtonin punën, të cilët e njihnin gjuhën, të rij që do të mund të vrapojnë e ngjashëm..."

ruajtjen e rendit në qytet”.³ Kërkesa e Said Efendiut, u përkrah nga pjesëmarrësit, të cilët më pas si përfaqësues të tyre në Komitetin myslimano - kristian zgjodhën: Emin Beu, Feta efendi Raufin, Qani Jusufin, Nuri Fetafun dhe Reshit Xhavitin. Kryetar i Komitetit maqedono - shqiptar u zgjodh Stefan Stefanov, ndërsa zëvendës kryetar u zgjodh Emin Beu.⁴ Menjëherë pas formimit të Komitetit, me sugjerimin e Dirigelit, u zgjodh kreu i policisë së Shkupit. Për kryeshef u zgjodh Stefan Sefanov, ndërsa për komandant të policisë Emin Beu. Gjithashtu, Qani Jusufi, mori postin e komandantit të policisë për lagjen “Jahja Pasha”, ndërsa Reshit Xhaviti u zgjodh në udhëheqësin e shëndetësisë së Shkupit.⁵

Ndërkohë, posa u themelua Komiteti i përmendur më sipër, në Shkup shkoi Mefail Zajazi bashkë me Arif Kapedanin, të cilët në Bojali Han organizuan një takim me krerët shqiptarë. Qëllimi i ardhjes së tyre në Shkup, ishte: “që të konsultohen me parinë e Shkupit për vendosjen e pushtetit shqiptar në qytet”.⁶ Në mbledhje ishte ftuar edhe Said Efendiu, mirëpo, për arsye të panjohura ai nuk morri pjesë.⁷ Me qenë se drejtuesit shqiptarë të Shkupit, pa pëlqimin e Said Efendiut, nuk dëshironin të merrnin asnjë vendim, në mbledhje u vendos që një delegacion i udhëhequr nga Mefail Zajazi, Arif Arifi dhe imami i xhamisë së “Jahja Pashës”, Hamdi Nuha, të takoheshin me Said Efendiu.⁸ Takimi u mbajt në shtëpinë e myftiut. Mirëpo, edhe për kundër insistimeve nga ana e Mefailit, që Shkupin ta marrin në duart e veta shqiptarët, myftiu nuk u pajtua.⁹ Ekziston mundësia, që refu-

³ Po aty.

⁴ ДАРМ.1. 267..9056,27.IX.1944.

⁵ Po aty.

⁶ ДАРМ.Ф.УДБ-РСВР.Д.Ариф од Дрвента. АМ.Ф.УДБ-РСВР.

⁷ ДАРМ.Ф.УДБ-РСВР.Д.53000448, në deklaratën e Said Hoxhës, para organeve të UDB, mospjesëmarrja e tij në këtë mbledhje qëndronte në faktin se paria e Shkupit, në këtë kohë ishte e ndarë në dy pjesë, ku dominon fryma orientalo - turke.

⁸ Po aty, Д.Нуха Хамди од Скопје, lidhur me aktivitetin politik të Hamdi Nuhës UDB-a në dosjen e tij veç tjerash shkruan: “hoxhë, imam në xhaminë e Jahja Pashës. Pas kapitullimit të Bullgarisë bashkërisht me komandantin e Ballit - Mefailin dhe Arif Kapetanin shkuan te shtëpia e myftisë Said Idriz Said...”.

⁹ Po aty, Д.Емин Бег: Emin Beu, tash më ishte nënkryetar i Komitetit myslimano - krishterë, dhe komandant i policisë për qytetin e Shkupit, i cili nuk dëshironte që pushtetin

zimi i Said Efendisë, të jetë i lidhur drejtpërsëdrejti me disa lëvizje pro anglo-amerikane, të iniciuara nga Hamit Kruja. Burimet e UDB-ës jugosllave bëjnë të ditur se në gusht të vitit 1944, Kruja u vendos në Shkup: “me detyrë që të vendosë lidhje me anglezët në Greqi dhe krijimin e Komitetit shqiptaro - maqedonas”.¹⁰ Që këto lidhje të vendoseshin sa më parë: “Hamidi dërgoi një njeri për në Manastir”. Por në atë kohë pushtetin në ato vise e morën forcat partizane jugosllave “dhe lidhja nuk u vendos”.¹¹

Kjo informatë e plasuar nga shërbimi sekret jugosllav, përputhet me ngjarjet që do të zhvillohen më pas, rreth organizimit politik të shqiptarëve në qytetin e Shkupit. Rol vendimtar do të kenë pikërisht dy personalitetet e më sipër përmendura. Falë angazhimit të tyre, pas shumë përplasjeve dhe mosmarrëveshjeve, siç do të vërehet më poshtë, edhe më 9 shtator në Shkup u themelua Komiteti i Lidhjes të Dytë të Prizrenit. Kjo nismë, fillimisht rrodhi nga takimi i myderrizit të Tetovës, Hafëz Xhemil Efendiut me Sylë Hotlën, Xhemë Gos-tivarin, dy Mefailat dhe Aqif Reçanin. Nga mesi i shtatorit të vitit 1944, ata u takuan në afërsi të Tetovës. Në atë takim Sylë Hotlës iu dha detyrë: “që me 50 vetë të futet në Shkup dhe për Bajramin e Madh ta vë flamurin kombëtar”.¹² Mbështetur në atë vendim, Sylë Hotla në Gjilan u takua me Hamit Krujën me 1 tetor të vitit 1944, të cilin e informoi për vendimin e marrë. Sipas deklaratës së Sylë Hotlës, kuptojmë se: “Hamit Kruja personalisht do ta marr përsipër ngritjen e Komitetit”, dhe se gjatë udhëtimit për Shkup, Sylë Hotla

ta marrin krerët e Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Kjo si duket, ishin arsyeja që Said Efendiut nuk do të merr pjesë në mbledhjen e Bojali Hanit, edhe pse ishte i ftuar. Ai nuk dëshironte të krijohet një përçarje në mesin e parisë së qytetit të Shkupit, shumica e të cilëve edhe pse ishin shqiptarë, kishin një kulturë orientale, pa një definim të qartë kombëtar. Sipas UDB-së, për mosdhënien leje që forcat shqiptare nga Gjorçe Petrovi të futen në qytet, nga ana e myftiut, më i kënaqur ishte vetë Emin Beu.

¹⁰ ДАРМ.Ф.ВИИ.М.349.Реферат о Национално Демократским Шиптарски Комитета.

¹¹ Po aty.

¹² Lidhja Kosovare - Kongresi i parë botnuer, Chicago 24 - 25 nanduer, 1973, shih fjalën përshëndetëse të kryetarit të kongresit, Hafiz Jusuf Azemit, f. 70.

“t’i ofrojë atij një numër të konsiderueshëm të ushtarëve”, të cilët do të angazhoheshin “në ruajtjen e rendit”.¹³

Menjëherë pas kësaj, në fillim të muajit tetor të vitit 1944,¹⁴ Hamit Kruja i shoqëruar prej rreth 15 ushtarëve, udhëtoi në Shkup, ku do të takohet me Said Hoxhën, të cilin e informoi për qëllimin e ardhjes së tij, duke kërkuar nga ai që të mbahej një konferencë më e zgjeruar, në të cilën të “ftoheshin personalitetet më me ndikim të qytetit”. Kësaj kërkesë, iu përgjigj pozitivisht myftiu, i cili urgjentisht e ftoi parinë e atëhershme të Shkupit. Konferenca u mbajt në sallën e Myftinisë, me një pjesëmarrje tejet të madhe. Ja se si e përshkruan mbajtjen e kësaj Konference Said Efendiu: “Salla ishte e stërmbushur, ndërsa merrnin pjesë këto figura: Emin Jashari beu, Daut Ali-këpucëtari, Hafëz Nuhiu, Hafëz Mamut Ymeri, Halit Tregtari, Gani Selimi, Esad Doko nga Ohri etj”.¹⁵ Në Konferencë, të pranishmëve fillimisht iu drejtua Hamit Kruja, i cili veç tjerash, kërkoj që të themelohej Komiteti i Lidhjes së Dytë të Prizrenit, i cili “do të angazhohet që në pushtetin e sapoformuar, t’i mbrojë interesat e myslimanëve, shqiptarëve dhe turqve”. Kjo për Krujen është e domosdoshme, për shkak siç vuri në dukje “se edhe ju jeni komb dhe se duhet t’i keni po ato të drejta sikurse krishterët në shtetin e ri të cilin e krijojnë gjermanët”.¹⁶ Pas fjalës së Krujes, foli Said Efendiu, i cili u pajtua me parafolësin.¹⁷ Kështu u vendos të themelohej Komiteti i Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Me qenë se Emin Beu, më parë mbante postin e nënkryetarit të komitetit myslimano - krishterë, ai tash u zgjodh kryetar i Komitetit të Lidhjes së Dytë të Prizrenit për qytetin e Shkupit, ndërsa veç tij në të u zgjodhën edhe: Ismail Hoxhë Kaçaniku, Feta efendi Raufi, Riza Agë-Kaçaniku, Gani Selimi etj.

¹³ ДАРМ.Ф.УДБ-РСВР.К.11.Д.Космет.

¹⁴ Këto janë deklarata nga hetuesia dhe nuk jepen data konkrete dhe përcaktohen në periudha kohore gjatë muajit.

¹⁵ ДАРМ.Ф.УДБ-РСВР.Д.53000448, Записник од саслушањето на окривениот Саид Идриз Саид, бивш Муфтија од Скопје, по ату: Sipas deklaratës së Said Efendiut, shihet se kërret e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, me insistimin e gjermanëve, mbanin takime me përfaqësuesit e VMRO-së, për krijimin e një shteti të përbashkët shqiptaro - maqedonase.

¹⁶ По ату.

¹⁷ По ату.

Pasi përfundoi punimet konferenca, drejtuesit e sapozgjedhur të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, bashkë me Hamdi Krujën, organizuan një takim me udhëheqësin e komitetit të VMRO-së.¹⁸ Duhet shtuar këtu se, gjatë mbajtjes së konferencës, u vendos para ndërtesës së Myftinisë, flamuri kombëtar shqiptar.¹⁹

Në fillim të tetorit 1944, KQ i Lidhjes së Dytë të Prizrenit, në Kuvendin e saj të jashtëzakonshëm, mbajtur në Prizren, mori disa vendime të rëndësishme. Ndër to duhet veçuar, vendimin që “Hamit Kruja emërohet prefekt i Shkupit”²⁰, si dhe vendimi për themelimin e katër zonave ushtarake, për mbrojtjen e Kosovës, ku si komandant i zonës së Karadakut, u emërua Shefqet Shkupi.²¹ Menjëherë, pas këtij vendimi, Hamit Kruja, i cili deri në atë kohë mbante postin e nënprefektit në nënprefekturën e Gjilanit, u vendos në Shkup, dhe mori detyrën e prefektit, duke qëndruar në këtë detyrë deri nga mesi i nëntorit 1944, kur Shkupi e pushtuan forcat partizane.²²

Kjo periudhë e veprimit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në trevat shqiptare lindore, është me rëndësi historike, ngase ndikoi në zhvillimin e vetëdijes nacionale dhe në afirmimin e çështjes kombëtare shqiptare në suaza të brendshme dhe ndërkombëtare. Kjo lëvizje e dalë nga gjiri i popullit u shtyp. Meqë ishte lëvizje e madhe politike për unitet kombëtar, ruajtje të tërësisë tokësore dhe krijimin e shtetit të bashkuar shqiptar, ajo do të linte gjurmë dhe do të mbetej një pikë referimi për lëvizjet e mëvonshme për liri dhe bashkim kombëta

¹⁸ По ату.

¹⁹ ДАРМ.Ф.УДБ-РСВР.К.11.Д.Кружа Хамид.

²⁰ По ату.

²¹ ДАРМ.Ф.ВИИ.М.349, по ату.

²² ДАРМ.Ф.УДБ-РСВР.К.11.Д.Космет, Sylë Hotla në deklaratën e lartpërmendur thekson edhe këtë: “Hamit Kruja me vendimin e marrur udhëtoi për në Shkup dhe atje e pranoi detyrën. Me të shkuan edhe 15 ushtarë të mi”.

Ph.D. Kandidate Etleva GOXHAJ
(Tiranë)

QËNDRIMI I MBRETIT ZOG NDAJ PUSHTIMIT TË SHQIPËRISË NGA ITALIA FASHISTE

Shqipëria ka qenë vazhdimisht qendra e interesave italiane në Ballkan. Pozicioni gjeostrategjik i Shqipërisë portës së Adriatikut, zinte një vend të veçantë në planet italiane. Vendimet e 9 nëntorit 1921, produkt i Konferencës së Ambasadorëve në Paris, i njohu *de facto* interesat italiane në Shqipëri. Ky vendim do të përbënte bazën e pretendimeve ku do të mbështetej politika italiane ndaj Shqipërisë në periudhën midis dy Luftërave¹. Trysnia e vazhdueshme italiane ndaj shtetit shqiptar, të dobët ekonomikisht e të paqëndrueshëm politikisht do të përshkallëzohej përherë dhe më tepër.

Vitet '30, veçanërisht gjysma e dytë e tij, dëshmoi një agresivitet në rritje të dy shteteve diktatoriale në Evropë:

¹ Në vitet '20 e '30 qeveria italiane u lëkund midis një politike që synonte ta bënte Shqipërinë një shtet solid për t'i shërbyer si një mur mbrojtës ndaj skllavëve e grekëve të cilët i konsideronte armiq, ta kish si aleate në rast konflikti në Ballkan, ta bënte një protektorat italian ose një shtojcë të territorit kombëtar me anë të formulës së bashkimit kombëtar. Në këtë kuadër u vijëzuan synimet politike dhe ekonomike. Ilir Ushtelenca, *Diplomacia e Mbretit Zog I-rë*, Tiranë:1995, f.1

Gjermanisë dhe Italisë. Politikës agresive të diktaturave, shtetet e tjera evropiane: Britania e Madhe, por edhe Franca, iu përgjigjën me një politikë pajtimi “*Appeasement*” në emër të ruajtjes së ekuilibrit të forcave dhe paqes botërore. Në vitin 1935, Italia pushtoi Abisininë (Etiopisë), pa pasur ndonjë sanksion serioz nga Lidhja e Kombeve. Ndërkohë, pas bashkimit (anshlusit) të Gjermanisë me Austrinë në vitin 1938, Britania e Madhe nënshkroi Marrëveshjen e Mynihut (shtator 1938), e cila i lejoi Gjermanisë në mars 1939 marrjen e Sudeteve në Çekosllovakia².

Në këtë situatë ndërkombëtare u përgatit pushtimi italian i Shqipërisë. Projekti ishte një iniciativë personale e Ministrit të Jashtëm të Italisë, kontit Galeaco Çiano (Galeazzo Ciano). Pas vizitës së tij të parë në Tiranë, më 1937, ai i paraqiti Benito Musolinit një projekt për aneksimin e Shqipërisë. Sipas këtij projekti, Italia do t’i jepte ndihma ekonomike Shqipërisë; u përshpejtuan ndihmat për përfundimin e objekteve ushtarake në Veri e Jug³ dhe u hartua një listë për ndërtimin e objekteve të reja strategjike në Karaburun të Vlorës, Tepelenë, Porto-Palermo, Durrës etj⁴.

² Në një kohë kur demokracitë perëndimore, Britania e Madhe e Franca u bënë lëshime fuqive fashiste me shpresën se ato do të frenonin orekset për ekspansion të mëtejshëm territorial, Gjermania dhe Italia u inkurajuan edhe më tepër në ndërmarrjen e veprimeve agresive. Më 15 mars 1939 kur ushtria gjermane pushtoi Çekosllovakinë, situata evropiane u komplikua shumë. Kjo situatë u reflektua edhe në Ballkan dhe në Mesdhe. Ndër dy fuqitë e Boshtit, Italia ishte më e interesuar për pozitën e saj strategjike në këto dy rajone. Në planet e Musolinit Shqipëria ishte një pikëpamje e rëndësishme për zotërimin e plotë Adriatikut e për ekspansion në Ballkan. Përparimi i shpejtë gjerman në Evropën Qendrore e shqetësoi Romën sepse ende nuk kishte në fillim të vitit 1939 një marrëveshje të qartë e të shkruar midis dy vendeve për bashkëpunim e ndarje të sferave të influencës. Paskal Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë I*, Tiranë: Toena, 2013, f. 890

³ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. III, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 355.

⁴ Po aty, f. 355

Në maj 1938, një muaj pasi kishte qenë dëshmitar në dasmën e Mbretit Zog, Çiano i paraqiti Musolinit një plan më të detajuar për pushtimin e Shqipërisë. Në të përfshiheshin disa masa si: dobësimi i ushtrisë shqiptare; rekrutimi me anë të korrupsionit i një numri të madh zyrtarësh shqiptarë që do të punonin pro interesave italiane në Shqipëri; eliminimi fizik i Mbretit Zog⁵; provokimi i një kryengritje të përgjithshme në vend, gjë që do t'i jepte mundësi Italisë të ndërhynte për rivendosjen e rendit⁶. Ky projekt i kontit Çiano u miratua përfundimisht nga Musolini më 8 janar 1939⁷. Për ta zbatuar projektin në Shqipëri u dërgua Xhiovani Xhiro (Giovanni Giro)⁸, një nga krerët e Partisë Fashiste të Italisë.

Planet për pushtimin e Shqipërisë u mësuan nga Mbreti Zog në mes të shkurtit të vitit 1939. Duke kuptuar planet e Italisë, Mbreti Zog u vendos para një dileme për qëndrimin që duhet të mbante. Përgatitja e hapur për t'u bërë qëndresë italianëve, mund t'u siguronte atyre justifikimin për një ndërhyrje të armatosur në Shqipëri⁹. Ky shqetësim duket qartë në takimin që u zhvillua më 14 shkurt 1939, kur Mbreti mbledhi në Pallatin e tij: kryeministrin Koço Kote, ministrin e Punëve të Brendshme, Musa Jukën,

⁵ Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009, f. 616, 617, 618

⁶ Brend J. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja e tij për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë: Çabej, 2004, f. 279-280.

⁷ *Historia e Popullit Shqiptar Vëll. III....*, f. 356

⁸ Xhiovani Xhiro zyrtar fashist italian i cili u dërgua në Shqipëri për të organizuar rininë shqiptare sipas modelit fashist. Do të shtohet numri i shqiptarëve nën pagesën italiane dhe njerëzit më të rëndësishëm, veçanërisht bajraktarët e kryetarët e fiseve, do të bëheshin për vete mbi “një bazë personale nën shenjë e interesit të ndërsjellë, me premtime dhe korrupsion. Rreth qershorit 1939, Giro raportonte se kishte vendosur nën kontrollin e tij një pjesë të mirë të elementëve vendas. Ai shtonte se opinion publik po fryhej gjithnjë e më shumë kundër Zogut dhe se ndërhyrja italiane në rastin e një trazire nuk do të haste kurrfarë kundërshtimi. Bernd J. Fischer, *Shqipëria gjatë Luftës 1939-1945*, Tiranë: Çabej, 2004, f. 37, 38, 39 si dhe Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria nën Pushtimin Italian (1939-1943)*, Tiranë: Mësonjëtorja, 2005, f. 28

⁹ Ky qëndrim Mbreti Zog i referohej Paktit të Dytë të Tiranës, 22 nëntor 1927.

komandantin e Mbrojtjes Kombëtare, gjeneral Xhemal Aranitin, komandantin e Gardës Mbretërore, Hysen Selmanin, komandantin e Xhandarmërisë, kolonel Shefki Shatkun. Këtyre Mbreti ju tha: “Siç po e shihni punët me Italinë po venë nga prishja, megjithëse shpresat për ndreqje janë të mëdha. Por, sidoqoftë, unë kam vendosur të mos pranoj asgjë që do të cenojë sovranitetin dhe ndershmërinë e kombit shqiptar edhe nëse Italia ka për të ngulur këmbë me përdhunë d.m.th. duke na shpallur luftë. Dhe kjo është e mundur, pasi fashizmi do të përfitojë për shkak se shtetet demokratike të Perëndimit: Britania e Madhe dhe Franca nuk janë të gatshme për Luftë. Pra qëllimi im është ky: me u përgatit për çdo eventualitet, por pa i dhënë rast ankimi Italisë, d.m.th. që Shqipëria të mos quhet, as shkaktare lufte, as prishëse traktatesh, mbasi në fakt bota mbarë e di se nuk mundemi të nxitim për luftë një shtet të madh e, sidomos, kur nuk kemi përkrahje prej askujt”¹⁰.

Siç duket edhe nga këto fjalë Mbreti Zog ishte i shqetësuar. Në këto kushte ai i kushtoi rëndësi dy detyrave kryesore: *E para*: të ruhej qetësia dhe rendi publik në të gjitha krahinat e vendit¹¹. *E*

¹⁰ Hysen Selmanaj, *Nga notimet e Zogut I Mbretit të Shqiptarëve*, Tiranë: Kristalina-KH, 2008, f. 291

¹¹ Situata e ngarkuar ndërkombëtare në atë kohë pati reflektimin e saj edhe në zhvillimet e brendshme. Megjithë porosinë e Mbretit dhe impenjimin e qeverisë së Tij në muajin janar-shkurt kemi zhvillimin e e disa ngjarjeve. Me porosi të vetë Mbretit Zog u ngrit një trup gjykues, i cili do të drejtonte Gjyqin e Posaçëm për Faje Politike. Pak ditë më parë organet e Ministrisë së Brendshme kishin arrestuar 73 veta. Gjyqi i bujshëm filloi më 4 shkurt 1939 dhe vazhdoi për 5 ditë në ndërtesën e Bashkisë, në qendër të Tiranës. Akuza kundër tyre ishte se në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë përhapur në tokën e Mbretërisë me gojë dhe me shkrim, teorira dhe ideo komuniste në kundërshtim të hapur me rendin shoqëror dhe ekonomik që është në fuqi. Pasi konsumoi me ngut të pesë ditët, gjyqi kundër të 73 përfundoi më 9 shkurt 1939. Gjykata me vendimin e saj, pasditen e 11 shkurtit 1939, theksoi se faji i kryer nga 12 prej të akuzuarve “ përmbledh ekstremet juridike të nenit I të ligjës datë 30 prill 1937 mbi faje kundra rregullit shoqëror dhe ekonomik”. Për grupin tjetër të të akuzuarve vendimi gjyqësor ngulte këmbë se “veprimi i tyre është kufizuar në një bisedim të thjeshtë”. Përfundimisht

dyta: të hartohet një plan masash për t'u përgatitur për t'i rezistuar pushtimit. Lidhur me këto dy çështje Mbreti urdhëroi Ministrin e Punëve të Brendshme të thërrasë të gjithë prefektët dhe t'i këshillojë që duhet të kenë një kujdes të posaçëm këto ditë për sigurimin e qetësisë së vendit dhe në bashkëpunim me Komandantin e Xhandarmërisë të mobilizoheshin dhe të përgatiteshin për luftë. Gjithashtu, ai i dha urdhër Komandës së Mbrotjtjes Kombëtare që të bënte një mobilizim të pjesshëm, dhe të furnizonte me armë e mjete të tjera ushtarake xhandarmërinë, por që të gjitha këto duheshin bërë në fshehtësi, “pa i kuptuar organizatorët italianë të ushtrisë, e duhet të ketë si bazë kryesore mosdukjen e asnjë veprimtarie që të pezmatojë veprimet diplomatike, që po përpiqemi për të evituar këto errësira që na thurën”¹². Gjithashtu, u arrestuan disa shqiptarë të cilët dyshoheshin se po ndihmonin italianët në planet e tyre.

Në fushën e politikës së jashtme Mbreti u mundua të mbronte lirinë e vendit ndaj ndërhyrjeve gjithnjë e më të mëdha të Musolinit në jetën shqiptare. Ai filloi të bënte disa lëvizje të cilat flisnin për një politikë realiste ndaj shteteve evropiane. Filloi një politikë afrimi me Poloninë dhe Hungarinë. Kryediplomati polak që mbulonte Shqipërinë, por që deri në atë kohë selinë e kishte në Athinë, u vendos në Tiranë. Rauf Fico, ministri shqiptar i akredituar në Beograd, u transferua në Gjermani e Hungari me seli

gjyqi i bujshëm antikomunist për të 73-ve të burgosurit dhe gjithsej 102 vite. Ndëshkimi maksimal që 10 vjet dhe këtë masë të rëndë e pësuan vetëm 4 persona. Mes të dënuarve të tjerë 7 qenë me 6 vite, 4 me katër vite, 5 me tre vite, 18 me nga një vit. Të tjerët u burgosën me muaj, nga 6 në 2 dhe 1. Mes të arestuarve ndodhën dhe Qemal Stafa, i cili në gjyqin e të 73-ve e shpalli veten publikisht se ishte komunist. Kur pritej të dërgohej në burgun e vjetër të Tiranës, midis bisedës së zakonshme Qemal Stafa u pyet nga dikush “po sikur Italia fashiste të sulmojë Shqipërinë, ne çfarë qëndrimi do mbajmë?”. Ai u shpreh saktësisht: “Ne duhet të rezistojmë, kështu të pakët si jemi dhe në rast se Zogu do të rezistojë kundër fashistëve, ne do të bashkohemi me të”. *Gazeta Shqiptare*, 5 shkurt 1939, f. 1; *Gazeta Shtypi*, 12 shkurt 1939, f.1

¹² H. Selmani, *Nga notimet e Zogut I...*, f. 292, 293

në Berlin. Mbreti Zog, duke dërguar si përfaqësues të tij në Berlin z. Rauf Fico, synonte të siguronte një post vrojtimi të sigurt në Evropën Qendrore që po shndërrohej në teatrin e operacioneve që po paraprinin shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore, për të ditur se ç'mund të bëhej me Shqipërinë. Më 21 nëntor 1938, z. Rauf Fico i paraqiti Hitlerit letra-kredencialet në Berchteygarden¹³. Më 21 dhjetor u shkëmbyen në Tiranë nota ndërqeveritare, në realitet traktatet që u njihnin palëve reciprokisht të drejtën e kombit më të favorizuar në fushën e tregtisë së jashtme, megjithëse, si Shqipëria ashtu dhe Gjermania, ishin të bindura se s'do të arrihej asgjë serioze nga çka ish nënshkruar¹⁴. Gjatë muajit shkurt 1939, kujdesi i Mbretit Zog u përqendrua edhe në zbutjen e Italisë. Adjutanti i Mbretit Zog u dërgua në Itali për të zhvilluar bisedime me Benito Musolinin. Italisë iu propozua një traktat ushtarak, por ky propozim u hodh poshtë nga kjo e fundit¹⁵.

Më 23 mars, ditën që italianët morën miratimin e Hitlerit për pushtimin e Shqipërisë, Çiano (Ministri i Jashtëm) dhe Musolini hodhën në letër një projekt-traktat i cili iu paraqit Zogut në datën 25 mars 1939.¹⁶ Projekt-traktati ishte në fakt një ultimatum ndaj qeverisë shqiptare dhe parashikonte *de facto* pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste, u hodh poshtë nga Mbreti Zog. Mbreti këmbënguli duke i argumentuar qeverisë së Romës se kushtet e parashtruara prej saj ishin tepër të rënda dhe se vendosja e trupave italiane në vend, në kushte paqeje, nuk përputhej me sovranitetin e vendit. Vendosja e trupave ushtarake italiane, sipas marrëveshjeve të deriatëhershme, mund të ndodhte vetëm në kushtet e luftës, por edhe në këtë rast ajo duhej të legalizohej nga një konventë ushtarake.¹⁷ Mbreti Zog ishte i

¹³ I. Ushtelenca, *Diplomacia e Mbretit Zogu I-rë*, f. 308.

¹⁴ *Po aty*, f. 309.

¹⁵ *Po aty*, f. 326.

¹⁶ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ)*, V. 139, D. 65, fl. 11, Projekt-traktati italian paraqitur qeverisë shqiptare më 29 mars 1939.

¹⁷ *Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëll. III, f. 392.

ndërgjegjshëm se pranimi i projekt-traktatit do të thoshte humbje e sovranitetit të shtetit shqiptar e, bashkë me të, edhe i pushtetit të tij. Qëndrimin e tij Zogu ua bëri të ditur dhe përfaqësuesve diplomatikë të vendosur në Tiranë.¹⁸

Në Romë ishin përgatitur të vepronin. Për Çianon “makina ishte vënë në lëvizje dhe nuk mund të ndalej më”.¹⁹ Duke vonuar disa ditë përgjigjen, Zogu synonte të fitonte kohë për gjetjen e një zgjidhje më të favorshme për të. Këtë gjë ai ua bëri të ditur si Fuqive të Mëdha, ashtu edhe vendeve fqinjë ballkanikë. Në një letër drejtuar vendeve fqinjë thuhet se “Populli shqiptar i bashkuar rreth Mbretit të tij, nuk punonte për gjë tjetër veçse për t’u zhvilluar dhe për të fituar kohën e humbur nga skllavëria. Italianët nuk vijnë në Shqipëri sepse u kërcënohet ndonjë nga interesat e tyre, vijnë këtu që të kalojnë përpara drejt Ballkanit. Në këtë çast kritik dhe tragjik shpirti shqiptar po ju drejtohet veçanërisht juve o grekër”.²⁰

Por, fatkeqësisht, thirrjet e tij takuan heshtjen si të Fuqive të Mëdha, ashtu dhe të shteteve ballkanike. Kryeministri britanik Chamberlain deklaronte se qeveria e tij nuk kishte interesa të drejtpërdrejta në Shqipëri, por vetëm një interes të përgjithshëm, atë të ruajtjes së paqes në rajon e më gjerë.²¹ Për këtë Foreign Office mbështetej në Marrëveshjen e vitit 1938, që ishte nënshkruar midis Britanisë së Madhe dhe Italisë për ruajtjen e *status quo-së* në Mesdhe. Nga ana tjetër, Gjermania dukej se ishte e gatshme të mbështeste Musolinin në aventurën shqiptare të tij. Më 4 prill 1939, Rauf Fico, pasi ishte konsultuar me diplomatë të

¹⁸ *Documents on British Foreign Policy* (më tej: DBFP), Third Series, Vol. 5, Doc. Nr. 434/673 – 262, f. 172.

¹⁹ P. Milo, *Politika e Jashtme...*, f. 894.

²⁰ AMPJ, V. 1939, D. 64, fl. 1, Deklaratë e Ministrisë së Punëve të Jashtme, drejtuar vendeve fqinjë ballkanikë.

²¹ A. Puto, *Shqipëria Politike...*, f. 936, si dhe P. Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë...*, f. 869.

lartë gjermanë, i raportonte Mbretit Zog nga Berlioni se “në rast të një debarkimi italian, qeveria gjermane ka me përkrahë Italinë”.²²

Ndonëse në fshehtësi Mbreti Shqiptar Zog, po përpiquej të fitonte mbështetje ndërkombëtare, ai nuk mendoi ta ndante me vetë shqiptarët rrezikun që i kanosej vendit. Edhe në ditët e para të prillit, zyrtarët e lartë shqiptarë refuzonin të pranonin se situata ishte serioze. Shumica e anëtarëve të qeverisë shpreheshin me ndershmëri, pasi Zogu e drejtonte vetë shumicën e këtyre negociatave dhe nuk i kishte vënë në dijeni, edhe një pjesë të anëtarëve të kabinetit qeveritar. Madje, ministri shqiptar i Punëve të Jashtme nuk e pranonte se midis Italisë dhe Shqipërisë kishin lindur probleme serioze, ose që Shqipëria kërcënohej prej Italisë.²³

Ndërkohë që Zogu ishte në përpjekjet e tij të brendshme dhe të jashtme për të shmangur pushtimin e vendit, italianët vendosën të vepronin njëkohësisht në dy drejtime: përfundimin e përgatitjeve ushtarake për pushtim dhe vazhdimin e presionit diplomatik për ta detyruar Mbretin shqiptar të pranonte skemën italiane të projekt-traktatit.²⁴ Duke parë hezitimin e Zogut, Çiano porositi Jakomonin, që t’i bëheshin Zogut disa propozime të reja, më të moderuara, të cilat të ishin më të pranueshme për të ruajtur, sipas autorit Muharrem Dezhgiu, “nderin e mbretit shqiptar”.²⁵ Në Traktatin e ri të 2 prillit 1939 propozimet përqendroheshin në 4 pika: 1. Kontrollin nga Italia të të gjithë porteve, komunikacioneve, rrugëve dhe aerodromeve në rast se kërcënohej pavarësia e Shqipërisë; 2. Të dërgohej një këshilltar Italian në çdo ministri shqiptarë, i cili, pavarësisht nga emërimi si përfaqësues të ishte në rangun e një zëvendësministri shqiptar; 3. T’u njiheshin qytetarëve italianë në Shqipëri të drejtat qytetare dhe politike,

²² AMPJ, V. 1939, D. 44, fl. 1, Telegram i R. Ficos për Ministrinë e Punëve të Jashtme, dt. 4 prill 1939.

²³ B. J. Fisher, *Shqipëria gjatë luftës...*, f. 44.

²⁴ P. Milo, *Politika e Jashtme...*, f. 894.

²⁵ M. Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian...*, fq. 35.

njësoj si shqiptarëve; 4. Të ngrihej niveli i përfaqësimit të legatave në Tiranë e në Romë në rangun e ambasadave.²⁶

Së bashku me dorëzimin e propozimeve, Zogut iu bë e qartë edhe serioziteti i tyre. Nëse Zogu do të refuzonte sërish, në datën 6 prill në mbremje do të shpërthenin trazira të atilla që do të bënin të nevojshme ndërhyrjen e menjëhershme italiane. Pas kësaj, Zogu e ndjeu se rreziku ishte tashmë i sigurt, i afërt dhe çështje orësh. I ndodhur përballë kësaj situate, Zogu përpunoi një sërë kundërpropozimesh, në të cilat pranonte disa kërkesa të mundshme të ultimatumit italian.²⁷ Ai pranoi vetëm ato kërkesa që nuk cenonin pavarësinë dhe integritetin e Shqipërisë²⁸ dhe në një farë mënyrë dhe integritetin e tij personal.

Kundërpropozimet shqiptare iu paraqitën pasditen e 6 prillit 1939 Jakomonit, ministrit italian në Shqipëri, të cilit iu bë gjithashtu e ditur se zbarkimi i trupave italiane do të konsiderohej nga qeveria shqiptare si një sulm i armatosur.²⁹ Këto kundërpropozime u injoruan nga ana e Italisë fashiste. Jakomoni e hodhi poshtë kërkesën e Zogut duke i lënë 24 orë kohë për të reflektuar dhe vendosi orën 12 të datës 6 prill si afatin e fundit për të pranuar ultimatumin.³⁰ Tani mbetej vetëm një detyrë për qeverinë italiane, të gjendej një mënyrë për të përligjur aktin e pushtimit të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.

Italia kishte vite që punonte për ta shndërruar Shqipërinë në koloni të saj. Shqipërisë iu premtua ndihmë që më 1913 kur

²⁶ *Historia e Popullit Shqiptar...* Vëll. III, fq. 362.

²⁷ *AMPJ*, V. 1939, D. 65, fl. 13-14, Projekt i modifikuar për lidhjen e një traktati midis Shqipërisë dhe Italisë.

²⁸ *AMPJ*, V. 1939, D. 44, fl. 163, Telegram qarkore për legatat si dhe konsullatat në Berlin, Sofje, Paris, Londër, Athinë, Romë, Ankara, Beograd, Vjenë, Korfuz, Janinë, Selanik, Bari, Gjenevë, Shkup, Stamboll, ku thuhet: “Porositeni për të përgënjeshtuar çdo lajm që bën fjalë mbi ndonjë të pretenduar protektorat mbi Shqipërinë dhe mbi ndonjë konditë të papranueshme për sovranitetin dhe integritetin e vendit tonë”.

²⁹ Francesko Jakomoni, *Politika e Italisë në Shqipëri*, Tiranë: 55, 2005, f. 109.

³⁰ I. Ushtelenca, *Diplomacia e Mbretit...*, f. 323.

Fuqitë e Mëdha njohën shtetin shqiptar, ndihma të cilat nuk erdhën kurrë. Kancelaritë evropiane shpreheshin qartë, që Shqipërisë së dobët mund t'i ofronin hua financiare vetëm shtete që kishin interesa të drejtpërdrejta politike në atë vend. Në këtë pozicion do të ishte vetëm Italia dhe interesat e saj. Ajo nënshkroi me qeverinë shqiptare akte të ndryshme politike dhe ekonomike, derisa e detyroi qeverinë shqiptare që politika e saj e jashtme të ishte njëdimensionale, e orientuar vetëm nga bashkëpunimi me Italinë në të gjitha fushat dhe njohja e interesave italiane në Shqipëri. Përfundimi që i pashmangshëm: humbja e pavarësisë së Shqipërisë, duke u bërë pjesë e perandorisë koloniale italiane.³¹

Përballë kësaj situatë kërcënuese shqiptarët shfaqën gatishmërinë për të mbrojtur atdheun e tyre. Në vend u krijua një situatë pasigurie. Megjithatë Zogu dhe qeveria e tij u munduan ta mbanin krizën e marrëdhënieve me Italinë brenda kanaleve zyrtare, për opinionin e gjerë përkeqësimi i marrëdhënieve me Italinë ishte i dukshëm. Zogu u ndodh në dilemën më të madhe të jetës së tij, të luftonte apo të dorëzohej. Nuk bëri as njërin e as tjetrën.³² Shpresoi dhe u përpoq të gjente kompromisin me Musolinin, i bindur se nuk kishte rrugë tjetër.³³

Nga data 1 prill deri në datën 6 prill u organizuan demonstrata antiitaliane ku iu kërkua qeverisë shqiptare armë për të rezistuar. Forca vullnetare shfaqën gatishmërinë për t'i bërë ballë agresionit. Demonstrata patriotike u organizuan nga njerëz të thjeshtë, por veçanërisht binin në sy të rinj dhe studentë.³⁴ Ata ndoqën performancën e një loje patriotike.³⁵ Demonstruesit prisnin urdhërin e Mbretit për mobilizim të përgjithshëm. Në datën 6 prill

³¹ A. Puto, *Shqipëria Politike...*, f. 633.

³² P. Milo, *Politika e Jashtme...*, f. 895.

³³ Herman Bernstein, Hugh G. Grant, *Dy diplomatë amerikanë për Mbretin Zog*, Tiranë: Dardania, 1994, f. 70.

³⁴ Tajar Zavalani, *Historia e Shqipërisë*, Pjesa e Dytë (1878-1965), Botimi i Parë, Londër, 1966, f. 226-227, 229.

³⁵ *DBFP, Third Series*, Vol. 5, Doc. 2285/1335 -90.

1939, ish-kryeministri Mehdi Frashëri me anë të Radio Tiranës iu drejtua demonstruesve me thirrjen që të bashkoheshin me forcat ushtarake qeveritare si vullnetarë. Demonstratat ishin qartazi antiitaliane.³⁶ Një grup prej demonstruesve arriti të siguronte edhe një takim me Mbretin, i cili i përcolli duke i siguruar se ishte ende në negociata, por, do të thirreshin që të nesërmen nën armë, nëse do të ishte nevoja. Zogu siguronte se në rast sulmi, ai do të rezistonte, por për momentin bënte thirrje për qetësi sepse “negociatat vazhdonin”. Mesa duket gjatë gjithë kohës qeveria dhe vetë Mbreti Zog kanë qenë të dyzuar në lidhje me qëndrimin që duhej të mbanin ndaj Italisë. Realisht çdo gjë mbetej hermetike brenda pallatit mbretëror. Këtë ide e përforcon edhe ministri britanik në Tiranë, Sir A. Ryan në një opinion që ai ia përcjell Foreign Office në datën 4 prill. Në të thuhet se ai ishte takuar me “gjashtë kolegë të huaj pa përfshirë italianë apo gjermanë. Të gjithë e kishin të vështirë në marrjen e informacionit mbi gjendjen (faktet) reale, nga qeveria shqiptare”.³⁷

Po në mbrëmjen e 6 prillit Zogu thirri në pallat qeverinë dhe disa deputetë. Të gjithë së bashku i hodhën poshtë ultimatimet e Italisë dhe i bënë thirrje Musolinit të hynte në bisedime me qeverinë shqiptare. Por kryeministri fashist Italian dha urdhër për pushtimin e Shqipërisë, urdhër që filloi të zbatohej në orën 5.30 të datës 7 prill. Pushtimi i Shqipërisë ishte akti final i një historie të parashkruar. Zogu i humbi përfundimisht shpresat në datën 6 prill. Në datën 8 prill ai u largua nga Shqipëria. Në pasditen e datës 8 prill, Zogu kaloi kufirin për në Greqi. Ai e bëri zgjedhjen e tij. Ky largim e nxori atë përfundimisht nga jeta aktive politike e shtetit shqiptar.

Largimi i Ahmet Zogut nga Shqipëria, krijoi një vakuum institucional. Shteti shqiptar nuk ekzistonte më, por legjitimiteti i tij ndërkombëtar nuk mund të mohohej. Megjithëse populli luftoi

³⁶ DBFP, *Third Series*, Vol. 5, Doc. 2332/1335 -90.

³⁷ DBFP, *Third Series*, Vol. 5, Doc. 2332/1335 -90.

së bashku me ushtarakët atdhetarë për t'i bërë ballë pushtimit, duke regjistruar edhe dëshmorët e parë të rezistencës kundër italiane, Shqipëria u pushtua relativisht lehtë. Kjo lloj situatë tregoi se vendi ishte i papërgatitur për luftë, pa masa serioze për një qëndresë mbrojtëse, dhe pa një udhëheqje ushtarake. Ushtria kombëtare ishte shkërmoqur.³⁸ Kjo dëshmonte edhe për një politikë jo largpamëse të Mbretit Zog dhe shënon një përfundim jo të lavdishëm të pushtetit të tij.

Në ligjërimin e sotëm shkencor, por dhe publik, mendimet për largimin e Mbretit Zog janë të ndryshëm. Vetë Mbreti Zog nuk ka folur asnjëherë publikisht për këtë moment të jetës së tij. Ai nuk e ka përligjur këtë veprim të tij. Mbështetës të monarkisë janë më aktivë për ta përligjur largimin e Mbretit, me argumentet se Shqipëria e vogël dhe e pafuqishme nuk mund t'i rezistonte një fuqie të madhe, siç ishte Italia. Kështu, mos rezistenca i kurseu shqiptarëve jetë njerëzish.

Largimi i Mbretit ishte një akt i papëlqyer për shumekënd, sepse braktisja e vendit dhe mosorganizimi i një qëndrese të armatosur konsiderohej përgjegjësi madhore e tij. Koha dhe mënyra se si Zogu u largua nga Shqipëria ka mbetur një nga ngjarjet më të errëta të historisë së tij. Ai braktisi shqiptarët dhe vendin e tij në një nga momentet më të rënda të historisë së vendit. Arsyeja shtetërore, por edhe morale kërkonin që ai të qëndronte në krye të detyrës, të organizonte rezistencë kundër pushtuesve, pavarësisht sesa do të zgjaste kjo rezistencë.

Shumë zhvillime e pasoja të mëvonshme janë konsekuencë e këtij qëndrimi të 8 prillit 1939.

³⁸ M. Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian...*, f. 49-51.

Dr. Qerim LITA
(Shkup)

SITUATA POLITIKO-USHTARAKE NË TREVAT SHQIPTARE LINDORE PAS KAPITULLIMIT TË ITALISË

Në fillim të vitit 1943, me nismën e disa atdhetarëve shqiptarë nga krahina e Dibrës dhe e Lumës, u vërejt një lëvizje, e cila synonte organizimin politik e ushtarak të këtyre krahinave, si dhe të Gostivarit, Tetovës, Prizrenit etj., për një kryengritje të përgjithshme antifashiste, si dhe kundër çdo pushtuesi tjetër eventual, veçmas atij jugosllav. Në një informatë të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Tiranë, veç tjerash thuhej se, në pjesën e dytë të muajit shkurt 1943, në Dibër ishte mbajtur një mbledhje ku kishin marrë pjesë nacionalistët e njohur si: Muharrem Bajraktari, Abaz Kupi, Cen Elezi, Myftar Kaloshi, Ali Maliqi, Fiqiri Dine etj. Temë debati kishte qenë: "Shqyrtimi i një programi revolucionar"¹. Po kjo ministri, sipas burimeve të saj të vërtetuara, më 27 shkurt të atij viti njoftonte se: "... po formohet një parti nacionaliste, e cila po simbas këtyre informatave qenka formue." Themelimin e kësaj partie, kjo ministri e sheh nga fakti se: "Në mbledhjen që u ba në Dibër u lidh besa që me i mësyje kush, të jenë gati me i bamë ballë

¹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi 253, Viti 1943, K. 28, Dosja 342. f. 44.

e me qenë solidar me krahinat e tjera. Kjo lidhje bese duket çiltazi që asht politike dhe ka lidhje me një organizatë të përgjithshme."²

Krerët e lëvizjes së sipërpërmendur ftuan edhe udhëheqjen e PKSH-së të Dibrës, që të bashkëpunonin për një veprim të koordinuar, mirëpo ajo refuzoi, duke deklaruar se: "Ka me veprue vetëm simbas instruksioneve qi do t'i jepen prej qendrës së saj."³ Pavarësisht nga refuzimi, nacionalistët dibranë organizuan disa takime me Haxhi dhe Aqif Lleshin, në Maqellare dhe në Homesh⁴, mirëpo, nuk u arrit ndonjë marrëveshje konkrete, sepse, siç vinte në dukje Ministria e Punëve të Brendshme: "Shifet një ashprim marrëdhënesh ndërmjet Partisë Nacionaliste dhe asaj Komuniste". "Qëllimi i Partisë Nacionaliste, - vazhdonte informata, - asht të punojë në qetësi dhe të përgatitet që, në një eventualitet zbarkimi të fuqive anglo-amerikane në Ballkan, të fillojë veprimin e saj përkundër fuqive të Boshtit dhe deri në atë kohë, qi ata shpresojnë të jetë e afërt, të pregatiti popullin moralisht dhe materialisht për luftimin".⁵

Përballë dy opsioneve politike, asaj të nacionalizmit progresiv shqiptar (anglo-amerikan), dhe asaj të "Frontit Nacionalçlirimtar" me në krye PKSH-ë, e cila vepronte sipas diktatit të PKJ-së, shqiptarët e viseve lindore, në mënyrë masive mbështetën opsionin e parë. Për ta alternativa e duhur ishte ajo e "Bashkimit Kombëtar". Në një dokument që gjendet në Arkivin e Maqedonisë, veç tjerash thuhet se deri në vitin 1945, në radhët e Partisë komuniste të Maqedonisë pati vetëm gjashtë anëtarë shqiptarë përkatësisht në: Dibër 1 anëtar, në Gostivar 1 anëtar, në Kërçovë 2 anëtarë dhe në Kumanovë 2 anëtarë, në Tetovë dhe në Shkup nuk kishte asnjë anëtar partie⁶. Përkundër këtij fakti,

² Po aty.

³ Po aty.

⁴ AQSH, F. 253, V. 1943, K. 28, D. 342, f. 52.

⁵ AQSH, F. 253, V. 1943, K. 28, D. 342, f. 42.

⁶ Даржавен архив на Република Македонија (më tej ДАРМ) 1.878.1.9/16.

Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar i Shqipërisë, tentonte me çdo kusht t'i bindte shqiptarët e këtyre viseve të bashkëpunonin me LNÇ-në maqedonase.⁷

Me kapitullimin të Italisë fashiste (8 shtator 1943), me iniciativën e disa intelektualëve dhe nationalistëve shqiptarë nga të gjitha trojet shqiptare, saktësisht më 14 shtator 1943, në Tiranë u mbajt një kuvend kombëtar, në të cilin u formua "Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm", si dhe u vendos të rishpallet pavarësia e Shqipërisë. Kryetar i Komitetit u zgjodh Ibrahim Biçaku, ndërsa anëtarë: Eqrem Telhaj, Vehbi Frashëri, Bedri Pejani, Mihal Zallari dhe Xhafer Deva.⁸ Në seancën e parë që mbajti "Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm", u vendos që të amnistohen të gjithë të burgosurit politikë shqiptarë, pa marrë parasysh bindjet e tyre politike, ndërsa për të burgosurit jo shqiptarë u formua një komision i posaçëm, të cilit iu dha kompetencë të plotë për vendimmarrje. Veç kësaj, në seancë u vendos të lëshohet një "Thirrje", përmes së cilës njoftohej mbarë kombi shqiptar se: "Simbas vendimit të Kuvendit për shpalljen e pamvarsisë, Komiteti Ekzekutiv Provizor ka marrë në dorëzim drejtimin e punëve të shtetit deri në formimin e Qeverisë". Më poshtë, në thirrje, kërkohet: "një përkrahje morale dhe efektive" më e zgjeruar, si kusht, siç thuhet në të: "për të mujtë me e përmbushë me fitim misjonin e randë që kemi marrë mbi vëdi". Thirrja përfundonte me fjalët: "Besimi n'ardhmënin e Atdheut, vendimi i premë me i shlye radikalisht gabimet e maparshme, dëshira e jonë me i shëruë plagët e randa të popullit shqiptar janë mjetet e vetme që do të përdorën nga Komiteti Ekzekutiv Provizor. Asht detyra e çdo shqiptari me i ardhë në ndihmë Komitetit".⁹ Dy ditë më pas, 16-21 shtator 1943, në Prizrenu themelua "Lidhja II e Prizrenit"¹⁰. Në të delegatë nga viset e Shqipërisë Lindore ishin:

⁷ Qerim Lita, KQ i NDSH-së dhe Azem Marana, Logos-A, Shkup 2011, f. 24-25.

⁸ *Kombi*, Tiranë, 19 shtator 1943, f.1.

⁹ *Po aty*.

¹⁰ *Kombi*, Tiranë, 23 shtator 1943, f.1; *Kosova*, nr. 51-52-53, Tiranë, tetuer 1943.

Mentor Çoku nga Struga, Rustem Imeri dhe Shahin Cami nga Dibra, Ahmet Lusha, Jusuf Jahja nga Tetova, Remzi Ragipi dhe Kadri Saliu nga Gostivari, Shefqet Shkupi dhe Haxhi Xheladini nga Shkupi.¹¹ Ndër oratorët e parë, ishte Shefqet Shkupi, i cili në fillim u ndal në qëllimet që duhej të arrinte Kuvendi Kombëtar i Prizrenit, e që sipas tij ishin "të lidhura ngushtë me vullnetin e përbashkët të krejt Popullit të Kosovës, Dibrës, Strugës dhe Tetovës", çka "don me thanë", vazhdonte Shkupi, "pikë së pari, sigurimi i bashkimit të së gjitha këtyne vendeve me Shqipninë e Vjetër, së cilës i përkasin nga çdo pikpajje: nga ajo historike, nga ajo gjeografike dhe nga ajo etnografike; së dyti, për të sigurue plotësimin e njësisë s'onë athnike tue përfshimë në rrethin e Votrës s'onë kombëtare, të shtetit të Lirë, të pavarun, Shqiptar, të gjitha ato Vise që, për një arsye ase për një tjetër, fshajnë ende nën robni; së treti, tue u frymëzue nga vepra atdhetare e paharrueshme e Lidhjes së Prizrenit, me hedhun, qysh tashti, themelet e një organizimi mprojtjeje politike, diplomatike dhe ushtarake të këtyne të drejtave të pamohueshme para çdo të drejte, edhe para asaj ma fillestare"¹².

Ndër vendimet më të rëndësishme të Kongresit ishin: "Kërkesa për bashkim të përhershëm dhe të pazgjithshëm të të gjitha krahinave të banueme qysh prej mija vjetsh prej popullsinash shqiptar. Zani i përgjithshëm i të gjithë delegatëve nalëson vullnetin e mbarë popullatës së këtyne krahinave, që zë vendin e një plebishiti populluer për kët bashkim. Prandaj kërkojmë shpalljen botnisht të këtij vullneti të shenjtë të banorëve të Kosovës, Dibrës dhe Strugës me Shqipninë; formimi i Komitetit Qendror me seli në Prizren. Komiteti Qendror të hapë degët e saj në të gjitha prefekturat, nënprefekturat dhe komunat të krahinave të Kosovës, Dibrës dhe Strugës, të cilët do të marrin përsipër organizimin ushtarak e politik të Kosovës; mbledhjen e të gjitha

¹¹ Fejzulla Shabani, *Organizimi dhe formimi i Ballit Kombëtar në Maqedoni*, Tetovë, 2004, f. 200.

¹² *Kosova*, nr. 51-52-53, tetuer 1943.

dokumentave historike, politike dhe diplomatike që forcojnë qënien shqiptare të Tokave të Lirue, ashtu dhe ngjarjet dhe vuajtjet e pafund të banorëve të ktyne viseve në kohën e sundimit jugosllav si dokument në rase një paqeje të arthme....etj".¹³

Themelimi i "Lidhjes II të Prizrenit", sipas shërbimit sekret jugosllav OZN-a, erdhi me sugjerimin e gjermanëve, të cilët menjëherë pas kapitullimit të Italisë, vijnë në Kosovë "nën parullën çlirimi i Shqipërisë nga Italia", duke u deklaruar shqiptarëve, se "në Shqipëri kanë ardhur vetëm për shkak që ta ruajnë shtetin" nga sulmet eventuale dhe se "nuk do të përzihen në punët e tyre të brendshme" Gjithnjë sipas këtij shërbimi, ideja për themelimin e kësaj organizate erdhi nga shefi i Gestapos në Mitrovicë – Haisding, ndërsa realizues të këtij projekti ishin siç thuhej "reaksioni shqiptaromadhi" në krye me Xhafer Devën, që për synim patën: "mbrojtjen e Kosovës nga sulmet serbe dhe malazeze, krijimin e Shqipërisë në kufijtë e saj etnik"¹⁴.

Formimi i "Lidhjes II të Prizrenit", u përshëndet anë e mbanë trojeve shqiptare. Gazeta "Kombi", më 23 shtator 1943, njoftonte opinionin shqiptar se: "Viset shqiptare të lirueme, me anën e një Kongresi të mbledhun në qytetin historik të Prizrenit, shpallnë me vullnetin e tyre të lirë bashkimin me Shqipni". Më tej gazeta vlerësonte se: "me këtë bashkim, aspiratat shqiptare në Veri dhe Verilindje u-realizuan deri në skajin e mbramë; në këto dy drejtime kurgja s'jet jashtë vatrës kombëtare. Fakt ky, historik dhe me randësi të madhe". Sipas kësaj gazete, rëndësia historike është se: "për të parën herë, prej epokës iliriane, këto vise paraqiten si pjesë të një shteti shqiptar të lirë e të pavarur".¹⁵

¹³ *Kombi*, Tiranë, 23 shtator 1943, f. 1.

¹⁴ Qerim Lita, Referat për Komitetet Nacional Demokratike Shqiptare, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Prishtinë 2009, f. 11-12; Државен архив на Република Македонија (më tej ДАРМ) Ф. Војно Историки Институт, Микрофилм 349, л. 60: Реферат о Национално Демократским Шиптарским Комитетима, Београд, 1948 год.

¹⁵ *Po aty*, f. 2.

Rëndësi të madhe, themelimit të "Lidhjes II të Prizrenit", i dha edhe gazeta "Kosova", e cila në numrin për muajin tetor në tërësi ia kushtoi zhvillimeve pesë-ditore të Kongresit në Prizren. Në faqen e parë, gazeta në fjalë, shprehte vlerësimin e vetë lidhur me vendimet e Kongresit, që sipas saj: "Lidhja e rivendosun ndërmjet vëllazënve të vdjerun nuk do të këputet ma", sepse siç thuhet në të: "do të shkrihemi, po ta lypë nevoja, me rob e robi, me bij e me bija, me plang e me shtëpija, me gja e me pasuni, me të madh e me të vogël, për ta mprue, për ta përjetësue...etj".¹⁶

Ndërkohë që në Prizren zhvillonte punimet Kongresi i "Lidhjes II të Prizrenit", me iniciativë të Kadri Saliut dhe Shuaip Kamberit u thirrën në Gostivar krerët nacionalistë shqiptarë të atjeshëm, për t'u njohur me vendimet e marra në Kuvendin Kombëtar, mbajtur në Tiranë, si dhe për themelimin e degës së "Lidhjes II të Prizrenit". Pjesëmarrës në këtë takim ishin krerët intelektualë dhe nacionalistë të këtyre viseve si: Xhemë Gostivari, Aqif Reçani, Xhevat Kallajxhiu, Shuaip Kamberi, Kadri Saliu, Xhafer Sulejman Tetova, Mefail Zajazi, si dhe krerët e Lumës Muharrem Bajraktari, Osman Lita, Zyber Lita etj.¹⁷

Nuk kaloi shumë kohë dhe ndodhën disa trazira në Dibër. Këto trazira do t'i shkaktojë Svetozar Vukmanoviqi – Tempo, i cili në fillim të tetorit i dërgoi një letër Haxhi Lleshit, duke kërkuar prej tij: "Të ndërmarrë masa të rrepta ndaj reaksionit shqiptaromadh". Sipas tij, "ky reaksion në Dibër reflektohet edhe në Kërçovë." Ai po ashtu i sugjeronte "mikut" të tij që mundësisht të shkaktonte "përçarje mes ... [njerëzve në zë] duke përfutur ndonjë prej tyre". Gjithashtu "menjëherë të lëshohen propaganda për etiketimin e të tjerëve". Tempo, mandej kërkonte që Haxhi Lleshi të krijonte në Dibër një "batalion të ri dibran, me ushtarë të përzier shqiptaro-maqedonas, ku krahas flamurit shqiptar të valojë

¹⁶ *Kosova*, nr. 51-52-53, tetuer 1943.

¹⁷ Q. Lita, KQ i NDSH-së dhe Azem Marana..., po aty, f. 31; Moisi Murra, *Jeta dhe veprimtaria e Aqif Lleshit*, Tiranë, 2005, f. 103.

edhe ai jugosllav; krejt kjo duhet të bëhet në frymë të vëllazërim bashkimit, ku pushteti i ri, që do të vendoset, të jetë kryekëput pushtet komunist. Batalioni të udhëhiqet prej maqedonëve dhe shqiptarëve vendas"¹⁸, përfundonte letrën Tempo.

Reagimi i Tempos, erdhi nga shkakut se Dibrën e Madhe e çliruan forcat e bashkuara shqiptare. Bashkimi i forcave shqiptare në krahinën e Dibrës ishte bërë menjëherë pas Mukjes. Kjo mund të shihet edhe nga raporti i Sotir Vullkanit dërguar Shtabit të Përgjithshëm të LNÇSH-së, në të cilin thuhej: "Para se të merrej Zerqani, arritëm në një marrëveshje me parinë, ku u formua një lloj shtabi me qëllim që të bashkëpunojmë në luftë kundër okupatorit. Shtabi përbëhej prej Fiqiri Dines, Hysni Demës dhe Esat Ndreut"¹⁹.

Menjëherë pas çlirimit të qytetit të Dibrës, u vendos pushteti shqiptar, që përbëhej prej dy krahëve, atij nationalist dhe komunist. Kjo politikë për komunistët jugosllav ishte e papranueshme, prandaj Tempo kërkoi prej Haxhi Lleshit të zbatonte me përpikëri, marrëveshjen e nënshkruar mes Shtabit të Përgjithshëm të LNÇSH-së dhe atij të LNÇM-së. Sipas kësaj marrëveshjeje, të gjitha territoret shqiptare, që ishin bashkuar me Shqipërinë nga viti 1941, llogariteshin si territore "maqedonase", prandaj në to duhej të vendosej pushteti maqedonas. Në letrën që Tempo ia dërgoi Sh.P. të LNÇM-së, ndër të tjera vihej në dukje, se bashkëpunimi politik midis PKM-së dhe PKSh-së: "do të realizohet me ndihmën e ndërsjellët" për t'u ngritë, siç thuhet në dokument, "pakica nacionale në luftë kundër okupatorit; shumica e së cilës sot qëndron në shërbim të okupatorit: në radhë të parë është pakica shqiptare në Shkup të Maqedonisë...".²⁰ Gjithashtu, Svetozar Vukmanoviq Tempo, kishte arritur ta detyronte PKSH-

¹⁸ ДАРМ, 1. 427. 421. 01.10.1943/1.

¹⁹ АQSH, F. 41. D. 28, viti 1943. Док. 32.

²⁰ ДАРМ.Фонд. Главен Штаб на Македонија (254) Досие 20, 25.07. 1943 год., л. 2.

në, më konkretisht Enver Hoxhën, që të shpërndante një qarkore deri te komunistët shqiptarë, që punonin në Trevat Lindore, që ta “rekomandojnë politikën komuniste” dhe në mesin e popullsisë vendore shqiptare: “ta propagandojnë vëllazërim bashkimin mes popullit shqiptar me ato jugosllav...”.²¹ Krahës bashkëpunimit ushtarak, ata arritën edhe një marrëveshje ushtarake ku Partia Komuniste Shqiptare obligohej “të dërgojë çeta shqiptare, të cilat do të jenë nën komandën e Haxhi Lleshit në zonën operative i të Maqedonisë...”.²² Çetave shqiptare, sipas marrëveshjes, do t’u jepej detyrë speciale të propagandojnë në rajonet shqiptare me këto parulla:

1. Pakica shqiptare për interesat e veta, duhet që bashkërisht me maqedonasit të luftojë kundër okupatorit dhe kundër të gjithë bashkëpunëtorëve të saj.

2. Pakica shqiptare për interesat e veta, duhet të ndërpresë luftën vëllavrasëse, të cilën e inspiron okupatori dhe shërbëtorët e tij.

3. Pakica shqiptare për interesat e veta, duhet që bashkërisht me popullin maqedonas, të krijojnë UNÇ-në e përbashkët nën komandën e Shtabit të Përgjithshëm të LNÇ-së maqedonase.

4. Vetëm në këtë rrugë pakica shqiptare, bashkërisht me popullin maqedonas, do të marrë garancinë që me të vërtetë lirisht do të vendosë për fatin e vet në të drejtën e vetëvendosjes ...!²³

Marrëveshja për bashkëpunim politik dhe ushtarak që u arrit mes Tempos dhe udhëheqësit e PKSH-së, fillimisht do të kontestohej nga Haxhi Lleshi, i cili në një letër dërguar SHP të Frontit Nacionalçlirimtar, shkruante: "Në një dokument që na tregoi shoku Tempo, të firmosur nga shoku Koçi Xoxe, thuhet se disa krahina megjithëse shumica janë shqiptare, si për shembull

²¹ ДАРМ.1.254.Дос. 21, 08.08.1943 год, л.7.

²² ДАРМ.1.254.20. 25.07.1943 год, л.2.

²³ По аты.

Dibra, varen nga Shtabi Maqedonas për organizimin etj. (ky dokument ka edhe firmën e Tempos dhe të një përfaqësuesi grek)". "Nëse kjo krahinë, do të mvaret prej Shqipnisë", shkruante më tej Haxhiu, mejtojmë, natyrisht, dhe të mirën e popullit maqedhonas simbas parimit t'onë (K). E mvarmja e Dibrës nga Shtabi Maqedhonas bën përshtypje të keqe edhe në krahinat e tjera si, për shembull, në Kërçovë, në Gostivar, në Strugë e tjera, ndërsa, e kundërta, ban përshtypjen ma të mirë, meqë neve jemi të njohur në ato anë dhe i mbyllet rruga njëherë e përgjithnjë (deri sa të forcohemi ne) çdo rruge reaksionare".²⁴ Nga ky reagim që vjen prej Haxhi Lleshit, shihet qartë se kishin nisur përplasje dhe mospajtime edhe në shtabin e tij, prandaj ai kërkonte që përkohësisht, siç thekson në letër, "deri sa të forcohemi", krahina e Dibrës të ishte e varur prej Shtabit të Përgjithshëm të LNÇSH-së.

Nëse shikohet përmbajtja e marrëveshjes në të cilën Partia Komuniste Shqiptare obligohej që, krahas propagandimit politik, të dërgonte edhe çeta ushtarake, të cilat do të vepronin sipas direktivave të Shtabit të Përgjithshëm maqedonas, atëherë mund të konkludohet se krijoheshin premisa për lutjen e vëllavrasjes në këto treva. Koha kur është nënshkruar kjo marrëveshje përputhet me bisedimet e Mukjes, andaj nga kjo del se "Fronti Popullor", "Mukjen nuk e konsideronte si një projekt me karakter afatgjatë mbarëkombëtar, por si një reklamë para opinionit shqiptar, që me kalimin e kohës ajo të hidhej poshtë. Ndikimi jugosllav ishte tepër i madh, andaj Tempo, Popoviçi dhe Mugosha, nuk patën vështirësi t'i imponojnë projekte antishqiptare krahut komunist shqiptar.

Në ndër kohë, më 17-20 janar 1944, Komiteti Qendror i "Lidhjes II të Prizrenit", , organizoi kuvendin të jashtëzakonshëm, në të cilën morri pjesë e tërë struktura politike dhe ushtarake e saj. Në të, të pranishmit lidhën besë se: "Do të veprojnë pikërisht, ashtu siç patën bërë të parët e mëdhej, 65 vjet më parë, për t'i

²⁴ AQSH, Fondi 41, dos. nr.28, viti 1943, fl.25.

dalun zot me çdo çmim tokës së të parvet".²⁵ Lidhja e besës, shpejt u zgjerua edhe në prefekturat, nënprefekturat dhe komunat ku vepronte organizata e "Lidhjes II të Prizrenit" për trevat lindore. Në këtë drejtim, Shefqet Shkupi, u autorizua nga Komiteti Qendror, që të formoheshin komisione të besëlidhjes, në Shkup, Tetovë dhe Gostivar. Në raportin e Komandës së Përgjithshme të xhandarmërisë shqiptare, njoftohemi se: "...më datën 23 Kallnuer-1944, n'orën 10 para dite, në Zyrën e N/Prefekturës Gostivarit, tue qenë prezentë edhe Rreth-Komandanti, janë mbledhë parijs e Gostivarit si edhe disa nënpunësa, dhe në mest të tyne ashtë ndodhun dhe ish kolonel Shefqet Shkupi, i ardhun nga Tetova, dhe i cili ka kërkuar me pretekst se qenka i dërguem prej Komitetit të mbrojtjes Kosovës të lidh bes.". ²⁶ Më pas, raporti, njoftonte se: "Në lidhjen e besës asht kërkuar që të formohet një komision me kryetar e antar, ku si antarë do të ishte edhe Komandanti Rrethit atyshëm".²⁷

Organizimi dhe veprimet konkrete, të "Lidhjes II të Prizrenit", e pamundësuan, depërtimin e njërive partizane jugosllave, në "tokat e liruar" shqiptare. Për këtë arsye, më 26 mars 1944, komandanti i Korpusit II sulmues jugosllav, Peka Dapçeviç, i shkruante një letër, Shtabit të përgjithshëm të LNÇSH-së, ku fillimisht ankohej se: "Komiteti i Kosovës ka arrit të bëjë bashkimin e popullit në veri dhe veri-lindje të Shqipërisë në luftën kundra nesh, dhe ka arritur ta bindë atë popull se ne jemi ushtria "serbe" dhe "komuniste", dhe me këtë e ka frikësuar...".²⁸ Në vazhdim, Dapçeviçi, e paraqet qëndrimin e Shtabit të Përgjithshëm të LNÇJ-së. Ai ua bën të qartë udhëheqjes së Frontit NÇL të Shqipërisë se nuk duhej të shpresonin për lëvizje kufijsh.

²⁵ Tahir Zajmi, *E drejta me i dalë zot vetvehtës, Lidhja e Prizrenit*, Prizren, 9 prill 1944, f. 1.

²⁶ AQSH, F. 152, D. 178, v. 1944, fl. 4.

²⁷ Po aty.

²⁸ AQSH, F. 41/AP, D. 136, v. 1944, fl. 2-4.

"Ju e dini, theksonte ai, se ne qëndrojmë në atë, se as një pëllëmbë të tokës tonë, për lirin e së cilës ne luftojmë tash më tre vjet dhe japim djemtë më të mirë të vendit tonë, nuk do t'ua japim askujt, aq më pak atyre të cilët kanë arrit të grabisin disa krahina tona me ndihmën e forcave okupatore".²⁹

Siç shihet, politika e PKJ-së, nuk ndryshonte nga politika e mëparshme hegjemoniste serbe, përkundrazi, strategjia e saj, kur bëhet fjalë për çështjen shqiptare, ishte vazhdimësi e strategjisë serbe të viteve të para të shekullit XX-të. Këtë më së miri mund ta shohim nga qëndrimi i PKJ-së, që Dapçeviqi ua përcolli, udhëheqësve të PKSH-së, i cili për shumë çka përputhej me memorandumun e Vlladan Gjorgjeviqit, dërguar Fuqive të Mëdha në Londër në janar të vitit 1913, ku ndër të tjera në të thuhej: "A thua do të mundet sot Evropa pas fitores së ushtrisë së krishtere, edhe atë në një luftë legjitime të zhvilluar, të vetësakrifikohet për hir të atyre gjakpirësve dhe dhunuesve dhe të kërkojnë nga ne që tokën, të cilën ushtria jonë e ka fituar nga Turqia dhe nga shqiptarët, t'ua dorëzojmë pikërisht të njëjtëve shqiptarë, të cilët kohë më parë e kanë uzurpuar atë tokë. Edhe nëse Evropa dëshiron diçka të tillë të bëjë, populli serb asnjëherë nuk do ta lejoj atë...".³⁰

I vetmi ndryshim, që ekzistonte tridhjetë vjet më pas, qëndronte në faktin se Tito dhe PKJ, tashti si mashë, për zbatimin e kësaj politike antishqiptare, kishte PKSH. Kjo shihet edhe në vazhdimin e letrës së mësipërme, ku shprehimisht thuhej:

"1/ është e nevojshme që forcat Tuaja pjesërisht të orientohen në drejtim të Shqipërisë së veriut dhe Kosovës, me qëllim të veprimit të përbashkët me forcat tona;

2/ që pandërprerë t'i sqaroni popullit në Shqipërinë e veriut qëllimet e luftës sonë, që të pengoni intervenimin ndaj nesh e njësive ushtarake nga ajo anë;

²⁹ Po aty.

³⁰ Vlladan Gjorgjeviq, *Arnauti i Velike Sile*, Beograd 1913, god. fl. 176-177.

3/ nevojitet një lidhje sa më të fortë me ne, e që kjo lidhje e njësisve tuaja dhe tonat të kenë sukses sa më të lartë politiko-ushtarake, si në luftën e tanishme kundër okupatorit, ashtu edhe në luftën kundër reaksionit, i cila është i lidhur me okupatorin, si sot ashtu edhe nesër".³¹

Mbështetur në kërkesën jugosllave, Enver Hoxha më 15 prill 1944, urdhëroi UNÇSH-së, që brigadat e saja të kalonin në veri të Shqipërisë.³² Një ditë më pas, Liri Gega, i shkruante Enver Hoxhës, duke e njoftuar se nisja e brigadave në drejtim të veriut do të fillonte nga data 17 prill. "Brigada e I-rë me ne (Liri Gega-Q.L.) do të veproj Verçe-Shpat, shkruante Liria; brigada e V me Mehmetin do të veprojë në Sulovë dhe deri Ballsh .. forcat e brigadës së IV, të cilat kanë mbetur, do të marrin drejtim për Mokër..".³³ Më pas në letër, Gega, shprehet: "Do ta godasim armikun, do të spastrojmë terrenin nga forca reaksionare dhe do të punojmë politikisht dhe organizativisht..".³⁴

Për sa më sipër, qartë shihet se PKSH, i zbatonte me përpikmëri direktivat që vinin nga PKJ, madje edhe atëherë kur kjo e fundit kërcënohej se në asnjë mënyrë nuk do të lejonte bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Përderisa politika e PKSH-së, për sa i përket çështjes së Kosovës, dirigohej nga PKJ, në anën tjetër, "Lidhja II e Prizrenit", nëpërmjet kreut më të lartë të saj politik, në mënyrë të argumentuar, e njoftonte opinionin e gjerë shqiptar dhe ndërkombëtar, se politika e PKJ, nuk është asgjë tjetër, veç se vazhdimësi e politikës hegjemoniste serbe. Kështu, Bedri Pejani, në një shkrim botuar në gazetën "Lidhja e Prizrenit", më 28 maj 1944, veç të tjerash shkruante: "Partija komuniste Jugosllave përbuzë me krejtë shejet simptomatike të një kolektiviteti isterik çdo forcë t'organizueme shtetnore a po

³¹ AQSH, F.41/AP, D.136, Viti 1944, fl. 2-4.

³² Bernd J. Fischer, *Shqipëria gjatë luftës, 1939-1945*, Çabej, Tiranë 2004, f.271.

³³ AQSH, F.14/AP, D.78, V.1944, fl. 2.

³⁴ Po aty.

nacionale Shqiptare. Çdo punim ndërtimtar asht për te një krim apo një trathiti". Duke e komentuar politikën e PKJ, për sa i përkiste Kosovës, Pejani, shtonte: "Ajo kërkon që edhe Kosova të transformohet në një zonë anarshijet, në një zonë gërmadhash". Mirëpo, sipas tij, "një qëllim i tillë nuk mund të realizohet në një Kosovë t'organizueme. Pra, shkak i përbuzjes asht fare i qartë: Kosova nuk asht një vend i tillë ku aventurat mund të zhvillohen aqë lehtë. Populli i Kosovës nuk ka shkue n'anarshi edhe at herë kur Kosovari në shpi të vet e në tok të vet ishte ba bulku i shkajut, jo pse i pëlqente kjo robni mizore, por sepse aj ishte i sigurtë se një ditë shkajau do të shporejë prej këndeje për të shkue në vend të vet.."³⁵, theksonte veç tjerash kryetari i "Lidhjes II të Prizrenit", Bedri Pejani, në komentin e tij.

Rol të rëndësishëm, në ngritjen e vetëdijes kombëtare, në atë periudhë, pa dyshim luajti paria intelektuale dhe nacionaliste shqiptare, përkatësisht figura si: Bedri Pejani, Tahir Zajmi, Shefqet Shkupi, Shuaip Kamberi, Kadri Saliu, Shemsi Hatipi, Xhemë Gostivari, Mefail Zajazi, Sulë Hotla etj., si dhe rinia intelektuale, e krijuar gjatë viteve 1941-1944, në krye të së cilës qëndronte Azem Marana. Ky personalitet, edhe pse në moshë shumë të re, me tërë potencialin e tij mendor dhe fizikë, u përqendrua në zgjidhjen e problemit kombëtar. Në këtë drejtim, ai u aktivizua gjatë punës si mësues në Gajre të Tetovës³⁶, mandej si zëdhënës i komitetit të "Lidhjes II të Prizrenit" për qarkun e Tetovës,³⁷ dhe si gazetar fillimisht në gazetën "Lidhja e Prizrenit"³⁸, më vonë edhe në "Zanin e Sharrit".³⁹ Shkrimet e tij, që gjithmonë patën synim bashkimin kombëtar, zgjuan interesim të jashtëzakonshëm tek lexuesit shqiptarë. Në një shkrim, politiko-

³⁵ Bedri Pejani, *Nji përgjegje: Lidhja e Prizrenit*, 28 maj 1944, f. 1.

³⁶ Shkolla fillore "Muzaka"- regjistri i përditshëm - mësues Azem Marana.

³⁷ *Zani i Sharit*, Tetovë 12 tetor 1944.

³⁸ *Lidhja e Prizrenit*, Prizren, 23 mars 1944.

³⁹ *Zani i Sharit*, Tetovë, 18 tetor 1944.

historik, me titull "Qëllimet zaptuese të serbve dështuen, kufijt që na ndajshin u - zhdukën", botuar në "Lidhjen e Prizrenit", më 7 maj 1944, Azem Marana e përshkruaja kështu politikën zaptuese serbe: "Vendi i ynë, qysh prej kohëve ma të vjetra, ka pasë llojlloj okupimesh: por prej të gjithëve ma i tmerrshmi ka qenë ai i serbve tash në periudhën e fundit"...: "Ma nuk na ndan asgjë prej nanës, kufijt që na ndajshin u zhdukën, pengesat që na pengojshin bashkimin u larguan njëherë e përgjithmonë". Për të, rol vendimtar, në ngritjen e vetëdijes kombëtare në trevat lindore, pati inteligjenca shqiptare, e ardhur në ndihmë nga brendia e Shqipërisë, për të cilët ai shkruante: "Shofim nëpër rrugët e qytetit t'onë, bile edhe nëpër katundet ma të largëta, profesorat t'onë, mësuesit t'onë, nënpunsat dhe oficerat t'onë, të cilët i janë përvesh punës me gjith shpirt për me mbajt ekuilibrin në viset t'ona, në këto ditë të vështira në të cilat bota po mbytet në gjak.... Ekzistenca e Shqipërisë Ethnike mund të sigurohet vetëm me bashkëpunimin t'onë, përndryshe na pret një katastrof e tmerrshme..".⁴⁰

Mesazhi, i Azem Maranës, ishte më se i saktë, sepse propaganda që zhvillohej nga PKJ dhe satelitët e saj të mbuluar nën petkun e PKSH, në çdo mënyrë tentonin përçarjen e parisë intelektuale dhe nacionaliste shqiptare. Kjo shihet edhe nga letra e Fadil Hoxhës, dërguar SH.P. të LNÇSH-së, në të cilën veç tjerash ai shkruante: "Lidhja e Prizrenit, Iredentizmi dhe aty-këtu Zogizmi, nën parrullën mprojtja e kufijve, Shqipëria Etnike, çojnë një pjesë të mirë të masës shqiptare në luftë për mprojtjen e kufijve, që ka vu fashizmi, kundra ushtrisë s'onë (jugosllave-Q.L.) nacional çlirimtare... Urrejtja shoviniste, e mbjellun nga hegjemonistat serbë dhe mprehur nga okupatorrët dhe trathhtarët e popujve t'onë dhe friga e kthimit të kohës së vjetër, bajnë që Kosmeti të bahet baza ma e rrezikshme reacionare kundër lëvizjes s'onë nacional çlirimtare dhe asaj tujes por ardhja e

⁴⁰ Po aty, *Lidhja e Prizrenit*, 7 maj 1944 fq.3.

brigadave shqiptare në këtë terren kishte me përmbys planet e okupatorrit dhe të reaktionarëve tue e këthye këtë terren prej bazës së reaktionit në bazë liridashëse...".⁴¹

Faktet e dokumentuara dëshmojnë, se shqiptarët jashtë Shqipërisë politike të 1913-ës, fuqishëm qëndronin në linjën e politikës të "Lidhjes II të Prizrenit", dhe se forcat komuniste jugosllave e kishin të vështirë të shkelin në këto toka shqiptare pa ndihmën e brigadave komuniste shqiptare. Ishin pikërisht këto arsyt kryesore, që komunistët jugosllavë kërkuar vendosjen e brigadave partizane shqiptare në këto vise. Këtë e shohim edhe në letrën e anëtarit të SH. P. të LNÇM-së, Cvetko Uzunovski – [me pseudonimin] Abaz, dërguar SH.P të LNÇSH-së, në të cilën ai shkruante: "Me ardhjen e divizionit t'uaj në Shqipninë e mesme, me bamjen e planeve të përbashkëta aksionesh të njësiteve t'uaja dhe t'onave, na mundemi shpejtë dhe me siguri me e thye reaktionin..." "Thymja e reaktionit, vazhdonte Uzunovski, në Shqipninë e mesme dhe në terrenin e Dibrës, Kërçovës, Strugës, Tetovës dhe Gostivarit, do të thotë ...të krijosh kondita për me shvillue luftën në Shqipninë e veriut dhe në Kosovë dhe lidhjen e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare të Shqipërisë me Ushtrinë Nacional Çlirimtare të Jugosllavisë".⁴²

Për rrjedhojë, Enver Hoxha, përmes letrës dërguar në qershor të vitit 1944, e njoftonte SHP të LNÇM-së, se udhëheqja e FNÇSH-së dhe personalisht ai, në tërësi pajtoheshin që zhvillimet ushtarake kundër forcave nacionaliste shqiptare: "...në sektorët e Dibrës, Peshkopis, Librazhdit, Strugës, Kiçevës, Gostivarit dhe Tetovës të bahen të kombinuara ...", sepse, siç shprehet ai në letër, "Kemi bindjen se ndërmarrjet e përbashkëta do të japin rezultate të mira, do t'i japin një hov të ri luftës në atë sektor, do të mobilizojnë popullin e atyre krahinave rreth frontit nacional çlirimtar të Jugosllavis dhe të Shqipëris dhe këto veprime të

⁴¹ AQSH, F. 41/AP, D. 135/1, v. 1944, fl. 1.

⁴² AQSH, F.41/AP, D.135, v. 1944, fl.6.

përbashkëta do të kenë reprekusione të thella në Kosovë, ku do të hapen perspektiva lufte të gjëra dhe pjesëmarja më aktive në luftë të popujve të Kosovës në frontin nacional çlirimtar tuajin dhe në ushtërin Glorioze të popujve të Jugosllavis e udhëhequr me aq brio prej komandatit t'uaj të madh Mareshalit Tito".⁴³

Dërgimi i brigadave komuniste shqiptare, në krahinat e lartpërmendura, ishte kërkesa e hershme e kreut udhëheqës të PKJ, andaj nuk ishte e rastit që, menjëherë pas kësaj letre të Enver Hoxhës, të pasonin urimet e përzemërta si nga SHP i LNÇM, po ashtu edhe nga vetë Tito, drejtuar Enver Hoxhës. Në letrën përshëndetëse, që SHP i LNÇM i dërgonte Enver Hoxhës, veç tjerash, thuhet: "Ne krenohemi dhe ia urojmë emrimin Komandantë Supremë, dhe gradën Gjeneral - kolonellë shokut Enver Hoxha, dhe i dëshirojmë suksesë në luftën heroike që po e zhvillon populli shqiptarë dhe ushtria e saj heroike LNÇ nën udhëheqjen e djemve më të mirë të popullit Shqiptarë...".⁴⁴ Ndërsa, Tito, në letër fillimisht shpreh "krenarinë e admirimin për luftën këmbengulëse dhe të pakursyer të patriotëve shqiptarë për lirinë kombëtare kundër okupatorëve fashistë dhe veglave të tyre..", për të vazhduar: "Ndërmjet vllazërimit me armë lindi dashurija e madhe midis popujve të Jugosllavisë dhe forcave çlirimtare të Shqipërisë..".⁴⁵

Në një situatë, kur PKSh, ishte nën ombrellën e PKJ, misionarët anglezë, e kishin të qartë se ishte e pamundur të krijohet një "front i përbashkët antifashist, mes shqiptarëve dhe jugosllavëve", sidomos kjo në tokat shqiptare që ishin bashkuar në vitin 1941. Prandaj, ata, nga dhjetori i vitit 1943, filluan misionin e tyre në zonat veriore të Shqipërisë, duke mbajtur disa takime me krerët nationalist si: Muharem Bajraktari, Abaz Kupi, Gani

⁴³ AQSH, F.41/AP, D.135, v.1944, fl.6/1.

⁴⁴ AQSH, F.41/AP, D.135, V.1944, fl.7.

⁴⁵ AQSH, F.41/AP, D.135, V.1944, fl.2.

Kryeziu, Fiqiri Dine, Sherif Lita, Cen Elezi, Selman Riza, Shefqet Shkupi etj..

Një takim i tillë u mbajt në dhjetor të vitit 1943 në Gjakovë, respektivisht në shtëpinë e Hasan Kryeziut, ku, krahas tij, mori pjesë edhe një major britanik, si edhe Halim Spahia, Selman Riza, Ejup Binaku dhe Rexhep Meta. Në mbledhje u vendos të krijohet "Komiteti Nacional Demokratik Shqiptar", me kryetar Selman Rizën, si dhe të shkohet menjëherë në "formimin e çetave të armatosura nën komandën e Ejup Binakut".⁴⁶

Ndër pikat më të rëndësishme të programit të KNDSH-së, ishte "rregullimi demokratik i Kosovës në kuadër të Shqipërisë". "Ne nuk jemi kundër Rasisë dhe partizanëve, mirëpo ne nuk kemi besim te të huajt dhe dëshirojmë ta mbrojmë Kosovën nga të gjithë ata që dëshirojnë ta okupojnë atë", thuhej ndër të tjerave në program⁴⁷.

Një mbledhje tjetër me rëndësi mes "KNDSH" dhe misionarëve britanikë u mbajt në muajin shkurt 1944, në shtëpinë i Din Dobroshtit, në të cilën u mor vendimi, siç thuhet në një dokument të OZN-ës që "Kosova patjetër duhet t'i bashkëngjitet Shqipërisë". Krerët e KNDSH-së, kërkuar nga misionari britanik, që "çetat ushtarake të organizatës të furnizoheshin me pajisje ushtarake nga Britania e Madhe."⁴⁸ Një muaj pas këtij takimi, në fshatin Gjinovcë të Suharekës u mbajt një mbledhje tjetër, ku morën pjesë Selman Riza, Sokol Dobroshti, Qazim Bllaca, Halim Spahia, dhe Nuredin Haliti. Në mbledhje u vendos që Qazim Bllaca, të formonte çetën antifashiste për rrethin e Suarekës, ndërsa furnizimi i saj do të bëhej nga Britania e Madhe nëpërmjet

⁴⁶ ДАРМ. F.VII, M.348, 1946 god.,str.1-60.

⁴⁷ Qerim Lita, Referat për Komitetet Nacional Demokratike Shqiptare, po aty, f. 15-18; ДАРМ. Ф Војно Историски Институт, po aty.

⁴⁸ Po aty.

Mehdi Elezit⁴⁹, i cili me direktivën e britanikëve në këtë kohë, nga Dibra u vendos në Prizren.⁵⁰

Me formimin e "Komitetit Nacional Demokratik", tashti në tokat e çliruara shqiptare, vepronin dy organizata kombëtare, që kishin një qëllim "Çlirimin dhe Bashkimin Kombëtar". Në kuadër të këtyre organizatave (Lidhja II e Prizrenit dhe KNDSH), qëndronte mbarë popullata shqiptare, si në Kosovë, ashtu edhe në Shkup, Kumanovë, Tetovë, Gostivar, Dibër, Kërçovë dhe Strugë. Pikërisht, ishin këto arsye, që komunistët jugosllavë insistonin që me çdo kusht të vendoseshin brigadat komuniste shqiptare në këto vise. Në anën tjetër, Britania e Madhe mendonte si ta parandaloj gjakderdhjen në krahinat shqiptare, që ishin nën kontrollin e organizatave nacionaliste shqiptare, e që rrezikoheshin të pushtohen nga komunistët jugosllavo-shqiptarë. Në kuadër të kësaj politike, Qeveria e Britanisë së Madhe, më 30 qershor 1944, hartoi një plan sekret, lidhur me kufijtë e ardhshëm të Shqipërisë. Sipas këtij plani, tokat shqiptare që ishin bashkuar me Shqipërinë në vitin 1941, do të duhej të ndaheshin përgjysmë mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Kështu sipas këtij plani :

"Kufiri Shqiptaro-Jugosllav duhet të ndjekë kurrizin malor midis sistemit lumor të Adriatikut e sistemeve të Detit të Zi dhe Egjeut d.m.th., kështu ai do të mund të ndryshohej në mënyrë që të shkojë nga veriu gjatë maleve të larta midis Plavës dhe Peçit (Pejës-Q.L.), të rrotullohet në drejtim të lindjes gjatë kurrizit malor midis Drinit të Bardhë dhe Sitnicës (do të thotë gjatë lartësive midis Metohisë dhe rrafshinave të Kosovës, duke ndarë kështu midis dy shteteve krahinën të marrë nga Jugosllavia dhe dhënë Shqipërisë në këtë lokalitet më 1941), të futet në drejtim të jugut gjatë kreshtës së maleve të larta, në lindje të Prizrenit dhe të Dibrës, të arrijë Liqenin e Ohrit midis Ohrit dhe Strugës. Kufiri

⁴⁹ I vëllai i Cen Elezit, përkatësisht i biri i Elez Isufit, i cili mbante lidhje me misionin ushtarak anglez.

⁵⁰ Po aty.

veriperëndimor i Shqipërisë relativisht nuk ka rëndësi. Kufiri i vendosur më 1941 etnikisht është më i mirë se ai që ekzistonte më parë".⁵¹

Një plan tjetër, që gjithsesi ishte më i favorshëm për çështjen shqiptare, paraqiste plani i një vëzhguesi amerikan. Ndër të tjera ai përfshinte edhe pikat që po paraqiten në vazhdim:

"...Në një kohë sa më të shpejtë duhet që rreth 5 000 ushtarë amerikanë të dërgohen për të pushtuar Tiranën e Durrësin, me qëllim:

a/ Të risigurojë shqiptarët që Amerika, tek e cila shqiptarët kanë besim, interesohet për fatin e tyre.

b/ Të ndalojë ndonjë okupacion të mundshëm nga trupat ruse dhe të ndalojë planin për të futur Shqipërinë në një bllok sllav ballkanas.

c/ Të ndaloj mundësinë e F.Naç.Çl., në qoftë se ai i mund kundërshtarët e tij, që të mohojë të drejtën e aleatëve për të pushtuar Shqipërinë. Ky nuk është veprim i papëlqyeshëm.

ç/ Të ndalojë luftimet midis nacionalistëve dhe partizanëve në kufijtë e territoreve të tyre, që do të jenë caktuar.

d/ Të përgatitet për të pasur një forcë të gatshme për të invaduar Kosovën, në qoftë se do ta lypi nevoja.

e/ Të ndalojë afrimin e mëtejshëm të F.Nac.Çl. me Titon e me rusët.

.... Unë jam i mendimit që aleatët të pushtojnë Kosovën, ose të dërgojnë komision atje..

Aleatët duhet të premtojnë mbrojtjen e popullatës shqiptare, që janë për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë dhe ata duhet të jenë gati të vënë në jetë premtimet e tyre me anë të forcës ushtarake, në qoftë se ata kanë shpresë që kjo gjë do të pritët mirë nga shqiptarët mbrenda dhe jashtë Shqipërisë..".⁵²

⁵¹ Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë (më tej: AIH), A-V.159; Fondi i Arkivit të Londrës (Foreign Office-London (në vazhdim FO) 371/43567, Nr.10439.

⁵² AIH, FO.371/43554,Nr.16079/39/G-fl. 7.

Fatkeqësisht, ky plan nuk u pranua nga aleanca anglo-amerikane, për shkak presionit që bëhej nga ana e Stalinit dhe Titos, të cilët, për sa i përket Shqipërisë, me çdo kusht kërkonin që të mbështetet vetëm "Fronti Nacionalçlirimtar", me në krye PKSH, ndërsa organizatat tjera antikomuniste shqiptare të shpallen si bashkëpunëtore të fashizmit. Pa marrë parasysh këtë, qëndrimi i Parisë Nacionaliste Shqiptare nuk do të ndryshonte. Vendosmëria e prerë e shqiptarëve, mund të shihet edhe në një shkrim botuar në "Zanin e Sharrit". Veç tjerash aty thuhej: "Zani i Sharrit do të tregojë se shumica dërmuese e banorëve të këtyre viseve shqiptare ka me vendos mbi fatin e vet dhe se ky vendim është i shkurtë dhe i premë: Bashkim me nanën Shqipëri e kurrë më jashtë prehrut të saj... Pra, Sharri po e ngren zanin dhe po thotë se nuk lejonë ma kambë të huaj në këto vise thjeshtë shqiptare. Nuk lejon ma që lakmija e të huajve të plotësohet në këto vise... Zani i Sharrit do t'u tregojë se këto vise nuk kanë tjetër ideologji veç shqiptarizms, zjarrit për bashkim e çlirim".⁵³

Mesazhet e "Zanit të Sharrit", në fakt ishin mesazhe të popullit shqiptar, të cilët kishin krijuar një elitë politike dhe ushtarake, të gatshme të sakrifikonte vetveten, vetëm e vetëm të arrihet ideali i kamotshëm i shqiptarëve të kësaj ane: "Çlirimi dhe Bashkimi Kombëtar". Kjo elitë në këtë kohë qëndronte fuqishëm pranë organizatës "Lidhja II e Prizrenit", e cila udhëhiqte pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv. Në ballë të kësaj elite qëndronin intelektualët si: Shefqet Shkupi, Shaip Kamberi, Kadri Saliu, Azem Marana, Nexhmedin Besimi etj., si dhe ushtarakët në krye me: Xhemë Gostivari, Aqif Reçani, Sulë Hotla, Mefail Zajazi, Memish Bukoviku, Arif Kapetani, Ukë Cami, Mehmet Bushi, Murat Labënishti e shumë të tjerë.

⁵³ *Zani i Sharrit*, Tetovë, 5 tetor 1944, f. 1.

Dr. Zeqirja REXHEPI
(Shkup)

TETOVA DHE RRETHI I SAJ GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Lufta e Dytë Botërore, pa dyshim është një ngjarje e madhe që zë vend të veçantë në historinë njerëzore. Ishte një ndeshje historike me përmasa planetare, midis doktrinės liberalo-demokratike në aleancë me të majtën komuniste dhe doktrinės së djathtë nazifashiste. Epilogu i saj ishte një hap pararendës i fitores përfundimtare të liberalizmit demokratik në Evropë dhe më gjerë.

Me fjalë tjera, vendeve të demokracisë parlamentare (Perëndimore), fitoren e Luftës Antifashiste u duhej ta ndajnë me vendet e doktrinės marksiste. Lufta e Dytë Botërore, krijoi dy kampe kundërshtare, ku secili përpiqej që përmes premtimeve të joshte sa më shumë vende dhe popuj. Në formulimin e këtyre premtimeve llogariteshin antagonizmat e trashëguar nga e kaluara historike. Në Ballkan, kishte shumë të këtillë. Në këtë cep të Evropës, “forca” dhe aleancat më të fuqishme kishin përcaktuar në të kaluarën fatin e popujve dhe të vendeve. Duke e njohur këtë histori të dhimbshme, me plot kundërthënie, fuqitë e njërit apo tjetrit kamp nuk e patën të vështirë të bëjnë për vete vende dhe popuj, përmes “pazareve”, të cilat vareshin nga epilogu i luftës.

Shqiptarët, si të gjithë të tjerët, nuk mund t'u shpëtonin zhvillimeve politiko-ushtarake të Luftës së Dytë Botërore. I ndarë përgjysmë në Konferencën e Londrës, kombi shqiptar ishte në pozitë më të pafavorshme dhe në dilemë hamletiane. Klasa udhëheqëse politike nacionaliste e shtetit shqiptar me mbretin Zog në krye, zgjodhi rrugën e “ikjes” nga vendi, me çka hapi rrugën e dezorientimit total të kombit.

Historia shqiptare e periudhës së Luftës së Dytë Botërore, nuk mund të analizohet në rrafshin ekskluziv brenda kornizave kombëtare, sepse në këtë rast “lëmshin” nuk do të mund ta zgjidhnim kurrë dhe, nga ana tjetër, do të vazhdonin të përplaseshin nga njëri ekstrem tek tjetri - epilogu i tërë kësaj do të ishte përbaltja e historisë sonë kombëtare, me këtë do të mohonim karakterin antifashist të LNÇSH.

Në qoftë se analizojmë me gjakftohtësi zhvillimet në Luftën e Dytë Botërore në hapësirën shqiptare, nuk mund t'i ikim faktit se Shqipëria është okupuar nga Italia fashiste dhe pas kapitullimit të saj, ky okupator u zëvendësua me okupatorin e ri, Gjermaninë naziste. Të dy okupatorët krijuan “qeveri kukulla”, të cilave iu dhanë kompetenca shumë të kufizuara.

Pas copëtimit të Mbretërisë së Jugosllavisë, në një pjesë të territoreve ku jetonin shqiptarët u shtri administrata e “qeverisë kukull”, e cila aplikoi disa të drejta, nga të cilat shqiptarët në Jugosllavi kishin qenë të privuar (gjuha dhe shkolla shqipe). Këtë fat e pati edhe qyteti i Tetovës, me një pjesë të rrethinës. Popullata shqiptare e trevave “lindore”, pra edhe qyteti im Tetova, këtë kohë e perceptoi si “çlirim”, edhe pse në fakt ky ishte një pushtim i ri, por i kamufluar me vellon e Shqipërisë.

Është i njohur fakti se, një ditë para invazionit të ushtrisë fashiste italiane, më 6 prill 1939, Jugosllavia ishte e njoftuar nga ambasadori jugosllav në Romë Hristiq, i cili të njëjtën ditë ishte takuar me ministrin e jashtëm italian, Kontin Çiano.¹ Jugosllavët

¹ Dnevnik grofa Qano..., f. 58-63.

nuk reagues për të penguar invazionin dhe, nga ana tjetër, madje llogariten të nxirrnin ndonjë përfitim nga situata e krijuar. Përfitimi kishte të bënte me tentativat e qarqeve ushtarake jugosllave për të “korrigjuar” vijën kufitare jugosllavo-shqiptare.² Raportet jugosllavo-taliane, pas pushtimit të Shqipërisë, u sqaruan në takimin midis Kontit Çiano dhe Dragisha Markoviqit, në Venedik, më 22-23 prill 1939, pas të cilës u dha një deklaratë e përbashkët. “Janë shqyrtuar çështje të ndryshme që u interesojnë dy vendeve, thuhej në të, duke pasur parasysh ngjarjet e fundit në Shqipëri dhe se është shprehur për zemërsia midis Jugosllavisë dhe Italisë”.³ Edhe përkundër frymës “miqësore” të deklaratës, në esencë marrëdhëniet jugosllavo-italiane ishin përkeqësuar tej mase. Të dy vendet thurnin plane të shfrytëzojnë pakënaqësinë e shqiptarëve në të dy anët e kufirit për interesat e tyre.

Shqiptarët e Mbretërisë së Jugosllavisë, përgjithësisht e dënuan pushtimin e Shqipërisë nga Italia. Me këtë rast, u organizuan demonstrata edhe në qytete të ndryshme të Jugosllavisë. Shumë shqiptarë shprehën gatishmëri për t'i rezistuar me armë pushtuesve italianë. Sipas raporteve të Korparmatës III-të jugosllave, që i dërgoheshin Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave, një numër i madh shqiptarësh kërkonin armë për të luftuar kundër italianëve.⁴

Pas shpartallimit të shumë vendeve të Evropës Veriore dhe Perëndimore gjatë vitit 1940, Fuqitë e Boshtit filluan të vinin në jetë planin tjetër për pushtimin e vendeve të Evropës Juglindore dhe Lindore. Në prill të vitit 1941 ata e shpartalluan Jugosllavinë dhe pushtuan Greqinë. Shpartallimi i Jugosllavisë ndodhi në mënyrë të rrufeshme, me ç'rast ushtria gjermane arriti në rajonin

² Arkivi i Institutit historiko-ushtarak në Beograd, nga Raporti i Korparmatës III-të, nr. 910, të 12. 04. 1039.

³ Po aty, Kutia 54, Raport i Dragisha Cvetkoviç-it dërguar Oborrit mbretëror, më 20 shkurt, 1941.

⁴ Po aty, Raporti i Korparmatës III-të, Kutia 11, nr. 18.

Shkup-Tetovë-Gostivar-Dibër. Ndërkohë, në Vjenë, më 21 prill 1941 u mbajt takimi midis aleatëve të Boshtit për ndarjen e territoreve jugosllave. Sipas marrëveshjes së Vjenës, pjesa lindore e Maqedonisë së sotme, përfshirë edhe Shkupin, iu dhanë Bullgarisë, ndërsa një pjesë e territorit të Maqedonisë Perëndimore, me qytetet: Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Strugë dhe Dibër iu dha Italisë.⁵

Mbi bazë të Marrëveshjes së Vjenës, Benito Musolini më 17 maj 1941 aprovoi Dekretin, sipas të cilit një pjesë e territorit të Maqedonisë së sotme perëndimore, me qytetet: Tetovë, Dibër, Gostivar, Kërçovë, Strugë i bashkëngjiteshin “Shqipërisë Italiane”. Në parim, aleatët e Boshtit u pajtuan me ndarjen territoriale, por pati edhe mosmarrëveshje të vogla, të cilat u zgjidhën në kontakte bilaterale. Kështu ishte rasti edhe me qytetin e Tetovës, për të cilin Bullgaria kundërshtoi që të hynte në përbërje të “Shqipërisë Italiane”.⁶ Sipas Gligor Todorovski-t, mosmarrëveshjet italo-bullgare, rreth çështjes së territoreve kanë zgjatur për një kohë, për t’u zgjidhur përfundimisht kah fundi i vitit 1942 (nëntor), pas takimeve në Tiranë dhe në Shkup, të përfaqësuesve italianë dhe atyre bullgarë.⁷ Tetova, me një pjesë të rrethinës së saj, mbeti në përbërje të “Shqipërisë Italiane”. Vija e demarkacionit që ndante Italinë nga Bullgaria kalonte në afërsi të qytetit të Tetovës, përkatësisht rreth fshatrave të banuara me shqiptarë, në linjën: Setole-Neproshten-Ratajë-Zhelinë.⁸

Sipas shënimeve të Gajur Lumës, një bashkëkohës i ngjarjeve, ushtria italiane hyri në Tetovë, më 11 maj, 1941 në një

⁵ Ferdo Çulinoviq, *Okupatorska podjela Jugoslavije*, Beograd, 1970, f. 61-70.

⁶ “Shqipëria Italiane” apo “Gjermane” një kohë të gjatë është imponuar si “Shqipëri e Madhe”.

⁷ Глигор Тодоровски, *Односи измеѓу Бугарске и Италије 1941-1943, у вези западне Македоније*, “Историјски гласник”, Београд, 1965, бр. 2-3, стр. 84-88.

⁸ Новица Вељановски: „Создавањето и развојот на органите на Народната власт во Тетово и Тетовско 1941-1944 год.,, Тетово и Тетовско во НОВ 1941-1945, f. 202.

atmosferë të veçantë dhe konfliktuale të banorëve. Elementët probullgare të Tetovës, të organizuar nga Komiteti bullgar, organizuan manifestime dhe pati përleshje midis shqiptarëve dhe bullgarëve.⁹

Mirëpo, duhet theksuar se, fillimisht, në Tetovë u vendosën trupat ushtarake gjermane, ndërsa italianët erdhën kah mesi i majit. Pushtuesit gjermanë, në Tetovë dhe rrethinë ringjallën dhe nxitën ndasinë etnike midis popullatës shqiptare dhe sllave, duke u premtuar të gjitha grupeve etnike “shtete të mëdha”, pra “Shqipëri të Madhe”, “Bullgari të Madhe” dhe “Maqedoni të Madhe” të Vanço Mihajllovi-t.

Gjatë kohës së shkurtër të administrimit të tyre, gjermanët emëruan Emil Pureber-in (i lindur në Novo Mesto), si shef të Qarkut. Ndërkaq, për nevoja të furnizimit të qytetit me artikuj të ndryshëm, formuan Këshillin e qytetit, në përbërje etnike të përzier: Jusuf Jahja (shqiptar), Trifun Apostollov-i dhe Mijo Serafimov-i (bullgarë) dhe Tomo Serafimovski (serb).¹⁰ Pikërisht në këtë kohë, pra para vendosjes së pushtetit italian, filloi aktiviteti propagandues midis aktivistëve shqiptarë (Jusuf Jahja, Shaip Kamberi, Xhafer Sulejmani...) dhe elementeve probullgare (Trifun Apostollov, Mijo Serafimov, Mijo Neshov...) se kujt do t'i takojë Tetova.

Që më 15 prill 1941, akoma pa kapitulluar Jugosllavia, qarqet probullgare në Tetovë formuan “Komitetin nacional bullgar”.¹¹ Komiteti kishte për qëllim të agjitonte te popullata sllave për t'u bashkëngjitur me Bullgarinë. Më 9-10 maj, edhe qarqet atdhetare shqiptare të Tetovës formuan “Komitetin Shqiptar”.

⁹ Ismet Jonuzi – Krosi, *Ditari i Gajur Lumës*, Tetovë, 2012, f. 71-72.

¹⁰ Sqarim: Tomo Serafimovski në prag të shkatërrimit të Mbretërisë së Jugosllavisë ka ushtruar postin e kryetarit të Komunës në Tetovë.

¹¹ Боро Митровски, Воспоставувањето на италијанската воена окупациона власт и квислиншка албанска цивилна власт, мај 1941 до септември 1943 год. Тетово..., f.. 246.

Në kohën kur akoma kishte dilema se kujt do t'i takonte qyteti i Tetovës, në gusht 1942, nënprefektura e Tetovës u vizitua nga gjenerali i ushtrisë bullgare me seli në Shkup, Bojde. Autoritetet italiane kishin marrë masat paraprake, për të evituar ndonjë konflikt të mundshëm midis shqiptarëve dhe probullgarëve.¹²

Pas okupimit italian të territoreve të Maqedonisë Perëndimore, sipas marrëveshjes së Vjenës, pushteti civil dhe gjyqësor vazhduan të funksionojnë si në Mbretërinë e Jugosllavisë, duke përdorur edhe më tutje gjuhën serbokroate.¹³ Kjo administratë tani kryente detyrat të cilat i merrte nga komanda ushtarake italiane. Situata ndryshoi në kohën kur administrata kaloi në kompetencat e qeverisë “kukull” të Tiranës.

Gjatë kohës së pushtimit italian, shqiptarëve të Tetovës me rrethinë iu hapën mundësitë për të gëzuar të drejtat më elementare kombëtare, aplikimin e gjuhës dhe arsimimit në gjuhën amtare shqipe. Tetova hyri në sistemin arsimor të “Shqipërisë Italiane”. Andaj, në Tetovë, sikurse në qendrat tjera të territorit të “çliruar”, u hapën shkolla në gjuhën shqipe dhe, krahas tyre, si nevojë urgjente u ngritën edhe kurset për shkrim-lexim. Mungesa e mësuesve u zgjidh duke i sjellë, kryesisht nga Shqipëria. Sipas të dhënave, del se në Tetovë një numër i madh i shqiptarëve ishin të interesuar për të mësuar. Është përmendur numri prej 700 vetësh si frekuentues të kurseve të gjuhës shqipe. Ndërkaq, në gjimnazin e Tetovës, në vitet 1941-42, kanë mësuar 65 nxënës.¹⁴

Për sa i përket çështjeve politiko-ushtarake, nga të dhënat e dokumentuara del se në Tetovë italianët mbanin rreth 3.000 ushtarë, 400 karabinierë dhe 400 pjesëtarë të forcave kufitare.

¹² Masar Kodra, *Shqiptarët e Maqedonisë gjatë Luftës së Dytë Botërore (1939-1944)*, Kumanovë, 1996, f. 68.

¹³ Gligor Todorovski, *Okupimi i Maqedonisë Perëndimore (1941-1944)*, Shkup, 1986, f. 11.

¹⁴ M. Kodra, *Shqiptarët...* f. 90.

Pra, nga numri i përgjithshëm prej 15.000 pjesëtarë të forcave ushtarake, në nivel të Prefekturës së Dibrës, në Tetovë ishin vendosur 3.800 trupa.

Krahas forcave ushtarake të sipërpërmendura italianët, u përpoqën edhe në Tetovë, të formonin njësitë e armatosura fashiste të këmishëzinjve. Por, ky projekt dështoi tërësisht, sepse shqiptarët nuk iu përgjigjën thirrjes.

Deri në shkurt 1944, Maqedonia Perëndimore ishte e organizuar administrativisht në Prefekturën e Dibrës, e cila përfshinte nënprefekturat: Gostivarin, Tetovën,¹⁵ Kërçovën dhe Strugën. Më 21 shkurt 1944, nënprefektura e Tetovës u ngrit në rang prefekturë. Në përbërje të saj hynin nënprefektura e Gostivarit dhe e Kërçovës.¹⁶ Në maj 1944, kryetar i komunës së Tetovës, në vend të Xhafer Sulejmanit, u bë Shaip Kamberi ndërsa prefekt u emërua T. Boletini¹⁷.

Zhvillimet politiko-ushtarake në Itali, pas invadimit të Aleatëve në Sicili, ndikuan që gjermanët të mos kapen në befasi, në çastin e kapitullimit të aleatit të tyre. Pak ditë para kapitullit të Italisë, disa njësi ushtarake gjermane u koncentruan në vijën e demarkacionit, në linjën Shkup-Tetovë, duke pritur urdhrin të hyjnë në Tetovë.¹⁸ Sapo Italia kapitulloi, trupat ushtarake gjermane hynë në Tetovë dhe qytetet tjera shqiptare, me ç'rast pushteti italian u zëvendësua me atë gjerman.

Në nivelin qendror të shtetit shqiptar, gjithashtu u bënë ndryshime. Me ndihmën e gjermanëve, më 16 tetor, 1943 u organizua “Kuvendit Popullor i Shqipërisë”, i cili, më 4 nëntor 1943, formoi qeverinë e Rexhep Mitrovicës.

¹⁵ Sqarim: Nënprefektura e Tetovës përfshinte disa qendra komunale, si: Pallçisht, Neproshten, Shipkovicë, Stençe, Senekos, Zhelinë, Brvenicë dhe qyteti i Tetovës.

¹⁶ Боро, Митровски, Некои аспекти на германската политика на Балканот и нејзиниот одраз за задушвање на НОБ во Западна Македонија 1943 год., Скопје, 1975.

¹⁷ Tafil Boletini, *Kujtime*, Tiranë, 2011, f. 464-473.

¹⁸ Зборник на НОР. Тем. VII, Књ. 2, f. 138-139.

Sipas historianit Masar Kodra, pas kapitullimit të Italisë, në një pjesë të Maqedonisë u formua zona e lirë, të cilën e drejtonin forcat partizane shqiptaro-maqedonase. Kërçova dhe Dibra ishin qytete të lira. Kërçova gjendej në duart e partizanëve maqedonas dhe shqiptarë, ndërsa Dibra drejtohej nga forcat partizane të Haxhi Lleshit. Në qoftë se pohimi rreth “territorit të lirë”, të cilin e drejtojnë forcat partizane shqiptaro-maqedonase është i saktë, atëherë duhet theksuar se Lëvizja Antifashiste ishte në epërsi përballë forcave nacionaliste shqiptare.

Duke e konsideruar pushtuesin italiano-gjerman si “të keqen më të vogël” në krahasim me sundimin serbo-jugosllav, rrethet nacionaliste shqiptare, pas kapitullimit të Italisë, organizuan një Kuvend në Prizren, në të cilin u krijua një organizatë politike, që do të përpiquej të mbronte trojet etnike nga ripushtimi jugosllav.¹⁹ Kuvendi i zhvilloi punimet nga 16-20 shtator 1943 dhe njihet në histori si Lidhja e Dytë e Prizrenit. Kuvendi zgjodhi Komitetin Qendror, (7 vetë), me kryetar Rexhep Mitrovicën. Në Kuvendin e Dytë të Lidhjes, mbajtur midis 17-21 janar 1944, në krye të KQ të Lidhjes u zgjodh Bedri Pejani.²⁰

Bazuar në qëllimet e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, Komiteti Qendror i saj formoi Komitetet e Lidhjes nëpër qytetet e “lirueme”. Një Komitet i tillë u formua edhe në Tetovë, të cilin e udhëhiqte Selim Sheholli.²¹

Sikurse në Tetovë, edhe në Gostivar, me angazhimin e gjermanëve u formua “Komiteti i Lidhjes së Dytë” në krye me Xhemë Hasin, të cilit iu dha grada major dhe iu siguria e drejta të formojë njësitin vullnetar të armatosur.²² Në këtë linjë ishte edhe Mefail Shehu – Zajazi, nga Kërçova. Pra, në qoftë se njësitë e

¹⁹ *Historia e popullit shqiptar*, vëll.IV, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, Toena: 2008, f. 139.

²⁰ *Po aty*, f. 139.

²¹ AM, Fondi, Prokuroria publike, Tetovë, Kutia 3, Dok. 426.

²² *Arkivi historiko-ushtarak në Beograd*, Kutia 1.

armatosura vullnetare të Xhemë Hasës dhe Mefail Zajazit kanë qenë nën drejtimin e Komitetit Qendror të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, atëherë del se Balli Kombëtar si organizatë politike apo ushtarake në Maqedoni nuk ka ekzistuar.

Në fillim të vitit 1944, “Lidhja e Dytë e Prizrenit” e përshpejtoi projektin e saj për mbrojtjen e “kufijve etnikë”, duke formuar edhe Komitetin Nacional të Rinisë. Komiteti i Rinisë kishte për detyrë të mobilizonte të rinjtë e moshës 15-20 vjeç. Nën përkujdesjen e Xhemës Hasës u përgatitën listat e rekrutëve nga nënprefektura e Gostivarit.²³

Në përpjekjet e tyre për të rekrutuar sa më shumë shqiptarë për njësitë e armatosura, që do t’i shfrytëzonin për qëllimet e tyre, gjermanët u përpoqën të formonin divizionin “Skënderbeg”. Por, përpjekja e gjermanëve pothuajse dështoi tërësisht. Në të vërtetë, rekrutët që u mobilizuan, arritën deri në Pogradec, prej nga u kthyen në Tetovë dhe u çarmatosën nga vetë gjermanët.

Për rendin publik në Tetovë përkujdesej xhandarmëria shqiptare, e cila sipas të dhënave dokumentare, thuhet se nuk i ndiqte ithtarët e Luftës Antifashiste, pasi komanda e saj mbante lidhje sekrete me organizatën komuniste të Tetovës. Kjo xhandarmëri shqiptare nuk i lejoi edhe Xhemë Hasën të mobilizonte njerëz nga Tetova për njësitet e tij.²⁴

Në Tetovë ka vepruar edhe organizata komuniste, e cila fillimisht vepronte përmes “celulave partiake”, (si Komitet partiak dhe SKOJ), në të cilën ka pasur të angazhuar edhe shqiptarë, ku është dalluar Gani Selmani dhe Abdurrahman Tresi. Përmes komunistëve shqiptarë është propaganduar Lufta Antifashiste tek masat shqiptare. Në ndihmë organizatës komuniste të Tetovës do të vinin edhe shqiptarë tjerë komunistë, të cilët kishin qenë anëtarë të PKJ që nga viti 1939 - 40, si: Shaip Mustafa, Abdulla Presheva,

²³ Po aty, i njëjti dokument.

²⁴ AM, Fondi Komiteti i Parë Qarkor i PK të Maqedonisë, Letër e Todor Cipovski-Merxhan, dërguar një shoku, 5. X. 1943.

Jahja Osmani. Komunistët shqiptarë e shtruan çështjen e funksionimit të organizatës së Tetovës në kuadër të PKSH, por nga instruksionet që mori Shaip Mustafa në Tiranë, komunistët tetovarë u lanë të vepronin në kuadër të PKJ.

Më duhet të them se, për komunistët shqiptarë të Tetovës ky ishte zhgënjimi i parë, ndërkaq veprimtaria tek masat shqiptare në mbështetje të Luftës Antifashiste, në këto rrethana u vështirësua.

Komunistët, në shumë sfera të veprimtarisë së tyre vepronin sipas metodologjisë së ngjashme. Kështu, organet e para të pushtetit ishin Këshillat NÇ, që në fakt ishin bërthamat e para të pushtetit komunist. Kur është fjala për Tetovën me rrethinë, nga një raport dërguar Komitetit të parë qarkor të PKM-së, në fund të vitit 1943, njihemi me faktin se në Tetovë vepronin dy Këshilla NÇ, ai shqiptar dhe ai maqedonas. Në Raport, thuhet se: “Këto Këshilla nuk janë të bashkuar, sepse nuk ka mundësi të bashkohen. Mirëpo, bashkëpunimi ekziston dhe udhëheqja e partisë është e sigurt në të dy Këshillat. Të dy Këshillat janë shumë aktivë në demaskimin e propagandës armiqësore dhe në mbledhjen e ndihmave”.²⁵ Këtë fakt e vërteton edhe V. Burzevski, i cili pasi thekson angazhimin e shqiptarëve në *organizatën komuniste të Tetovës, përfshirë këtu edhe grupet edukative dhe organizatën e rinisë (SKOJ) e cila kishte 20 shqiptarë*.²⁶

Edhe historiani maqedonas, Novica Veljanovski, thotë se: “për shkak të propagandës së fuqishme të okupatorit italian, rreth iluzionit se populli shqiptar është çliruar, më 1942 organizatat partiake (komuniste) këtë çështje filluan ta zgjidhin, duke formuar celula të posaçme shqiptare. Është sugjeruar që, përmes aktivitetit partiak shqiptarët do të fitojnë garancë për zgjidhjen e drejtë të

²⁵ AM, Fondi, Prvi oblasni komitet, Kutia-10, nr. 436. Raport i Vanço Burzevskit, dërguar Komitetit të Parë qarkor të PKM, 30. XI. 1943.

²⁶ AM, Fondi Prvi oblasni komitet, Kutia – 10, nr. 436. Letër e V. Burzevskit dërguar komitetit më 30. XI. 1943.

çështjes nacionale përmes luftës së përbashkët me popullin maqedonas në Maqedoni në kuadër të bashkësisë së re jugosllave”.²⁷

Jehonë të veçantë, me impakt në rritjen e pjesëmarrjes në njësitë e armatosura në Lëvizjen Antifashiste të shqiptarëve të Tetovës, do të kishte sulmi i forcave partizane të UNÇSH, në Dibër, në fillim të Gushtit 1944. Për shqiptarët e Tetovës dhe rrethit të saj, depërtimi i njërive antifashiste shqiptare në terrenin e ish-Jugosllavisë e lehtësoi aktivitetin e komunistëve shqiptare dhe, si epilog, përshpejtoi formimin dhe masivizimin e njërive të armatosura antifashiste, qoftë etnikisht të përziera, apo vetëm shqiptare. Në frymën e masivizimit të Luftës Antifashiste u formuan Aradha partizane shqiptare të Kërçovës dhe Dibrës. Këto dy aradha partizane shqiptare, pas çlirimit të Dibrës më 4 shtator 1944, u nisën për në Karaorman, me ç’rast, gjatë rrugës u rrit numri i shqiptarëve që i bashkëngjiteshin Luftës Antifashiste. Më 10 shtator 1944, nga këto Aradha shqiptare u formua Brigada e Katër Shqiptare, e cila fillimisht numëronte rreth 450 luftëtarë.²⁸

Deri kah fundi i vitit 1944, Brigada IV Shqiptare operoi në Rrafshin e Pollogut, pra në Tetovë dhe Gostivar dhe në fshatrat përreth. Në këtë kohë, Brigada IV Shqiptare ushtroi ndikimin e saj edhe në rastin e përfolur të “*Monopolit*” të Tetovës.²⁹ Prania e Brigadës IV Shqiptare dhe intervenimi i krerëve të saj, Nexhat Agolli, Xhafer Kodra dhe Qemal Agolli, ndikoi që shqiptarët e arrestuar dhe të mbyllur në Monopol të lirohen.³⁰ Personalisht, nuk dyshoj në tradhtinë politike të komunistëve jugosllavë

²⁷ Тетово и Тетовско... Новица Вељановски... стр. 206.

²⁸ AM, Fondi Divizioni i 42, Kutia 54a, nr. 6831. Historiku i Brigadës IV Shqiptare. (Më 7 janar 1945, Brigada IV Shqiptare u rrit në 5.000 luftëtarë – riemërtohet në Brigada VII Sulmuese, në të cilën numri i luftëtarëve u caktua në 2.500, ndërsa pjesa tjetër shpërndahet në brigada tjera).

²⁹ Në Monopolin e duhanit, në Tetovë janë izoluar një numër i madh shqiptarësh, të cilët “akuzoheshin” si “bashkëpunëtorë” të armikut.

³⁰ M. Kodra, *Maqedonia...*, f. 234-235.

kundrejt shqiptarëve dhe marrjen e masave të ashpra që pushteti komunist mori për të disiplinuar shqiptarët në Tetovë (Maqedoni), por njëkohësisht shtroj pyetjen: si do të zhvilloheshin proceset në rrafshin politik dhe ushtarak, në qoftë se do të kishte 10 brigada shqiptare (divizione apo korparmata), ashtu siç ditën të tjerët të gjinden në rrethanat përfundimtare të luftës?

Më 10 shtator 1944, gjermanët u larguan nga Tetova. Periudha prej rreth dy muaj e gjysmë (nga 10 shtatori 1944), deri në vendosjen e pushtetit komunist, karakterizohet nga përpjekjet e forcave nacionaliste për të mbrojtur “territoret e lirume” dhe të forcave komuniste shqiptaro-maqedonase, të cilat përpiqeshin të vendosin pushtetin e tyre. Disa historianë komunistë maqedonas këtë periudhë historike e përshkruajnë si një periudhë anarkie: me terror, vrasje, plaçkitje, dhunime..., natyrisht pa përmendur fakte konkrete.

Rreth çlirimit të Tetovës, në Historinë e popullit shqiptar, vëll. IV, thuhet: “Në mesin e nëntorit 1944, popullsia e Tetovës, e mbështetur nga forcat e Brigadës IV Shqiptare, u ngrit në kryengritje, çarmatosi policinë dhe më 16 nëntor vendosi pushtetin nacionalçlirimtar. Më pas Shtabi Kryesor i UNÇ të Maqedonisë urdhëroi Brigadën e IV Shqiptare të largohej nga Tetova për në Shkup”.³¹

Ndërsa, historiografia komuniste maqedonase, ka thurur legjenda, që nuk i përgjigjen realitetit. Mund të përmendet historiani, Boro Çaushev-i, i cili në punimin e tij, “Çlirimi i Tetovës”, pa kurrfarë reference, midis tjerash, shkruan: “Më 18 nëntor, brigadat e divizionit 50 dhe tre brigada të divizionit 42 e patën rrethuar tërësisht Tetovën. Në natën e ditës së njëjtë, brigada 14 depërtoi në fshatrat Miletinë dhe Çellopek; brigada 19 depërtoi në linjën Bërvenicë-Leshnicë; brigada 13 arrin në rajonin e Çellopekut; Nga ana e djathtë e divizionit 50, tre brigada depërtuan në linjën e f. Shemshovë... Nga këta pozicione, në

³¹ *Historia e popullit shqiptar ...*, vëll. IV, f. 147-148.

mëngjesin e 19 nëntorit 1944, UNÇ e Maqedonisë hyri në Tetovë, në të cilën nuk pati kurrfarë rezistence”.³²

Më tutje, thuhet: “Nga aspekti ushtarak është për t’u theksuar se të gjitha brigadat nuk hynë në Tetovë, në përbërje të plotë, për shkak të sulmeve të mundshme nga ballistët (diç e imagjinueshme), brigadat përpiqeshin të kontrollojnë një hapësirë të gjerë në rrethin e Tetovës. Kështu pas çlirimit të Çellopekut dhe Miletinës, brigada 14 është stacionuar në këto fshatra. Brigada 13 i rrethoi fshatrat: Pallçisht, Kamjan, Sedlarcë e Epërme dhe Pirok. (Autori ka harruar edhe Bogovinën, Z.R.). Në fakt, këto ishin çastet historike, kur këto brigada që kanë hyrë në fshatrat shqiptare kanë ushtruar dhunë, duke pushkatuar shqiptarë për të cilët është “dyshuar”.³³

I njëjti autor, përmend edhe për “qendrën tubuese”, siç e quan ai izolimin e shumë shqiptarëve në Monopolin e duhanit në Tetovë, në të cilin sipas tij u vendosën “ballistët” e kapur apo të dorëzuar, rreth 800-1.000 njerëz.³⁴

Mbështetur në principet universale të Lëvizjes Komuniste, “internacionalizmin” e Luftës Antifashiste, dukej qartë se fati i shqiptarëve të Tetovës me rrethinë ishte i lidhur me PKJ-PKM. Kjo çështje substanciale është kuptuar me vonesë tek shqiptarët. Andaj dhe të gjitha proceset janë kapur me vonesë, si në formën e organizimit politik, ashtu edhe atë ushtarak. Nga ky këndvështrim, shqiptarët e Tetovës ndodheshin në margjina të zhvillimit të procesit. Këtë fakt mund ta vërejmë, nga procesverbalet e Këshillit iniciativë për thirrjen e Kuvendit të Parë të ASNOM-it, të datës 30 prill 1944, nën drejtimin e Metodi Andonov – Çento-s, në të cilin nuk merrte pjesë asnjë shqiptar.³⁵

³² Тетово и Тетовско, Боро Чаушев, “Ослободување на Тетово”, стр. 107.

³³ По ату.

³⁴ Me nocionin “ballistë” në territorin e Maqedonisë identifikoheshin të gjitha forcat antikomuniste shqiptare.

³⁵ Зборник на Документи на АСНОМ 1944-1964, Скопје, 1964, стр. 112-113.

Nga dokumentet e Luftës Antifashiste, mund të vërejmë se, me rastin e përpilimit të listës së delegatëve për në Kuvendin e ASNOM-it, organet e Lëvizjes Komuniste, kur është fjala për Tetovën, nuk e kanë përfillur fare përbërjen etnike të saj. Tetova me rrethin e saj, në Kuvendin e ASNOM-it është përfaqësuar nga dy maqedonas: Todor Pecov - Cipovski (punëtor) dhe Jordan Bllazhevski (inxhinier agr.).³⁶ Ky do të ishte zhgënjimi i radhës për komunistët tetovarë.

Krerët komunistë sllavë (serbë, maqedonë etj.) nuk e përfillën realitetin etnik as në përbërjen e Presidiumit të ASNOM-it, i cili nga 17 anëtarë, kishte vetëm një shqiptar, Qemal Agollin.

Zhgënjimi i fundit për komunistët tetovarë dhe shqiptarë në përgjithësi, do të ishte “tradhtia” e idealeve të tyre, kur vërejtën se në nenin 1 të vendimeve të ASNOM-it, thuhej: “*Në shtetin maqedonas gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase*”.³⁷

Themelimi i shtetit të ri - Republikës Popullore të Maqedonisë, siç do të përkufizohet më vonë, në kuadër të Jugosllavisë Federative, ishte një devijim flagrant nga parimet e proklamuar të Luftës Antifashiste në Maqedoni.

PËRFUNDIM

Lufta e Dytë Botërore dhe shpartallimi i Jugosllavisë në vitin 1941, shqiptarët jashtë Shqipërisë dhe në veçanti shqiptarët e Maqedonisë, i vuri në pozitë tejet specifike. Një pjesë e tyre, në përbërje të Italisë dhe një pjesë tjetër, në përbërje të Bullgarisë. Pushtuesit e rinj u përkujdesën të përhapnin propagandën për “çlirimin” e popullit shqiptar, apo të popullit maqedonas.

Shqiptarët e Tetovës me rrethinë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, edhe pse në rrethana shumë të ndërlikuara, pra në rrethana të propagandës së fuqishme të pushtuesit italian dhe më

³⁶ Po aty, f. 251-252.

³⁷ Po aty, f. 241.

pas edhe atij gjerman, arritën të ruajnë njëfarë kohezioni të brendshëm ndëretnik. Me përjashtime të rasteve shumë të rralla, shqiptarët e Tetovës dhe rrethit të saj, në kohën e pushtimit italian dhe gjerman nuk ranë pre e propagandës pushtuese për të dëmtuar popullatën sllave.

Ndërkaq, forcat nacionaliste shqiptare, të cilat historiografia maqedonase i emërton me një emër “ballistë”, fatkeqësisht ishin rreshtuar në alternativën e Fuqive të Boshtit (pro-fashist). Megjithëse, nuk mund të dyshohet në atdhetarizmin e tyre, fati i tyre ishte vulosur për dështim, sepse tërë politika e Fuqive të Boshtit, dështoi.

Dr. Lush CULAJ
(Prishtinë)

VRASJET NË KLINË E RRETHINË NË VITET 1944-1945

Klina me rrethinë, si edhe tërë Kosova, në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, ishte e pushtuar dhe i nënshtrohej terrorit shtetëror të Mbretërisë Jugosllave. Në vitin 1941 ushtritë fashiste të aleatëve, Italisë, Gjermanisë dhe Bullgarisë e pushtuan këtë territor. Shqiptarët kaluan nga një pushtues nën disa pushtues të rinj. Por për dallim nga pushtuesit serbo-malazezë, pushtuesit italo-gjerman ndoqën një politikë tjetër, me qëllim që t'i përfitonin masat shqiptare. Keqtrajtimet dhe reprezaljet mbi popullin shqiptar, që ishin ushtruar nga Serbia, pothuajse në vazhdimësi nga viti 1912, tani ishin ndaluar sikurse në periudhën 1916-1918 të pushtimit austro-hungarez. Në një situatë, gjithsesi të vështirë, mbetën shqiptarët e trevave që ranë nën pushtimin bullgar.

Pushtuesit e rinj italo-gjermanë filluan që t'u njohin shqiptarëve disa të drejta kombëtare, që në atë periudhë kohore, kishin vlerë të madhe. Qytetarët shqiptarë në Kosovë ato të drejta i kërkuan shekuj me radhë në luftëra kundër pushtuesve të ndryshëm. Kështu, shqiptarëve iu lejua shkolla shqipe, administrata në gjuhën shqipe, përdorimi i lirë i flamurit kombëtar.

Duhet vënë në pah natyrisht se secili pushtues ka qëllimet e veta.

Të tillë ishin edhe italo-gjermanët, por megjithatë, pushtimi i tyre ishte shumë më i lehtë se ai i mëparshmi dhe ua mundësoi shqiptarëve një frymim më të lirshëm.

Kur komunistët jugosllavë apeluan për luftë nacional-çlirimtare, shqiptarët një thirrjeje të tillë as që i besuan. Te shqiptarët në pjesën më të madhe ishte ngulitur në kokë se serbit nuk i besohej dhe se barazia për të cilën propagandohej, ishte vetëm një demagogji. Me inkuadrimin në luftë të forcave antifashiste në Shqipëri edhe Kosova si pjesë e saj filloi të lëvizte, e natyrisht edhe Klina me rrethinë lëvizi nga vendi. PKSH-ja i bëri thirrje masës për luftë antifashiste dhe një pjesë e popullatës iu përgjigj kësaj thirrjeje me dëshirën për fitimin e lirisë që nuk e kishin shijuar ende. Këtë ua garantonin PKJ-ja, PKSH-ja dhe koalicioni antifashist. Në nëntor të vitit 1944 shqiptarët i çliruan trevat e veta dhe, në vend se t'i mbronin ato nga serbët, treguan internacionalizëm të madh, duke u nisur për çlirimin e tokave të sllavëve të jugut.

Ushtria partizano-çetnike jugosllave ishte në dijeni se Mbrojtja Kombëtare Shqiptare e Kosovës dhe lëvizja për lirinë e tokave shqiptare ishin shumë të forta dhe se qëndresa shqiptare duhej thyer për të realizuar ringritjen e Jugosllavisë në kufijtë e dikurshëm. Për realizimin e këtij qëllimi, Shtabi Operativ i Kosovës bëri dislokimin e forcave të mëdha ushtarake të “nacionalçlirimtares” në territorin e Kosovës së sotme. Kështu, në një sipërfaqe prej 10.888 km², me rreth 680.000 banorë sa kishte Kosova atëkohë, u përqendruan mbi 40.000 “partizanë”. Realisht, Kosova në fund të nëntorit 1944, menjëherë pas “çlirimit”, u shndërrua në një poligon ushtarak, ku zbatohej një pushtet nënshtrues sllav që e kishte mbështetjen vetëm në forcën e ushtrisë. Kjo ishte forma më e egër e terrorit ushtarak në Kosovë.

Sipas të dhënave jo të plota, në territoret etnike shqiptare në ish-Jugosllavi: Kosovë, Serbi Jugore, Maqedoni dhe Mal të Zi, gjatë dimrit dhe pranverës 1944-1945, u likuiduan nga njësitë e UNÇJ-së rreth 47.000 shqiptarë, ndër të cilët edhe një numër grash dhe fëmijësh, u dogjën me dhjetëra fshatra e vendbanime dhe u plaçkit e u konfiskua me të madhe pasuria e shqiptarëve¹. Shumica e të likuiduarve përbënin popullsi joluftarake, e cila nuk kishte bërë kurrfarë rezistence. Kishte shumë edhe të tillë që ishin larguar dhe strehuar në mal, ose në vende të tjera nga frika e terrorit dhe vrasjeve, të cilët, kur janë gjetur, edhe pse kanë qenë pa armë, ose janë dorëzuar vetë, janë likuiduar nga disa njësi e individë të papërgjegjshëm. Për këtë ekziston dokumentacion voluminoz nga ajo periudhë kohore, raporte të shtabeve ushtarake, ditarë të Shtabit Operativ të Kosovës, të Shtabit të divizionit 46 serb dhe 52 kosovar, vërejtje, urdhëresa etj.²

Represion dhe terror mbi popullsinë shqiptare u ushtrua pothuajse institucionalisht. Kështu, bie fjala, në urdhrin e Shtabit të divizionit 46 serb, të 5 janarit 1945, thuhej: “Si kufi se deri në çfarë mase mund të shkohet në represion le t’ju shërbejë urdhri i Shtabit kryesor të Serbisë: “Represioni në aksionet e spastrimit të bandave mund të zbatohet në të gjithë kriminelët dhe ndihmësit e tyre, por jo në tërë grupin, ose në tërë fshatrat”.³

Në urdhëresë theksohej se në asgjësimin e kriminelëve të tillë duhej vepruar pamëshirshëm, mirëpo në rrethanat ekzistuese shtrohej pyetja logjike: Kush duhej ta vlerësonte se kush është kriminel ose ndihmës? Cili ishte kriteri për këtë? Vlerësimi i tillë i

¹ *Kosova në vështrim enciklopedik*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, Botimet Toena: Tiranë, 1999, f. 118; Faton Mehmetaj, *Veprimtaria kriminale e “Dorës së zezë” serbe në trojet shqiptare*, Anatomia: Prishtinë, 2004, f. 327.

² Mikel Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror 1912-1999*, Prishtinë, 2001, f. 150.

³ Po aty.

ishte lënë secilit individ dhe është më se e kuptueshme që për pjesën dërrmuese të serbëve, malazezëve dhe maqedonasve, secili shqiptar ka qenë ose kriminel, ose ndihmës - pra armik, që duhej të asgjësohej.

Në urdhëresën e Shtabit të divizionit 46 serb, nga 29 janari, ndër të tjera shkruhej: “Represioni mbi popullsinë të mos ushtrohet përveç në raste kur kihet punë me kriminelë! Ndalohet çdo rrahje, kërkim me dhunë i armëve, po ashtu ndalohet çdo plaçkitje, kallje shtëpish, përveç në rast se këtë e kërkojnë shkaqet operative... Ndalohet çdo konfiskim të pasurisë së armiqve, pa pasur vendim gjyqi”.⁴ Me gjithë këto paralajmërime, represionet dhe krimet mbi popullsinë shqiptare vazhdonin me intensitet. Në bazë të gjendjes faktike në teren, Shtabi Operativ i UNÇ-së dhe AP të Kosovës ishte i detyruar që përsëri, më 7 shkurt 1945, t’u drejtohej komisarëve politikë të brigadave kosovare dhe t’ua tërhiqte vërejtjen për gabimet dhe lëshimet.⁵

Populli shqiptar u detyrua të hynte në bashkësinë shtetërore të sllavëve të jugut me frikë dhe ankth për ardhmërinë e vet. Premtimi i dhënë gjatë luftës antifashiste dhe i paplotësuar, si dhe mënyra e pushtimit të Kosovës dhe territoreve të tjera etnike shqiptare në Jugosllavi, në fund të vitit 1944 dhe në fillim të atij 1945, i cili për nga mënyra e veprimit nuk dallonte aspak nga pushtimi i vitit 1912 dhe 1918, vetëm sa i rriti edhe më tepër frikën dhe dëshpërimin e popullit shqiptar.

Fushata e dhunës dhe e terrorit, e ndërmarrë nga repartet ushtarake jugosllave, i shkaktoi dëme të mëdha popullit shqiptar. Ajo, në të njëjtën kohë, thelloi hendekun e mërive dhe të armiqësive ndërmjet popujve të kësaj treve, që u trashëgua nga e kaluara, si dhe ngjalli urrejtjen e revoltën e natyrshme të këtij populli. Revolta përfshiu edhe repartet partizane kosovare.⁶

⁴ Vjetari i Arkivit të Kosovës, XXI-XXII - 1986, f. 301.

⁵ Po aty, f. 318.

⁶ Lefter Nasi, *Ripushtimi i Kosovës shtator 1944-korrik 1945*, Akademia e

Përpjekjet për spastrimin etnik të Kosovës dhe të trevave të tjera etnike shqiptare, të pushtuara nga Jugosllavia, u forcuan sidomos pas vitit 1944, me justifikimin se kinse luftohej kundër “kundër-revolucionit” dhe “mbeturinave” të tij. Pas rivendosjes së pushtetit okupues jugosllav, që në nëntor të vitit 1944, masakrat ndaj shqiptarëve i vazhduan çetnikët e konvertuar në partizanë.⁷ Për Serbinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi, tashmë nuk ishte problem çlirimi nga pushtuesit, por pushtimi dhe aneksimi i trevave shqiptare, pasi, tek e fundit, nazifashizmi gjerman dhe bullgar po jepte shpirt.⁸ Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Kosova dhe trevat e tjera etnike shqiptare në Jugosllavi u ndanë në katër njësi të Federatës jugosllave: në atë të Kosovës, të Maqedonisë, të Serbisë dhe të Malit të Zi, të cilat përjetuan një terror masiv.⁹ Dhuna dhe terrori antishqiptar përfshiu edhe Klinën me rrethinë. Në këto rrethana, shumë burra të njohur të këtyre anëve u detyruan t’i kapnin armët dhe të luftonin për vetëmbrojtje. Në krye të qëndresës u vunë trima si: Ukë Sadiku, Ymer Berisha, Ndue Përlleshi, Demë Ali Pozhari, Ramë Alia, Zef Gjioda etj.¹⁰ Secila trevë dha djemtë e vet për liri, të cilën nuk e gëzuan. Sistemi “i ri” me politikën e vjetër i shpalli dëshmorë të “lirisë” mu ata që edhe i vrau vetë. Klina me rrethinë doli, sipas regjistrit të organeve të “lirisë”, me 35 dëshmorë shqiptarë të luftës. Në këtë listë nuk lejohej të hynin dhjetëra e qindra dëshmorë që dha Klina për

Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 1994, f. 179.

⁷ Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1997, f. 67.

⁸ Shaban Braha, *Gjenocidi serbomadhi dhe qëndresa shqiptare (1844-1990)*, Tiranë, 1992, f. 430.

⁹ M. Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore...*, f. 301.

¹⁰ Lush Culaj, *Zef Gjioda - jeta dhe veprimtaria atdhetare, Shoqata për ndriçimin e historisë kombëtare shqiptare*, Prishtinë, 2002, f. 90-91.

lirinë. Në lista të tilla hynin vetëm ata që u vranë si pjestarë të ushtrisë jugosllave e që shumica u vra po nga kjo ushtri.¹¹

Pra, viti 1945 Klinës me rrethinë, si dhe mbarë Kosovës, nuk ua solli lirinë e shumëpritur, por ripushtimin jugosllav, vënien nën pushtetin ushtarak të Jugosllavisë së Titos. Përsëri tradhti, përsëri varre. Varianti i bashkimit me shtetin amë jo vetëm që nuk diskutohej, por edhe vetë Shqipëria rrezikohej t'i aneksohej Jugosllavisë. Duke qenë në udhëkryq fati i Kosovës, një delegacion i përbërë nga shqiptarët me ndikim në Kosovë ndërmori një udhëtim për në Beograd në prill të vitit 1945, me qëllim që t'i paraqiste shqetësimet e popullit Mareshalit Tito. Këtij delegacioni iu bashkëngjiti jo rastësisht edhe Dushan Mugosha. Delegacioni u vërtit në Beograd gjatë katër ditëve nga një forum në tjetrin, nga niveli republikan serb në atë federativ. Më në fund, Tito e "dëgjo" atë. Me tonin e një fitimtari prepotent ai theksoi: "Popujt e Kosovës e të Metohisë do të krijojnë një vëllazërim bashkim të thellë, sa që për popullin shqiptar do të jetë njësoj a gjendet brenda kufijve të Shqipërisë apo të Jugosllavisë".¹²

Likuidimi i kuadrove besnike, të afta, atdhetare, me ndikim e perspektivë, si dhe mënjanimi i tyre nga forumet udhëheqëse të luftës, është një praktikë e njohur e PKJ-së në Kosovë e në viset përreth saj. Qysh në muajin shkurt u vu në dilemë në se do të ekzistonte apo jo flamuri kombëtar shqiptar në Kosovë e në viset e tjera shqiptare. Në këto rrethana të okupimit, në Kosovë dhe në të gjitha territoret shqiptare këndeje kufirit, edhe pse u fol për gabimet e shumta nga vetë udhëheqësit, vazhdonte të zbatohet dhuna më e egër, e udhëhequr nga grupet e komandosëve çetnikë si dhe komunistët sllavë. Sidomos pas vrasjes së Milladin Popoviqit, më 13 mars 1945, OZNA haptazi justifikoi terrorin dhe likuidimin e

¹¹ Asllan Krasniqi, *Klina me rrethinë në valët e historisë*, Klinë, 2002, f. 156.

¹² *Rilindja*, Prishtinë, 15 prill 1945.

intelektualëve shqiptarë. Prijësit e Mbrojtjes Kombëtare dhe të njësisve vullnetare të Frontit Nacional Shqiptar, të cilët i kishin shpëtuar ndjekjes, bënë ndërkohë përpjekje të vazhdueshme për grumbullimin dhe konsolidimin politiko-ushtarak të forcave shqiptare. Qëllimi ishte dhe shpresohet që të vihej lidhja e të gjitha forcave antikomuniste, që më vonë do të shndërrohej në një ushtri me karakter gjithëkombëtar shqiptar.¹³

Në ballë të kësaj lëvizjeje qëndronin atdhetarët e sprovuar, të cilët ishin nga Klina me rrethinë. Profesor Ymer Berisha, edhe pse në kushte mjaft të vështira, zhvilloi një aktivitet të dendur politik në çdo pëllëmbë të Rrafshit të Dukagjinit dhe të Kosovës. Ai punonte me vendosmëri të madhe që ta bënte lidhjen e të gjithë krerëve të rezistencës shqiptare si në Kosovë, ashtu në Shqipëri. Në takimin që pati me Pashuk Bibën, më 20 korrik të vitit 1945, në fshatin Vogovë afër Gjakovës, pas qëndrimeve që u morën në atë takim për lidhjet e të gjitha grupeve ilegale, që vepronin në Kosovë e në Shqipëri, u informua se Pashuk Biba kishte rënë në kontakt me një mision perëndimor, që e përkrahte lëvizjen shqiptare.¹⁴

Pas kthimit nga takimi Ymer Berisha u takua me bashkëvendësin, mikun dhe shokun e idealit, Ukë Sadikun, i cili ishte njeriu më me ndikim në ilegalen kosovare. Të dy bashkë caktuan korrierët dhe ua dërguan ftesat të gjithë udhëheqësve të formacioneve ilegale kryengritëse, që të marrin pjesë në Kuvendin e Dobërdolit, i cili do të mbahej në gusht të 1945-ës, në Llugë të Dan Pjetrit në Doberdol të Klinës.¹⁵ Kuvendin e hapi, më 4 gusht në mënyrë solemne, Ukë Sadiku. Ai përshëndeti të pranishmit dhe

¹³ Sabile Keçmezi- Basha, *Lëvizja ilegale patriotike shqiptare në Kosovë 1945-1947*, Shkodër, 1999, f. 72.

¹⁴ Po aty, f. 75, L. Culaj, *Zef Gjigoda - jeta dhe veprimtaria atdhetare...*, f. 89-95.

¹⁵ S. Keçmezi- Basha, *Lëvizja ilegale...*, f. 75-76.

prezantoi profesor Ymer Berishën si iniciator ideor të lëvizjes dhe krijues të organizatës “Besa Kombëtare”. Situatën mjaft të rëndë shoqëro-ro-politike e paraqiti vetë profesor Berisha, por megjithatë ai apeloj për gatishmëri që, në momentin e duhur, forcat nacionaliste të jenë të gatshme ta marrin pushtetin. Në Kuvend merrnin pjesë 19 grupe me përcjellësit e tyre, ndër të cilët edhe përfaqësuesit nga Rozhaja dhe Pazari i Ri, pra gjithsej 158 vetë. Aty u takuan udhëheqës nacionalistë si: Ukë Sadiku, Demë Ali Pozhari, Ndue Perlleshi, Zef Gjioda, Qazim Bajraktari, Shaban Sadik Rama, Sadik Lutani, Alush Smajli, Zhukë Haxhia etj. Kuvendi Doberdolit zgjati dy ditë. Procesmbajtëse e këtij tubimi kaq të madh e të rëndësishëm ishte shkodrania Marie Shllaku.

Kuvendi zgjodhi Ukë Sadikun udhëheqës të sektorit ushtarak, ndërsa profesor Ymer Berisha u caktua udhëheqës i sektorit politik.¹⁶ Organizata politike-patriotike “Besa Kombëtare” kishte një strukturë organizative që u përshtatej kushteve dhe rrethanave në të cilat vepronte. Përveç Shtabit Udhëheqës, që përbëhej prej 12 vetash, në kuadrin e saj, në mënyrë aktive, vepronin edhe katër grupe.

OZNA kishte mbledhur informatat për grupet ilegale, drejtimet e veprimeve të tyre, si dhe aktivistët më të dalluar. Më 9 shtator të vitit 1945, organet e saj, në bashkëpunim me ushtrinë, sulmuan pjesën kryesore të organizatës, në fshatin Jashanicë të Klinës, e më pas Siçevën e Klinës. Në këto përleshje u vranë 28 ilegalë, në mesin e të cilëve e humbi jetën edhe vëllai i Ukë Sadikut, Shaban Sadiku. U plagosën 4 veta nga grupi, ndërsa nga brigada e Bokelit u vranë 14 veta.¹⁷

Të nesërmen e masakrës së Çelisë partizanët vranë me dhjetëra fshatarë të pafajshëm të rrethit të Klinës. Në fshatin Siqevë u vranë: Musë Salihu, Musë Tahiri, Jusuf Keqë Desku,

¹⁶ Po aty, 75-78.

¹⁷ Po aty, f. 80.

Jusuf Zeqir Caku, Rexhë Haliti, Tafil Rama, Adem Shala dhe Rrustem Cani nga Shtarica.

Në fshatin Jellovc u vranë: Tahir Rraci (para shtëpisë së tij), Tafil Bajram Rraci, Sejdi Fazli Rraci, Rexhë Halit Rraci, Ymer Ali Rraci (që u morën nga pamja e Halit Bekës në Jashanicë) i dërguan te mademet e rrasave në Jellovc dhe i pushkatuan.

Nga çeta e Ukë Sadikut u vranë në Çeli: Sadik Lutani nga Turiçevci, Smajl Hajdari nga Gjurgjevik i Madh, Pjetër Berisha nga Doberdoli, Metë Din Uça (nip i Sadik Ramës nga Uça e Istogut), Ramë Murati, Tafil Murati, Selim Sokoli, Zef Sokoli, Mark Sokoli (i biri i Zefit, 18-vjeçar nga Jagoda), Musli dhe Xhemë Hoti (vëllezër) si dhe Isa Hoti (i biri i Xhemës, 23-vjeçar), të tre nga fshati Resnik.

Ditën kur ndodhi masakra e Çelisë së Jellovcit, Ndue Perlleshi bashkë me Mark Dedën e Doberdolit gjendeshin në malet mbi Dobërdol, kurse prof. Ymer Berisha ishte në Krumë të Hasit bashkë me Ukë Sadikun dhe luftëtarë të tjerë, për t'u marrë vesh me Muharrem Bajraktarin që t'i bashkonin forcat për qëndresë ndaj brigadave partizane sllavo-komuniste jugosllave.¹⁸

Ndër shumë shqiptarë, të cilët u pushkatuan nga OZN-a në dimrin e vitit 1945, kishte mjaft njerëz edhe nga Klina me rrethinë. Në masakrën e Istogut, në kullën famëkeqe të Popit, pati viktima të atdhetarëve të devotshëm si Pjetër Jaku nga Ranoci, Llesh Gjon Lleshaj nga Zllakuqani, Pren Laska nga Zllakuqani, Ndue Mark Doda (Çeta) nga Videja, Rexhep e Sadri Hoti, Zef Kola nga Budisalci, Qazim Boja nga Kerrnica, Uke Zeneli- Elezaj nga fshati Gjurgjevik i Vogël etj.¹⁹ Nga të gjitha këto vrasje dhe masakra të llojllojshme, siç u theksua edhe më lart, Klina me rrethinë, sipas regjistrimit të organeve të "lirisë", kishte dhënë 35

¹⁸ Ramiz Kelmendi - Viktor Gashi, *Shqipëria e Marije Shllakut*, Pejë, 1995, f. 98-99, të dhëna nga Mark Deda nga fshati Doberdol të cilat i shënoi Jetish Kadishani.

¹⁹ Marjan Jaku, *Pjeter Jaku dhe Ranoci nder mote*, Klinë, 2006, f. 86.

dëshmorë shqiptarë të luftës. Në këto lista hynin vetëm ata që u vranë në Ushtrinë jugosllave, vrasjet e të cilëve ishin shumë të dyshimta. Dyshimin mbi këto vrasje e shtojnë edhe dëshmitë e poshtëshënuara: “Dëshmorët Gjergj Gjetaj nga Budisalci dhe Nok Pernokaj nga Zllakuqani u vranë më 8 mars 1941 në Kaçanik, si të mobilizuar, ende pa filluar lufta nga forcat serbe, në rrethana të pashpjeguara, ndërsa Avdi Desku (që në listën e luftëtarëve ishte shënuar Berisha) nga Gjurgjeviku u vra në mes të Dibrës e Strugës, nga çetnikët në vitin 1945, si ushtar i Brigadës së Tetë të Shqipërisë.²⁰ Dëshmori Brahim Berisha nga Gjurgjeviku u vra në prill të vitit 1945, derisa po përcillte postën ndërmjet njësive partizane të Ohrit dhe të Strugës si korrier i Brigadës VIII të Shqipërisë, në rrethana të pashpjeguara nga organet ushtarake jugosllave dhe shqiptare. Në rrethana të njëjta u vra edhe Hasan Gashi nga Mleqani më 1945 në Ohër, si ushtar i çetës së dytë, batalioni i tretë të Brigadës VIII të Shqipërisë, ndërsa Maliq Avdyli nga Drenovci u vra në Resnjë tek Ohri nga bandat çetnike. Po nga dora çetnike u vra edhe Ali Berisha nga Valljaku në fund të prillit 1945 në Sanxhak, ashtu siç u likuidua edhe Avdyli Tusha nga Poterqi në të njëjtën përleshje. Nga dora çetnike u vra edhe Gustin Buzhala nga Çabiqi në Gornji Milanovac, më 1945, si ushtar i Brigadës VII kosovare. Rexhep Gashi nga Kijeva u vra në prill të vitit 1945 në Doboj nga dora çetnike si përgjegjës politik në njësinë e tij. Edhe Zymer Morina nga Gollubovci ra në Ohër më 1945 si ushtar i çetës së dytë, batalioni i tretë, Brigada VI e Shqipërisë, në rrethana që nuk u shpjeguan nga asnjë palë, ndërsa Muharrem Bajraktari nga Rudica u vra më 1945 prej ushtarëve serbo-çetnikë. Edhe Selim Thaçi nga Shkarashniku vritet në Kikindë të Madhe nga dora çetnike më 1945. Rifat Kryeziu nga Bubaveci vdiq më 3 maj 1945 në Kikindë si i mobilizuar në njësitë partizane. Ai dhe qindra shqiptarë të tjerë gjetën vdekjen nga tifoja, nga moskujdesi dhe nga arroganca e organeve

²⁰ A. Krasniqi, *Klina me rrethinë ...*, f. 156.

ushtarake. Rifati ishte luftëtar i çetës së parë, batalioni i dytë, Brigada VII kosovare. Të njëjtin fat e pësoi edhe Sylë Gashi nga Balinca më 1945 si luftëtar i Brigadës VII kosovare. Po ashtu, nga tifoja vdiq edhe Sali Foniqi nga Llazica, ndërsa Sejdi Hoti nga Caralluka vdiq nga eksplodimi i bombës së komandantit të tij në maj të vitit 1945 në Krushevc, si ushtar i divizionit të 21-të të Brigadës XXXIII, batalioni i tretë. Vesel Berisha nga Perçeva vdiq në shtëpi më 1945 nga plagët që ia shkaktoi ushtria “nacionalçlirimtare” si ushtar i Brigadës së VII kosovare. Shaban Krasniqi nga Llashkadrenoci vdes në Llaushë më 1945 prej “ballistëve”, siç thotë pushteti “çlirimtar”, i cili i quan ballistë ata që e mbrojtën jetën e atyre që i vrau po ky pushtet. Edhe Zenun Idrizi nga Grabanica ra në fshatin Zajm prej “ballistëve”, e prej cilëve ballistë nuk u shpjegua asnjëherë.²¹

Siç shihet, dëshmorët tonë që ky pushtet i shënonte kishin rënë dëshmorë jo në kohë lufte, por në përfundim të luftës; jo në luftë kundër gjermanëve, por kundër partizano-çetnikëve. U nisën për liri, por lirinë nuk e shijuan.

Nga një analizë e tillë shtrohet natyrshëm pyetja: Cilin dëshmor e vranë fashistët e huaj? Natyrshëm del edhe përgjigjja se kush ishte fashizmi për shqiptarët në këtë luftë. A mund të besohet se dëshmorët si Brahim Gashi, Maliq Bacaliu, Metë Gashi, Qerim Boja, Binak Gashi, Feriz e Hasan Krasniqi, Mikel Doda, Hazir Berisha etj., nuk na i vrau ushtria jugosllave? Nga emrat në listën e dëshmorëve, sipas punës në terren, del se vetëm Hazir Berisha e Selman Gashi u vranë në luftë nga gjermanët”.²²

Kolonat e brigadave partizane lëviznin pareshtur ngadalë e të

organizuara nëpër fshatrat e rrethit të Klinës. Fillimisht rrethonin fshatrat dhe lagjet. Eprorët e këtyre brigadave mbanin një listë

²¹ Po aty, fq. 157.

²² A. Krasniqi, *Klina me rrethinë ...*, f. 156-157.

emrash të njerëzve që duheshin të arrestoheshin. Nëpër fshatra dhe lagje këto brigada nuk kanë hasur në rezistencë të armatosur. Njerëzit e shënjuar janë dorëzuar duarthatë, me qëllim që kështu t'i mbronin familjet e veta. Pushkatimet pa gjyq kryesisht bëheshin natën. Ishte formuar një njësit i posaçëm për ekzekutime, në mesin e të cilëve ka pasur edhe të rinj SKOJ-të.

Sipas të dhënave, pushkatimet vetëm në Pejë e rrethinë, që përfshinte fshatra edhe të Klinës së sotme, për thuhet një vit (nëntor 1944 - dhjetor 1945), u pushkatuan më se 3600 shqiptarë.²³ Pra, vrasje dhe vetëm vrasje shqiptarësh kudo nëpër Jugosllavi, jo vetëm në Kosovë, madje në vazhdim nëpër kazerma anembanë Jugosllavisë. Kështu i sillnin ushtarët shqiptarë gjoja të helmuar nga ushqimi, gjoja të vdekur e të vrarë aksidentalisht, gjoja të mbytur në ujë, gjoja të mbytur nga ashti në fyt etj. Mirëpo, shqiptarët veç vriteshin dhe të vrarë orë e çast i sillnin në shtëpitë e tyre pa lejuar që t'u hapeshin arkivolet. Edhe shumë shqiptarë të tjerë vdisnin e vdisnin nëpër burgje, kazamate e kampe, madje edhe tok me familjet e tyre, pa lejuar që kufomat e tyre të sillen e të varrosen në vendlindjet e tyre!

Kështu, vetëm në ato ditë e në ata muaj të viteve 1944-1945, të riokupimit të Kosovës, u likuiduan siç e theksuam më lart mijëra shqiptarë. Kurse problemi kombëtar i shqiptarëve të mbetur nën pushtetin jugosllavi u trajtua në mënyrë po aq të njëanshme, sikurse edhe në Jugosllavinë e vjetër.²⁴

²³ Ahmet Kelmendi, "Në 60-vjetorin e ripushtimit të Pejës (Kosovës) nga sllavo-komunistët-çetnikët" (2) *Bota sot*, 14 mars 2005.

²⁴ F. Mehmetaj, *Veprimtaria kriminale e "Dorës së zezë" serbe...*, f. 324.

Prof. dr. Nebi DERVISHI
(Tetovë)

**MASAKRA E LADORISHTIT NË VITET E LUFTËS
SË DYTË BOTËRORE (28 TETOR 1944)**

Nga ngjarjet dhe datat e shënuara të historisë sonë më të re në trevat Lindore shqiptare, në vitet e Luftës së Dytë Botërore, ndër më të dhimbshme, pa dyshimin më të vogël është masakra e Ladorishtit, më 28 tetor 1944, kur brenda një dite nga terrori nazifashist u vranë dhe u dogjën në zjarr 84 persona (burra, gra dhe fëmijë).¹

Ka ngjarje në jetën e popujve, të cilat për nga detyrat që shtrojnë për zgjidhje, për nga përmasat dhe forca e qëndrimit dhe sakrificës, mbetën përgjithmonë në histori, si udhërrëfyes për kohën e vetë dhe për të ardhmen. Një ngjarje e tillë, në jetën e popullit shqiptar të trevave Lindore, është masakra në fshatin Ladorisht të Strugës, më 28 tetor 1944, që është enigmë dhe sfidë për studiuesit dhe historianët edhe pas kaq vitesh.

¹ Zejnulla Qyra, “Masakra e Ladorishtit – sfidë për historianët”, në gazetën *Fakti*, 30. X. 1999, faqe 9; Nebi Dervishi, *Struga me rrethinë 1941-1944*, Strugë, 2012, f. 119-130.

Në vjeshtën e vitit 1944, si në gjithë Ballkanin Perëndimor² ashtu edhe në rrethin e Strugës, zhvilloheshin luftime të ashpra nga ana e kualicionit antifashist, kundër forcave nazifashiste gjermane. Komanda ushtarake gjermane e dislokuar në Strugë bëri përpjekje të mëdha për të asgjësuar njësitë partizane të UNÇ të Shqipërisë dhe Maqedonisë nga Qafa e Thanës. Në këto rrethana, Shtabi i Divizionit 48 të UNÇ dhe AP të Maqedonisë mori vendim që të shkatërrojë mbrojtjen e këtij territori nga forcat ushtarake gjermane, që shtriheshin nga Struga deri në Qafë të Thanës. Në këtë aksion u angazhuan luftëtarët e Brigadës IV shqiptare dhe njësitet partizane të Brigadës së Parë Maqedonase³, në bashkëpunim me disa njësi të UNÇ të Shqipërisë⁴, me të cilat kontakti ishte vendosur që më parë. Më 23 tetor 1944, në jugperëndim të fshatit Ermësë (Mali Vllaj), në afërsi të kufirit, është mbajtur një mbledhje, në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues të Shtabit të Brigadës së Parë Maqedonase, Brigadës së IV Shqiptare, si dhe përfaqësues të Batalionit IV së Brigadës XX të Shqipërisë⁵. Aty është arritur marrëveshja që në formë të koordinuar dhe me forca të përbashkëta, të sulmohen kolonat gjermane, të cilat ishin në lëvizje në drejtimin Qafë e Thanës-Strugë. Më 24 tetor 1944, forcat gjermane u sulmuan nga tre drejtime dhe thuajse u shpartalluan tërësisht, duke pësuar shumë të vrarë dhe të plagosur⁶. Edhe në ditët që pasuan, njësitë gjermane do të sulmohen pa rreshtur. Këto sulme të njësiteve antifashiste do të shqetësojnë komandën ushtarako-policore gjermane që ishte stacionuar në Strugë, e cila ishte e vendosur që me të gjitha mjetet

² Masar Kodra, *Shqiptarët e Maqedonisë gjatë Luftës së Dytë Botërore (1939-1944)*, Kumanovë, 1996, f. 237-264.

³ Po aty.

⁴ *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar*, Vëll. IV, Tiranë, 1989, f. 717-719.

⁵ Михајло Апостолски, *Завршните операции за ослободување на Македонија*, Скопје, 1953, стр.170-199ч

⁶ *Historia e Luftës Antifashiste ...*, Vëll.IV.

që i kishte në dispozicion, t'ua mundësojë në mënyrë të sigurtë njësiteve ushtarake që të tërhiqeshin në rrugën strategjike për në Qafë Thënë. Për këtë arsye, që më parë komanda në Strugë formon njësi të posaçme vëzhguese me detyrë: kontroll permanentë mbikëqyrës-shërbyes, në relacion Strugë-Qafë e Thënës dhe Strugë-Ohër, e cila ishte nën përgjegjësinë e nën komandës,-rang më i lartë policor⁷.

Njësitë ushtarake patrulluese, të komandës dhe njësitit të Lajtnantit Vajs (“njeri ngrenësi”), do të siguronin edhe kolonën e fundit më të madhe gjermane, e cila në orët e fundit të 27 tetorit të vitit 1944, nga Ohri do të arrijë në Strugë, e cila menjëherë do të ndiqte rrugën për në Shqipëri, nëpërmjet Qafës së Thënës. Dhe kjo do të parapri ngjarjen , e cila do të jetë shkaku që një fshat i qetë, jo shumë larg Strugës, i banuar pastër me shqiptarë, pra, fshati Ladorishtë, ditën e 28 tetorit 1944 do të mbulohet me flakë dhe do të notojë në gjak.⁸

Duke u ndodhur pa ndërprerë nën trysninë e pritave dhe sulmeve të befasishme, nazistët gjermanë, në shenjë hakmarrjeje vendosën ta ndëshkojnë Ladorishtin. Në mëngjesin e hershëm të 28 tetorit të vitit 1944, forcat e shumta gjermane, të armatosura deri në dhembë e rrethojnë fshatin, pa lënë asnjë mundësi për t'u larguar askush nga fshati. Shtëpive iu vu zjarri, ndërsa popullatën e tubuar e dërgojnë në fund të fshatit, në vendin e quajtur “Vakçare”, pranë rrugës Strugë-Qafë Thënë. Ata që u përpoqën të çanin bllokadën qëlloheshin dhe vriteshin në vend. Në këtë masakër nuk u kursyen as pleqtë, gratë dhe fëmijët. Nga 84 të masakruar, nga xhelatët nazifashistë, 7 ishin gra, 4 fëmijë, ndërsa 73 të tjerë të rijnë, burra dhe pleq. Në vendin e quajtur Vakçare, pasi i radhisin në kolona, i qëllojnë me breshëri mitrolezi. Për të qenë më të sigurtë se të pushkatuarit janë vranë, ata do t'i qëllojnë

⁷ Nebi Dervishi, *Etnokultura e Fushëgropës së Ohrit*, Tetovë, 2005, f. 271.

⁸ Po aty.

viktimat e tyre edhe nganjëherë në kokë, të cilët ishin të mbuluar në rrëke gjaku. Në këtë kasaphane hordhitë gjermane do të kryenin një nga masakrat më të tmerrshme në vitet e Luftës së Dytë Botërore.⁹

Ladorishtarët, pa përjashtim, edhe pas shumë vitesh të kaluara, ende i ruajnë kujtimet e kësaj masakre. Të gjithë ato që e përjetuan masakrën e 28 tetorit të vitit 1944, janë të një mendimi, se masakra ka qenë me skenar të parapërgatitur, për të cilën flasin qartë edhe dëshmitë. Ato ditë tetori, në Ladorishtë hynë eprorët e Brigadës IV Shqiptare¹⁰ dhe pasi formojnë njësitin e të rinjve për vetëmbrojtje, ose çetën që do të bëjë roje në fshat, do të largohen në fshatin Vishnjë. Kjo të shton dyshimin të mendosh se “kush u dha urdhër atyre të rinjve, ose detyrë 3-4 të moshuarve që ta sulmojnë patrullën gjermane, e cila lëvizte pandërprerë në rrugën Strugë-Qafë e Thënës dhe pastronte terrenin, me qëllim të tërheqjes së sigurtë të forcave gjermane. Ky provokim i 24 tetorit të shton dyshimin dhe dilemën se kjo masakër ka qenë e përgatitur, të cilën fshatarët nuk e kanë kuptuar, ose ashtu është dhënë komanda nga lartë. Mandej, kush ka qenë personi (Ladorishtarët e dinë, por publikisht u mungon guximi të tregojnë), i cili një natë para djegies së fshatit ka trokitur në disa shtëpi duke i paralajmëruar të largohen pa humbur kohë nga fshati, se të nesërmen fshati do të digjej? Kush i dinte pikat më të ndjeshme të fshatit Ladorishtë, të cilët ishin bllokuar që në orët e hershme të mëngjesit të 28 tetorit, që t’i pamundësohet popullatës ladorishtare që të largohet? Pse Brigada e IV Shqiptare, e cila gjendej në afërsi, në fshatin Vishnjë (rreth 700-800 metër në vijë ajrore) nuk iu dha urdhër luftëtarëve të vetë të sulmojnë dhe së paku të parandalojnë masakrën e falangës gjermane, që tërë ditën

⁹ V. Kasapi – H. Cipuri, *Çlirimtarët shqiptarë nga Dibra në Zagreb*, Tiranë, 1995, f. 67.

¹⁰ N. Dervishi, *Struga me rrethinë në vitet e Luftës së Dytë Botërore...*, f. 119

e 28 tetorit bënin hatanë mbi banorët fatkeq të Ladorishtit¹¹? Pse krerët e Brigadës së IV Shqiptare, më 3 nëntor 1944¹², pakë ditë pas masakrës së Ladorishtit, do të interesohen se çka fletë popullata e rajonit të Strugës për këtë masakër, në një letër që është e nënshkruar nga eprorët Qemal Agolli dhe Esat Doko? Ka edhe shumë pikëpyetje të tjera për këtë masakër...

Bilanci i kësaj masakre ishte i tmerrshëm: 84 persona u vranë, mbi 40 të tjerë përjetuan lëndime të tmerrshme fizike, mbi 60 shtëpi dhe 30 kasolle u dogjën nga themeli, ndërkaq numri i kafshëve shtëpiake dhe zahirja për to u dogjën në flakët e luftës¹³.

Gjatë kësaj masakre do të veçojmë disa raste: Plakën Myribane Çollaku, 84 vjeçare, gjermanët e detyruan që me dorën e saj, t'ia vë flakën kasolles së vetë dhe kur kasollja mori flakë, plakën e gjuajtën në flakë dhe ajo u dogj e gjallë. Gruaja Luze Lena, e cila duke e parë të shoqin të vrarë te lëma e Jashar Dautit, e kap për fyti ushtarin gjerman dhe më pas edhe ajo vritet. Është tepër tragjike, por edhe shumë tronditëse, humbja e foshnjës trevjeçare, Eshref Lenës, i cili vritet në kraharonin e të atit. Këtu po veçojmë trimërinë e vajzës 15 vjeçare Telete Dino Hoxha, e cila vritet nga ushtarët gjerman duke tentuar ta mbroj babanë e saj... Ka edhe shumë raste për tu përmendur për trimërinë e banorëve të këtij fshati, si ajo e Mustafa Hoxhës, i cili kërkonte në Vakçare që gratë dhe fëmijët të kursehen nga pushkatimi¹⁴.

Të masakruar mbetën 84 veta, prej tyre 80 nga Ladorishti dhe 4 të tjerë nga Struga, Veleshta, Belica e Epërme dhe nga Shqipëria. Familjet ladorishtare i humbën më të dashurit e tyre: Familja Lena humbi 9 anëtar; Familjet Murtishi e Zylali nga 6 anëtarë; Familjet Allka, Klenja dhe Dauti nga 5 anëtarë; Familjet

¹¹ Po aty.

¹² Letër e Shtabit të Brigadës së IV Shqiptare, dt. 3.XI.1944 nënshkruar nga Esat Doko e Qemal Agolli, dërguar Lutfi Llogës (në origjinal), ruhet te autori.

¹³ Z. Qyra, "Masakra e Ladorishti"

¹⁴ Nebi Dervishi, Masakra e Ladorishtit (28.X.1944), Referat në Simpoziumin e mbajtur me rastin e 65 vjetorit, në Strugë.

Kolonja, Lleshi, Mamudi, Hoxha, Sulejmani, Coma e Çollaku, nga tre anëtarë; Familjet Emini, Etemi, Ismaili, Karafili e Rika, nga dy anëtarë¹⁵.

Masakra e Ladorishtit që nisi në mëngjesin e 28 tetorit dhe zgjati deri në orët e vona të pasdites, për asnjë moment nuk u pengua nga efektivat e Brigadës së IV Shqiptare dhe Brigadës së XV Maqedonase, të cilat sipas atyre që e përjetuan atë golgotë, nuk kanë qenë shumë larg fshatit. Sipas disa të tjerëve, forcat e Brigadës së IV Shqiptare dhe Brigadës së XV Maqedonase, ditën kritike ishin të vendosur në fshatin Vishnjë, por edhe ky fshat nuk është larg fshatit Ladorishtë, dhe se ka pasur mundësi reale, që me efektivat e tyre ushtarake të intervenojnë, e në fund të fundit do të “ulnin koston” përfundimtare të kësaj masakre.

Ata që përjetuan këtë masakër edhe sot deklarojnë se radhët e falangës gjermane që kreu masakrën ka pasur edhe 4 persona me tesha gjermane nga Struga, emrat e të cilëve në buzë i përshtëpërisin, si Simon Uzuni, Jone Lazori, Gligor Jordanoski etj, të cilët pas përfundimit të luftës kanë qenë të privilegjuarit e sistemit.

Aty nga fundi i muajit shtator 1944, Brigada e Katërt Sulmuese Shqiptare me direktive të Shtabit të përgjithshëm të UNC të Maqedonisë, zbret në fshatin Dollogozhdë dhe nis aksionin për të hyrë në fshatrat e tjera të rajonit të Strugës. Shtabi i Brigadës së IV për të operuar më mirë, katër Batalionet i ndan si vijon:

Batalioni i Parë i Brigadës bashkë me shtabin u drejtua me marrëveshje paraprake që të hyjnë në fshatin Veleshtë, Batalioni i Dytë prej fshatit Drasllavicë kishte për detyrë të sulmonte njësite e ushtrisë gjermane që ishin të stacionuara, pranë fabrikës të tullave; Batalioni i Tretë kalon në fshatrat Zagraçan, Shumë, Vishnje, Ladorishtë e Ermezë, (Mali Vllaj), ndërkaq Batalioni i Katërt u

¹⁵ Po aty.

vendos pranë fshatit Misleshovë prej nga bënte përgatitjet për të sulmuar Strugën.¹⁶

Komanda ushtarake gjermane e dislokuar në Strugë bën përpjekje të madhe të asgjësoj njësit partizane të UANC të Shqipërisë dhe Maqedonisë nga Qafa e Thanës. Më 9 gusht 1944 Komanda ushtarake gjermane duke parë rrezikun nga forcimi i Lëvizjes Antifashiste dhe izolimit të qytetit të Strugës nisi të grumbullojë njësi të mëdha të armatosura si edhe Divizionin 279, me qëllim që të mos lejoj ndërprerjen e rrugës furnizuese tërheqëse Manastir – Ohër – Strugë - Elbasan.¹⁷

Në këto ditë vendimtare, kur njësitë e UNÇ, në bashkëpunim me ato të UNÇ të Shqipërisë e ndjekin në çdo hap “Armatën e pathyeshme” hitleriane, njësit ushtarake gjermane që ishin të stacionuara në Strugë, ishin të rrethuara prej njërive partizane. Të gjitha rrugët që të shpinin në qytet ishin të mbyllura prej njërive partizane, me përjashtim rrugës Ohër -Strugë prej nga gjermanët duke përdorur mjetet e motorizuara dhe tanket bënë tërheqjen tepër të rënduar. Në këto rrethana të tërheqjes në këtë rajon tepër të rëndësishëm ushtarako-strategjik, shtegu malor i Qafës së Thanës duhet të luaj rolin më të madh në shkaktimin e goditjeve të fuqishme si dhe për t’ia vështirësuar dhe pamundësuar tërheqjen e ushtrisë gjermane. Në këto rrethana, Shtabi i Divizionit 48 të UNÇ dhe Aradhave partizane /AP/ të Maqedonisë mori vendim që të shkatërrojë mbrojtjen e këtij territori nga forcat ushtarake gjermane që shtriheshin nga Struga deri në Qafë të Thanës. Në këtë aksion u angazhuan luftërat e Brigadës IV shqiptare dhe një njësi partizane të Brigadës së Parë Maqedonase, në bashkëpunim me disa njësi të UNC të Shqipërisë me të cilat kontakti ishte vendosur që më parë. Më 23 tetor 1944, në jugperëndim të fshatit Ermez në afërsi të kufirit, është mbajtur një mbledhje në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësuesit të Shtabit të Brigadës së Parë

¹⁶ N. Dervishi, *Struga me rrethinë 1941-1944...*, f.119-123;

¹⁷ Po aty.

Maqedonase, të Brigadës së IV shqiptare si dhe përfaqësuesit e Batalionit të IV të Brigadës 20 të Shqipërisë.¹⁸

Aty është arritur marrëveshja që në mënyrë të koordinuar dhe me forca të përbashkëta, të sulmohen kolonat gjermane të cilat ishin në lëvizje në relacionin në Qafë të Thanës - Strugë. Më 24 tetor të vitit 1944, forcat ushtarake gjermane u sulmuan nga tre drejtime dhe thuajse u shpartalluan tërësisht.¹⁹

Me këtë rast u vranë 30 ushtarë gjermanë dhe 22 u plagosën. Natën e kësaj date një njësit i armatosur gjerman nga Struga i shkoi për dore të depërtoj në drejtim të Qafës së Thanës, ku vendosi kontakte me një kolonë ushtarake gjermane që vinte nga Elbasani. Ndërkohë forcat e kombinuara partizane shqiptaro - maqedonase, përshkak të epërsisë së armikut, që me këtë rast përdori edhe tanket dhe mjetet e tjera të motorizuara, lëshuan pozicionet që i kishin marur gjatë ditës dhe tërhiqen në drejtim të Ladorishtit.

Dy ditë më vonë, forcat ushtarake gjermane sulmuan pozicionet mbi fshatin Ladorisht dhe në hyrje të fshatit Zagraçan²⁰, të cilat i mbante brigada e IV shqiptare. Luftërat e kësaj brigade u tërhoqën në fshatin Vishnje, ku ishin vendosur (stacionuar) edhe forcat e brigadës së parë maqedonase.

Pra, në këtë mënyrë njëra pas tjetrës ndalohen dhe sulmohen njësit ushtarake në ditët që ato bënë tërheqjen në këtë rajon tepër me rëndësi strategjike. Kjo veçanërisht do t'i shqetësojë komandën ushtarako - policore që ishte e stacionuar në Strugë, e cila ishte e obliguar që me të gjitha mjetet që i kishte në dispozicion, t'ua mundësojë në mënyrë të sigurt njërive ushtarake të tërhiqeshin. Për këtë arsye që më parë komanda në Strugë formon njësi të posaçme patrulluese me detyrë; kontroll

¹⁸ *Historia e LANÇ-së të popullit shqiptar...*, Vëll.IV, f. 717-721

¹⁹ По аты.

²⁰ Илија Калановски, Ослогодителната војна и револуцијата во Струга и Струшко, (1941-1945), Скопје, 1983, стр.150-151

permanente shërbyese në relacion Strugë- Qafë e Thanës dhe Strugë-Ohër.

Shërbimi ushtarako-policor në të vërtetë ishte në nën përgjegjësinë e Feltkomandaturës, e cila ishte rangu më i lartë policor. Feltkomandatura në Strugë mbulonte një territor tepër të gjerë. Juridiksioni i saj shtrihej që nga Tetova e deri në Korçë. Të gjitha feltkomandaturat e qyteteve si dhe stacionet policore nëpër fshatra në këtë rajon i nënshtroheshin kësaj komande. Më karakteristike ishte ajo, se kjo komandë në përbërje të saj kishte edhe të ashtuquajturën “Njësit speciale sulmuese, në krye të së cilës qëndronte Lajtnanti VAJS-i ashtuquajtura famëkeqi ”NJERINGRËNËS”-siç e thirrnin. Me emrin e këtij keqbërësi janë lidhur tërë vrasjet mizore që janë kryer në këtë rajon të gjerë kundër banorëve civilë²¹.

Njësit ushtarake patrulluese të feltkomandaturës dhe njësisë Lajtnantit Vajs do ta sigurojë edhe kolonën e fundit më të madhe gjermane e cila në orët e fundit të 27 tetorit të 1944 nga Ohri do të arrin në Strugë e cila menjëherë do të vazhdojë rrugën për në Shqipëri. Dhe kjo atëherë do të sjell ngjarjen e cila do të jetë shkaku që një fshat i qetë pran qytetit të Strugës i banuar tërësisht me shqiptarë, fshati Ladorisht, ditën e 28 tetorit të 1944 do të mbulohet me flakë dhe të notojë me gjak²². Atë ditë, njëra nga këto njësi patrulluese e cila lëvizte rrugës për në Qafën e Thanës, afër vendit të quajtur “SHTABI” pa prituri do të sulmohet nga njësit partizane. Zëri i armëve do të dëgjohet deri në stacionin bazë të feltgjandarmërisë. Për kujdestarët e stacionit kjo ishte një sinjal i mjaftueshëm. Ato pa humbur kohë dalin dhe i vinë në ndjekje drejt vendit prej ku u dëgjua të shtirat e pushkëve. Patrulla e cila ka qenë e sulmuar, nuk dinte që të tregojë prej dhe nga kush

²¹ Nebi Dervishi, *Etnokultura e Fushëgropës së Ohrit*, Tetovë, 2005, 272-273.

²² N. Dervishi, “Masakra e Ladorishtit”...

që e sulmuar, por vetëm se dyshon se ka qenë e sulmuar nga partizanët²³.

Ndoshta çdo gjë do të mbaronte me këtë, se në atë moment nuk do të zbres rastësisht një fshatar, i cili duke rrugëtuar nga fshati Frëngov që udhëton për në Strugë. Ai menjëherë është ndaluar dhe është pyetur për të treguar se kush kanë qenë ato që kane gjuajtur patrullën, sa kanë qenë dhe nga janë larguar. Kush e di se si, por sigurisht fshatari është frikuar së tepërmi, ndonëse nuk ka vërejtur askënd dhe aspak nuk ka pasur ai njohuri, vetëm se për të shpëtuar, ju thotë se dy-tre vete i ka parë se si largohen në drejtim të fshatit Ladorisht, pranë malit, nëpër një rrugë të ngushtë.

Kjo që e mjaftueshme për këtë. Menjëherë rojet e stacionit kthehen në bazë dhe me telefon për këtë rastin e njoftojnë Feldkomandaturën në Strugë, dhe atë personalisht komandanti Fonensberger.

Menjëherë pasi pranon lajmin përmes telefonit për sulmet pranë Shtabit dhe për atë që kanë gjuajtur janë larguar në drejtim të fshatit Ladorisht, majori Fanensberger menjëherë e thirrën për t'u këshilluar lejtntantin Vajs, i cili pa humbur kohë i deklaron se ato janë pjesëtarë të partizanëve dhe e këshillon që të ndërmarrë masa më të rrepta.

Fanensbergeri atëherë e thirrën dhe për tërë rastin e njofton komandantin e Ohrit Baumgartenin, i cili pas tërheqjes nga Ohri më 13 tetor qëndronte në Strugë. Bindja (mendimi) i të dyve ka qenë identike: Fshati Ladorishtë është fajtorë për këtë, sepse i pranojë partizanët, mandej që nuk i kapi dhe nuk i dorëzoj sulmuesit të komanda gjermane.

Vendimi i përbashkët i dy komandantëve ka qenë: “fshati fajtor Ladorishti, t'i vëndohet zjarri ndërsa fshatarët fajtorët të pushkatoen”²⁴!

²³ Po aty.

²⁴ N. Dervishi, “Masakra e Ladorishtit“...

Që atë natën në vigjilje e 28 tetorit të 1944 nëpërmes disa pjesëve të caktuara të kolonave ushtarake të cilat tani tërhiqeshin, nga ana juglindore u “mbulua” fshati. Gjatë natës kritike ka pasur gjallëri të pakët. Kalona që arrin nga Ohri pa humbur kohë pjesë-pjesë vazhdon rrugën e Qafë Thanës. Janë dëgjuar luftime veçanërisht pranë Qafës së Thanës, ku atë natë janë zhvilluar përpjekje të armatosura në mes ushtareve gjermanë dhe njësisve të Brigadës së Katërt dhe Brigadës së Parë maqedonas.

Çdo luftë të sjellë edhe viktimat e veta por rasti i viktimave-masakra të paparë në fshatin Ladorishtë të Strugës më 28 tetor 1944, është enigmë dhe rast i veçantë unikal në vitet e Luftës së Dytë Botërore, ndonëse kanë kaluar 70 vjet, shumë gjëra heshtën edhe pse çdo gjë dihet se si erdhi deri te kjo masakër. Plot 70 vjet këto viktima u lanë në harresën e historisë nga organet kompetente dhe shoqata e komunës së Strugës, por edhe Lidhja e Luftëtarëve të Strugës ku kanë gravituar anëtarë edhe një numër i konsideruar i shqiptarëve, të cilët për 50 vjet nuk e kanë gjetur të arsyeshme të vizitojnë këto varreza, në fshat, por kanë gjetur kohë të vizitojnë varreza shtazësh dhe të kësaj natyre.

Është për të përshëndetur që vitet e fundit në shtypi tonë haset ndonjë shkrim për këtë masakër, si Mr. Shaban Prevalla, “Kultivues i traditës shqiptare”²⁵, studiuesi e historiani Zenulla Qyra, “Sfidë për Historjanët-rasti (Masakra) i Ladorishtit”²⁶, e ndonjë tjetër. Në histografinë e Maqedonisë me sa jemi te informuar deri më tani nuk është shkruar gati asgjë. Është mëkat se si këto “Historjanë të mëdhenjë” pa pikë turpi duanë të bëjnë historinë e vetë me gjakun e të tjerëve. Kulminacionin e turpin e tejkaloi çdo kufi në tubimin “shkencor” mbajtur në Ohër dhe Strugë, më datë 2-5 prill 1986 nga Këshilli i organizatës të

²⁵ Shaban Prevalla, “Kultivues i traditës shqiptare”, *Flaka*, 28 tetor 1944.

²⁶ Z. Qyra “Sfidë për historianët – rasti i Ladorishtit” në gazetën *Flaka* me rastin e 55 Vjetorit, 30 tetor 1999.

luftëtarëve me temë “Ohri e Struga në LNÇ (1941-45)”²⁷. Në këtë tubim çdo gjë mund të ishte por jo edhe shkencorë, kanë marrur pjesë historianë të dekoruar me titull shkencor si dhe pjesëmarrës në luftime që janë zhvilluar në këto rajone në vitet 1941-1945. “Kumtesat” referuesve në këtë tubim, “Shkencor” do të botohen në katër vëllime në 1990, me të njëjtin titull siç e kishin pagëzuar edhe vetë tubimin. Për habinë e të gjithëve askush nga këto pseudo-historianë e studiues që marrin pjesë në këtë tubim nuk e gjetën të udhës që në punime e tyre jo të hedhin dritë në këtë masakër por vetëm të përmendim këtë të cilën nuk e bënë shoqata e historianëve shqiptarë dega në Strugë në bashkëpunim me aktivistet nga Fshati Ladorisht, me rastin e 50 vjetorit jubilar 27-28 tetor të 1994 e gjeten të rrugës të organizojnë një akademi dhe një sesion shkencor ku me punimet tuaja morën pjesë studiues historianë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia, të cilët me punimet e tyre shkencore dhanë aq shumë të dhëna me çka pjesërisht u ndriçua kjo masakër që jo rastësisht, pra qëllimisht është rënë në harresë .

Për të fituar një tablo më të saktë, për këtë ngjarje makabre të masakrës së Ladorishtës do të jap disa segmente të Deklaratës së njërit prej atyre që e ka përjetuar masakrën ato ditë të fundit të tetorit të vitit 1944, të Sali A.Zylali²⁸.

“...Në gjysmën e dytë të muajit gusht të 1944 u zgjodh Këshilli Nacional Çlirimtar, në mbledhjen e mbajtur në fshatin Belicë e Epërme. Udhëheqës i kësaj konference ka qenë Vasil Kallajxhiu, Shaziman Oran Coma, Josif Misa, Stojce Leci si dhe Shtabi i brigadës maqedonase.

Në këtë konferencë gjithashtu u zgjedh edhe Këshilli NÇ për fshatin Ladorishtë: Seit J.Zylali-kryetar, Sali Zylali-sekretar si dhe Kadri Cenka, Daut Çermenika, Amdi Rashit Murtishi, Ramadan Etem Ajro dhe Xheladin Amdi Hoxha që të gjithë anëtarë. Për

²⁷ Охрид и струга во НОБ (1941-1944).

²⁸ Salo Zylali, *Kujtime*, lindi 1910, dhënë autorit më 28.09.1993.

shtatë fshatrat kryetar i Këshillit NÇ u zgjodh Aziz Maksut Ajro, kurse sekretar Simon Kutani. Këshilli i përmendur ka pasur për detyrë të agjitojë në mesin e rinisë për t'i inkuadruar në radhët e partizanëve, të mbledhë veshmbathje, të grumbullojë ushqime e medikamente etj. Këshilli me angazhimin e përditshëm ka arritur rezultate. Ai ishte i betuar që të punojë ditë e natë, vetëm e vetëm të luftohet kundër okupatorit fashist gjerman. Qendra e tubimeve (mbledhjeve) ishte në shtëpinë e Shazo Oran Comës në fshatin Shumë. Në këtë qeli merrnin pjesë jo vetëm Këshilli i lartpërmendur, por edhe Vasil Kallajxhiu, Sandre Kuckini, Josif Misa, si dhe faktori i Lëvizjes NÇ, Shazo Oran Coma, i cili direktivat e merrte prej Komitetit Partiak në Strugë. Urdhri me rëndësi ishte dërguar që Aradhat partizane (lexo Brigada e IV Shqiptare) të vendoset në Ladorishtë. Shazo Coma me anën e korierit.... Izet Zyber Tela iu drejtua Këshillit NÇ në Ladorishtë, i cili ia paraqet direktivën e Komitetit Partiak të Strugës, që Njësitë e Brigadës së Katërt Shqiptare të hyn në Ladorishtë. Kundër këtij hapi të nxituar ishte fisi Merko dhe Lena. Mustafa Merko tentoi që t'u bije partizanëve që ishin te Krastë, afër shtëpive të Comollarëve. Fshatarët e Ladorishtës i dolën përpara Mustafa Merkos me shokë dhe e ndaluan të bëjë pushkë me partizanët. Prej atij vendi partizanët ishin rreth 200 metro larg tyre. Meqenëse partizanët dhe Shtabi i Brigadës së Katërt u vendos në Ladorishtë, Këshilli NÇ filloi të mbledhë bukë, groshë, e mish. Mandej blenë edhe një lopë prej Rraim Lenës. Kazani ziente para ndërtesës të ish-xhandarshmërisë jugosllave. Fshatarët me këtë rast u treguan mjaft bujar, duke dhënë bukë e gjëra të tjera. Para se të hynë partizanët në Ladorishtë, qendra e gjermanëve ka qenë në fshatin Fërngovë. Këtë e vërtetoj unë Sali Zylali. Një ditë vjen Rexho Emimi i shoqëruar me disa gjermanë aty te ndërtesa e vjetër e Bashkisë, ndërsa unë (Salua) gjendesha te xhamia e fshatit. Rexho Emimi mu drejtua me këto fjalë: “Shiko mos ketë prej atyre”. Unë, pa humbur kohë vrapova për te shtëpia e axho Seit Zylalit, ku para

shtëpisë qëndronte Esat Doko i shoqëruar me nja 6 partizanë të tjerë. Atyre u lajmërova të largoheshin sa më parë, sepse te xhamia e fshatit kishin ardhur gjermanët. Esat Doko me shoqëruesit menjëherë u largua përpjetë malit. Pas dy-tre ditëve partizanët filluan të luftojnë kundër gjermanëve te vendi i quajtur Fierishta, duke shtjerë drejt Shtabit që mbahej nga forcat gjermane. Në këto luftëra të ashpra vritet një partizan, si duket ishte nga rajoni i Kërçovës, të cilin bashkëluftëtarët e sollën te ndërtesa ku ziente kazani i ushqimit që përgatitej për partizanët. Partizanit të vrarë i kishte dalur syri sa një kokërr arre, të cilin pastaj e morën dhe nuk e dimë se ku e varrosën.

Pasi kalojë kjo luftë, strukturat partizane dhe Shazo Orhan Coma insistuan që patjetër në fshatin Ladorishtë të formohet një “roje-çetë” e fshatarëve, të cilët do të luftonin kundër gjermanëve. Ky plan ka qenë hartuar nga Komiteti i Partisë në Strugë. Këtë direktivë në Këshillin e fshatit e pranuan dhe menjëherë formuam një grup për luftë. Personat që morën pjesë në këtë çetë ishin: Sherif Coma, Arslan Mahmudi, Sherif Malo, Mustafa Merko, Sefer Murtishi, Murat Murtishi, Murteza Lena, Murat Lena, Kalosh Yska, Muharrem Ajro, Dehar Lena, Lutfi Zylali, Dajlan Sh.Merko, Bejadin Klenja e Rexhep Qazo. Këto 15 persona të armatosur e kryen sulmin e armatosur kundër patrullës gjermane në vendin e quajtur “vakçare”, ku u vranë 4-5 gjermanë. Në këtë betejë të pabarabartë me gjermanët, fshatarët ladorishtarë e liruan frontin. Gjermanët të armatosur gjer në dhëmbë, i ndoqën çetën e fshatit gjer te mulliri i Llabunshtarit, i cili gjendej në afërsi të fshatit. Në ato momente u lëshuan në ndihmë çetës edhe anëtarët e Këshillit, por gjermanët u tërhoqën. Kjo ngjarje ka ndodhur më 24 tetor të 1944. Në ndërkohë na erdhi lajmi se gjermanët po vinin nga prapashpina, pra nga mali, nga ana perëndimore, me qëllim që t’i rrethojnë partizanët. Prej kësaj propagande luftëtarët e Brigadës së Katërt u larguan nga fshati Ladorishtë dhe u vendosën në Vishnje. Në këtë mënyrë Ladorishta ngeli e pambrojtur. Më 27

tetor të vitit 1944, nga fshati Fërngovë me altileri të rëndë na ranë dhe gjylja e këputi majën e minares të xhamisë dhe predha (granata) bije në sheshin e fshatit. Kjo predhë edhe sot ndodhet aty. Në momentin e dhënë Këshilli i fshatit ndodhej në shtëpinë e Mustafa Merkos, jo fort larg ku ra gjylja. Ne të gjithë u frikuam. Kryetari i Këshillit propozoi që sonte të mbrohet fshati, duke lënë roje në tri anët e fshatit dhe atë: në lindje, veri dhe në jug. Axhi Allka ishte roje e fshatit në fushë. Ne e porositëm atë që t'i thërras edhe korrierët e tjerë për të mbrojtur fshatin, kurse ai i revoltuar nuk na ndigjojë. Pothuajse në ato momente të gjithë pa përjashtim ishim si pa mend. Sapo dolëm nga zyra, u shpërndamë. Po në këto momente erdhën nga Vishnja tre partizanë, të cilëve po ashtu duke hyrë në fshat, gjermanët ndaj tyre gjuajtën me altileri, por pa ndonjë pasojë serioze. Partizanët e thirrën Seit Zylalin, që ta marrin lëkuren e lopës e ta çojnë në Vishnje, e në këtë mënyrë shpëtoi Kryetari i Këshillit Seit Zylali. Prej këtij momenti nga fshati u larguan shumë fshatarë. Atë natë (natën e 28 tetorit 1944) në fshat kanë ardhur disa Fërgovarë të cilët kanë pasur për detyrë të kontrollojnë fshatin që mos ketë partizanë. Më në fund u bindën se në fshat nuk ka partizanë. Gjermanët ishin të lirë e të sigurtë të rrethojnë fshatin Ladorishtë dhe njëherit t'i zënë vendet strategjike, si Belika, te krasta, te Burimi, afër shtëpive të Comollarëve dhe në qoshe të fshatit, rrugës për në fshatin Vishnje...) ²⁹”

Pra, në shenjë hakmarrje gjermanët natën midis 27-28 tetorit 1944 e rrethojnë fshatin në pikat më strategjike, gjë e cila të jep të kuptosh se në radhët e gjermanëve ka pasur edhe njerëz të cilët shumë mirë e kanë njohur pozitën e fshatit.

Në orët e hershme të mëngjesit, duke gdhirë (aguar) 28 tetori, gjermanët fillojnë si bisha të egërsuara veprën makabre të masakrës, një pjesë e tyre hyn në fshat, kurse pjesa tjetër e ushtrisë gjermane nuk i lejonte fshatarët të largoheshin nga fshati.

²⁹ Kujtimet e Salo Zylalit në dorëshkrim ruhen në Arkivin e autorit.

Banorët e fshatit të tmerruar nga ky skenar, tentuan të largohen nga fshati nga të gjitha anët, por pa sukses, meqenëse që të gjitha shtigjet ishin të bllokuara. Gjatë këtyre tentativave për t'u larguar vriten një pjesë e fshatarëve, kurse pjesa tjetër më e madhe e tyre vriten brenda në fshat, edhe atë: nëpër shtëpi, oborre, kasolla, rrugica etj. Krahës me likuidimin fizik gjermanët kryen edhe djegien e fshatit, me ç'rast pati edhe viktimë të djegura.

Sipas të dhënave të mbledhura në teren, nga ato që e përjetuan këtë masakër gjermanët brenda në fshat vranë 54 persona, kurse të tjerët i detyruan të grumbullohen në mes të fshatit prej ku i dërguan në vendin e quajtur "Vakçare", dhe pas një torturimi shtazarak, nga radha i ndanë pleqtë, gratë e fëmijët, kurse meshkujt në moshën më të mirë, me batore armësh i pushkatojnë. Në këtë ekzekutim grupor ranë 30 burra, kurse një numër i vogël, falë gjeturisë së momentit, si Kurtish Lena, Ramadan Opari, Esheref Hoxha e Skënder Mahmudi, shpëtojnë nga më e keqja³⁰.

Bilanci i këtij maskarai do të jetë i tmerrshëm. Në fshatin Ladorishtë afër Strugës, në agimin (paraditen) e 28 tetorit të 1944 u vranë 84 persona, mbi 40 vetë përjetuan lëndime të tmerrshme fizike, mbi 60 shtëpi dhe mbi 30 kasolla u dogjën nga themelet, ndërsa numri i kafshëve shtëpiake e ushqimin për to tërësisht u shkatërrua.³¹

Pas tërë kësaj masakre, "të privilegjuarit" kishin për detyrë të shohin se çka ndodh nëpër fshatrat përreth, çka flitet për djegien e Ladorishtit (siç do të shprehen krerët e Brigadës shqiptare më 3 nëntor 1944) dhe si reagojnë ata që mbetën gjallë, të cilët edhe sot krimet i kanë të freskëta. Masakra e Ladorishtës, megjithëse kanë kaluar plot 65 vjet akoma flet shqip, ndërsa ne e kemi për detyrë dhe jo borxh që ta ndriçojmë këtë masakër që është rast unikal jo vetëm në këto anë, por edhe më gjerë në vitet e Luftës së Dytë

³⁰ N. Dervishi, "Ladorishti ka gjurmë të lashta...."

³¹ Po aty.

Botërore, është tragjedi që kurrë nuk duhet harruar, por përkundrazi duhet t'i japim vendin e merituar në historinë tonë jo fort të largët.³²

PASQYRË E TERRORIT FASHIST NË MASAKRËN E LADORISHTËS – 28 TETOR 1994

1. Nazim Mehmed Allka.....14.07.1911 –
28 Tetor 1944
2. Bilal Abdi Allka.....14.06.1927 –
28 Tetor 1944
3. Haxhi Tahir Alka.....11.01.1870 –
28 Tetor 1944
4. Mislim Bilall Allka.....16.02.1876 –
28 Tetor 1944
5. Abdi Mislim Alka.....03.09.1905 –
28 Tetor 1944
6. Emin Demisha Ajazi.....17.07.1911–
28 Tetor 1944
7. Selman Mustafa Alizao.....10.05.1915–
28 Tetor 1944
8. Behare Sherif Belica.....10.01.1890 –
28 Tetor 1944
9. Qamile Miftar Dauti.....03.02.1890 –
28 Tetor 1944
10. Ismail Selman Dauti.....20.02.1912 –
28 Tetor 1944

³² Po aty.

-
11. Mefail Selman Dauti30.01.1919 –
28 Tetor 1944
 12. Etem Demir Dauti.....13.03.1911–
28 Tetor 1944
 13. Jashat Maksut Dauti.....10.01.1962 –
28 Tetor 1944
 14. Nuredin Isa Emini13.10.1911 –
28 Tetor 1944
 15. Ismail Isa Emini.....13.09.1907 –
28 Tetor 1944
 16. Qani Etem Etemi17.03.1925–
28 Tetor 1944
 17. Nafi Etem Etemi17.09.1907–
28 Tetor 1944
 18. Dilaver Rexhep Zylali10.05.1908–
28 Tetor 1944
 19. Xhevid Mehmedali Zylali29.12.1921–
28 Tetor 1944
 20. Memedali Halil Zylali10.01.1865–
28 Tetor 1944
 21. Mersim Elez Zylali.....11.01.1914–
28 Tetor 1944
 22. Arif Jashar Zylali15.09.1865–
28 Tetor 1944
 23. Faik Jashar Zylali.....28 Tetor–
1944
 24. Arif Ajdin Islami15.05.1899–
28 Tetor 1944
 25. Bujar Ismail Ismaili20.01.1912–
28 Tetor 1944
 26. Mehmed Shaban Ismaili.....10.07.1918–

- 28 Tetor 1944
27. Miftar Osman Klenja21.01.1917–
28 Tetor 1944
28. Beadin Osman Klenja.....05.06.1926–
28 Tetor 1944
29. Istref Kadri Klenja.....01.02.1862–
28 Tetor 1944
30. Qemal Dalip Klenja.....11.01.1925–
28 Tetor 1944
31. Ariz Ajrulla Klenja20.12.1896–
28 Tetor 1944
32. Tefik Kamber Kolonja.....10.01.1914–
28 Tetor 1944
33. Hajdar Rushan Kolonja.....13.03.1908–
28 Tetor 1944
34. Rexhep Veis Kolonja.....05.05.1905–
28 Tetor 1944
35. Ahmedan Xhemail Karanfili21.06.1929–
28 Tetor 1944
36. Akik Xhemail Karanfili30.03.1914–
28 Tetor 1944
37. Zendel Beqir Kala25.03.1904–
28 Tetor 1944
38. Maksut Pasho Lleshi27.10.1881–
28 Tetor 1944
39. Sadush Demirali Lleshi.....10.02.1915–
28 Tetor 1944
40. Murat Abdulla Lleshi.....30.07.1910–
28 Tetor 1944

-
41. Nazim Beqir Lena10.01.1914–
28 Tetor 1944
 42. Luze Rrahim Lena11.12.1895–
28 Tetor 1944
 43. Rrahim Ali Lena10.09.1869–
28 Tetor 1944
 44. Zenu Rrahim Lena.....15.10.1914–
28 Tetor 1944
 45. Demir Ali Lena..... 20.01.1855–
28 Tetor 1944
 46. Rexhep Bajram Lena.....26.06.1913–
28 Tetor 1944
 47. Dear Elez Lena..... 26.12.1911–
28 Tetor 1944
 48. Pajazit Amit Lena.....13.02.1926–
28 Tetor 1944
 49. Esheref Ferik Lena.....30.05.1941–
28 Tetor 1944
 50. Osman Demisha Murtishi30.12.1896–
28 Tetor 1944
 51. Sefer Arif Murtishi.....18.08.1905–
28 Tetor 1944
 52. Murat Arif Murtishi20.05.1910–
28 Tetor 1944
 53. Faik Rustem Murtishi.....25.01.1897–
28 Tetor 1944
 54. Nazim Rushit Murtishi10.01.1912–
28 Tetor 1944
 55. Elvan Jakup Murtishi..... 15.09.1897–
28 Tetor 1944
 56. Fijat Adem Merko.....30.09.1907–

28 Tetor 1944

57. Shemo Dajlan Merko.....1922– 28–
Tetor 1944
58. Qamil Xhemail Mahmudi30.03.1914–
28 Tetor 1944
59. Sadush Baftjar Mahmudi21.05.1913–
28 Tetor 1944
60. Irfan Ibrahim Mahmudi13.10.1922–
28 Tetor 1944
61. Bexhet Ismail Malo10.01.1878–
28 Tetor 1944
62. Ajdin Arif Hoxha05.05.1876–
28 Tetor 1944
63. Telete Dine Hoxha.....17.02.1929–
28 Tetor 1944
64. Gjuladin Hamid Hoxha13.02.1877–
28 Tetor 1944
65. Nazif Yzeir Rika.....20.03.1896–
28 Tetor 1944
66. Shaziman Yzeir Rika25.11.1906–
28 Tetor 1944
67. Muharrem Murat Sulejmani26.02.1883–
28 Tetor 1944
68. Asip Veli Sulejmani..... 25.03.1908–
28 Tetor 1944
69. Shaban Gani Suljemani13.04.1925–
28 Tetor 1944
70. Nexhip Kurtish Saliu.....10.03.1902–
28 Tetor 1944
71. Ibrahim Kurtish Saliu.....25.01.1898–
28 Tetor 1944

-
72. Isa Kalosh Yska.....26.07.1923–
28 Tetor 1944
 73. Emin Isa Yska.....20.01.1877–
28 Tetor 1944
 74. Amide Jusuf Coma.....10.02.1908–
28 Tetor 1944
 75. Feim Jusuf Coma.....10.02.1908–
28 Tetor 1944
 76. Hamza Rakip Coma.....05.05.1860–
28 Tetor 1944
 77. Abdurrahman Hajrulla Çollaku.....10.10.1882–
28 Tetor 1944
 78. Fatime Demir Çollaku05.10.1880–
28 Tetor 1944
 79. Myriban Tafil Çollaku.....25.06.1860–
28 Tetor 1944
 80. Emin Zeqir Lena (Vrça)1904 nga Struga.....– 28
Tetor 1944
 81. Hasan Abdurrahman Shaipi.....20.12.1908–
28 Tetor 1944
 82. Velçani.....Nga Shqipëria–sejmeni i Asan Beut – 28 Tetor
1944
 83. Qemal Tela Vlashi (Veleshtë).....1920–
28 Tetor 1944
 84. Risto Anastas Belkoski.....1894 –
nga Belica e Epërme–28 Tetor 1944

Dr. Nuri DRAGOJ
(Tiranë)

VËSHTRIM MBI LUFTËN ITALO-GREKE DHE PASOJAT QË RRODHËN PREJ SAJ NË TREVAT JUGORE TË SHQIPËRISË

Në prag të Luftës së Dytë Botërore, thuajse gjithë shtetet e europiane dominoheshin nga tregtia gjermane. Shumë prej tyre qenë zhytur në borxhe nëpërmjet kredive dhe e kishin të vështirë shlyerjen. Në muajin mars 1939, Italia i detyrohej Gjermanisë 350 milionë lira borxh. Por veçanërisht ekspansioni gjerman në Evropën Qendrore e kishte shqetësuar Musolinin dhe e nxiti të veprojë në drejtim të Shqipërisë. Më 18 mars, Bernero, në emër të kabinetit të Romës siguronte Hitlerin se qëllimi i tyre ishte të mbështesnin Gjermaninë.¹

Më 7 prill forcat italiane zbarkuan në bregdetin shqiptar dhe brenda një jave kishin nën kontroll gjithë territorin e vendit. Pas pushtimit të Shqipërisë, synimi i Musolinit ishte Greqia. Pushtimi i saj do të balanconte sadopak sukseset e Hitlerit dhe do t'i shpëtonte Duçes prestigjin e lëkundur. Përgatitjet për këtë filluan menjëherë. Në kuadër të ristrukturimit të administratës, ndër veprimet e para, ishte shkrirja e ushtrisë

¹ Roberto Bataglia, *Lufta e Dytë Botërore*, Tiranë: 8 nëntori, 1991, f. 121-122.

shqiptare dhe organizimi i saj në njësi të vogla, të cilat do të ishin në varësi të ushtrisë italiane. Repartet e mëdha shqiptare u shpërbënë për të shmangur ndonjë rrezik të mundshëm.² Pas kësaj filloi puna për krijimin e disa batalioneve shqiptare, të cilët do të quheshin “Batalione Vullnetarësh Rajonal Shqiptarë”. Ata drejtoheshin nga komandantë shqiptarë me gradën major, të cilët caktoheshin nga Luogotenencia.³ Në çdo batalion ishte dhe një oficer italian, që quhej “këshilltar”.

Me pushtimin e Shqipërisë, Italia ndërmori edhe një aksion të madh ndërtimor në rajonin lindor dhe jugor të vendit. Propaganda e komentonte atë si një hap pozitiv për zhvillimin infrastrukturor dhe bujqësor të Shqipërisë, por nuk ishte e vështirë të kuptohej që ato ishin punime ushtarake, të cilat kryesisht synonin hapjen e rrugëve. Kjo shihej edhe në ndërtimin e disa objekteve sanitare që do të shërbenin për dhënien e ndihmave mjekësore. Pikat sanitare në jug u vendosën në Vlorë, Delvinë, Gjirokastrë, Përmet, Këlcyrë, Çorrovodë, Leskovik, Jorgucat, Sarandë etj. Ndërkohë u ndërtuan me urgjencë dhjetra burgje të shpërndara në gjithë vendin. Për jugun ato u përqëndruan në Porto Palermo, Drashovicë, Berat e Skrapar.⁴

Në janar të vitit 1940 u kërkua thirrja nën armë e të rinjëve shqiptarë të datlindjes 1919. Në muajin prill duhej të ishin mbledhur 5 280 vetë. Ata do të stërviteshin dhe të punonin në rrugë deri në muajin shtator. Pas kësaj duhej të ishin të gatshëm për luftë. General Visconti Prasca, më 28 shtator 1940 vinte në dukje se ministria e luftës kishte miratuar krijimin e batalioneve vullnetare shqiptare. Do të ngriheshin 6 batalione të tilla, me qendër në Sarandë, Delvinë, Gjirokastrë, Përmet, Leskovik dhe

² Piero Croaciani, *Shqiptarët në forcat e armatosura italiane (1939-1943)*, Romë 2001, Tiranë 2005, f. 23.

³ Po aty, f. 188.

⁴ Gj. Titani, *Lufta italo-greke..*, f. 58-59.

Korçë. Në Përmet do të krijohet batalioni IV me 3 kompani që i përkiste divizionit “Ferrara”.⁵

Italia luajti me ndjenjat e shqiptarëve. Duke qenë se ngjarjet e vitit 1914 ruheshin ende të freskëta në kujtesën e banorëve të trevave jugore, propagandohej se ajo, një mike e mirë e Shqipërisë, po përpigjej të korrigjonte padrejtësitë e bëra nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës së vitit 1913. Nën këtë frymë ishin inkadruar në radhët e ushtrisë italiane edhe trupa shqiptare. Ato besonin se Italia do të sillte bashkimin e Kosovës dhe Çamërisë me Shqipërinë. Më 16 shtator 1940 raportohej se trupa e batalionit “Gramozi”, pas një shfaqje kinematografike, kishte kënduar “plotë entuziazëm për Perandorin dhe Duçen, duke i kërkuar në mënyrë të përsëritur Themeluesit të Perandorisë, që të çlironin vëllezërit e Çamërisë dhe Kosovës”.⁶ Më 15 tetor, Jakomoni i raportonte Duçes se në Shqipëri sulmi ndaj Greqisë pritej me ankth. Për gjeneralin Viskonti Prasca, nga radhët e shqiptarëve mund të angazhoheshin çeta me 2 500 - 3 000 veta nën kujdesin e oficerëve italianë.⁷ Ndërsa Jakomoni premonte 7 000 rekrutë të rinj. Këto raportime e bënë më entuziastë Duçen. Çiano dhe Jakomoni e siguruan Musolinin se Greqia do të binte menjëherë.⁸

Me propozim të kryetarit të Këshillit të Ministrave, duke filluar nga mesnata e datës 28 tetor 1940, deklarohet gjendje lufte duke përfshirë çdo efekt tjetër ligjor mbi tokat e prefekturës Tiranë, Korçë, Vlorë, Elbasan, Gjirokastër, Durrës, Berat.⁹ Po ashtu urdhrohej mobilizimi civil i gjithë atyre që i përkisnin administratës shtetërore, bashkiake e komunale.¹⁰ Po atë ditë ishte

⁵ *Po aty*, f. 331

⁶ P. Croaciani, *Shqiptarët në forcat e armatosura italiane ...* f. 60.

⁷ *Po aty*, f. 62.

⁸ R. Bataglia, *Lufta e Dytë Botërore...*, f. 139.

⁹ *Fletore Zyrtare* Nr. 165, datë 28 tetor 1940, f. 1. Dekret Nr. 448, datë 28 tetor 1940. Deklarohet gjendje lufte në disa prefektura.

¹⁰ *Po aty*.

dhënë urdhëri për sulm. Fillimisht në përpjekje me forcat greke kishte rënë një batalion shqiptar, në lindje të Peratit, të cilët kishin luftuar ashpër për gati tri orë.¹¹

Të nesërmen e sulmit mbi Greqi, legata shqiptare e A.Zogut vijonte të qëndronte në Paris i ofroi ministrit grek mbështetjen shqiptare kundër armikut të përbashkët. Të njëjtën gjë bëri dhe legata shqiptare në Ankara, me thirrjen e së cilës u regjistruan shumë vullnetarë për të shkuar në mbështetje të frontit grek kundër Italisë.¹² Dihet se shpejt situata ndryshoi në dëm të italianëve. Divizioni alpin italian në front u habit nga sulmi i papritur grek dhe komanda italiane në Shqipëri i dha urdhër të tërhiqej dhe t'u priste rrugën forcave greke për të mos hyrë në Urën e Peratit.¹³ Më 6 nëntor Çiano detyrohej të pranonte se inisiativa kishte kaluar në favor të grekëve. Ata kishin kundërsulmuar në frontin e Maqedonisë Perëndimore, duke u shkaktuar disfatë trupave italiane. Më 23 nëntor deri në 10 dhjetor, forcat greke u hodhën në ofensive të përgjithshme me objektiv marrjen e Malit të Gjerë, Dhëmbelit dhe Kokojkës së Frashërit. Ndërsa Këlcyra paraqiste çelësin për zgjidhjen e betejës së madhe. E ndodhur midis malesh të lartë, kjo pikë strategjike kontrollonte të gjitha kalimet drejt detit dhe drejt Prevezës.¹⁴ Ajo ishte marrë e lënë disa herë nga palët por në mesin e muajit dhjetor, trupat e komanduara nga gjenerali Ekonomakis u hodhën në ofensivë dhe jo vetëm që mbajtën Këlcyrën, por shkuan deri në Tomorricë.¹⁵ Më 30 janar forcat greke sulmuan nga lartësitë e Dhëmbelit e Golikut dhe të dy palët luftonin ashpër për të mbajtur Urën e Dragotit.¹⁶

¹¹ Gian Carlo Fusco, *Lufta në Shqipëri*, Tiranë: “55”, 2008, f. 27-29.

¹² B. Meta, *Tensionin greko-shqiptar ...*, f. 54.

¹³ Gian Carlo Fusco, *Lufta në Shqipëri ...*, f. 35-36.

¹⁴ *Gazeta Tomorri*, 18 prill 1941, f.1.

¹⁵ Gian Carlo Fusco, *Lufta në Shqipëri ...*, f. 59-60.

¹⁶ Gianni Granzotto, *Vjosa ime e dashur, ditar lufte*, Tiranë: Elena Gjika, 2005, f. 25. “Ansaldo, 1938”, ishte emri i firmës italiane që e kishte ndërtuar.

Shqiptarët në radhët e ushtrisë italiane

Pjesëmarrja e shqiptarëve në radhët e ushtrisë italiane, është parë në këndvështrime të ndryshme. Nga pala greke ata janë konsideruar agresor njëloj si dhe forcat italiane. Në fakt ushtarakët shqiptarë nuk kanë qënë asnjëherë dakord për të sulmuar fqinjin. Ata e kuptuan që një sulm i tillë nuk sillte dobi për Shqipërinë, përveç robërisë. Por situata e vështirë ekonomike bënte të mos shpreheshin hapur. Këtë e konstatuan dhe italianët, ndaj komanda e lartë vendosi të largonte nga shërbimi një numër të madh oficerësh shqiptarë, të vjetër në moshë që nuk jepnin garanci politike, duke u siguruar më parë një rrogë të mjaftueshme, për të shmangur mundësinë e ndonjë pakënaqësie dhe propagande kundër tyre.¹⁷

Fronti i luftës italo-greke përditë jepte lajme në favor të ushtrisë helene, e cila bënte një luftë të drejtë. Një gjë të tillë e dinin mirë dhe shqiptarët, të cilët nuk mund të bëheshin bashkëpunëtorë me italianët në një luftë të padrejtë. Gjatë një takimi me Duçen në Romë, më 7 nëntor, duke argumentuar shkaqet e humbjes, gjeneral Benini bënte përgjegjës batalionet shqiptare që ishin tërhequr nga fronti, ndërsa për forcat italiane jepte garanci që nuk do të tërhiqeshin derisa të vritej dhe ushtari i fundit.¹⁸

Mareshalli Badolio kujtonte optimizmin e madh që ekzistonte te Duçja për fitoren ndaj Greqisë. Ky besim shihej dhe te disa gjeneralë që besonin se trupat greke do të dezertonin në masë. Mirëpo kjo nuk ndodhi. Shqiptarët, që ishin pjesë e ushtrisë fashiste, nga ana tjetër, ndërmorën akte sabotazhi kundër italianëve ose kaluan me grekët. Në rrethana të tilla komanda italiane u detyrua t'i tërhiqte forcat shqiptare dhe t'i çarmatoste. Musolini i shkruante Hitlerit më 20 nëntor 1940 se ndër shkaqet

¹⁷ P. Croaciani, *Shqiptarët në forcat e armatosura italiane ...*, f.34-35.

¹⁸ G. Ciano, *Ditari i Kontit Ciano...*, f. 68.

kryesore të mossuksesit ishte dezertimi thuajse total i forcave shqiptare, të cilat ishin revoltuar kundër njësive italiane.¹⁹

Gjeneral L. Zannini, në një letër që i dërgonte komandës së Korpomatës C, duke bërë fjalë për qëndrimin e batalioneve shqiptare “Dajti” dhe “Gramozi” shkruante se, në periudhën fillestare “qëndrimi i tyre ishte i kënaqshëm, ndërsa me intensifikimin e sulmit armik, u vunë re “braktisje kolektive të frontit të luftës”.²⁰ E njëjta situatë vrehej dhe në batalionet e tjera vullnetare shqiptare. Ndaj general Zannini arrinte në konkluzionin se prezenca e batalioneve shqiptare në “kompanitë divizionale italiane ishte e dëmshme”.²¹ Prania shqiptare mund të ndikonte negativisht para ushtrisë italiane, të krijonte kriza të rënda apo të sillte ndonjë situatë kompromentuese. Në radhët e tyre kishte paqëndrueshmëri, pasi një repart shqiptar, i cili në mëngjes dukej aktiv për luftë kundër trupave greke, në mbrëmje mësohej se kishte kaluar në krahun e armikut me gjithë armatime.²²

Anglezët me anë të radios BBC dhe burimeve të tjera mediatike, i bënë jehonë dezertimit të forcave shqiptare nga fronti, ndërsa qeveria italiane e fshihte atë në publik, duke deklaruar se shqiptarët kishin besim te Italia dhe po qëndronin përkrah forcave të saj.²³ Dy majorë italianë në informacionet e dërguara në datat 12-14 nëntor, raportonin se batalionet shqiptare kishin patur shumë të ikur dhe ankoheshin për mungesa në veshje e çadra. Ndaj jepej porosi të plotësoheshin disa kushte dhe angazhimi i trupave shqiptare në vijën e parë të frontit, të bëhej përherë i shoqëruar dhe nën mbikëqyrjen e trupave italiane.²⁴

¹⁹ Sherif Delvina, *Mid'hat Frashëri figurë madhore e diplomacisë shqiptare*, Tiranë: Fan Noli, 2002, f.137-138.

²⁰ *Po aty*, f. 235.

²¹ *Po aty*.

²² *Po aty*, f. 250.

²³ *Gazeta Tomorri*, Nr. 343, datë 23 shkurt 1941, f.1. Shqiptarët dhe ne.

²⁴ P. Croaciani, *Shqiptarët në forcat e armatosura italiane ...* f. 69.

Duçe pohonte se humbja kishte për shkak bllokimin e mjeteve të motorizuara nga balta dhe dezertimet ndaj kishte urdhruar çarmatosjen e 6000 shqiptarëve.²⁵ Një gjë të tillë e pranonte dhe vetë mareshalli Badiglio, kur shkruante se forcat shqiptare që bënë pjesë në divizionet italiane kishin tradhëtuar, madje një pjesë patën kaluar në anën e grekëve.²⁶

Shumë shpejt shqiptarët e përfshirë në radhët e ushtrisë italiane kuptuan se qëllimi i fashistëve në sulmin ndaj Greqisë nuk ishte realizimi i aspiratave shqiptare për bashkimin kombëtar, por pushtimi i vendit fqinj. Për këtë shkak oficerë dhe ushtarë dezertonin çdo ditë nga fronti, duke i krijuar shqetësime të mëdha komandës italiane. Në ditarin historik të regjimentit të 47 të këmbëorisë, të datës 26 nëntor, duke bërë fjalë për batalionin shqiptar “Dajti”, thuhej se gjithë efektiv i tij “me pajisje dhe armatim kaloi te armiku”.²⁷ Në ditar theksohej se gjatë gjithë ditës dhe natës vazhdonin goditjet e mortajave “Brixia” dhe mitrolozëve “Breda” mbi trupat italiane. Besohej se ishin shqiptarët që i përdornin ato armë, pasi grekët nuk i njihnin dhe s’mund t’i përdornin dot, sidomos mortajat “Brixia”.²⁸

Me marrjen e këtij informacioni, komanda qendrore urdhronte që shqiptarët të tërhiqeshin në prapavijë, pasi do të fillonte riorganizmi i tyre në një batalion tjetër në Shijak. Një numër i madh i të rekrutuarëve u burgos. Çështja u bë problem deri në instancat e larta. Vetë Musolini në telegramin që i dërgonte Hitlerit më 10 nëntor 1940, humbjet e shkaktuara për ushtrinë italiane dhe mos përparimin e saj i shpjegonte me mungesën e mbështetjes shqiptare në fushën politike, mos organizmin e një kryengritjeje në Çamëri dhe qëndrimin e keq të disa reparteve shqiptare. Sipas Musolinit, detyra mbrojtëse e ushtrisë gjatë

²⁵ A. Puto, *Lufta italo-greke...*, f. 78.

²⁶ *Po aty*, f. 79.

²⁷ P. Croaciani, *Shqiptarët në forcat e armatosura italiane ...*, f. 70.

²⁸ *Po aty*, f. 71.

dimrit, në radhë të parë duhet të ishte ajo e rimarrjes së asaj pak toke që shqiptarët patën humbur.²⁹ Në letrën drejtuar Hitlerit thuhej se gjithë trupat shqiptare kishin hedhur armët duke kaluar në masë te armiku, prandaj çarmatimi i ushtarëve shqiptarë ishte i domosdoshëm.³⁰

Hendeku i krijuar mes italianëve dhe shqiptarëve vinte duke u thelluar. Fryma e mosbesimit ndihej kudo. Kishte raste kur nga italianët propozohej për veprime drastike duke ndëshkuar me pushkatim dezertorë të veçantë, por kjo nuk mund të zgjidhte problemin e dezertimeve, kur numëroheshin rreth 3100 raste.³¹ Numri i dezertorëve në muajin janar 1941 arrinte shifrën 3 114, nga të cilët 1 872 këmbësorë, 135 karabinierë, 542 artilierë etj. Të gjithë këta oficerë dhe ushtarë shqiptarë do të dërgoheshin në gjyqin ushtarak territorial të luftës.³²

Duhet theksuar se shqiptarët e dezertuar nga forcat italiane, që shprehën gatishmërinë për të luftuar krahas atyre greke, u pritën me indiferencë dhe u internuan në kampe përqëndrimi duke u trajtuar si robër lufte. Në mbarim të luftës nga kampi i Kretës u liruan 842 ushtarë dhe 45 oficerë shqiptarë.³³

Qendrimi i politikës greke dhe italiane ndaj Shqipërisë

Me fillimin e sulmit ndaj Greqisë, në trevat jugore të Shqipërisë u vendos ligji i luftës. Komanda italiane evidentoi gjithë personat që ishin me bindje antiitaliane, të cilët i internoi

²⁹ Piero Croaciani, *Shqiptarët në forcat e armatosura italiane ...* f.77. Cituar sipas Dokumente të Diplomacisë Italiane, seria e Re, 1939-1943, Vol.V.

³⁰ Sherif Delvina, *Mid'hat Frashëri figurë madhore e diplomacisë shqiptare*, Tiranë: Fan Noli, 2002, f.137-138. Piero Croaciani, *Shqiptarët në forcat e armatosura italiane ...*, f.78.

³¹ Piero Croaciani, *Shqiptarët në forcat e armatosura italiane ...*, f.80.

³² *Po aty*, f. 85.

³³ Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian 1939-1943*, Tiranë: Mësonjtorja, 2005, f. 222.

menjëherë. Më 31 tetor 1941, kuestura e Gjirokastrës informonte këshilltarin e përhershëm të Policisë se ishin evidentuar disa persona që merreshin me politikë dhe kishin alarmuar popullsinë grekofone, duke folur kundër Italisë.³⁴ Gjeneral Agostinucci njoftonte Mëkëmbësinë e Përgjithshme rreth veprimeve të Armatës së Përmetit, e cila kishte proceduar njerëz të dyshimtë në çështje politike. Ata ishin: Kristul Joçka, avokat në Përmet; Aleksandër Lipe, prift ortodoks në Kaludh të Petranit; Androkli Angjeli, këpucar; Vasil Teli Shukollari, tregtar në Përmet; Dhimitër Kola, pronar tokash në Biovizhdë; Sotir Ranca, prift në Biovizhdë.³⁵

Komandës italiane i raportohej çdo bisedë e dyshimtë. Ditët e para të muajit nëntor, në Përmet ishin gjetur fletushka kundër luftës. Kurse kryetari i bashkisë së Përmetit Abas Shukri, gjyqtari Estref Myftiu, drejtori i financës Fuat Frashëri dhe avokati Dhimitër Kacimbra ishin përfshirë në një debat. Ndërsa kryetari i bashkisë konfirmonte që Anglia ishte në prag të rrëzimit, Kacimbra i qe përgjigjur se ajo ishte ende e fortë dhe, me kalimin e kohës do të forcohej më tepër, pasi furnizohej nëpërmjet ajrit nga Amerika, ndërkohë që fabrikat e mjeteve ajrore gjermane po shkatërroheshin çdo dite nga forcat ajrore angleze. Sipas tij, shumë shpejt Gjermania do të detyrohej të kapitullonte.³⁶ Meqënëse Kacimbra vlerësohej si njeri me bindje anglofile dhe

³⁴ AQSH, F. 153, V. 1940, D. 31/4, f.215. Shkresë e Kuesturës Gjirokastrë, Nr. 0671, datë 31.10.1940, dërguar Këshilltarit të Përhershëm të Policisë.

³⁵ AQSH, F. 161, V. 1940, D. 558, f. 7. Shkresë e Gjeneral Divizioni C. Agostinucci, Nr. 834/28, datë 25 tetor 1940, ku njofton Mëkëmbësinë e Përgjithshme (Shërbimin e Informacionit Ushtarak në Shqipëri) mbi kërkesën e Komandës së Regjimentit të 47 të Fanterisë lidhur me procedimin e disa personave nga Armata e Përmetit.

³⁶ AQSH. F. 161, v. 1940, D.670, fl. 1. Comando Superiore Carabinieri Reali dell'Albania. Ufficio Servizio, Nr. 2473/5, Tirana 4 novembre 1940. Propaganda a favore della Grecia. Alla R. Luogotenenza Generale- Uff. Aff. Civili, Tirana; Al Servizio Informazioni Militare, Ufficio Albania, P.M.22 A. Rir. Folio Nr. 2134/Int, del 16.10.1940.

sidomos grekofile, u urdhërua që të internohej menjëherë në Elbasan.³⁷

Nga dokumentacioni i kohës mësojmë se prifti ortodoks Aleksandër File dhe avokati Joçka ishin regjistruar në listën e personave për t'u arrestuar në rast emergjence. Pasi u ndaluan, ata u dorëzuan te S.I.M. ndërsa Simon Dilo, person i rendësisë dytësore, për momentin, nuk u procedua.³⁸ Kiço Baleshi nga Këlcyra u internua në Brindisi. Pas 3 muajësh ai kthehet sërish në vendlindje, por me kusht që të paraqitej rregullisht në zyrën e policisë.³⁹ Kur ky person ishte larguar në drejtim të Burrelit për të punuar në zanatin e vet, komanda e alarmuar porosiste kuesturën e Durrësit për ta detyruar që të vinte në dijeni policinë për çdo lëvizje.⁴⁰

Të dy palët si italianët edhe grekët, bënë arrestime, te njerëzit që dyshonin se ishin venë në shërbim të kundërshtarit. Lista e nëpunësve të arsimit të arrestuar nga italianët me motivacionin: “s’kanë mbajtur sjellje të mirë gjatë okupacionit italian”, ishte relativisht e gjatë. Ishte arrestuar p.sh. Goli Dango, mësues në Kaludh të Përmetit, me argumentin “ishte sjell keq”. Peço Stefani, mësues në Limar të Malëshovës i raportuar prej kryetarit të Komunës Zagori, se kishte qenë spiun i autoriteteve greke etj.⁴¹ Nën arrest ishin vënë edhe Marika Pantazi nga Delvina; Marika Vaso, Nivicë; Gjergji Jani, Delvinë; Koço Mosko, Libohovë; Grigor Muço e Misto Vrana, Piqeras; Spiro

³⁷ AQSH, F. 161, V. 1940, D. 670, f. 1. Shkresë e Komandës Eprore të Karabinierisë Mbretërore të Shqipërisë, Nr. 2473/5, datë 4 nëntor 1940, firmosur nga kolonel G. Riccioni.

³⁸ *Po aty*.

³⁹ AQSH, F. 153, V. 194, D.135/1, fl. 291. Kuestura Gjirokastër më 25 qershor 1941, bënte me dije Komandën Stacionare CC.RR. të Këlcyrës, komandën e kompanisë në Përmet, si dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Tiranë.

⁴⁰ *Po aty*, f. 294.

⁴¹ AQSH, F. 195, V. 1941, D. 84, f. 4. Shkresë e ministrit të Arsimit, Nr.12, 27 dt. 19.5.1941, dërguar Kryeministrit.

Mëhilli, Salari e Tepelenës, të cilët akuzoheshin se kishin qenë në shërbim të politikës greke.⁴²

Veprime të njëjta kryenin edhe forcat ushtarake të Athinës. Sipas ministrit të Arsimit, komanda greke kishte arrestuar dhe internuar 6 mësues, “për të cilët, deri tash s’dihet asgjë”. Ata ishin: Hamid Rami, nga Tatzati, mësues në Kalasë të Delvinës; Sami Seferi nga Malëshova e Këlcyrës, mësues në Leskaj; Pandeli Neçka dhe Filip Tole nga Labova e Poshtme e Tepelenës; Foto Mexi nga Labova e Madhe dhe Andrea Andriku, mësues i gjuhës shqipe në Dhrovjan.⁴³

Ndërkohë autoritetet fashiste kishin filluar ndjekjen dhe internimin i shumë familjeve, që gjykoheshin me bindje antiitaliane dhe sidomos familjeve e oficerëve dhe nënoficerëve që dezertuan nga fronti. Prefektura e Gjirokastrës, në bazë të propozimit të bërë nga nënprefektura Përmet, vinte në dijeni M.P.B. për internimin e disa personave që kishin mbajtur qëndrim antiitalian. Për secilin prej tyre paraqiteshin dhe argumentet përkatëse.⁴⁴ Nisur nga rëndësia që kishte shmangia e personave, që nuk pajtoheshin me politikën italiane dhe rrezikun që paraqeste propaganda e tyre, prefektura kërkonte lejen e ministrisë për të vepruar, por dhe vendin se ku duhej të dërgoheshin personat që nevoitej të internoheshin.⁴⁵

⁴² AQSH, F. 195, V. 1941, D. 84, f. 4. Shkresë e ministrit të Arsimit, Nr. 12, 27 dt. 19.5.1941, dërguar Kryeministrit.

* Sami H. Seferi, lindur më 1901 në Leskaj. Kishte kryer shkollën fillore në turqisht dhe më pas italisht. Kishte kryer kursin në Labovë të Gjirokastrës. Filloi si mësues më 1918 në shkollat Limar e Malëshovë. AQSH. F. 803. D. I-212, f. 63.

⁴³ AQSH, F. 195, V. 1941, D. 84, f. 2. Kjo letër i mbërriti kryeministrit më 19 prill të vitit 1941, ditën e hënë, në orën 10. ⁰⁰ të mëngjesit. Ai thirri menjëherë një prej inspektorëve të tij dhe ishte këshilluar me të, por nuk u mor asnjë masë.

⁴⁴ AQSH, F. 152/2, V. 1940, D. 95, f. 362. Shkresë e prefekturës Gjirokastrë, Nr. 370, dt. 10.10.1940, firmosur nga prefekti Daut Çarçani, drejtuar MPB, mbi internimin e disa personave propozuar nga nënprefektura Përmet me shkresën Nr. 119, dt. 8.10.1940.

⁴⁵ AQSH, F. 152/2, V. 1940, D. 95, f. 362.

Më 21 tetor 1940, MPB i dërgonte Komandës Eprorë të KK MM, listën me emrat e personave që duhej të internoheshin, shoqëruar me motivacionin “propagandist kundër regjimit të sotëm”. Ata ishin: Kristul Joçka, Dhimitër Kacimbra, At Aleksandër Lipe, Simo Dilo, banues që të gjithë në Përmet.⁴⁶ Mirëpo, prefektura Gjirokastrë, me anë të një tjetër shkrese jepte mendimin se nuk kishin bindje të plotë që Dhimitër Kacimbra dhe Simo Dilo të merreshin me propaganda të tilla.⁴⁷ Ndërsa Komanda Superiore e Karabinierisë më 4 nëntor 1941 bënte me dije se komanda e Ballabanit kishte arrestuar barinjtë Baftjar Çapokaj 15 vjeç, Hydai Toçiaj 15 vjeç, Nevruz Lazaj 15 vjeç, Haxhi Çapokaj 37 vjeç, të cilët cilësoheshin përgjegjës për mbajtje të armëve e municioneve që konsideroheshin plaçkë lufte.⁴⁸

Qeveria greke kishte marrë të gjitha masat për t’u informuar hollësisht mbi zhvillimet në Shqipëri dhe për krijimin e një fryme antiitaliane në Jug. Prefektura e Gjirokastrës, qysh në muajin shkurt 1940, pra para fillimit të Luftës Italo-Greke, njoftonte M. P. Brendshme se ishte konstatuar që konsulli grek zhvillonte propagandë të gjerë në disfavor të “shtetit shqiptar” dhe bënte ndërhyrje të vazhdueshme në çështje që ishin jashtë kopetencave të tij. Ai mbante lidhje me popullsinë grekophone të asaj province me anë të sekretarit të vet. Duke aktivizuar gjithë grekomanët dhe duke financuar shuma të mëdha, ai kishte mundur të siguronte ndikim të madh në gjithë trevën. Sipas prefekturës, mund të thuhej pa ekzagjerim se çdo çështje e atyre katundeve dirigjohej prej konsullit, i cili pati mbledhur dhe pleqësinë e atyre

⁴⁶ *Po aty*, f. 363. Shkresë e M.P.B. Nr. 2602, datë. 21.10.1940, me firmën e ministrit, drejtuar Komandës Eprorë të KK MM, shoqëruar me shkresën Nr. 119, datë 8.10.1940, XVIII, të nënprefekturës Përmet, përcjellë nga prefektura Gjirokastrë.

⁴⁷ *Po aty*, f. 363.

⁴⁸ AQSH, F. 153, V. 1941, D. 33/1, f. 197. Shkresë e Komandës Superiore të Karabinierisë, Zyra e Shërbimit dhe Gjendjes, Nr. 1/316, datë 12.11.1941, dërguar Ministrisë së Brendshme.

katundeve dhe i kish këshilluar që t'i drejtoheshin telegrafisht Mëkëmbësit të Përgjithshëm për çështjen e shkollave të minoritetit.⁴⁹ Ndërhyrja e tij favorizohej prej personave që ende jetonin me iluzionin e grekomanisë. Prefektura kërkonte të dinte se çfarë masash duheshin marrë kundër disa krerëve të parisë, që guxonin të shoqëronin konsullin nëpër fshatra për të bërë propagandë antishqiptare.⁵⁰

Zyra Politike e M. P. Brendshme i dërgonte Mëkëmbësisë së Përgjithshme një kopje të raportit Nr. 43, të prefekturës së Gjirokastrës, që bënte fjalë për aktivitetin propagandistik të zhvilluar prej konsullit grek. Ata luteshin t'u dërgohej sa më parë udhëzimi për mënyrën e veprimit.⁵¹ Pas kësaj do të arrestoheshin disa persona që ushtronin propagandë antishqiptare, por kjo do të haste në reagimin e konsullit të Athinës. Ai ishte ankuar në prefekturë për arrestimin e pesë personave që kishin qenë në konsullatë. Zemërimi i tij "vihej re në çdo rast kur i zbuloheshin agjentët dhe informatorët" Madje konsulli donte të dinte, nëse ishte venë nën vëzhgim edhe ai vetë.⁵²

Diversionin propagandistik të politikës greke ndaj Shqipërisë në prag të Luftës Italo-Greke e kishte mbështetur edhe Anglia. Më 18 shtator 1940, P. Dikson shkruante se Forin Ofisi e aprovonte mendimin, që të përparonte puna me planet subversive greke në Shqipëri. Por, në të njëjtën kohë, Forin Ofisi paralajmëronte që të bëhej kujdes në hapat që hidheshin. Nuk duhej t'u jepej shkas italianëve që të pretendonin se ishin grekët

⁴⁹ AQSH, F. 152, V. 1940, D. 201, f. 2. Shkresë e prefekturës Gjirokastrë, Nr. 43 datë. 8.2.1940, dërguar M.P.Brendshme, Zyrës Politike dhe të Personelit, mbi propagandën antishqiptare të konsullit grek.

⁵⁰ Po aty, f. 3. Shkresa mban firmën e Prefektit Daut Çarçani.

⁵¹ AQSH, F. 152, V. 1940, D. 201, f. 1. Shkresë e Zyrës Politike të M.P.Brendshme, Nr. 476, datë 16.2.1940, dërguar Mëkëmbësisë së Përgjithshme të Madhërisë së tij, Mbretit Imperator në Shqipëri.

⁵² AQSH, F. 152, V. 1940, D. 201, f. 5 Shkresë e prefektit të Gjirokastrës Daut Çarçani, Nr. 43/1, datë 19 shkurt 1940, dërguar M.P. Brendshme.

ata që po kryenin veprimtari kundër Shqipërisë, pasi në këtë mënyrë do të gjenin pretekst për të sulmuar Greqinë.⁵³

Në këtë situatë nuk munguan edhe përpjekjet e Ahmet Zogut për të marrë rol në krahin antifashist. Ai kishte ofruar për të prurë në frontin antiitalian rreth 30 mijë forca, që besonte se do t'i siguronte në sajë të mbështetjes së madhe që kishte në veri të vendit. Duke u rënë italianëve pas vijës së frontit, Zogu mendonte se mund t'i detyronte ata që ta lëshonin vijën mbrojtëse. Një propozim i tillë u pëlqeu dhe anglezëve, por ai u refuzua nga politika greke. Athina kundështoi edhe organizimin e një revolte të armatosur antiitaliane në prefekturën e Gjirokastrës, e cila kishte si kusht njohjen e pavarësisë së Shqipërisë⁵⁴.

Endrju Rajën, një oficer ndërlidhës midis mbretit shqiptar dhe Foreign Office, e shihte konstruktiv propozimin e Zogut. Prandaj, Foreign Office udhëzonte këshilltarin britanik në Athinë, Majkëll Pelëre t'i kërkonte qeverisë greke të binte dakord me ofertën e mbretit shqiptar, duke theksuar se Athina nuk kishte asnjë detyrim të merrej me ardhjen e tij në fron, pas ribërjes edhe një herë të Shqipërisë së pavaruar. Por përsëri Athina nuk pranoi. Madje qeveria greke edhe ata shqiptarë që ishin rreshtuar me trupat greke kundër koalicionit fashist, i dërgoi në thellësi të Greqisë, duke vënë në dyshim fatin e tyre.

Me marrjen e Korçës, Metaksa deklaroi se grekët luftonin edhe për “çlirimin e Shqipërisë”, por këtë nuk e bënë për pavarësinë e Shqipërisë. Metaksa theksonte se Greqia luftonte jo vetëm për ekzistencën e saj, por edhe për popuj të tjerë të Ballkanit sidomos për çlirimin e Shqipërisë, por jo për pavarësi të saj.⁵⁵ Duke përmendur deklaratën e Metaksasë lidhur me

⁵³ *AIH*, A-V-122. Marrëdhëniet greko-shqiptare dhe qëndrimi i Greqisë karshi Shqipërisë, f. 3. Publikim i vitit 1940, material i përkthyer nga Shpëtim Mema.

⁵⁴ B. Meta, *Tensionin greko-shqiptar...*, f. 58-59.

⁵⁵ *AIH*, A-V-122. Marrëdhëniet greko-shqiptare dhe qëndrimi i Greqisë karshi Shqipërisë, viti 1940, Materiali i përkthyer nga Shpëtim Mema, f. 20.

pavarësinë e Shqipërisë kërkonte një përsëritje e saj, në mënyrë që të ndikonte pozitivisht në veprimtarinë e politikës greke me njerëzit e rekrutuar në Shqipëri. Përfaqësuesi i Forin Office, nënvizonte se, fjala “çlirim” në gjuhën greke ishte një fjalë krejtësisht e ndryshme nga fjala “pavarësi”. Metaksa ka dashur të thotë që Greqia luftonte për çlirimin e Shqipërisë nga sundimi italian dhe në asnjë mënyrë nuk do të implikohej në çështjen për restaurimin e një Shqipërie të pavaruar.⁵⁶

Pas zotërimit të trevave jugore, Përmet, Korçë, Kolonjë dhe Gjirokastrë, komanda greke vendosi ligjin e luftës dhe bëri disa arrestime në radhët e patriotëve, të cilët u internuan në ishujt e largët të Greqisë.⁵⁷ Më 8 dhjetor trupat helene hynë në Gjirokastrë dhe Përmet, bashkitë e të cilave do të merreshin nën drejtimin e njerëzve që ishin në shërbim të Athinës.⁵⁸

Qeveria greke mori të gjitha masat për administrimin e trevave jugore, e bindur se ato do t'i jepeshin Greqisë prej Fuqive të Mëdha. Metaksa përfitoi nga kërkesa gjermane për largimin e anglezëve nga Greqia dhe të pushimit të luftës me Italinë, duke u kërkuar atyre më 20 dhjetor 1940, që t'i lejonin të mbanin të pushtuar jugun e Shqipërisë, deri në Vlorë, të cilën nuk kishin mundur ta merrnin ende.⁵⁹ Komanda greke dha urdhër të arrestoheshin gjithë elementi patriot shqiptarë, myslimanë dhe ortodoksë. Në janar të vitit 1941, në Korçë u arrestuan 21 vetë për shkak të ndjenjave të tyre atdhetare.⁶⁰

Natyrisht, politika greke për aneksimin e Shqipërisë kishte mbështetjen e britanikëve. Shefi i departamentit të Forin Office për Jugun, P. Nichols, pohonte se nuk ishte për të mbështetur

⁵⁶ Po aty.

⁵⁷ Përmeti gjatë Luftës Nacional Çlirimtare..., f. 97.

⁵⁸ A. Puto, *Lufta italo-greke...*, f. 95-97.

⁵⁹ B. Meta, *Tensionin greko-shqiptar...*, f. 52-53.

⁶⁰ S. Boçi, *Minoritetet në Shqipëri...*, f. 93.

nacionalistët shqiptar kundër italianëve. Sipas tij, ishte e mundur që dhe në të ardhmen të mos bëhej asnjëherë një gjë e tillë.⁶¹

Dëmet nga lufta dhe riparimi i shtëpive të dëmtuara

Aviacioni i të dy ushtrive bombardonte pa pushim tokën shqiptare. Fshatarët të tmerruar nga bombardimet, humbja e shtëpisë dhe pasurisë, merrnin rrugët. Iknin drejt rretheve që nuk ishin përfshirë në luftë. Komandat e të dy ushtrive ndërluftuese i këshollonin të zbraznin vendin. Shumë shtëpi ziheshin nga oficerë italianë apo grekë. Një pjesë ktheheshin në spitale. Pati dhe nga ata që u larguan nga frika e masakrave, duke kujtuar ato që kishin ndodhur në vitin 1914. Ikjet filluan në muajin dhjetor, por në janar e shkurt ato ishin masive. Në Berat dhe fshatra të tij u strehua një numër i madh refugjatësh. Të tjerë do të shkonin në Mallakastër, Fier, Vlorë e gjetkë.⁶²

Bagëtitë thereshin për ushqim, pasi kishte periudha kur vononin furnizimet. Nuk kurseheshin as qetë e punës. Ata që qëndruan në shtëpitë e tyre dhe mundën t'u mbijetonin predhave dhe plumbave, ruajtën një pjesë të pasurisë. Të tjerët e humbën atë pak pasuri që kishin. Luigi Gianturco, duke përshkruar luftimet e 20 janarit 1941, në fshatin Bubës, tregon se goditjet me mortaja i kishin tmerruar barinjtë, të cilët iknin dhe i linin tufat e deleve vetëm. Të gjitha ato u therën dhe u konsumuan nga ushtria, e cila kishte patur probleme në furnizimin me ushqime nga prapavija.⁶³ Banorët që braktisën fshatin, kur u kthyen nuk gjetën asgjë në shtëpi. Zairet e dimrit ishin konsumuar nga ushtria. Bagëtitë ishin therur në intervalet kohore kur ushtrisë i vonohej furnizimi. Gjithë shtresat ishin grabitur ose djegur dhe pemet frutore ishin prerë për dru zjarri për shkak të dimrit të madh.⁶⁴

⁶¹ B. Meta, *Tensionin greko-shqiptar...*, f. 61.

⁶² A. Sulo, *Dy net që ngrinë Romën...*, f. 95-98.

⁶³ L. E. Gianturco, *Pietro del muro...*, f. 72-75.

⁶⁴ A. Sulo, *Dy net që ngrinë Romën...*, f. 95-98.

Në korrik doli një dekret mbretëror, sipas të cilit, refugjatëve që kishin lënë banimet e tyre për shkak të urdhërave të autoriteteve ushtarake dhe nuk mund të mbanin veten e familjen për shkak të papunësisë, u akordohej ndihmë nga shteti. Familjet e kategorisë së parë me 1 pjestar përfitonin 3 franga shqiptare, me 2 persona 4 franga dhe për çdo person më tepër shtohet një frangë. Familjet e kategorisë së dytë me një pjesëtar merrnin 2 franga dhe kështu me radhë, duke patur një frangë më pak se kategoria e parë. Kur numri kalonte 8-10 persona, jepeshin 10 franga. Dekreti këshillonte të shihej mundësia edhe për ndihma të tjera.⁶⁵

Numri i saktë i refugjatëve nuk dihej. Në janar të vitit 1942, pranë Këshillit të Ministrave ishte krijuar një komision, i cili u quajt Komiteti Qëndror për Refugjatët.⁶⁶ Komunitat duhej të dërgonin pranë tij informacione të hollësishme për refugjatët, të cilat kalonin nëpërmjet prefekturës. Për çdo të shpërngulur lëshohej një certifikatë, në të cilën nuk vihej numër, por bëhej shënimi “extra”. Kryesisht të ikurit ishin përqëndruar në prefekturat Tiranë, Berat, Vlorë, Elbasan, Durrës, Shkodër, gjë që shihet edhe në korrespondencën që Komiteti Qëndror i Refugjatëve kishte me ato prefektura. Në certifikatat e lëshura nga prefektura e Beratit mësohet se refugjatët vinin nga fshatrat e Përmetit, Leskovikut, Këlcyrës dhe Kolonjës.⁶⁷

Dëmet e shkaktuara nga lufta italo-greke në trevat jugore qenë të mëdha. Popullsia e pafajshme përballoi bombardimet e aviacionit dhe goditjet e artilerisë së dy ushtrive ndërluftuese. Gjatë asaj periudhe u vranë 127 njerëz të pafajshëm dhe u shkaktuan dëme të mëdha materiale, si djegie të shtëpive,

⁶⁵ *Fletore Zyrtare*, Nr. 98, datë 5 korrik 1941, f. 3. Dekret i Mëkëmbësit Mbretëror Nr. 218, datë 1 shkurt 1941. Caktimi i ndihmës për refugjatët.

⁶⁶ *Fletore Zyrtare*, Nr. 11, datë 3 shkurt 1942, f. 1-2. Dekret i Mëkëmbësit Nr. 2, datë 22 janar 1942. Formimi i Komisionit Qendror për vërtetimin e pagimin e dëmeve të luftës.

⁶⁷ A. Sulo, *Dy net që ngrinë Romën...*, f. 100-101. Certifikata të lëshura nga prefektura e Beratit për refugjatët.

shkatërrime të rrugëve, dëmtim të të mbjellave për më shumë se 1400 familje.⁶⁸ Fshatarësia u detyrua të braktiste banesat dhe të merrte rrugët, duke i rezistuar jetesës nën qiell të hapur, pa asnjë mbështetje ekonomike. Shumë prej tyre gjetën strehë në shpellat e Nemërçkës, Dhëmbelit dhe Trebeshinës.

Ministria e Punëve të Brendshme i kërkonte mendim kryeministrit si të vepronte me kërkesat për dëmshpërblim lidhur me dëmet e shkaktuara nga operacionet ushtarake apo trupat civile, pasi vlera financiare ishte e madhe. Nëse ata duhej të shpërbleheshin, shihej e nevojshme të planifikohej një shumë e caktuar nga buxheti. Në të kundërt, duhej të refuzoheshin, duke vënë si shkak mungesën e fondeve. Gjithsesi ministria mendonte që të bëhej likujdimi i pjesshëm i tyre.⁶⁹

Kabineti i Musolinit, për të krijuar përshtypjen se kujdesej për popullin, i dha porosi qeverisë shqiptare në varësi të saj, për të pranuar dëmet e shkaktuara nga lufta, e cila në shkresa cilësohej “dëme nga ushtria armike”. Zyrat përkatëse, për dëmtimet e shkaktuara në banesa dhe prona gjatë luftës, bënë përgjegjëse vetëm ushtrinë greke dhe aviacionin e saj. Ligji parashikonte dhënien e shpërblimeve për dëmet e shkaktuara nga lufta në toka, sende të luajtshme dhe të paluajtshme.⁷⁰

⁶⁸ AQSH, F. 193, V. 1942-1943, D. 179, f. 213- 412. Komiteti Qendror për dëmet e shkaktuara nga lufta italo-greke. Të dhëna për nënprefekturën e Përmetit. AQSH F. 193 V. 1942-1943 D. 180, f. 3 -125; D. 181, f. 3 -15; D. 183, f. 2 -76; D. 184, f. 3 -70; D. 185, f. 1 -22; D. 186, f. 1 -74; D. 187, f. 1 -87; D. 188, f. 1 -7; D. 189, f. 3 -320; D. 190, f. 2 -142; D. 191, f. 3 -95; D. 192, f. 3 -255; D. 193, f. 3 -158; D. 194, f. 2 -15; D. 195, f. 2 -445; D. 196, f. 3 -176; D. 197, f. 1 -10; D. 198, f. 1 -154; D. 199, f. 1 -116; D. 199, f. 2 -260 dhe F. 177, V. 1941, D. 43, f. 249; D. 73, f. 245-290.

⁶⁹ AQSH, F. 149, V. 1943, D. III-839, f. 73. Shkresë e MPB (Drejtoria e korrespondencës) Nr. 33523/II, datë 13 korrik 1943-XXI. Mbi dëmet e shkaktuara nga ushtria dhe vullnetarët. Dërguar P.T.Kryesisë së Këshilit të Ministriave, Zyrës Ushtarake. Firmoset nga ministri dhe majori Isa Kokalari, ndihmës i kryetarit të zyrës ushtarake.

⁷⁰ *Fletore Zyrtare*, Nr. 147, datë 2 tetor 1941, f. 1-4. Shpërblime për dëme lufte,

Çdo person që pretendonte se ishte dëmtuar nga lufta duhej të paraqeste një kërkesë, në të cilën shkruhej adresa e saktë, lloji i dëmit dhe vlera financiare. Mund të bëhej fjalë për dëmtim të bagëtive, shtëpivë të banimit, kasolleve, prodhimeve, pemëve frutore dhe tokës bujqësore. Lutja dorëzohej në komunë, e cila duhej të provonte në praktikë vërtetësinë e dëmeve që listoheshin në bazë të dokumenteve që dispononte. Njëkohësisht ajo verifikohet edhe nga zyra italiane, e cila favorizonte qytetarët shqiptarë pa precedentë penal e politikë.⁷¹

Riparimi i dëmeve nga lufta ishte problem dite. Njerëzit që u ishin dëmtuar banesat nuk kishin ku të fusnin kokën. Numri i ndërtesave të dëmtuara ishte i madh. Por qeveria kishte vendosur që të ndihmonte vetëm familjet me gjendje të keqe ekonomike dhe që nuk kishin anëtarë në moshë pune. Vështirësi në procesin e meremetimit të tyre shtoheshin edhe për faktin se qeveria donte të shpenzonte sa më pak. Këshilltari i Ministrisë së Punëve Botore, L. Gambarini, në muajin dhjetor 1941, i shkruante Federalit Fashist në Gjirokastrë, se në Këlcyrë, muratorët dhe zdruthkëtarët vendës po bënin kërkesa të papranueshme, pasi për një ditë pune në riparimin e shtëpive të dëmtuara nga lufta kërkonin 15 fra. shq.⁷²

Për përballimin e situatës dhe dhënien e ndihmave elementare u ngritën dhe shoqëri mirëbërëse, të cilat bënin përpjekje për të grumbulluar fonde dhe ndihmuar familjet që ishin më keq ekonomikisht. Shoqëria Mirëbërëse e Prefekturës

Ligji Nr. 272, datë 10 shtator 1941.

⁷¹ AQSH, F. 193, V. 1942/1943, D. 169, f. 96-99. Komisioni Qendror për Kompensimin e Dëmeve të Luftës, Nr.1565 D/G. Gjirokastrë, 19 Shtator 1942, për dëmet e shkaktuara nga lufta ndaj qytetarit Aleks Koçi Meçi. Shkresat gjenden me firmën e Kapiten komandant Angelo di Petrillo, N/Kolonel Komandant Francesco Murgia, F. to C. Fusco.

⁷² AQSH, F. 177, V. 1941, D. 73, f. 245. Shkresë e Këshilltarit të MPBotore, L. Gambarini, datë 3.12.1941, dërguar Federalit Fashist në Gjirokastrë. Një shifër e tillë zyrtarëve u dukej e lartë.

Gjirokastrë, në një dokument që mbante datën 24.8.1944, njoftonte se kishte mbledhur 112.083 fra.shq. Në të thuhej se “deri tani kemi shpërndarë 9715 fr.shq. dhe janë blerë 163 kv miell gruri me vlerë 72.903 fra.shq.”⁷³

Ndihma jepeshin herë pas here. Pati familje që do të merrnin ndihma më shumë se një herë, ashtu siç kishte të tjera që nuk morën fare. Në një dokument pohoj që merrnin ndihmë për herë të parë 15 persona në shumën 2600 fra.shq.⁷⁴ Po atë ditë do të ndihmoheshin dhe 20 familje të tjera përmetare nga 140 deri në 220 franga shqiptare secila.⁷⁵

Qeveria kërkonte që lutjet e paraqitura të verifikoheshin nga shoqëritë mirëbërëse dhe të raportoheshin kujt i qe dhënë ndihmë prej tyre. Ishte menduar, që, për të lehtësuar qeverinë, ndihmat të shpërndaheshin prej këtyre shoqërive.⁷⁶ Më 10 qershor 1944, nga Përmeti kishin marrë ndihmë 84 familje me 470 frymë, në shumën 15.120 fra.shq. Dy ditë më pas morën ndihmë dhe 56 familje të tjera përmetare, me 330 frymë ose 10.640 fra.shq.⁷⁷

Çështja ishte se nuk kishte evidencë të qartë rreth numrit të refugjatëve dhe vendosjes së tyre. Ata që ishin shpërndarë në fshatra të ndryshme të vendit apo ishin strehuar pranë miqve dhe të afërmëve në qytete nuk ishin evidentuar. Në plan të parë dilnin familjet që ishin rrugëve dhe të tjerë që do të guxonin të trokisnin në dyert e institucioneve shtetërore.

⁷³ AQSH F. 189, V.1944, D. 10, f. 80. Shkresë e Shoqërisë Mirëbërëse të Prefekturës së Gjirokastrës, datë 24.8.1944, dërguar Komisionit Qendror për Kompensimin e Dëmeve të Luftës, Tiranë.

⁷⁴ AQSH, F. 189, Pa vit, D. 15, f. 304.

⁷⁵ *Po aty*, f. 315.

⁷⁶ *Po aty*, f. 117.

⁷⁷ *Po aty*, f. 271-275.

**Akademik Beqir META - Drejtor i Institutit të Historisë,
Tiranë**

**FJALA E MBYLLJES SË PUNIMEVE TË KONFERENCËS
SHKENCORE “SHQIPTARËT GJATË LUFTËS SË DYTË
BOTËRORË”**

**Të nderuar studiues,
Të nderuar familjarë, miq, kolegë e studentë,**

Më lejoni të shpreh mendimin tim duke thënë që kemi zhvilluar një konferencë shumë të mirë. Ka pasur kumtesa shumë interesante, dhe dua ta përgëzoj drejtorin e ri të Institutit të Historisë së Prishtinës bashkë me kolegët e tij që kanë bërë një punë shumë të madhe për ta përgatitur konferencën, sepse e dimë të gjithë se përgatitja e një eventi të tillë është një punë delikate dhe e vështirë.

Dua të theksoj, se përsa i përket konferencave, ne duhet të jemi shumë korrekt. Ndonjëherë të shtyn presioni dhe nevoja për të organizuar një aktivitet, për shkak të përkujtimit të ndonjë përvjetori, lëshohet pe në kurriz të cilësisë. Kjo nuk

duhet të ndodhë. Të ftuarit në konferencë duhet të kenë një standard të përcaktuar. Në këtë konferencë, pati dhe disa studiues të ri e doktorantë që përgatitin ndërkohë doktoraturat. Në referimet e tyre kishte elementë pozitivë por duhet synuar më tepër. Me këtë nënkuptoj që udhëheqësit e këtyre doktorantëve të jenë shumë të kujdesshëm në momentet e paraqitjes së kumtesës. Pra, kumtesat duhet të jenë të kontrolluara me qëllimin e mirë, që studiuesit e rinj të arrijnë sukses, sepse kanë nevojë shumë që në hapat e parë të bëjnë kumtesa të thella dhe jo thjesht kumtesa me regjistrim faktesh etj.

Nga ana tjetër, dua të theksoj, se që të përgatitësh një kumtesë, normalisht duhet të kesh bërë një hulumtim të ri, ose të kesh zbuluar një ose disa dokumente të reja të rëndësishme, që çojnë në një konkluzion të ri, ose kumtesa duhet të jetë pjesë e një studimi të thelluar siç janë monografite, artikujt kërkimorë të papublikuar. Në rast se shkelen këto kritere dhe humbet risia, që është elementi thelbësor i potencës dhe kërkimit shkencor, sigurisht kumtesa bëhet monotone, është një përsëritje e vetvetes apo e pikëpamjeve të të tjerëve dhe, sigurisht, që nuk i shërben konferencës. Unë do të thoja se kjo konferencë pati avantazhin se shumica dërmuese e pjesëmarrësve solli gjëra të reja, prandaj është e vlefshme dhe e suksesshme. Për sa i përket studiuesve të rinj, do të thoja që ata mund të mbajnë referate vetëm në rast kur kanë ecur përpara me studimet e tyre doktrale dhe kur udhëheqësit e tyre e kanë licencuar aftësinë e tyre për të mbajtur një kumtesë mbi bazën e arritjeve në kërkimin shkencor. Por, edhe për kolegët tanë që janë shumë profesionistë dhe me shumë eksperiencë, sigurisht që do të duhej të mos mbeteshin te po i njëjti nivel i konstatimeve dhe i realizimeve të tyre të mëparshme. Duhet patjetër diçka e re mbi atë çka kanë

analizuar deri në momentin e mbajtjes së kumtesës. Nëse do ta bëjmë këtë një kërkesë ndaj vetes, dhe komisionet organizative t'i kërkojnë këto kritere në mënyrë rigorozë, konferencat do të jenë padyshim të suksesshme.

Desha të them tani, pasi i dëgjova të gjitha kumtesat, se konstatoj me kënaqësi se ne si historianë do të bëjmë historinë e historisë, apo historinë e historiografisë. Në qoftë se do të shikonim vetveten tonë përpara një dekade apo dy dekadash, ne aktualisht jemi jo vetëm shumë më të thellë shkencërisht, më të thelluar në kërkimin tonë dhe në argumentet tona, por po fillojmë të puqemi dhe më shumë në çështje dhe teza ku kishte pak konvergjencë. Kjo është e logjikshme sepse serioziteti dhe thellimi i kërkimit shkencor, shtimi i argumenteve dhe heqja e dozave politike nga çdo lloj krahu, sigurisht që do të çojnë te kjo konvergjencë. Natyrisht që nuk do të ketë konvergjencë absolute, do të ketë çështje të diskutueshme, por nuk do të ketë kaq çështje divergjente siç kemi pasur në historiografinë dy dekada më parë. Nga ky këndvështrim, si edhe për faktin që po vërehet largimi i historianëve nga përplasjet për arsye jo parimore, konferencën e konsideroj një arritje të suksesshme.

Midis historianëve ka një shumicë që bëjnë një punë shumë të madhe, të vlefshme e të lodhshme, ndonëse ende jo dhe shumë e vlerësuar. Kështu që, ne duhet të jemi të kujdesshëm, kur e dimë se ka edhe të tjerë që përpiqen t'i bien më anash gjërave, e sigurisht me dashamirësi, me kujdes e korrektësi mund të mbahen qëndrime kritike në këto raste me qëllim që të shmangen prodhimet jo të mirëfillta kërkimore. Gjithsesi, kur ne analizojmë historiografinë, ne analizojmë punën e historianëve profesionistë. Ata janë pjesa kontributore reale në historiografi. Kjo pjesë që kontribuon në zhvillimin e historiografisë, duhet të jetë solidare, për të ruajtur standarde të larta në studimet dhe

botimet që mbajnë vulën e historiografisë shqiptare.

Desha të përgëzoj me këtë rast, drejtorin e ri të Arkivave të Shqipërisë, i cili me të vërtetë dëshmoi një vizion, me angazhim e tij për të lehtësuar punën hulumtuese të historianëve. Jo gjithnjë, arkivi është trajtuar si kontributor për shoqërinë dhe shkencën, çka ka vështirësuar punën e historianëve dhe studiuesve për shfrytëzimin e dokumenteve.

Kështu qasja e drejtorit të Arkivit, me studiuesit për zhvillimin e studimit dhe hulumtimit i bën mirë shkencës, por edhe reputacionit të arkivave, në fund të fundit i bën mirë shoqërisë. Lehtësitë e punës në arkiva do të ndihmojnë në nxjerrjen e fakteve të reja dhe produkti i historianëve do të shëmojë me shp[ejt arritje të reja. Duhet të ecim gradualisht edhe në fushën e arkivave në një hap me botën e qytetëruar. Sigurisht që arkivat evropiane, të cilat ne i njohim mirë, kanë një standard të jashtëzakonshëm, por me vullnet e dëshirën e mirë atyre mund t'u ofrohen dhe Arkivi Qendror i Shqipërisë dhe arkiva të tjera të institucione tona.

Në mbyllje, më lejoni t'ju rekomandoj, që këto referate të përgatiten nga autorët për botim deri në muajin dhjetor. Të më lejojnë të rinjtë t'u tërheq vëmendjen që referencat të paraqiten të plota dhe korrekte, sepse referenca është pasaporta e punës shkencore dhe e seriozitetit shkencor.

Duke përfunduar ju falënderoj për kontributin dhe për vëmendjen e studiuesve dhe dëgjuesve që kanë qenë këtu. Shpresoj të kemi aktivitete të tjera të përbashkëta edhe më të mira, me qëllim të shtojmë gjithherë hapa të vogla në zhvillimin e shkencës dhe në sqarimin e çështjeve të ndryshme të historisë sonë kombëtare.

Ju faleminderit!

